



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 6, 7 DHE 11 SHKURT 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 6., 7. I 11. FEBRUARA 2014. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2014**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Debat parlamentar lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore,
8. Shqyrtimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”,
9. Emërimi i një (1) anëtari në Bordin e RTK-së,
10. Zgjedhja e Organit të Pavarur Përzgjedhës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
11. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
12. Propozimi i Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Parlamentarna debata u vezi sa razvojem na Prištinskom univerzitetu “Hasan Prishtina”,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o Posebnom veću Vrhovnog suda Kosova za pitanja u vezi sa Kosovskom agencijom za privatizaciju,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o stvaranju nacionalne infrastrukture prostorne informacije u Republici Kosova,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o prodaji stanova za koje postoji stanarsko pravo,
8. Razmatranje Prostornog plana o Nacionalnom parku “Šar”,
9. Imenovanje jednog (1) člana Borda RTK-a,
10. Imenovanje članova Nezavisnog izbornog organa za izbor predsedavajućeg i članova Organa za razmatranje javne nabavke,
11. Predlog Parlamentarne grupe LDK za zamenjivanje članova u parlamentarnim komisijama,
12. Predlog Parlamentarne grupe SLS za zamenjivanje članova u parlamentarnim komisijama.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia bashkë me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Ju e dini që diskutimet zgjasin 30 minuta. Në emër të grupeve parlamentare, 5 minuta dhe në emër të deputetëve, 3 minuta.

Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Jemi duke kaluar momente të veçanta dhe zhvillime të jashtëzakonshme në vendin tonë.

Janë ngritur në këmbë, janë ngjallur, teveqelë dhe njerëz të cilët i kanë bërë dëm të madh këtij vendi, përballë këtyre janë edhe dinjitarë, të cilët mundohen të fusin gjithë këtë ‘gjurulldi’ në organizimin e sistemit, i cili duhet të funksionojë patjetër dhe gjithqysh më mirë.

Unë për veten time nuk kam mund ta merrja me mend që do të ringjalleshin xhelatë të cilët nuk i ka ngasë, nuk i ka ngacmuar, nuk i ka prekur, nuk i ka anatemuar dhe nuk i ka përmendur këto 15 vjet pas luftës, me mendimin që do të reflektojnë, do të pendohen dhe do të struken në jetën e tyre familjare pa i etiketuar askush dhe pa ua kujtuar të kaluarën e tyre.

Megjithatë, tani kur shohim se zhvillimet janë stërkequr shumë keq, neve na imponohet të bëjmë një vështrim për të kaluarën tonë.

Ky popull, më 1945 pësoi zhgënjimin e radhës, filloi dhe u bë një rianeksim. Populli, gjithnjë ndërgjegjja e tij nuk u pajtua me këtë rianeksim dhe filloi kundërshtimin. Pastaj, mbi të filloi një batërdi masash represive, vrasje, ndjekje, burgosje, izolim, në emër të gjithçkajes, duke filluar në emër të anti-luftës, në emër të “otkupit”, në emër të mbledhjes së armëve, në emër të gjithçkajes dhe kështu u ushtrua një represion edhe për të vrarë edhe për të zhdukur edhe për të shpërngulur.

Falë një kontrate të tmerrshme që ishte atëherë për sigurimin e “vesikave” për të ikur në shkretëtirat e Anadollit, gjithë kjo u vazhdua pastaj me masa nga më të ndryshme dhe u krijua një dhunë e tmerrshme.

Dua t'ju them që ne kemi bërë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

(Ndërhyrje)

Jo, jo, nuk je në emër të grupit, në emër të grupit tjetërkush është. Jo, urdhëro shko dhe vazhdojmë. Salih Morina e ka fjalën.

Është dashur shqip për të folur. Urdhëro, shko, në emër të grupit, tjera herë kur të përgatitesh.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Unë sot do të ngre çështjen që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore, e në veçanti me kthimin e artefakteve. Qe plot 14 vjet, një pjesë e koleksionit arkeologjik dhe etnologjik të Muzeut të Kosovës, vazhdon të mbahet padrejtësisht në Beograd. Pra, janë më shumë se 1 200 eksponate arkeologjike dhe etnologjike, të cilat vazhdojnë të mbeten nëpër bodrume të Muzeut të Beogradit.

Përpos artefakteve, Serbia ka marrë edhe arkivat e Kosovës për mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore, material ky i cili pamundëson manipulimin e dokumentacionit të trashëgimisë kulturore.

Ishte menduar që menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe hyrjes në fuqi të pakos së Ahatisarit, e cila e ka paraparë kthimin e të gjitha artefakteve të vjedhura nga Serbia, në një periudhë kohore brenda 120 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e kësaj pako, të realizohet kthimi i artefakteve në mënyrë të detyrueshme, por Beogradi deri më tani nuk ka treguar as më të voglën gatishmëri, nuk ka bërë asnjë hap në këtë drejtim.

Ndërsa, në anën tjetër, Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse, Ministrisë së Kulturës, po u mungojnë iniciativat serioze për kthimin e thesarit të Muzeut të Kosovës.

Pra ky thesar, përpos që po mbahet peng në mënyrë të padrejtë gjatë vitit 2013 nga disa persona serbë të papërgjegjshëm në mënyrë ilegale janë kapur nga polica e Landit të Hessenit në Gjermani, duke i shitur shtatë artefakte dhe kjo dëshmon më së miri se çfarë kujdesi bën Beogradi ndaj këtij thesari të çmuar të Muzeut të Kosovës.

Andaj, me të drejtë shtroj pyetjen për zëvendëskryeministren Edita Tahiri:

- Pse deri më tani nuk keni shtruar në agjendën e bisedimeve Kosovë-Serbi çështjen e trashëgimisë dhe me theks të veçantë kthimin e artefakteve të vjedhura nga Serbia?

- Pse Kosova deri më tani nuk ka platformë apo strategji për trashëgiminë kulturore në bisedimet me Serbinë?
- Unë kërkoj që Qeveria e Kosovës, urgjentisht në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar ta fusin në agjendën e bisedimeve Kosovë-Serbi, çështjen e trashëgimisë kulturore me theks të veçantë kthimin e artefakteve.
- Kosova duhet të ketë një kërkesë të qartë ndaj Serbisë.
- Duhet të kërkojë kthimin e artefakteve që po mbahen padrejtësisht nga Serbia që plot 14 vjet.
- Duhet të kërkojë kompensimin e dëmeve të trashëgimisë kulturore të shkatërruar nga forcat serbe gjatë luftës së vitit 1998 – 1999 në Kosovë.
- Kompensimin për sanimin e dëmeve të mijëra ndërtesave tradicionale dhe historike.
- Kompensimin për djegien e koleksioneve të librave dhe dokumenteve të rëndësishme të shekullit XV – XIX.
- Kthimin e koleksioneve muzeale, dosjeve, fondeve të arkivave dhe dokumentacionit të monumenteve të Kosovës.
- Krijimin e qasjes publike - profesionale në lokacionet dhe ndërtesat e trashëgimisë kulturore, siç janë manastiret dhe kishat ortodokse të Kosovës.
- Kthimin e artefakteve dhe dokumentacionit të gërmimeve arkeologjike dhe vendosjen e tyre në institucionet e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Nga “Vetëvendosja” nuk e kanë kërkuar fjalën. Nga Aleanca, e ka fjalën Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po më vjen keq që ministri i Shëndetësisë nuk qenka këtu, sepse është temë apo kërkesë që lidhet drejtpërsëdrejti me një nevojë që i njëjti të ndërhyjë në një proces i cili në vazhdimësi po ndodh në komunën e Gjakovës, ku komplet mjekësia familjare është bllokuar, është mbyllur dhe realisht për shkak të mosdijes ose tekeve ose inateve, janë me dhjetëra fshatra të cilat më shumë se një muaj kanë mbetur pa asnjë qasje në mjekësinë familjare, respektivisht në pikat apo ambulancat në fshatra. Kjo për faktin se niveli komunal ka vendosur që t’ua ndërpresë të gjitha derivatet dhe transportin të gjithë atyre mjekëve të cilët deri tani kanë udhëtuar nga Gjakova e në fshatra.

Bëhet fjalë për fshatra të thella të Shqiponjës, ku qytetarët në vazhdimësi po vazhdojnë të udhëtojnë nga 20-30 kilometra për të ardhur në Gjakovë, ku është mbingarkuar kjo qendër dhe nuk ka kapacitete që t'i përballojë.

Unë jam e vetëdijshme se kjo është një çështje e komunës, mirëpo kur komuna me dy këmbë e shkelë ligjin, është do të thotë kompetencë e Qeverisë dhe me këtë rast e Ministrisë së Shëndetësisë që të ndërmarrë masa që në këtë kohë të ftohtë, në kohë kur qytetarët më shumë se kurrë ballafaqohen me gripa dhe me viruse të tjera, kur fëmijët kanë temperaturë të lartë kanë nevojë që të kenë mjekë në ambulancat pranë fshatrave të tyre dhe jo të udhëtojnë me kilometra dhe të ballafaqohen me një mbingarkim në qendër.

Prandaj, besoj që edhe pse nuk është këtu, dikush do t'ia përcjellë këtë mesazh dhe do të angazhohen që të zhblokohet ky proces i cili qytetarëve jo vetëm se po u merr mjete të cilat edhe nuk i kanë, sepse dihet në çfarë varfërie janë këto fshatra, mirëpo në njëfarë forme edhe po ua rrezikon jetën dhe të drejtën në qasje të shërbimeve shëndetësore. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Këto ditë jemi në prag të shtatë vjetorit të demonstratës së mbajtur në Prishtinë, më 10 shkurt të vitit 2007.

Demonstrata u thirr nga Lëvizja “Vetëvendosje” me qëllim të kundërshtimit të planit të Ahtisarit dhe decentralizimit etnik që çon në ndarjen e Kosovës.

Atë ditë, për derisa mijëra protestues po marshonin të qetë gjatë sheshit “Nëna Terezë” ata u bllokuan të ecnin tutje nga disa rrathë kordonësh të policisë.

Në përpjekje për ta shfrytëzuar të drejtën legjitime dhe të njohur ndërkombëtarisht për shprehjen e pakënaqësisë në hapësirën publike, qytetarët befasisht filluan të goditeshin me armë zjarri nga policët e UNMIK-ut.

Si pasojë e dhunës së pakontrolluar të policisë ranë Arben Xheladini nga Prishtina dhe Mon Balaj nga Besiana, si dhe u plagosën 82 protestues, disa prej të cilëve me pasoja të rënda fizike të cilat do t'iu zgjasin përgjatë gjithë jetës.

Por për 10 shkurtin nuk pati drejtësi. Qeveritarët e asaj kohe dhe figurat kryesore politike u rreshtuan përkrah UNMIK-ut. Edhe sot drejtësia nuk është se ka bërë ndonjë përpjekje të veçantë që kriminelët të ndiqen, kurse Qeveria nuk e ka shfrytëzuar ndikimin politik që përgjegjësit të vihen përpara drejtësisë.

Por të mos harrojmë se një qeveri vlen aq sa kujdeset për qytetarët e vet dhe aq sa bën përpjekje që të gjithë ata që kanë shkaktuar krime kundër këtyre qytetarëve ta marrin dënimin e merituar.

KRYETARI: Deputetja Vesna Mikiq e ka fjalën.

VESNA MIKIĆ: Ja ću pokušati da u naredne 3 minute opišem kako danas izgleda zapravo demokratija ali na kosovski način iz ugla srpske zajednice.

Proteklu 2013. godinu obeležila su ubistva srpskih povratnika u Talinovcu. Takođe se obeležila i otimanje srpske imovine sa falsifikovanom dokumentacijom. Rušenje srpskih nadgrobnih spomenika i ploča, hapšenjem srpskih radnika u centru za socijalni rad kojima se na teret stavlja to što su svakodnevno obavljali svoje radne zadatke.

Da bi smo u 2014. godini ušli još žešćim terorom nad srpskom zajednicom tako što smo otpočeli godinu kamenovanjem autobusa u Đakovici koji je krenuo na najveći hrišćanski praznik pun prognanih Srba proslavi u svom zavičaju, na svojoj zemlji.

Poslednja u nizu događaja su palenje povratničkih kuća i hapšenje srpskih političara, srpskih uticajnih, zapravo uticajnih Srba na srpskoj političkoj sceni.

Pa prosto, mi ne logičan i neprirodan zahtev Albanaca iz Preševa i Bujanovca koji traže reciprocitet, odnosno traže ista prava kao što ih Srbi imaju na Kosovu i Metohiji.

Gospodo, imajući sve ovo u vidu ne mogu a da vas ne pitam – kuda plovi ovaj brod? Šta je zapravo sledeće, odnosno ko je sledeći? Da li je sledeći neki od nas poslanika ispred srpske zajednice, ili neko od gradonačelnika srpskih opština kao što se već to u visokim političkim krugovima albanske zajednice spekuliše.

Da li to znači gospodo da i posle 15 godina Srbi nisu sigurni i ne mogu da se osećaju bezbednim u svojim domovima i na ulici? Da li to znači da i posle 15 godina svako od slučajnih prolaznika na ulici može da uperi prstom u mene uz prisustvo 2-3 svedoka nazove me ratnim zločincem a ekzekutori u vidu EULEX-a odrede mi pritvor i propišu mi robiju.

Gospodo iz EULEX-a međunarodne zajednice ovakvim načinom delovanja vi se direktno stavljate na jednu stranu, vi zapravo hoćete da obezvređite svaku srpsku žrtvu, hoćete da relativizujete sve zločine od strane albanskih ekstremista koji su počinjeni u predratnom, ratnom i posleratnom periodu.

Gospodo, na ovakav način ja ne vidim kraja ovoj konfuziji. I ono što želim da poručim sa ovog mesta jeste da ćete na kraju doneti zaključak da su se Srbi sami međusobno ubijali, da su Srbi sami međusobno vadili svoje organe i prodavale ih na zapadnom tržištu bogatim industrijalcima.

Pošto mi vreme ističe, hoću samo da završim rečenicom da svi oni koji imaju moć, i oni koji misle da je danas imaju, da pravo....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

E nderuar ministre,

Të respektuar kolegë deputetë,

Tema ime sot ka të bëjë me funksionimin e institucioneve të pavarura të mbikëqyrura nga ne si deputetë dhe komisionet në të cilat funksionojmë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Janë gjithsej 34 institucione të pavarura të cilat ligjërisht për performancën e tyre kujdeset ky Kuvend. Dhe e vetmja mënyrë për ta bërë këtë deri tani nga komisionet funksionale ushtrohet përmes raportimeve të këtyre institucioneve.

Raportet e paraqitura shpeshherë subjektive po adresohen te komisionet përkatëse një herë në vit, janë raporte që nuk kanë një kriter unik të prezantimit. Pra, fjalën e kam për raportet e punës, për këto raporte që miratohen apo jo, nuk çojnë peshë shumë për vlerësimin e tyre, pasi që ne si Kuvend nuk kemi ndërtuar mekanizma tjerë që përcjellin punën e tyre në kontinuitet. Votohen apo jo nuk ndëshkohet as shpërblehet askush për këtë performansë që vlerësohet me votën tonë në këtë Kuvend.

Ne e kemi vetëm një zyrtar pra që punon këtu në Kuvend, i cili ka detyrë të korrespondojë me këto institucione, një zyrtar i vetëm me 34 agjenci, sigurisht se nuk mjafton.

Ideja që të ketë një tubë më të gjerë, të përbërë nga njerëz profesionistë që do të përcillnin punën e këtyre agjencive në vazhdimësi, do të ndihmonte që Kuvendi të jetë më i familjarizuar, me sfidat dhe të arriturat e të gjitha këtyre institucioneve të pavarura.

Ne do të kishim një pasqyrë më të qartë, më dinamike, do të ishim më të njoftuar edhe për nevojën e ekzistencën e tyre, edhe për aktivitetin e tyre.

Nga të gjitha vendet e rajonit ne kemi më së shumti agjenci të pavarura, të cilat realisht edhe janë të varura se po financohen nga buxheti i vendit.

16 nga 34 që kemi janë të vendosura në objekte me qira dhe shumica nga to nuk mbikëqyren fare nga ky Kuvend.

Komisionet janë të ngarkuara me shumë dikastere dhe punën e agjencive e përcjellin formalisht.

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj që ka vend për diskutime të cilat krijojnë mundësinë t'i bëjmë propozimet tona reale për një funksionim më normal të gjitha atyre agjencive që kontrollohen nga Kuvendi, duke e krijuar një zyre ekzekutive që e përcjell punën e tyre, pra punën e këtyre agjencive profesionalisht gjatë tërë vitit dhe jo vetëm një herë në vit kur ne i marrim raportet e tyre.

Ne po ashtu në raportin e sivjetshëm të Raportit të Progresit kemi një vërejtje, citoj: “Kuvendi gjithashtu ka nevojë ta përmirësojë kuptimin e rolit të tij nën mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe autoriteteve rregullatorë”.

Në këtë drejtim, mekanizmat adekuat duhet të krijohen dhe kemi mundësi ta bëjmë këtë. Bazat ligjore mund të rregullohen, ato baza të cilat deri tani janë të paqarta për raportim, koordinimi i dobët me Qeverinë, dështimi për përcaktimin e mekanizmave të anëtarëve të Bordit, pra të gjitha janë vërejtje të cilat janë në Raportin....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kjo fjalë, në rend të parë, nuk shkon për këtë pikë të rendit të ditës dhe komisionet parlamentare kanë obligim parësor t’i kontrollojnë institucionet e pavarura. Është e vërtetë që ka shumë, por edhe një herë po them, kjo fjalë absolutisht s’është për këtë pikë të rendit të ditës. Pra, ju mund të thoni çka të doni, është çështje e deputetëve, por komisionet parlamentare i kontrollojnë agjencitë e pavarura. Është detyrë e tyre, jo e dikujt tjetër. Fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Anëtarë të Kryesisë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Unë sot në këtë pikë do të ngre një shqetësim dhe mendoj se pikërisht vendi është këtu dhe bëhet fjalë për “Trepçën”.

Siç dihet me miratimin e Ligjit për ristrukturimin e ndërmarrjeve publike, AKP-ja e ka pasur për obligim që të njëjtën ta bëjë në një afat kohor të cilin veç e ka tejkaluar më se një vit.

Pastaj duke e parë këtë ngecje ne e kemi ngritur një debat këtu, falënderoj të gjithë kolegët, të cilët e kanë mbështetur këtë iniciativë dhe kemi votuar një rezolutë e cila pastaj obligon Qeverinë, përkatësisht ministrinë përkatëse që të dalë me një ligj të veçantë për “Trepçën”.

Tani kemi informacionin se ajo ide sado që në një formë tjetër ka kaluar nëpër Qeveri dhe u mbetet komisioneve funksionale dhe Parlamenti të shohë se me idenë e re a po futet ideja primare, pra që “Trepçës” t’i krijohen mundësitë e një autonomie të veprimit... të zhvillimit dhe vendeve të punës. Dhe, për çudi derisa ligji edhe pse me një ngecje, edhe pse nga prilli ka pasur 3 muaj, ai po vonohet dhe në momentin kur ai kaloi në Qeveri, në AKP shpallet një thirrje publike, pra një tender për një kompani konsulente dhe për këtë ndan 9 milionë. Dhe kjo është hera e dytë që për “Trepçën” paguhet kompani konsulente, të njëjtë e kanë bërë edhe në kohën e UNMIK-ut. Dhe, ajo pikërisht është paguar ajo kompani konsulente dhe mbas shumë milionave të shpenzuar ajo ka ardhur me një konstatim se “Trepça” është një dinozaur që e ha vetveten, dhe koha e ka demantuar, ka treguar se nuk është ashtu.

Prandaj, ne duke mos qenë indiferentë se si trajtohen resurset tona dhe si ato shfrytëzohen për zhvillim, edhe unë me këtë rast protestoj me këtë gjendje dhe në këtë tendencë të AKP-së.

Është e çuditshme se si Qeveria dhe ministri e kanë toleruar këtë çështje.

Është e çuditshme se si në këtë fazë para miratimit të ligjit, AKP-ja ngutet me emërimin e menaxhmentit dhe tash me këtë tender për konsulentë 9 milionë.

Unë pavarësisht se a merren ato 9 milionë nga pozicioni i privatizimeve apo nga buxheti megjithatë ... me këta 9 milionë dhe posaçërisht kur kjo e njëjta ka ndodhur pa asnjë konsultim të menaxhmentit të ministrisë përkatëse dhe të ekspertëve.

Prandaj unë sugjeroj që urgjentisht të veprohet, nëpërmes ministrit, nëpërmes komisionit që një diçka e tillë të ndërpritet. Faleminderit!

KRYETARI: Po, ministër ashtu është, por komisionet duhet t'i mbrojnë dokumentet që i miraton Kuvendi dhe pastaj ata duhet të ftojnë ty për të dhënë përgjegjësi pse nuk është bërë realizmi i rezolutës. Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Është bërë tashmë pjesë e debatit publik se çfarë po ndodh në “Trepçë” dhe rreth “Trepçës” edhe jemi duke i dëgjuar qëndrimet e ndryshme edhe nga vetë përfaqësuesit e Qeverisë karshi kësaj çështjeje, pra duket se ka një mospajtim brenda Qeverisë se çfarë duan të bëjnë me “Trepçën”, mirëpo gjithsesi ne e dimë që në Qeveri ka kaluar një vendim i cili mëton ta ndryshojë Ligjin për ndërmarrjet publike, ta plotësojë atë siç është thënë nga ministri duke e shndërruar pra “Trepçën” në ndërmarrje publike.

Është e qartë se kjo qeveri ose një pjesë e kësaj qeverie duan ta përfundojnë mandatin e tyre në pushtet duke u marrë me “Trepçën” dhe duke marrë vendime të rëndësishme për “Trepçën”.

Konsideroj që së pari këto vendime, për shkak të mungesës së një debati publik, dhe për shkak të mungesës së informimit të shoqërisë në Kosovë për atë se çfarë duan të bëjnë me “Trepçën” janë vendime, megjithatë, të ngutshme. Tash ministri mund të thotë se kemi pritur 15 vjet, pra nuk është e ngutshme, por unë mendoj që vetë procedimi i kësaj është i ngutshëm aq më tepër kur është i nxitur, në njëfarë mënyre nga një debat në Kuvend dhe është pastaj si vendim në shpërputhje me atë rezolutë që e ka nxjerrë Kuvendi. Pra, është në shpërputhje të plotë, sepse ne po flasim për dy gjëra të ndryshme këtu, po flasim nëse duam ta bëjmë “Trepçën” siç ka kërkuar Kuvendi si ndërmarrje të veçantë publike me një ligj të veçantë i cili nuk do t'i nënshtrohej ligjit të logjikës aktuale të trajtimit të ndërmarrjeve publike apo thjeshtë duan ta shndërrojmë “Trepçën” në ndërmarrje publike, pra për ta nxjerrë atë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe për t'ia dhënë në duar të Qeverisë.

Natyrisht që në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, aty ku është dhe si është, “Trepça” nuk është mirë, por unë jam më se i bindur që prej kësaj qeverie po ashtu “Trepça” nuk do të qeveriset mirë.

Formalisht mund të thuhet që ky hap është i mirë, dhe këtu të gjithë besoj jemi dakord. Pra, po të lihet “Trepça” nën ligjin aktual dhe nën qeverisjen aktuale atëherë “Trepça” rrezikon me likuidim siç e thotë edhe Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara, pjesë e të cilit është edhe “Trepça”.

Mirëpo, ky shndërrim i “Trepçës” në ndërmarrje publike, pa e pasur të qartë një plan paraprak se çfarë duan të bëjmë me “Trepçën”, atëherë edhe ky i bart rreziqet e veta në vete dhe natyrisht që është vështirë që të çmohet si hap, për shkak se nuk po dihet se çfarë duhet të ndodhë me “Trepçën”.

Ne mendojmë si Lëvizje “Vetëvendosje” që është e domosdoshme që “Trepça” për shkak të rëndësisë që ka për zhvillimin ekonomik të vendit, për kohezionin shoqëror të vendit dhe përgjithësisht për sovranitetin e vendit, duhet të trajtohet si ndërmarrje e veçantë. Nuk bëjmë të lejojmë në asnjë mënyrë që “Trepça” me këso ngutje të shndërrohet në ndërmarrje publike dhe t’i vihet 100% nën menaxhim të kësaj qeverie duke pasur parasysh edhe historikun që kjo qeveri e ka me menaxhimin, qeverisjen e ndërmarrjeve tjera publike.

Çështja e dytë që duhet të bëhet pjesë e ligjit, është që minierat, metalurgjitë dhe industria kimike të organizohen në ndërmarrje publike. por që këto në asnjë mënyrë të mos privatizohen as të koncensionohen. Pra, është e qartë se privatizimi apo koncensionimi i minierave dhe metalurgjisë do ta shkatërrojë “Trepçën”.

Shiheni sot debatin që po ndodhë në Shqipëri për koncensionimet që u janë bërë minierave atje dhe këqyrni gjendjen e minierave në Shqipëri, pas koncensionimit.

Pra në këtë drejtim konsideroj se ato që po i thotë zëvendëskryeministri Pacolli dhe që i ka thënë edhe ministri Fadil Ismajli, për tendencën e koncensionimit të pjesshëm, të përkohshëm e kështu me radhë të “Trepçës” dhe minierave të saj do të ishte fatale për “Trepçën”, pra do ta hiqnim “Trepçën” nga harta e minierave të Kosovës.

Detyrë primare konsiderojmë është që të vazhdohet hulumtimi në brezin mineral të “Trepçës” si dhe zgjerimi i kapaciteteve prodhuese dhe aplikimi i teknologjive dhe pajisjeve bashkëkohore në to. Pastaj rehabilitimi dhe ristartimi i kapaciteteve ekzistuese, i cili do të mundësonte rritjen e prodhimit të elektrolitit të zinkut dhe po ashtu të ndërtohen kapacitete të reja që do të rrisnin prodhimin e plumbit. Këto janë të domosdoshme në mënyrë që “Trepça” si minierë dhe si metalurgji të kthehet në namin që e ka pasur dikur ekonomik dhe organizativ.

Po çka është po ashtu domosdoshmërisht që duhet të ndodhë është që shteti duhet t’i stimulojë dhe inkurajojë dhe të marrë pjesë aty ku ka nevojë në investime në kapacitetet

përpunuese dhe të garantojë njëkohësisht furnizimin e këtyre kapaciteteve me metale cilësore që nxirren dhe përpunohen në “Trepçë”.

Pa këto kapacitete përpunuese prapë Kosova do të përfundojë në industrinë nxjerrëse, pra që është një shkallë më poshtë se sa industritë moderne të përpunimit të metaleve dhe resurseve tona që i kemi dhe prej të cilave duhet të përfitojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja të cilën dua ta ngre sot ka të bëjë me moskujdesin e duhur nga Qeveria e Kosovës për familjet e viktimave civile të luftës.

Si rezultat i luftës së fundit në Kosovë nga e cila natyrisht erdhën liria dhe pavarësia e vendit, Kosova edhe sot e 14 vjet nga përfundimi i saj, vazhdon të përballlet edhe me familjet e viktimave të luftës.

Sot familjet e viktimave të luftës mbulohen me Ligjin 04-L/054 për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të luftës dhe familjeve të tyre.

Sipas këtij ligji familjet e viktimave marrin 135 euro në muaj. Shtrohet pyetja: Sa është e arsyeshme kjo shumë për një familje të viktimizuar e cila nuk e ka asnjë anëtar të punësuar gjatë, si do ta përballojë ajo peshën e rëndë të gjendjes së sotme ekonomike në vend trendi i së cilës nuk ka të ndalur?

Sot pasiguria ekonomike është fakt jetësor i shumicës sonë, krahas të gjitha shtresave, varfëria më së shumti i ka prekur familjet e viktimave të luftës. Forma e ndihmës së dhënë nga Qeveria e Kosovës është e pamjaftueshme dhe se ajo ndikon shumë pak në zbutjen e barrës financiare, sidomos në rastin e familjeve më të mëdha.

Në këtë kuptim kontributi i Qeverisë nuk mbulon as koston themelore të veshmbathjes.

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë vi nga zona ndër më të prekurat në Kosovë nga kjo dukuri, pra nga zona e Rekës së Keqe, më besoni se kam shumë e shumë shembuj të familjeve të tilla që kanë deri në 10 anëtarë të familjes dhe nuk marrin më shumë se 135 euro në muaj.

Pra, shumica prej tyre sot e kësaj dite janë të papunë, ndërsa fëmijët e tyre duhet të vazhdojnë edhe shkollimin.

Unë nuk e di, vërtet nuk e di se si këto familje arrijnë të kujdesen dhe t'i mbulojnë shpenzimet elementare për fëmijët e tyre për shkak të mungesës së trajtimit dhe rehabilitimit që ata e meritojnë.

Prandaj, ne si shtet a nuk do të duhej të ndjejmë dhe të marrim përgjegjësi për gjithë këtë gjendje të këtyre familjeve.

A nuk duhet Qeveria e Kosovës të veprojë urgjentisht në lehtësimin dhe krijimin e kushteve më të favorshme dhe që kjo shtresë tepër e nderuar e shoqërisë sonë të arsimohet, të favorizohet dhe mbi të gjitha të jetë e barabartë me të gjithë pjesën tjetër të shoqërisë sonë.

Përfaqësuesit e familjeve të viktimave civile nga mbarë Kosova i janë drejtuar Presidencës, Qeverisë, por edhe Kuvendit që në plotësim-ndryshimin e ligjit të bëhen dhe të arsyetohen pra se kjo çështje në të cilën ata dhe sot e kësaj dite po ballafaqohen me këto kushte elementare sadopak të ndryshojë me plotësimin dhe ndryshimin e ligjit që aktualisht është në Kuvendin e Kosovës.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi e ka një deklaratë për këtë pikë të rendit të ditës.

JAKUP KRASNIQI: Unë do të vazhdoj aty ku e la deputeti Halit Krasniqi. Dhe sigurisht fjalën nuk do ta merrja sikur organet përkatëse që i ka Kosova duke filluar nga Këshilli i Sigurisë Kombëtare, dy komisione parlamentare që i kemi ne dhe Prokuroria e Kosovës të merreshin me atë çështje.

Unë nuk dua të merrem me histori, po deklarami i tre ish- agjentëve të sigurimit të shtetit të Jugosllavisë se edhe sot në Qeverinë e Kosovës, në Kuvendin e Kosovës dhe në Universitetin e Kosovës ka individë që spiunojnë Kosovën te siguri i shtetit të Serbisë, për mua është shqetësuese.

Është shqetësuese edhe pse si Kosovë ende nuk e kemi ligjin për t'i ndaluar spiunimet ose vënien në shërbim të organeve të ndryshme të sigurimeve të huaja në Kosovë.

Po, konsideroj që edhe komisionet parlamentare, edhe Këshilli për Sigurinë Kombëtare, edhe Prokuroria është dashur dikush ta shohë përgjegjësinë për t'i marrë ata njerëz, për t'i pyetur dhe për të ditur se vërtet kush janë ata sot pas 15 vjetëve që punojnë për një shërbim të huaj, për një shërbim i cili e dimë se krejt çka ka bërë gjatë 45 vjetëve apo 50 vjetëve në Kosovë.

Unë mendoj që kjo çështje duhet të merret parasysh, ata njerëz duhet t'i japim ata emra dhe pastaj edhe Parlamenti, edhe opinioni publik në Kosovë duhet ta dijë se kush vërtet vazhdon ta spiunojë Kosovën dhe qytetarët e saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar! Kjo pikë e rendit të ditës është kryer, është koha për pyetje parlamentare.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Për deklarime jashtë rendit të ditës janë lajmëruar edhe dy ministra, Ministrja e Integriteteve Evropiane dhe ministri për Zhvillim Ekonomik.

Regjia, fjalën ministres!

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Ju drejtohem sot lidhur me miratimin e Projektligjit për plotësim- ndryshimin e Ligjit për prokurimin publik dhe ndërlidhjen e tij me procesin e negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Gjatë vitit 2012 Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik duke pasur parasysh ndikimin e madh financiar dhe ekonomik të cilin aktivitetet e prokurimit publik e kanë në kuadër të ndërmarrësisë së sektorit privat në Kosovë, ka nisur debatin rreth ofrimit të insentivave dhe përkrahjes së komunitetit të biznesit në kuadër të aktiviteteve të prokurimit publik.

Pas një debati gjithëpërfshirës me komunitetin e biznesit, Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, më 18 dhjetor 2012, ka vendosur që të fillojë plotësim- ndryshimin e Ligjit të prokurimit publik duke bërë favorizime të ndërmarrjeve vendore për prokurimet publike.

Një vendim i tillë është i bazuar në nevojën për të mbështetur prodhimet vendore dhe për të krijuar masa të përkohshme për stimulimin e rritjes ekonomike.

Në anën tjetër gjatë vitit 2013 kanë filluar negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit. Sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian favorizimet e prodhimeve vendore bazuar në origjinën e produktit nuk lejohen. Ky është edhe themeli i tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian.

Si do qoftë duke marrë parasysh nevojën për stimulimin e rritjes ekonomike në Kosovë, krijimin e masave mbështetëse për prodhuesit vendorë dhe precedentët paraprakë të vendeve tjera në kuadër të procesit negociator të MSA, me ç'rast janë lejuar favorizime të këtilla, institucionet tona kanë vendosur që të negociojnë një periudhë transitore për aplikimin e favorizimeve të ndërmarrjeve vendore në kuadër të aktiviteteve të prokurimit publik.

Në këtë kontekst gjatë procesit negociator për MSA, ne jemi dakorduar për fazën transitore të favorizimit të produkteve dhe kompanive vendore në prokurimin publik.

Së fundmi jam informuar që Kuvendi i Kosovës ka pranuar një letër nga shefi i EULEX, i cili e ka njoftuar Kuvendin që projektligji në fjalë është në shpërputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Të nderuar deputetë,

Që nga fillimi i këtij procesi ne kemi qenë plotësisht të vetëdijshëm që plotësim-ndryshimi i Ligjit për prokurimin publik nuk është në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Si do qoftë, më lejoni ta them qartë, detyra ime si kryenegociatore e MSA nuk është që të përkujdesem vetëm a është çdo gjë në harmoni me legjislacionin e BE-së, por të negociojmë një marrëveshje e cila është sa më e favorshme për vendin, ekonominë dhe ndërmarrjet tona.

Për këtë arsye edhe e kemi negociuar periudhën transitore me Komisionin Evropian dhe përfshirja e EULEX-it në këtë çështje është tërësisht e panevojshme dhe unë nuk e shoh arsyen pse ata kanë shkruar një letër të tillë.

Ligji është produkt i negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ka kaluar në lexim të parë dhe unë ju ftoj që ta kalojmë në lexim të dytë, sepse në rast se mbetet në këtë formë para se të përmyllen negociatat, ne nuk mund ta ndryshojmë më.

KRYETARI: Fjalën e ka Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë desha t'ia bëj një pyetje ministres në këtë kontekst, do të thotë që lidhet me vizat.

Para disa ditëve na është thënë që edhe nga 3-4 vjet qytetarët e Kosovës nuk mund të presin liberalizim vizash.

Dje pas skandalit që ka ndodhur kur një deputet i koalicionit qeverisës akuzohet për shitje të vizave, po dua të pyes sa na ka prapakthyer kjo në proces? Edhe sa vjet liberalizohen, sa na ka prapakthyer se kjo dalja sot tash me këtë ligj që po del që do të na përkrah në këtë proces, një ditë mbas skandalit për të cilin s'kemi pasur asnjë sqarim do të thotë po pyes në rast që do të thotë kjo del e vërtetë, sepse është akuzë shumë e rëndë, është deputet i koalicionit qeverisës që zihet duke shitur viza, a bën të na kallëzosh sa na ka dëmtuar si Kosovë dhe sa na ka prapakthye?

KRYETARI: Deputetët kanë të drejtë t'u parashtrojnë pyetje ministrave. Lexojeni Rregulloren. Rreth temës konkrete, jo të dalin jashtë saj, natyrisht! Fjalën ministres!

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: E nderuara deputete,

Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për prokurimin publik është në Kuvendin e Kosovës tani e disa muaj dhe nuk ndërlidhet me agjendat apo me çështjet të cilat, apo lajmet që janë prodhuar ditëve të fundit.

Dhe, arsyeja e vetme pse unë sot jam këtu është një letër që ka ardhur në adresë të Kuvendit të Kosovës nga shefi i EULEX-it, i cili nuk do të duhej të ishte aspak i përfshirë në këtë punë, sepse negociator i Qeverisë së Republikës së Kosovës në këtë proces është Komisioni Evropian dhe ligjin ne e kemi negociuar me Komisionin Evropian dhe ka

precedent paraprak. Ne duhet të sigurojmë që Marrëveshja e MSA-së mbron dhe stimulon prodhimin vendor për një periudhë transitorë aq sa më shumë që të jetë e mundur gjatë procesit të negocimit.

Ndërkohë që lidhur me skandalin që plasi dje e tëra çka mund të them unë si ministre e Integritetit Evropian është që ne duhet të përqendrohemi në përmbushjen e detyrave tona, lista është e gjatë, institucionet e Kosovës kanë bërë çdo gjë që të prodhojnë argumente për të bërë më të lehtë vendimmarrjen në Bruksel, por sigurisht lajmet dhe skandalet e tilla krijojnë perceptime të cilat kanë efekte negative.

KRYETARI: Ne e presim rezultatin e gjyqeve, nuk jemi media këtu, ta keni parasysh. Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Në emër të Komisionit për Integritet Evropian desha ta adresoj çështjen konkrete për të cilën foli ministrja, pra Ligjin për prokurimin publik.

Siç e dini gati gjysma e deputetëve të këtij Kuvendi ka votuar kundër atij ligji në lexim të parë për një arsye të vetme që kishte të bënte me gjuhën që është përdorur në atë ligj lidhur me mbrojtjen, siç e tha ministrja, të kompanive dhe produkteve vendore.

Në fakt ligji nuk i përmend produktet vendore fare, flet vetëm për kompanitë vendore dhe shqetësimi i deputetëve ishte që këto kompani vendore sipas procedurave të tanishme, mund të jenë edhe të huaja, por që regjistrohen në Kosovë, e rrjedhimisht konsiderohen si vendore që nënkupton që jo domosdoshmërisht mbrohet përfundimisht produkti vendor.

Dhe kjo si rezultat mund të lë hapësirë edhe për metoda korruptive, prandaj edhe nga kontaktet që i kemi pasur me EULEX-in është paraqitur pikërisht kjo brengë.

Unë mendoj që në mënyrë që kjo të tejkalohet duhet edhe Qeveria të pajtohet që gjuha në atë ligj të ndryshojë që nënkupton që t'u referohet në mënyrë specifike produkteve vendore, sepse ne si deputetë e patëm propozuar këtë ndryshim në seancën e kaluar, mirëpo edhe ministri i Financave që e pat adresuar ligjin në emër të Qeverisë, nuk pranonte që kjo gjuhë të ndryshojë.

Kështu që unë i bëj thirrje edhe Qeverisë që të jenë dakord, por edhe deputetëve tjerë që nuk kanë qenë në seancën e kaluar, që të pajtohen që kjo gjuhë në ligj të specifikohet, pra t'i adresohet në mënyrë të drejtpërdrejtë produkteve vendore e si rrjedhojë besoj që edhe ligji pastaj në qoftë se e adreson këtë çështje mund të kalojë pa problem.

KRYETARI: Ministrja e ka fjalën.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Edhe ne kemi insistuar fillimisht që ligji t'i specifikojë produktet vendore, mirëpo një precedent i tillë në negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nuk ekziston.

Ne mund të vendosim masa të përkohshme të mbrojtjes vetëm për kompanitë vendore dhe ky është maksimumi që mund të arrihet duke pasur parasysh edhe përvojat e mëhershme të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Dhe ajo çfarë ju keni në ligj tani është maksimumi që kemi arritur të përfitojmë ne. Po ju them nuk ka qenë e lehtë të arrihet edhe deri këtu dhe ne insistojmë që ky ligj të kalojë në këtë formë para se të përmbyllem raundet e negocimit të MSA-s, sepse më pas do të jetë e palejueshme dhe e pa pranueshme. Unë ju ftoj që ta miratojmë tani.

Sinqerisht e shoh tërësisht të paarsyeshme përfshirjen e EULEX-it në këtë proces, nuk është EULEX-i bashkëbisedues yni në këtë proces, ne ligjin çfarë e keni ju sot, në sirtar, e kemi negociuar me Komisionin Evropian.

Po e ripërsëris, insistimi i tyre ka qenë që ligji të mos preket fare, mirëpo, ne bazuar në përvojat paraprake dhe precedentët e mëhershëm të MSA-ve të vendeve të rajonit, kemi insistuar që të ketë masa të përkohshme të mbrojtjes për kompanitë vendore, kështu që ju ftoj që ta kalojmë sa më parë.

Raundi i fundit i negociatave teknike parashihet të mbahet javën e ardhshme dhe takimi i fundit i kryenegociatorëve pritet të mbahet në fund të muajit shkurt ose në fillim të muajit mars.

Pra, nuk kemi shumë kohë, në rast se nuk e përmbyllem këtë ligj para përfundimit të negociatave ne nuk do të mund ta ndryshojmë më pas.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,

Unë nuk desha të reagoj, por me të thënë të drejtën më shqetësoj pak deklarimi për “Trepçën” dhe atë në të dy pikat.

Tash nuk po di çka të them: “hip se të vrava, zbrit se të vrava”. Unë po e kryej një punë të cilën e kemi marrë prej Parlamentit. Fatmirësisht, ka kaluar koncepti nëpër Qeveri, pritet të vijë në Parlament dhe tani në Parlament dëgjojmë zëra se nuk u dashka, se u dashka pritur që dikush tjetër të vijë në Qeveri për ta bërë një punë të mirë për qytetarët e qytetarët e Kosovës po presin që “Trepça” definitivisht të dalë nga ngërçi në të cilin është tash 15 vjet. Dhe, për qytetarët e Kosovës nuk është me rëndësi cila qeveri, cili person, cili ministër, cili Parlament do ta aprovojë, por është me rëndësi mirëqenia të cilën “Trepça” do ta sjellë me aktivizimin e saj të plotë.

Dhe, çështja tjetër që gjithashtu u përmend, po e përsëris përsëri në këtë foltore, më 29 nëntor unë i kam dërguar letër të fundit edhe Kryesisë së Parlamentit në lidhje me atë që Kryesia e Parlamentit ta shfrytëzojë autoritetin e vet dhe ta ndërpresë procesin filluar nga AKP-ja për angazhim të konsulencës për ristrukturim të “Trepçës”, sepse ristrukturimi

duhet të fillojë këtu me nxjerrjen e “Trepçës” nga AKP-ja dhe pastaj hapjen e perspektivave të zhvillimit.

Unë përsëri them, edhe pse tani sigurisht ndalja e këtij procesi do të ketë edhe efekte negative të dyanshme, ndërsa në kohën kur kemi kërkuar që të ndalet nuk do të kishte pasoja, sepse tani unë dëgjoj që i kanë hapur ofertat dhe AKP me Gjykatën Supreme ecin rrugës së vet. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ne vetëm para një viti kemi bërë një ligj i cili ka të bëjë me “Trepçën”. Edhe atëherë kanë qenë debate të ndryshme sa i përket këtij aseti të rëndësishëm për ekonominë e vendit tonë. Edhe atëherë ka qenë një dakordim i të gjithëve, që një ligj i tillë do ta zhblokonte “Trepçën” prej atyre pretendimeve të shumë investitorëve në kohën kur pushteti serb ka menaxhuar me këtë aset kombëtar. Dhe, prej asaj kohe me këtë ligj ka pasur edhe përparime të ndjeshme, për sa i përket funksionimit të minierave e tjerë.

Megjithatë, është koha kur të gjithë e thonë që kemi nevojë që të gjithë të merremi në mënyrë më serioze me këtë aset. Dhe, siç e dimë, tash për tash kompetencë menaxheriale ka Agjencia e Privatizimit. Letra që ka ardhur nga ministri, që ka shkuar në drejtim të AKP-së, që ka shkuar edhe në Kuvend, ne si komision kemi pasur një kërkesë prej Kryesisë së Kuvendit që të japim sqarime për këtë letër. Ne kemi bërë një vizitë në Agjencinë e Privatizimit dhe po ashtu, edhe prej tyre kemi kërkuar sqarim lidhur me këtë.

Ajo që mund të themi tash është, Qeveria duhet të dalë e vendosur, e qartë, me qëndrime që ka për këtë aset, me vizionin që ka dhe Kuvendi dhe Qeveria duhet të iniciojë ligj për të ardhmen, se çka të bëjë më tutje me “Trepçën” dhe ne jemi dakord që të bisedojmë edhe për një vizion të tillë për “Trepçën”.

Po, letra që i është dërguar agjencisë, zoti ministër, ata nuk kanë asnjë të drejtë të veprojnë ndryshe, përpos se si është ligji aktual i “Trepçës”. Asnjë letër e ministrit, as e kryetarit të Kuvendit, as e Kuvendit tash, asnjë letër e kryeministrit, nuk mund t’i devijojë ata që të mos e respektojnë ligjin aktual.

Unë them që tash për tash, vetëm procedura e ndryshimit të ligjit, ne mund të flasim për vizionin që ka Qeveria për të ecur më tutje me “Trepçën”, nuk po paragjykoj tash. Mendoj që shumica këtu kemi njëfarë dakordance se si duhet të bëhet më tutje me “Trepçën”, që të mos trajtohet sikur ndërmarrjet tjera, e tjerë, e tjerë, por vetëm një ligj i ri mund ta zhvillonte këtë proces më tutje.

Për më tepër, unë mendoj, pavarësisht kësaj, është një urgjencë tjetër që ka të bëjë edhe me Ligjin e AKP-së se ju duhet të jeni pak më aktivë, është fjala për funksionimin e Bordit për pagesën e 20%-shit, e tjera. Mendoj që iniciativa për ndryshimin e ligjit është prioritare para se të sugjerohet AKP-ja për ndonjë veprim shtesë tash për tash.

Ata duhet të veprojnë vetëm në përputhje me ligjin që e kanë, përdërisa ne këtu në këtë Kuvend nuk e ndërrojmë ligjin ose nuk e bëjmë ndonjë ligj tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Meqë ministri në njëfarë mënyre jo drejtpërdrejtë iu referua edhe asaj që thashë unë, mendoj që duhet ta shfrytëzoj një kohë të shkurtë këtu në Kuvend, që ta qartësojë edhe njëherë atë që po mundohet ta mjegullojë në njëfarë mënyre ministri, ndoshta edhe pa dashje.

Unë thashë që shndërrimi i “Trepçës” në ndërmarrje publike, formalisht është hap i mirë, pra nuk po e kontestoj këtë, mirëpo mënyra se si po do ta bëjë Qeveria, mendoj që bart shumë rreziqe në vete.

Ky nivelizim që po ia bën “Trepçës”, domethënë që po e trajton sikur ndërmarrjet tjera publike, pra pa e ndryshuar ligjin dhe pa e bërë me një ligj të veçantë, për ta shpallur atë si ndërmarrje të interesit të veçantë, gjë që do të duhej të ishte, kjo pastaj e bën “Trepçën” të rrezikuar nga politikat e kësaj Qeverie, sepse e kemi parë se si sillet kjo Qeveri me ndërmarrjet publike. Pra, nuk është se nuk kemi një përvojë, shiheni PTK-në, shiheni çka i ka bërë KEK-ut, shiheni si e shitën KEDS-in, shiheni si e kanë koncesionuar Aeroportin e Prishtinës e kështu me radhë, domethënë nuk është se nuk e kemi parë se si kjo qeveri vepron me ndërmarrjet publike.

Pse po e them e ngutshme? Është e ngutshme sepse nuk ka pasur debat publik për këtë punë. Pra, në njërën anë të gjithë e kemi gojën plot që jemi të interesuar ta revitalizojmë “Trepçën”, në anën tjetër të gjithë thonë që është ndërmarrja më e rëndësishme në Kosovë, pasuria më e rëndësishme e Kosovës dhe pastaj na thuhet që do të vijë një ligj në Kuvend, i cili është diskutuar diku në qarqe të Qeverisë, madje as krejt Qeveria po duket s’e kanë diskutuar bashkë.

Edhe tash, pse një proces kaq jo transparent të ndërmerret për një ndërmarrje kaq të rëndësishme? Pra, ne insistojmë që Ndërmarrja Publike “Trepça”, kur të shndërrohet në ndërmarrje publike, t’i ketë të sanksionuara me ligj, në mënyrë shumë të qartë dhe të definuar disa prej çështjeve kryesore, që do të duhej ta mbronin “Trepçën” nga çfarëdo politike, ta quaj kështu, private, e koncesionimit dhe shkatërrimit të saj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Lidhur me “Trepçën” edhe unë si anëtar i Partisë Demokratike dhe anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik kam ngritur shqetësimet e mia për çështjen e procedurave, të cilat duhet të ndiqen dhe kam kërkuar po ashtu një sqarim në kuadër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, nga zëvendëskryeministri, nga ministri për Zhvillim Ekonomik, që të qartësohet strategjia e Qeverisë e jo të shpalosen interesat e individëve, duke filluar nga kryetari i komunës, ku jep një formacion joligjor, që nuk e njeh ligjin dhe thirret se do të bëhet zhblllokimi, në tjetrën anë thuhet se me “Trepçën” kam çua letër ministri në AKP, ndërsa për këto çështje kaq të mëdha duhet të merret një grup multisektorial i Qeverisë, i cili merret si vendim, nxirret objekti i trajtimit dhe nxirret procedura e ndjekjes nëpërmjet Parlamentit edhe për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Prandaj, mendoj që përfundimisht është duke u spekuluar edhe nga subjektet politike po fatkeqësisht edhe nga anëtarët e koalicionit në qeverisje, më shumë për konsum ndoshta politik, se sa për një strategji.

Unë jam që “Trepça” të aktivizohet, të faktorizohet si aset kombëtar dhe të gjendet rruga edhe juridike me krejt ngërçet politike që janë sot, por jo të spekulohet në interesa që shkaktojnë mjegull. Ndërsa, çështja, se “Trepça” a duhet të aktivizohet a jo, kjo është e padiskutueshme. Por, nëse ne nuk i bëjmë çështjet me radhë nga aspekti ligjor, ne mund të bëjmë gabime. Është ky problem qeveritar, i cili duhet të nisë me procedurë me Kuvendin dhe Kuvendi me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe të respektohet një procedurë ligjore, e cila jep edhe formë edhe përmbajtje.

Mandej, formën se çfarë ndërmarrjeje do të jetë, e veçantë, publike, me një ligj të veçantë, ne e kemi përkrahë unanimisht. Prandaj ne nuk kemi nevojë të punojmë më shumë me media, por kemi nevojë të punojmë mes veti më shumë, të sqarohemi në mes veti, jemi të pasqaruar. Faleminderit!

KRYETARI: Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Sikur duke u zgjeruar në temën, në përgjithësi rreth “Trepçës” sikur po ikim nga poenta kryesore, për të cilën ne sot mund të diskutojmë. Edhe strategjia edhe propozim-ligji janë çështje që vijnë dhe ne do ta kemi rastin, që më gjerësisht të diskutojmë për “Trepçën”.

Ajo që sot ne po diskutojmë është e çuditshme. Flitet për ligjin, do të thotë për ristrukturimin e ndërmarrjeve publike, në këtë rast po themi “Trepçën”. Ai afat ka kaluar moti. Dhe, ne kur e kemi pasur këtu debat çështjen e “Trepçës” AKP-ja i ka kaluar afatet e veprimit. Prandaj, duke parë që AKP-ja nuk po vepron, ne kemi marrë një iniciativë këtu. Dhe, për çudi edhe mas tetë muajve ajo s’ka vepruar, në momentin kur e ka parë se po vjen iniciativa në Qeveri, kanë filluar veprimet e ngutshme në raport me emërimin e menaxhmentit, në raport me tenderin e organizatës konsulente, që janë ndarë 9 milionë.

Çka po ndodh në prag të miratimit të një strategjie ose të një ligji? Dhe kjo çështje duhet të ndërpritet urgjentisht, ndërsa mbetet e hapur çështja se si do të shkohet më tutje për “Trepçën”.

Të mos i qesim mjegull kësaj çështjeje. Edhe ata që e kanë përfaqësuar Parlamentin në AKP, këtë çështje nuk e kanë ditur kësisoj dhe është dashur AKP-së për t’i thënë, ju lutem ndërprisni të gjitha veprimet, sepse jeni jashtë ligjit tash. Ndërsa, sa i përket atij debatit të madh se çka do të bëhet me “Trepçën”, nuk është koha sot, sepse nuk e kemi projektligjin në dorë.

Edhe unë thërras Parlamentin, Kryesinë, komisionin përkatës t’i urdhërohet AKP-së, ndërpritni të gjitha veprimet, sepse tani jemi në prag të ligjit. Ose, çka na duhet ligji nëse sot AKP-ja i bën të gjitha këto veprime, çka na duhet ligji pastaj?

Edhe unë po dyshoj, sinqerisht po dyshoj cili është interesi, kur AKP-ja një vit s’ka vepruar kurrgjë, në prag të ligjit e thërret një ndërmarrje, i jep 9 milionë konsulentë, të cilët njerëz kanë për të mësuar se ku është “Trepça”, me gjithë këta ekspertë që i kemi në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, ke përgjigje? Urdhëro.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, kryetar!

Për “Trepçën” mediet merren vetvetiu, nën një dhe ajo nuk është çështje me të cilën merrem unë ose Qeveria, i marrim informatat për të gjitha fazat që shkon.

E dyta është, grupi i ekspertëve ka punuar në të dhe atë grup multidisiplinar duke filluar prej ekspertëve sendorë të cilët janë marrë me “Trepçën” tërë jetën, prej ekspertëve ekonomikë për aspektin ekonomik, ekspertë legalë dhe propozimi të cilin e nxjerrin vjen nga mu një analizë shumë e thuktë se si duhet të trajtohet më tutje “Trepça”.

Pajtohem plotësisht se sot më e rëndësishme do të ishte që të merremi me atë pse duhet të harxhohen 9 ose 10 milionë euro të Buxhetit të Kosovës për angazhim të një konsulence kur ne në prag e kemi një fillim të ristrukturimit dhe që sigurisht do të duhet konsulentë edhe në të ardhmen, por duhet mbi terma krejtësisht të tjera të referencës dhe mbi tjera detyrime se si do të organizohet në të ardhmen. Prandaj prapë po them edhe komisionit i cili merret me këtë çështje, nuk ka mandat Qeveria ta urdhërojë AKP-në - urdhëroni, ndërmerri diçka që të mos zvarritet kjo punë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk po mund ta kuptoj, ne hymë në një debat për “Trepçën” që konsideroj që jemi shmangur pak prej pikave të rendit të ditës, po sidoqoftë edhe unë po dua t’i them nja dy-tri fjalë.

Po dua t'ua bëj me dije kolegëve të mi deputetë se në qoftë se nuk e dinë vijën menaxheriale të “Trepçës”, vija menaxheriale nuk është Qeveria. Qeveria krijon politika për “Trepçën” dhe për pasuritë nëntokësore, ndërsa vija menaxheriale është Dhoma e Posaçme, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Njësia për Menaxhimin e “Trepçës”, që është ndërlidhëse në mes “Trepçës” dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Krejt ajo çka po dua të them nuk është mirë që këtë çështje shumë të rëndësishme, siç është rasti i “Trepçës” mos ta përdorim për marketing politik. Qeveria veç i ka nisur hapat e vet lidhur me kërkesën që ka bërë Kuvendi për përcaktimin e statusit të “Trepçës” dhe, unë kam kërkesë decidoje nga Qeveria, sa më parë ta sjellë në Kuvend orientimin e vet, qoftë ligjin e posaçëm për “Trepçën”, qoftë plotësim-ndryshimin e Ligjit për ndërmarrje publike, që lidhet gjithashtu me statusin e “Trepçës” dhe të gjitha diskutimet dhe debatet, mundësitë për ndryshime e për plotësime i kemi ne si deputetë në Kuvend, pasi që Qeveria ta sjellë në Kuvend një ligj të tillë.

Kështu që nuk kisha dashur që për këtë çështje të rëndësishme secili prej nesh jemi të interesuar ta shfrytëzojmë për fushatë politike, për marketing politik. Përpjekjet se kah do të shkojë “Trepça” nuk janë veç sot, nuk janë veç para dy vjetësh, nuk janë veç përpjekje e këtij koalicioni, por janë përpjekje me vite që e kanë bërë ekspertë të lëmive të ndryshme që lidhen kryesisht edhe me pasuritë nëntokësore edhe me “Trepçën”. E dimë na se cilat kanë qenë mundësitë për të bërë ne diçka në atë drejtim, i dimë hapat të cilët kanë shkuar në këtë drejtim dhe nuk është mirë askush ta përvetësojë, asnjë pjesë e koalicionit e asnjë deputet, se cili është versioni e vizioni më i mirë, sepse ato versione e vizione kanë ekzistuar edhe më herët.

Është tjetër që ne jemi dëshmitarë në këtë Kuvend, nuk ka kaluar një vizion më i mirë për “Trepçën”, i cili ka ardhur nëpërmjet strategjisë së minierave, nuk është votuar në këtë Kuvend e tani janë riaktualizuar ato vizione dhe ato ide, se kah do të shkojë “Trepça”.

Unë pres me urgjencë që Qeveria të sjellë në Kuvend Ligjin për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për ndërmarrjet publike, i cili do të përcaktojë edhe statusin e “Trepçës” e ne do të kemi rast mbasandaj ta pastrojmë si deputetë në bashkëpunim me ekspertë të kësaj lëmie. Faleminderit!

KRYETARI: Pse jemi në temë, por dua t'u tregoj rregullën 48 të Rregullores së Kuvendit.

“Pasi ta ketë mbajtur fjalën ministri, kryetari i Kuvendit lejon të parashtrohen komente ose pyetje në emër të grupeve parlamentare dhe nga deputetët e Kuvendit individualisht”.

Pra, në këtë rrafsh jemi tamam duke e kryer punën sipas Rregullores së Kuvendit.

Nëse më lejoni, kjo çështje trajtohet edhe në nenin 122 të Kushtetutës, në pikën 2: “Pasuritë natyrore si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat

përcaktuar me ligj se janë përcaktuar me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë në pajtim me ligjet.”

Mendoj që kjo temë është dashur të trajtohet, qoftë si interpelancë, qoftë si debat, por jo në këtë formë, po ky ishte vullneti edhe i ministrave.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, pyetjet parlamentare.

Fjalën e ka kërkuar Ismet Beqiri, kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Kryetar!

Unë kisha propozuar që këtë pikë ta shtyjmë në fund, ose sot mos ta mbajmë hiç e të kalojmë menjëherë në pikën e debatit. Është propozim i grupit tonë, nëse vendos Kuvendi, le të vendosë Kuvendi. Unë po propozoj që të kalojmë në pikën e debatit për gjendjen në Universitetin e Prishtinës. Po e propozoj në emër të grupit, për shkak të urgjencës e të gjitha zhvillimeve edhe e kërkesës për debat.

Ky është një propozim, një mocion i Grupit Parlamentar të LDK-së.

KRYETARI: Ftoj grupet parlamentare, por pa debat tjetër. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar, faleminderit!

Ne propozojmë që rendi i ditës të shkojë sipas përshkrimit që është miratuar edhe në Kryesi. Kjo nuk paraqet ndonjë urgjencë, ndërsa formulimi i vet fjalisë së debatit do kishte qenë shumë më serioz edhe për parashtresin e debatit, për arsimin në tërësi, e jo vetëm për Universitetin “Hasan Prishtina” në veçanti. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo është çështje tjetër, pastaj. Visar Ymeri e ka fjalën, kryetar i Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Ne jemi dakord që ta fusim këtë pikë të rendit të ditës, para pyetjeve parlamentare, konsiderojmë që është një debat jashtëzakonisht i rëndësishëm edhe për shkak të atyre që po ndodhin për çdo ditë në Universitetin e Prishtinës, kështu që mendojmë që do të kishte qenë mirë që Kuvendi sa më shpejt të merret me këtë çështje.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës pajtohet me propozimin e dhënë nga Lidhja Demokratike e Kosovës që në rend të ditës tash të jetë debati. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Ne jemi të pajtimit që të shkohet sipas rendit të ditës, të propozuar nga Kryesia.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, Sasha Milosavleviqi e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče! I naša poslanička grupa se slaže da se nastavi sa dnevnim redom, bes preskakanja tačaka. Hvala!

KRYETARI: Tani nga “6+” e ka fjalën Albert Kinolli, kryetar i Grupit.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe ne jemi të pajtimit që të vazhdojmë me punën sipas rendit të ditës, i cili është miratuar në Kryesi të Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: 71 deputetë janë të pranishëm, shkojmë në një votim formal.

Kush është për? Faleminderit, shumica. Kush është kundër? Shumica ishte për.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Para se ta fillojmë debatin parlamentar, na duhet një votim për procesverbalin.

A ka ndonjë vërejtje? Nëse nuk ka, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 30 dhe 31 janar 2014.

Vazhdojmë me pikën e katërt:

4. Debat parlamentar lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka kërkuar debat parlamentar lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës. E ftoj deputetin Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe në cilësinë e propozuesit të çështjes.

Fjalën e ka Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Pasi i kam ndjekur me kujdes zhvillimet në Universitetin “Hasan Prishtina” në Prishtinë, me theks të veçantë edhe ngjarjet e fundit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka kërkuar këtë debat në institucionin kompetent, në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se ngjarjet e fundit e kanë dëmtuar shumë imazhin e universitetit më të madh e më të njohur në vend dhe se ato janë pasojë e ndërhyrjeve sistematike të koalicionit qeverisës, por LDK-ja mendon se në funksion të stabilizimit të gjendjes kontribut duhet të japim të gjithë.

Gjithashtu, konsiderojmë se edhe protesta si një e drejtë kushtetuese nuk duhet të ndikohet nga ndërhyrjet politike të cilitdo subjekt, qoftë qeveritar apo edhe opozitar.

Universiteti i Prishtinës përgjatë dekadave ka qenë institucioni më i rëndësishëm i arsimit të lartë në Kosovë dhe burim kryesor i dijeve në vendin tonë. Si institucion i parë dhe më i madh i këtij niveli, universiteti ishte prijës në fushën e arsimit dhe shkencës, vend nga kanë dalë njerëzit e dijes së Kosovës dhe drejtues edhe të fateve të vendit tonë.

Tradita e punës në Universitetin e Prishtinës është e lidhur me zhvillimet e reja sociale dhe politike në Kosovë, madje në një pjesë të mirë të tyre universiteti edhe ka vënë vulën e vet.

Por, gjatë viteve të fundit Universiteti i Prishtinës po kalon nëpër vështirësi të shumta të natyrës akademike dhe financiare dhe në kohë të fundit në pah kanë dalë dukuri si marrja e mitos, gradimet shkencore jashtë kriterëve dhe politizim i skajshëm.

Nga këto dukuri ka derivuar një gjendje me veprime dhe pasoja të shumta. Regjistrimi jashtë kriterë i studentëve në Universitetin e Prishtinës është njëra nga dukuritë negative që është përcjell gjatë këtyre viteve. Kjo dukuri është bërë fenomen përmes së cilit Qeveria ka tentuar ta ruajë qetësinë sociale, ndërkohë që për pasojë kemi rënien e cilësisë së studimit dhe të punës shkencore, si dhe krijimin e një problemi me ndikim afatgjatë dhe rritjen e diskrepancës ndërmjet të diplomuarve dhe tregut të punës.

Cilësia në arsimin e lartë është rrezikuar më tej me vendimet politike dhe me funksion elektoral për hapje të universiteteve të reja publike, pa ndonjë studim paraprak të nevojave, programeve dhe kuadrit dhe pa specifika të nevojshme ndërmjet këtyre universiteteve.

Zhvillimi i arsimit të lartë në Kosovë e në kuadër edhe të universitetit ka përjetuar një zhvillim ekspansiv me elemente të stihisë, për nga numri i studentëve në popullatën e moshës 18-24 vjeçe ka pasur një rritje eksplozive viteve të fundit.

Kështu, Kosova me një përfshirje prej 44% të të rinjve në këtë grupmoshë vjen menjëherë pas Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe është dukshëm përpara Bosnjës, me 27%, Maqedonisë 35% dhe Serbisë me 36%.

Megjithatë, indeksi i zhvillimit njerëzor i Kosovës është më i ulëti midis këtyre vendeve, e kjo ngjan edhe me përqindjen e popullatës me arsim të lartë, prej të cilës vetëm 6,7% me arsim universitar dukshëm më e ulët sesa në të gjitha vendet e përmendura.

Kjo do të thotë se rritja e numrit të studentëve, në këtë rast edhe e universiteteve, nuk po shprehet me përmirësim të këtyre treguesve. Kjo për faktin, se cilësia dhe efektiviteti i këtij edukimi është i ultë dhe rritja e numrit të studentëve nuk është përcjell edhe me rritjen proporcionale të investimeve në hapësirë, në staf dhe shpenzime operacionale.

Me një sistem efektiv dhe domethënës e sistematik të sigurimit të cilësisë, Kosova dedikon shumë pak për arsimin e lartë dhe atë vetëm 0,97%, çka do të thotë as 1% nga prodhimi i brendshëm bruto.

Gjithnjë sipas raporteve zyrtare, i referohem atyre të auditimit, ky fenomen i ka përfshirë të gjitha njësitë akademike, por më i theksuari siç e dini, ishte ai në Fakultetin e Mjekësisë. Gradimet në kundërshtim me procedurat e rregullta, gjithashtu janë njëra prej dukurive që barten nga stafet e kaluara menaxheriale, e që në pah kanë dalë tani.

Se deri në çfarë niveli ka arritur kjo dukuri, mbetet për t'u parë nga shkaku se kjo sferë është e ndjeshme dhe kërkon një qasje profesionale të rishikimit dhe ne nuk do të ndalemi shumë, por është detyrë e organeve përgjegjëse, që opinionit në përgjithësi, studentëve e stafit akademik të universitetit, t'ua prezantojë gjithësi gjendjen reale.

Dhe së fundi, si performansë e dobët menaxheriale në Universitetin e Prishtinës është edhe moskrijimi i klimës, rrethanave, kushteve, por edhe mungesë e mjeteve për kërkime shkencore, botim të revistave shkencore kredibile si dhe furnizimi me revista shkencore eminente të cilat do të duhej të ishin dritarja e parë shkencore e këtij institucioni të dijes dhe shkencës.

Këto dhe shkaqe të tjera kanë bërë që Universiteti i Prishtinës të rangohet tepër ulët në ranglistën e universiteteve botërore, madje ky universitet ka humbur pozicionin nga viti në vit. Vetëm nga viti 2012 deri te viti 2013 ka rënë në më shumë se një mijë vende.

Lidhja Demokratike e Kosovës edhe një herë bën thirrje që këto zhvillime të mos përdoren nga subjekte politike meqë këto nuk ndihmojnë depolitizimin e universitetit. Çështjet duhet të diskutohen paanshëm, me ndjeshmërinë dhe peshën që kanë dhe me këtë ne ju ftojmë në një debat konstruktiv në funksion të tejkalimit të gjendjes në Universitetin e Prishtinës.

Në vazhdim do t'i prezantojmë rekomandimet e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të cilat besoj se do të pasurohen me debatin që do të zhvillohet këtu dhe do të harmonizohen bashkërisht nga të gjitha subjektet.

Në këtë situatë dhe me qëllim që të ndihmojmë në mënyrë vendimtare, LDK-ja rekomandon:

1. Rektori dhe Këshilli Drejtues i universitetit e kanë humbur kredibilitetin për të udhëhequr më tutje me këtë institucion, prandaj rektori i Universitetit "Hasan Prishtina", zoti Ibrahim Gashi dhe anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të japin

dorëheqje si aktin e tyre moral, në mënyrë që t'i shërbejnë procesit të normalizimit të punës në universitet.

2. Të vlerësohet përgjegjësia e Ministrisë së Arsimit, në përgjithësi, ministrit dhe Ministrisë për mospërcjelljen me kohë të zhvillimeve në universitet dhe mosmarrjen e masave ligjore në kohën e duhur.
3. Qeveria të heqë dorë nga kontrolli i paligjshëm që ka vënë mbi universitetin dhe nga përdorimi i tij, si vend akomodimi për militantët e saj politikë, si dhe të respektohet autonomia e plotë e universitetit.
4. Organet kompetente, duke përfshirë edhe Prokurorinë, të kërkojnë përgjegjësi dhe t'i vënë para drejtësisë pjesëmarrësit në veprimet e kundërligjshme në universitet.
5. Të respektohet Statuti i universitetit për zgjedhjen dhe gradimin e stafit akademik dhe të revokohen zgjedhjet dhe gradimet e pamërituara.
6. MASHT-i së bashku me universitetin t'i përcaktojë politikat e regjistrimit në përputhje me kapacitetet akademike, fizike dhe financiare.
7. Të mos nëpërkëmben profesorët dhe shkencëtarët që janë pjesë e Universitetit të Prishtinës, të cilët kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë punë akademike të mirëfilltë shkencore.

Të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces duhet të angazhohen ta ruajnë kredibilitetin dhe integritetin e mësimdhënësve në universitet. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e ministrit Ramë Buja.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës, Kolegë ministra nuk paskam.

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës,

I nderuar Grup Parlamentar i LDK-së,

Faleminderit shumë për debatin e ngritur për këtë çështje që besoj na shqetëson të tërëve, sepse në fakt nuk besoj që arsimi ka as ngjyrë as ndasi politike, të gjithë jemi të interesuar që kjo çështje të shkojë mbarë e mirë dhe natyrisht kjo gjendje e krijuar na ka trazuar të gjithëve e padyshim e trazon atë që ka përgjegjësi më shumë.

Çështja në Universitetin Publik të Prishtinës është diçka që unë besoj që ka rrugëzgjdhje, ka mundësi që këto çështje, këto probleme të tejkalohen, por unë shoqërisht e miqësisht dhe institucionalisht ju kisha ftuar sot për një debat konstruktiv, që jam i bindur që do të ndodhë edhe për faktin që të gjithë ne këtu, ose me ndonjë përjashtim të vogël, jemi produkt i këtij institucioni shumë kredibil, shumë të respektuar që ka prodhuar të mira për Kosovën gjithmonë dhe ndonjëherë ka pasur edhe ndonjë lajthitje siç është tash.

Jam deklaruar edhe publikisht se kjo gjendje më ka trazuar shumë dhe më ka gëzuar njëkohësisht, mbase është shumë kontrastive kjo por fakti është që njëherë do të duhej filluar që kjo ployë dhe ky pështjellim të zhdavaritet, të zgjidhet. Dhe, unë besoj shumë që nuk është e mundur me kompetencat ligjore që ka, jo për t'u shfaqësuar, Ministria e Arsimit dhe ministri, për ta zgjidhur këtë problem gjer në fund, por do të duhej që ju si institucioni më i lartë shtetëror politik e juridik, ligjbërës dhe me të tri funksionet e juaja, zgjedhor dhe mbikëqyrës, padyshim Qeveria si tërësi, ministria në veçanti dhe legjislativi ose pushteti i tretë, gjyqësori, të merret me këtë çështje.

E dimë bashkë pse është kështu, pa dashur të sqaroj, sepse në fakt gjërat kanë shkuar gjer aty sa do të duhej që të shihen nga të gjitha rrafshet, nga të gjitha prizmat. Unë jam po kështu i bindur që do t'i përmbahemi një thënieje, le të më falë autori nëse nuk e citoj besnikërisht, por kuptimisht besoj po që e gjejmë diku në "Kështjellën" e Ismail Kadaresë ku thuhet që: "mallkuar qoftë ai njeri dhe ai popull që mallkon vendin ose burimin prej nga ka dalë."

Unë jam i sigurt për këtë, për faktin që debati do të jetë në funksion të asaj që ne të dalim bashkë nga kriza, për t'ia kthyer kredibilitetin institucionit që ishte dhe duhet të mbetet kredibil.

Çfarë ka bërë ministria në këtë çështje? Unë, mund të verifikohet, i kam bërë të gjitha detyrat e mia që më takojnë me ligjin që është aprovuar në këtë Parlament, këtu. Kam thirrur jo një herë Këshillin drejtues që është mekanizëm menaxherial dhe iu kam sugjeruar që ata këtë gjendje të krijuar ta menaxhojnë në atë formë të logjikshme dhe legale që të mos shfrytëzohet rasti nganjëherë qysh dimë ne në këto ambiente jo vetëm shqiptare që situatat e krijuara të tjera t'i shfrytëzojmë për hakmarrje të caktuara dhe jam zotuar dhe gjer më tani është vepruar gati racionalist. Dhe, natyrisht që sugjerimi im ka qenë që t'i marrin hapat që janë ndërmarrë për të, për t'i sugjeruar institucionit kredibil akademik - Senatit, që të marrë hapat që ka marrë, për të vlerësuar të gjitha këto gjëra që kanë ndodhur në universitet, duke vlerësuar punimet shkencore në atë nivel akademik, sepse nuk kemi të drejtë, as gazetarët nuk kanë të drejtë kështu, të vlerësojnë siç po vlerësojnë nganjëherë dhe pastaj të jepet kohë për t'i bërë të gjitha, për t'i vendosur në peshore logjike dhe legale të gjitha këto për të dalë nga kriza.

Unë ju zotohem këtu para jush që unë do t'i bëj të gjitha detyrat që më shtrohen edhe në bazë të sugjerimeve dhe rekomandimeve që ka grupi parlamentar për të realizuar ato që janë për synim për të dalë nga kriza dhe natyrisht t'i mbaj në supe të gjitha përgjegjësitë që më takojnë për të gjitha situatat edhe këtë situatën e fundit, të krijuar.

Çështja është se kërkohet gjithmonë që politika të mos jetë e pranishme në universitet. Faleminderit shumë për sugjerimin edhe unë sugjeroj kështu, por po kështu e dimë nga pak që është e pamundur në institucionet publike kudo në botë, të mos ketë ngjyrim politike paksa. Më gjeni diku një institucion publik që është ai që s'ka hiç ngjyrim politik dhe unë ju falënderoj shumë. Dhe, çështja është që jemi të përzier ose është përzier politika për aq se ka lejuar ligji, ligji që është aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Unë duke qenë, duke ju përshëndetur dhe duke ju uruar debat konstruktiv dhe përmbajtjesor, unë po ju them edhe njëherë, ju zotohem që do t'i kryej të gjitha detyrat e mija që më përkasin me ligjin që është aprovuar në këtë Parlament të nderuar të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Tani radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Ramë Vataj, po derisa deputeti ta marrë fjalën, mund t'ju them që kurrkush nuk mund t'ia mohojë një subjekti politik që të ketë politika arsimore, por politikat arsimore duhet të jenë për ngritje dhe jo për rënie të cilësisë.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër i Arsimit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqenëse është kërkuar debat parlamentar në lidhje me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës, do të fokusohem më tepër në këtë universitet edhe pse ne mendojmë që është dashur të bëhet debat në lidhje me gjendjen në përgjithësi në institucionet e arsimit të lartë dhe të shkencës në Kosovë.

Gjendja në institucionet e arsimit të lartë dhe shkencës nuk është e mirë ose së paku jo ajo gjendje çfarë ne dëshirojmë që të jetë. Nuk mund të prejdukjmë as t'i bëjmë për gjithçka fajtorë për këtë gjendje menaxhmentet e tanishme, ose ministrin e tanishëm të Arsimit, pasi që ndërtimi i sistemit arsimor është afatgjatë dhe proces në vazhdimësi dhe në rast të shkapjes së hallkës së këtij sistemi pasojat manifestohen me dhjetëra vite pas.

Mund të supozojmë ose të konstatojmë se tani jemi duke vuajtur pasojat e viteve të '90-ta kur kemi dalë nëpër shtëpi private dhe i tërë sistemi arsimor është organizuar në suaza të mbijetesës.

Gjendja e tanishme nuk është e kënaqshme në të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe të shkencës dhe mendojmë se për të filluar rregullimin e sistemit duhet përfshirë në radhë të parë Universitetin e Prishtinës e pastaj s'duhet lënë anash as Akademinë e Shkencave dhe të Arteve si institucioni më i lartë i shkencës dhe artit në Republikën e Kosovës.

Ndryshimi i gjendjes së rëndë mund të bëhet vetëm duke aplikuar kritere, të cilat i përdor i gjithë komuniteti akademik dhe shkencor në mbarë botën. Vlerësimi i veprimtarisë shkencore dhe akademike duhet të jetë transparent dhe i udhëhequr nga njerëz kompetentë në bazë të dëshmive prej motorëve të kërkimit relevantë për secilën lëmi, duke mos shikuar emra, por vetëm vlera dhe numër të publikimeve të secilit individ që punon në këto institucione.

Unë nuk do të bëj përshkrimin e gjendjes së tanishme në universitet, mirëpo do t'i sqaroj më tepër disa kritere që duhet ose është dashur të plotësohen në mënyrë që të mos vijnë deri te kjo gjendje, të përfolën profesorët ose punëtorët universitarë se janë ngritur në mënyrë jo të merituar në nivele, në grada akademike.

Unë rreth dy vjetëve më parë kur në këtë sallë të Kuvendit kam përmendur nocionet, “revista me recension ndërkombëtar”, citimet e punimeve të një autori “impakt faktori, indeksi i hiershit” e të tjerë, sikur atëherë edhe sot mendoj se vetëm kur ne do të jemi në gjendje t’i aplikojmë plotësisht këto standarde, atëherë mund të jemi krenarë për vlerën e cilësisë që ka Universiteti i Prishtinës dhe academia.

Pra, kur flasim për publikime kualitative, nuk mund të mos përmendim revistat me “impakt faktorë” dhe “indeksin e hiershit” apo edhe numrin e citimeve të publikimeve të kandidatit që janë masë e kriterit më real të publikimeve cilësore që e karakterizojnë një shkencëtar të mirëfilltë.

Ne në Universitetin e Prishtinës kemi profesorë të cilët kanë nga 30 deri 100 publikime në revista ndërkombëtare me impakt faktorë dhe që këto publikime citohen nga 1 500 deri 2 500 herë. Mirëpo, është absurd që rrogën e njëjtë e merr si ai që ka këto publikime si ai që publikimet, përveç që janë të pakta, asnjëherë nuk citohen, prandaj ky është një defekt në sistemin tonë arsimor dhe shkencor.

Duhet të themi se statuti i Universitetit të Prishtinës, duke u bazuar edhe në Ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, rregullon pranimin dhe avancimin e stafit akademik dhe kushtet e përcaktuara aty janë relativisht të buta. Është fakt se aty kemi vetëm një matje kuantitative të punimeve, pra kërkohen një, tre apo pesë publikime për avancim të profesorëve, ndërsa nuk kërkohet fare kriteri kualitativ i tyre.

Prandaj, më vonë dalin probleme të cilësimit nga më të ndryshmet, ku paraqiten edhe terminologji, si revista të dyshimta, korruptive, apo jo kualitative.

Nëse duhet të merremi me ata që botojnë në revista të tilla të dyshimta apo jo kualitative, duhet patjetër të merremi edhe me ata që nuk publikojnë fare dhe... avancohen dhe marrin përfitime nga këto avancime.

Prandaj, për të mos ardhur në keqinterpretime dhe vlerësime nga më të ndryshmet, duhet që përgjegjësi më të madhe të mbajnë komisionet recensuese dhe këshillat e fakulteteve dhe për çdo avancim të pamerituar të japin përgjegjësi. Këtyre komisioneve duhet që t’u kërkohet qartë respektimi i statutit aktual deri në ndryshimin e tij.

Ne kemi probleme me llojin e revistave që mund të merren parasysht, sidomos në shkencat shoqërore dhe humane, prandaj duhet që paraprakisht Senati i Universitetit të Prishtinës të miratojë listën e revistave relevante ku mësimdhënësit mund të publikojnë dhe ato punime mund të merren parasysht për avancime.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dënon të gjitha shkeljet të cilat kanë ndodhur në Universitetin e Prishtinës, si regjistrimet me të holla të studentëve, shitblerje e notave dhe falsifikimi i tyre, për të cilat përkrahim dhe inkurajojmë organet e hetuesisë që të merren me hetimet e tyre dhe të dënohen keqbërësit. Po ashtu, jemi edhe kundër pranimeve dhe avancimeve të pamerituara në cilindo institucion të arsimit të lartë dhe të shkencës.

Grupi ynë parlamentar jemi për një punë transparente në të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet tjera shkencore, që të formohen komisione vlerësuese të të gjitha fushave për t'i vlerësuar të gjitha diplomat e magjistraturës dhe doktoraturave, titujt e fituar dhe pesha e punimeve shkencore, mënyra e pranimit dhe avancimit të profesorëve gjatë karrierës së tyre akademike. Jemi që të hetohet se a ka plagjiatura në veprat dhe punimet e tyre, si dhe çdo përfitim i paligjshëm në këtë drejtim të sanksionohet me heqje të gradës dhe kthim të gjitha përfitimeve që i ka arritur nga avancimi apo pranimi i paligjshëm. Rishikimi i titujve duhet të bëhet për gjithë personelin aktiv që merr rrogë nga Buxheti i Republikës së Kosovës, nga një komision i ekspertëve të këtushëm, në rast nevoje edhe me ekspertë të jashtëm.

Ne kemi besim në organet e Universitetit të Prishtinës se ato do t'i kryejnë në mënyrë shumë profesionale dhe kompetente detyrat që ia jep statuti dhe ligji dhe mendojmë që problemet dhe zgjedhjet e tyre bëhen brenda universitetit. Çdo interferim i politikës në çështjet akademike të universitetit është shkelje e autonomisë akademike, të cilën e garanton ligji. Prandaj edhe duhet të besojmë që nga rekomandimet që do të nxjerrim nga ky debat vetë universiteti do të mund të bëjë përmirësimet e duhura.

Besojmë që kjo është një nismë e mirë që të fillohet me Universitetin e Prishtinës dhe të vazhdohet edhe me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ku janë vërtetuar shkelje të rënda gjatë pranimit të anëtarëve të rinj të Akademisë, ku një kohë jemi akuzuar për tentim të shkatërrimit dhe politizimit të Akademisë, nga partia në pushtet. ndërsa po na vjen mirë që dy vjet më pas po të njëjtit që akuzonin për tentim të shkatërrimit të institucionit më të lartë të shkencës, po kërkojnë të vënë rregull dhe ligj në një institucion më pak të ulët të shkencës.

Unë si kryetar i Komisionit për Arsim, njëherësh dhe profesor në Universitetin e Prishtinës, ndjej obligim dhe ftoj që të fillojë verifikimi i të gjitha gradave dhe titujve akademikë në institucionet e arsimit të lartë të Kosovës prej vitit '90 e tutje. Së pari, prej meje, me ç'rast po ia dorëzoj CV-në time me publikime nga avancimi i fundit dhe raportin e Komisionit recensues, sekretarisë së Kuvendit, në mënyrë që ta keni secili prej juve që jeni të interesuar të dini për veprimtarinë time shkencore dhe akademike.

Kuptohet, vlerësimin le ta bëjë një Komision profesional këshillimor, i cili do të bëhet nga personalitete të njohura të fushës së arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor më kompetent për këtë. Kuptohet, për rekomandimet që do t'i nxjerrim do të bëhemi bashkë me grupet parlamentare apo me propozuesin dhe ne jemi për të nxjerrë rekomandime që do të plotësohen nga ne. Faleminderit !

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", kush e do fjalën? E ka fjalën Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kriza e gjithanshme që e ka përfshirë shoqërinë tonë askund nuk është duke spikatur më shumë dhe më tepër se sa në sferën e arsimit në përgjithësi dhe atë universitare në veçanti. Kjo krizë ku ndodhet sot Universiteti i Prishtinës si bartësi më i madh i arsimit të

lartë në Kosovë, simptomatikisht përbën edhe thelbin e kaosit tonë politik, vleror dhe moral që ka pushtuar shoqërinë tonë tash e sa kohë, sepse aferat në këtë institucion akademik përbëjnë edhe njërin nga skandalet e tmerrshme politike. Pra, kriza në UP është edhe shprehje e drejtpërdrejtë e mendësisë politike dhe institucionale që ka dominuar në Kosovën e pasluftës.

Në fund të fundit nuk duhet harruar faktin se edhe çështja e arsimimit apo mos arsimimit të një shoqërie është çështje ekskluzive e një orientimi politik dhe kulturor të një entiteti organizativ e nga ndërthurja e këtyre aspekteve promovohen kriteret legjitimuese mbi të cilët ndërtohet një rend shoqëror, ndërkaq prishja e këtyre kriterëve përbën esencën e krizës. Dhe, ky fenomen mund të thuhet se përbën tiparin themelor të shoqërisë sonë në të gjitha aspektet e saj qenësore, si në aspektin politik, ekonomik, kulturor e tjerë. Madje, është e ditur se që nga origjina e këtij ligjërimi perëndimor ka qenë i fokusuar në definimin e kriterëve teorike për politikën, kërkimin e dijes dhe etikën. Pra, këto sfera kanë qenë në një raport binjakëzimi njëra me tjetrën dhe kanë derivuar nga ajo perspektivë që ne sot e quajmë Perëndim.

Natyrisht, me kalimin e kohës këto relacione do të marrin edhe dimensione të reja, sepse me lindjen e modernitetit dhe pasojat që do të prodhojë kjo frymë, do të shfaqet edhe ideja universiteti si një institucion akademik, ku do të promovohet vendndodhja, kërkimi dhe investimi i dijes. Kështu dija bashkë me format e instancat e prodhimit dhe riprodhimit të saj, do të bëhen në epokën moderne çështje përherë e më politike, një politikë e tërë shtetërore, por jo vetëm e dijes, zhvillohet këtu si kusht i ekzistencës së shteteve moderne, të cilat bëhen të pandashme, tani nga një politikë e tërë arsimore, madje e pakonceptueshme pa të.

Dhe, kuptohet që në një dinamikë të tillë universiteti do të jetë një nga hallkat kryesore. Kjo kthesë paradigmatisht që do ta shoqërojë epokën tonë do ta shtrojë si nevojë qenësore arsimimin e përgjithshëm të shoqërisë, sepse ajo do të jetë kruciale për ekzistencën e shtetit, për shkak të dinamikës ekonomike dhe politike dhe konkurrencës ndërmjet shteteve që prodhon kjo epokë.

Pra, sot dija është bërë njëra nga forcat kryesore të prodhimit dhe se tashmë shihet qartë se ajo jo vetëm që do ta ruajë, por do ta përforcojë edhe më tej rëndësinë e saj në baterinë e aftësive prodhuese të shteteve kombe, sidomos kur dihet fakti se tashmë hendeuku ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe atyre që nuk janë të zhvilluara, do të shkojë duke u thelluar pikërisht për shkak të qasjes të këto burime, sepse është e ditur për një arsye shumë të thjeshtë, për shkak të kohës tepër të gjatë që duhet për prodhimin, qoftë të një tekniku të lartë apo të një dijetari të mesëm e që është i domosdoshëm për t'i përballuar këto sfida që na janë imponuar.

E vendet që janë të privuara nga këto cilësi sikur rasti i Kosovës mbeten në margjinat e proceseve globale historike, qoftë si aftësi prodhuese apo si entitet kombëtar, madje lirisht mund të thuhet se edhe themelimi i Universitetit të Prishtinës ishte konceptuar mbi këto tipare.

Në këtë mënyrë synohej që paralelisht me zhvillimin e aftësive prodhuese të përpunuar industriale, dija e përgjithshme e shoqërore e prodhuar në universitet, të shndërrohet në aftësi të këtij prodhimi. Pra në sajë të këtij kombinimi, së bashku me zhvillimin e vetëdijes kombëtare, pretendohet që nëpërmjet Universitetit të realizohej emancipimi nga e ashtuquajtura atëherë “kolonializmi socialist”. Dhe, nuk është e rastësishme që Milosheviqi pas ardhjes në pushtet, prodhimin dhe arsimimin i goditi si të parat, sepse strategjikisht shkatërrimi i një shoqërie më së miri bëhet kur ai komb është i privuar nga aftësitë prodhuese dhe burimet e dijes.

Por ajo që vlen të diskutohet në këtë moment është mënyra katastrofave se si u menaxhua në Kosovën e pasluftës ky proces në përgjithësi e ai universitar në veçanti. Për shkak të logjikës partitokratike për hegjemoni shoqërore dhe politike, universitetet u shndërruan në viktime të para të kësaj mendësie. Me këtë rast nga qendër për prodhimin e dijes, në funksion të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor, ky institucion akademik u shndërrua në qendër të prodhimit, mashtrimit e të korrupsionit, mënyrë kjo që me këtë qeverisje arriti majën kulmore ashtu siç e dëshmojnë edhe skandalet e fundit.

Deficitet e tmerrshme që karakterizojnë këtë institucion sot, që nga mungesa e kushteve adekuate për studim, mungesa e literaturës së duhur shkencore e deri tek profesorët jo kredibil, tregon se UP-ja sot është shndërruar vetëm në një makineri për mobilizim partiak dhe në efektet e kësaj tendence varrmihëse për idenë e universitetit shihet qartë se qëllimi që të ketë sa më shumë studentë nuk është që bëhet edukimi i tyre, por sepse së pari duhet zvogëluar artificialisht papunësia, së dyti, sepse diqysh duhen marrë votat rinisë, së treti sa më shumë asistentë e profesorë, edhe pse shpesh më injorantë se studentët, sepse duhen punësuar dhe shpërblyer disi për militantizmin e tyre partiak.

Sa më shumë artikuj gjoja dhe punime shkencore dhe sa më shumë gjoja diploma, që në 99% të rasteve do të jenë certifikata papunësie, por 1% do të prodhojnë ndoshta ministra dhe rektorë. Kjo natyrisht që më pastaj e vret universitetin dhe shfaq fenomene si Ibrahim Gashi me kolegët e tij.

Në këtë kontest e ka edhe bazën logjike të këtij mashtrimi masiv në formë piramidale, i cili derivohet drejtpërdrejt nga shkatërrimi i kriterëve fundamentale, me të cilat legjitimohet dija akademike. Pra, kjo krizë e ka bazën pikërisht te kjo mënyrë menaxheriale e këtij institucioni, e kjo frymë e shkatërrimit të universitetit të zhvilluar pikërisht në bekimin e kësaj politike. Në fund të fundit, dihet se të gjitha strukturat e deritanishme menaxhuese të UP-së kanë ardhur nga strukturat partiake, e të mos flasim për komisionet recensuese, për zgjedhjen e stafit akademik, që si kriter të vetëm e kanë pasur rekrutimin e militantëve partiakë.

Përmbajtësisht, këtu ndodhet edhe shkaku i aferave të tmerrshme të zbuluara kohë më parë, ku tregohet se si një rreth i tërë i përbërë nga profesorë, asistentë dhe studentë, se si regjistronte jashtë afateve studentë, tregtonte provime, punësonte staf akademik, e shumë e shumë keqpërdorime të tjera, dukuri këto që fatkeqësisht duket sikur hetimi ndaj tyre për momentin është hequr.

E të mos flasim këtu për mashtrimet e paskrupullta, ku tregohet se ishte përfshirë një armatë e profesorëve mashtrues sa i përket pseudopublikimeve të tyre.

Duke artikuluar deficitet e Universitetit të Prishtinës, me të drejtë një profesor i këtij institucioni këto ditë deklaroi se UP-së sot i mungon profesori intelektual, i përgjegjshëm, i dijshtëm dhe i hapur për dije të reja, profesori i cili në shpirt e ndjen misionin, e jo vetëm postin ose pozicionin, profesori i cili në bashkëveprim me kolegun, me studentin, me ekspertin krijon dije të reja dhe ato dije i transmeton te publiku.

Sot UP-së po i mungon menaxhmenti i pavarur nga politika, i cili jep llogari stafit dhe studentëve, e jo shfave të partisë. Menaxhmenti i cili mendon për universitetin, duke filluar që prej rrethojave e deri te djerrinat e kampusit, deri te dokumentet e mbushura me frazeologji, të cilat as nuk kuptohen, as nuk zbatohen. Menaxhmenti i cili ka vizion për të ardhmen dhe që reflekton përgjegjësi për të sotmen.

Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron se situata në UP sot është më se urgjente dhe se situata të tilla kërkojnë edhe masa më radikale për të dalë nga kjo krahurë. Prandaj, duke marrë parasysh rekomandimet që ka propozuar Grupi Parlamentar i LDK-së, konsiderojmë se duhet shtruar edhe disa propozime tjera si mënyrë për të dalë nga kjo situatë.

Fillimisht konsiderojmë se Këshilli Drejtues duhet që nesër të bëjë shkarkimin e rektorit Ibrahim Gashi. Pra, të jetë vendim obligativ, sepse nuk ka kuptim që një person, i cili dyshohet se ka përdorur punime për avancim akademik, që nuk janë nga sfera e tij, të jetë edhe i pari i universitetit. Po ashtu, duhet urgjentisht të largohen forcat e Policisë nga hapësira e universitetit, sepse nuk mund të mbrohet injoranca në masa represive.

Duke marrë parasysh që Kuvendi është themeluesi i këtij institucioni, është më se e rëndësishme që komisioni i emëruar nga Senati ta informojë po ashtu Komisionin Parlamentar për Arsim në baza javore me shkrim mbi gjetjet e tij lidhur me hetimet mbi publikimet e profesorëve nëpër këto revista të dyshimta.

Po ashtu, në një situatë afatmesme të përgatiten ndryshime ligjore dhe statusore, ku Këshilli Drejtues i UP-së dhe Agjencia e Kreditimit të vihen në varësi të Kuvendit dhe anëtarët e këtyre mekanizmave duhet të emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 2/3 e deputetëve të pranishëm që votojnë.

Këto janë vetëm disa nga masat për ta përgatitur një strategji më masive që duhet të ndodhë për ta nxjerrë UP-në nga kriza. E nëse nuk ndodhin këto ndryshime menjëherë, atëherë lirisht mund të themi se nesër UP-së ia garantojmë një vdekje të palavdishme akademike. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,

Zhvillimet e fundit në Universitetin e Prishtinës s'do mend se e kanë krijuar në radhë të parë një atmosferë aspak të këndshme, për të mos thënë tepër të zymtë për vetë imazhin e institucionit tonë më të lartë arsimor, institucion ky që dikur ishte krenaria e Kosovës.

Ç'është e vërteta kjo gjendje dhe kjo atmosferë e rënduar në këtë vatër të diturisë është rezultat i politizimit të skajshëm që i është bërë për vite me radhë këtij institucioni.

Të gjithë pra jemi dëshmitarë se ku është katandisur kjo vatër e dijes dhe e zërit krye më vete, vatër në të cilën u farkuan gjenerata të tëra, të cilat më vonë u bënë bartëse e të gjitha zhvillimeve progresive për liri dhe dinjitet kombëtar.

Ndërsa para nesh shtrohet pyetja shumë e thjeshtë: A duhet të qëndrojmë duarkryq para kësaj gjendjeje të krijuar?

Realisht, keqmenaxhimi i vazhdueshëm i udhëheqjes së universitetit, mospuna shkencore e ligjëruesve në këtë institucion arsimor, skenat korruptive, skandalet e vazhdueshme, si ato në Fakultetin e Mjekësisë, të cilat veç janë të njohura për opinionin, ndërsa edhe sot e kësaj dite nuk është ndërmarrë asnjë hap për ndëshkimin e keqbërësve, e deri te arrestimet e fundit dhe dyshimet për keqpërdorime e mashtrime nga vetë rektori janë përfolur prej vitesh, krahas shumë mangësive të tjera, të cilat i kanë shoqëruar.

Pasiviteti studimor i stafit akademik nuk ka filluar me rektorin Gashi.

Ne si Aleancë mendojmë se e kemi kërkuar dorëheqjen e rektorit Gashi si pasojë e të gjitha këtyre zhvillimeve negative. Mendojmë se problemi i krijuar nuk qëndron vetëm te personaliteti apo dorëheqja e rektorit, por te mendësia që e solli atë si rektor në UP, pra politika. Universiteti i Prishtinës është politizuar dhe degraduar si kurrë më parë.

Madje, edhe pozita e rektorit fatkeqësisht bëhet pjesë e pazareve politike ndërmjet PDK dhe AKR-së.

Sidoqoftë, ne mendojmë se dorëheqja e rektorit as që duhet diskutuar. Dhe, kjo për shumë arsye. Për faktin se rektori e ka shfrytëzuar pozitën për t'u avancuar, e në fakt do të duhej të ishte e kundërta.

Universitetit të Prishtinës i duhen njerëz të ndërgjegjshëm, profile akademike, të cilat janë avancuar pasi marrin pozita në universitet. Sepse, brenda universitetit jemi të vetëdijshëm se kemi profesorë të përgjegjshëm, të cilët janë avancuar me meritë dhe mendojmë se ky numër nuk është i vogël.

Në këtë kuptim, kërkojmë që të publikohen të gjitha punimet shkencore që nga paslufta, në mënyrë që të dihet saktësisht numri i atyre që janë avancuar pa meritë nëpërmjet mashtrimeve dhe favore politike, klanore, grupore e tjera.

Ndarja e vlerave nga jovlerat do të jetë një fillim i mbarë për rikthimin e reputacionit të Universitetit të Prishtinës.

45 ditë të kërkuara nga komisioni i ngrehur në kuadër të Senatit për të dalë me rekomandime të qarta për zgjedhjen e problemit, mendojmë se është kohë e gjatë dhe madje e panevojshme, që mund të përdoret për humbje kohe e gjurmësh, apo marifetllëqe të tjera njerëzore të njerëzve të inkriminuar në këtë krim të organizuar brenda UP-së.

Ne sot, para së gjithash, duhet të reflektojmë përgjegjësi institucionale dhe morale para të gjithë qytetarëve të vendit, para studentëve tanë të nderuar dhe botës sonë akademike, sa nuk është bërë tepër vonë.

Neglizhenca dhe mjerimi i këtyre skandaleve të patolerueshme do të rëndojnë kurdoherë në ndërgjegjen tonë.

Përfundimisht, sot politika duhet të largohet nga universiteti.

Aleanca për ardhmërinë e Kosovës një gjë të tillë e ka kërkuar tani e tetë vjet më parë në Kuvendin e Kosovës. Të njëjtin gjë pra - që politika t'i largojë duart nga universiteti. Sepse, kjo situatë nuk është e momentit, por është zinxhiri i krijuar që nga paslufta. Për më tepër, hallkat e menaxhimit aktual të UP-së nuk kanë reaguar edhe atëherë kur njerëzit të ndërgjegjshëm brenda universitetit kanë raportuar parregullsi serioze.

Ndër të tjera, edhe rektori, menaxhmenti aktual i UP-së, ka përgjegjësi direkte për imazhin e shtrirë për tokë të universitetit tonë publik.

Ndaj, ne pa asnjë mëdyshje mendojmë se gjendja aktuale në universitet është rezultat i keqqueverisjes brenda PDK-së dhe AKR-së.

Ky politizim i skajshëm zaten e ka sjellë Universitetin e Prishtinës në këtë gjendje. Përballë skandaleve, publikimeve mashtruese, skenave të shumta korruptive brenda UP-së, institucionet përgjegjëse asnjëherë nuk kanë marrë masa serioze për parandalimin e tyre.

Prandaj, rektori Gashi, para se të japë llogari për skandalet e krijuara në UP dhe të gjitha skenat korruptive atje, duhet të shpjegojë se për se brenda universitetit ka profesorë të papërgatitur, të cilët si të tillë nuk mund të prodhojnë dituri, por sikur vetë prodhojnë padituri, injorancë dhe korrupsion, sepse nga kjo çorbë ata kanë dalë vetë.

Ai duhet të tregojë se pse në universitet sot ka lëndë të cilat nuk kanë literaturë, pse shumë objekte të fakulteteve nuk kanë ngrohje gjatë dimrit, pse gjeneratat që kanë pasur indeks nuk kanë përfituar nga digjitalizimi i administratës? Pse vazhdimisht brenda universitetit lejohet nepotizmi, pse nuk u jepet përparësi gjeneratave të reja, të cilat përgatiten brenda dhe jashtë vendit? Por, lejohet që një profesor të ketë dy e më shumë vende pune, apo të ligjërojë në më shumë se 10 programe.

Këto, të nderuar kolegë deputetë, janë aspekte të keqmenaxhimit në Rektorat, përkatësisht në universitet, krahas shkeljeve serioze të Statutit të universitetit, për të cilat ne mendojmë se detyrimisht duhet të japë llogari.

Ne kemi informacione se profesorët e angazhuar brenda universitetit, të cilët kanë qenë të angazhuar gjatë semestrit dimëror, ende nuk kanë marrë paga, sepse atyre ende nuk u janë lëshuar kontratat, ndërkohë që po fillon semestri tjetër.

Dorëheqja e tij sot do të ishte një fund i mirë për të, pra për vetë rektorin, sepse universitetit duhet t'i hapen dyert e së ardhmes.

Një institucion që për vite e dekada ishte bartës i proceseve historike nuk bën të përballet me rrezikun për të mbetur në histori. Duhet urgjentisht të ndalet degradimi i mëtejshëm të kësaj vatre të dijes. Sepse, përgjegjësia për gjendjen e UP-së i takon udhëheqjes politike, para se ato t'u atribuohen organizatave të ndryshme studentore gjatë proceseve të përditshme para nesh.

Dhe, jo vetëm kaq. Kjo gjendje nuk duhet në asnjë mënyrë të përmbillet me çështjen 'Gashi', apo së paku të mjaftohemi me të.

Ne para kësaj e kundërshtojmë me ngulm klasën politike në pushtet, Qeverinë e Kosovës, e cila me qasjen e vet, Universitetin e Prishtinës e ka shndërruar në çerdhe militantësh partiakë, organizatash kriminale, tash me fytyrë dhe rol tjetër. Në çerdhe bilbilash e manipuluesish, të cilët në këtë universitet kanë hyrë për të shkatërruar dhe për të degraduar, por edhe për t'u pasuruar dhe për të kriminalizuar çdo gjë.

Ne dyshojmë se bazuar në gjendjen e tanishme mund të na dalin me dhjetëra e dhjetëra raste si puna e rektorit Gashi.

Duke pasur parasysh gjendjen në Universitetin e Prishtinës, ne si Aleancë mendojmë t'i japim disa rekomandime, të cilat do t'i harmonizojmë patjetër me grupet tjera parlamentare:

Krijimi i një këshilli kombëtar për verifikimin dhe ndarjen e thirrjeve akademike si organ i përhershëm, i cili do ta verifikojë së pari vërtetësinë e të gjitha diplomave dhe thirrjeve akademike të stafit akademik të Universitetit të Prishtinës dhe rezultatet e këtij verifikimi të jenë publike dhe transparente.

Të iniciohen propozimet për modifikimin e paketës ligjore, pra, ashtu siç kemi kërkuar edhe në kuadër të komisionit tonë, në përgjithësi, posaçërisht me atë të arsimit të lartë, si dhe me statutin dhe aktet tjera normative të UP-së, duke garantuar autonomi të plotë buxhetore për njësitë e Universitetit të Prishtinës, rritjen e transparencës në përgjithësi, e posaçërisht garantimin e transparencës së zgjidhjes dhe punës shkencore-mësimore të stafit akademik.

Demokratizimi të gjitha strukturave të Universitetit të Prishtinës.

Parandalimi i ushtrimit të ndikimit nga politika ditore.

MASHT-i dhe Universiteti i Prishtinës të ndërmarrin hapa konkretë në mbrojtjen e standardeve të publikimeve shkencore dhe sigurimit, transparencës së punës së secilit anëtar të komunitetit akademik.

Të përmirësohet infrastruktura ligjore dhe administrative për nostrifikimin e diplomave të fituara jashtë vendit, në mënyrë që të mos vazhdoet të njihen diploma të dyshimta dhe të lëshuara pa kriter.

Përfundimisht, ne si Aleancë edhe një herë bëjmë thirrje që çështja e Universitetit të Prishtinës të trajtohet pra sot në Kuvend, ashtu siç e meriton, sepse nëse kjo gjendje vazhdon në këtë trajtim institucional, vështirë që mund të vijmë deri te një zgjidhje optimale.

Zëri i ndërgjegjes që moti e ka lëshuar alarmin, madje edhe shumë vite më parë. Sepse, është koha e fundit që Universiteti i Prishtinës nuk mund të përdoret për qëllime qeveritare e partiake që, në përgjithësi, e kontrollovan pamëshirshëm për qëllime tepër të ulëta.

Ne nuk mund të vazhdojmë me këtë gjendje skajshmërisht të rënduar të një institucioni dikur prestigjioz, i cili ka dhënë shumë për këtë vend. Është, pra, koha e fundit që të fillojë zgjidhja e këtij problemi madhor, duke e shkarkuar fillimisht menaxhmentin e tij për të filluar pastaj vlerësimin e të gjithë titujve shkencorë.

Në këtë mënyrë, ky Kuvend do të lejojë implikimin e individëve të caktuar, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me Universitetin e Prishtinës.

Pra, për fund, ne si Aleancë besojmë fuqishëm në kërkesat legjitime të studentëve, por ata që tentojnë të manipulojnë me studentët janë manipulues dhe asgjë më pak. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Debati i sotëm që po zhvillohet për gjendjen në universitet duhet të jetë i hapur dhe të çojë deri te përfundimet e duhura për ndryshimin e gjendjes së krijuar.

Koalicioni për Kosovë të Re me vëmendje të shtuar është duke e përcjellë situatën e krijuar në universitet, pra në Universitetin Publik “Hasan Prishtina”, i cili për ne ka rëndësi të veçantë, duke qenë se është bartësi i 80% të arsimit të lartë në Kosovë.

Të gjitha skandalet aktuale që janë duke u përcjellë me debat dhe që po marrin përmasa të brengës gjithëshoqërore paraqesin barrë të rëndë në ndërgjegjen institucionale të vendit, në të gjitha nivelet.

Koalicioni për Kosovë të Re vlerëson se rënia e Universitetit “Hasan Prishtina” ka filluar që moti dhe se dëshmitarë dhe pjesëmarrës së kësaj rënieje janë shumë prej bartësve të institucioneve, të cilët sot derdhin lot krokodili mbi të.

Është e turpshme hipokrizia, e cila është duke e përcjellë degradimin e tanishëm të universitetit më të madh publik të vendit.

Hetimet për keqpërdorime e korrupsion me rastin e regjistrimit të studentëve në fakultetet e këtij universiteti, si dhe dhënia e paligjshme e provimeve, madje me përfshirjen edhe të udhëheqësve të organizatave studentore, deri te arrestimet e profesorëve dhe asistentëve, paraqesin alarmin e fundit që situata duhet të ndryshohet në mënyrë përmbajtjesore.

Koalicioni për Kosovë të Re konsideron se ndryshimi duhet të ndodhë në bashkëveprimin e organeve të drejtësisë, organeve të universitetit, si dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e cila duhet të sigurojë leadership të qartë dhe të vendosur në situatën kur ligjshmëria në këtë institucion të arsimit të lartë është qartë e cenuar.

Nuk mund të ketë ndryshim të gjendjes pa konstatimin e përgjegjësisë penale, të shkelësve të ligjit, si dhe zbatimin e plotë të llogaridhënies të tyre ligjore.

Në këtë situatë, është e padiskutueshme edhe përgjegjësia e rektorit të universitetit, veçanërisht në aktin e dramës universitare që ka të bëjë me avancimin e tij akademik nëpërmjet artikujve shkencorë të publikuar në revista diskutabile shkencore.

Do të ishte shumë e dëshirueshme që në këtë periudhë tejet të ndjeshme, rektori Gashi të jetë në gjendje që të ofrojë shpjegime të pranueshme për komunitetin akademik studentor, si dhe për opinion e gjerë publik përkitazi me këtë çështje.

Kompleksitetin e situatës më së miri e qartëson përpjekja naive që nëpërmjet tentimit të shkarkimit të tërë përgjegjësisë mbi menaxhmentin e tanishëm të universitetit të zgjidhen të gjitha problemet.

Ku mbetet përgjegjësia e studentëve të regjistruar në mënyrë të paligjshme, ose të cilët kanë dhënë provime në mënyrë të paligjshme? Ku mbetet përgjegjësia e mësimmësuesve që ua kanë mundësuar këtë? Ku mbetet përgjegjësia e Agjencisë së Akreditimit, që i ka akredituar këto institucione? Ku mbetet përgjegjësia e Këshillit Drejtues të universitetit në këtë përbërje dhe në përbërjet e mëhershme, të cilat gjatë gjithë këtyre proceseve, në periudhën e pasluftës, kanë vazhduar heshtur degradimin sistematik të kodeksit etik dhe moral të universitetit në të gjitha strukturat e tij përbërëse? Ku mbetet përgjegjësia e organeve studentore, të cilat që moti janë bërë vegla në duart e zgjatura të partive politike dhe grupeve të interesit në universitet?

Koalicioni për Kosovë të Re vlerëson se nuk zgjidhen problemet e akumuluar të universitetit me shkarkime momentale të menaxhmentit aktual dhe vazhdimin afatgjatë të praktikave të vjetra turpëruese për një mjedis akademik.

Zgjidhja qëndron në ftesën dërguar Agjencisë Ndërkombëtare të Akreditimit nga Qeveria e Kosovës, e cila do ta zbatonte studimin detaj të fizibilitetit të të gjitha strukturave institucionale të ndërlidhura me arsimin e lartë në Kosovë dhe me këtë të siguronim prerje dhe ndarje të qartë nga e sotmja për hir të së ardhmes.

Koalicioni për Kosovë të Re thërret institucionet përgjegjëse, respektivisht Kuvendin e Kosovës dhe Ministrinë e Arsimit që sa më parë, në procedura të përshpejtuara, të bëjnë plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për arsimin e lartë, si dhe të Statutit të Universitetit “Hasan Prishtina”, në mënyrë që t’i adresojnë më mirë përgjegjësitë, kompetencat, por edhe llogaridhënien në secilën instancë.

Ne kemi propozime konkrete për ligjin, për statutin, për ndryshimin dhe përbërjen e Këshillit Drejtues, në nenet të cilat precizojnë ngritjen akademike, gradimin akademik të tyre e të tjera.

Koalicioni për Kosovë të Re gjithashtu i fton organet kompetente që sa më parë t’i marrin në shqyrtim të gjitha ankesat për keqpërdorime në universitet, në mënyrë që të mos lejojnë degradimin e këtij institucioni shumë të rëndësishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Nga grupet tjera nuk ka të lajmëruar për debat. Vazhdojmë me deputetët. Ramiz Ladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Universiteti “Hasan Prishtina” është institucioni më i lartë arsimor në vend dhe pothuajse të gjithë ne që ndodhemi në sallën e këtij Kuvendi jemi produkt i atij institucioni.

Universiteti “Hasan Prishtina” u themelua me vendim të Kuvendit të Kosovës dhe është institucioni nëpërmjet të cilit ne si individë dhe si shoqëri identifikohemi në totalitetin e botës universitare në rajon dhe në krejt botën.

Kjo që po ndodh këtyre ditëve, kur një grup studentësh apo individësh, që me militantizëm dhe hapur janë në funksion të politikës, nuk i ndihmojnë aspak Universitetit “Hasan Prishtina”. Përkundrazi, kjo është funksion të anarkisë dhe shkatërrimit të vlerave të Universitetit “Hasan Prishtina”.

Në asnjë universitet në botë studentët nuk janë ata që merren me vlerësimin e punës shkencore të stafit të tyre akademik. Kjo ndodh veç në Kosovë! Për këtë janë kompetente strukturat, komisionet dhe agjencitë e veçanta, të ngritura mbi bazën ligjore dhe institucionale. Zgjidhja duhet kërkuar vetëm nëpërmjet rrugëve institucionale dhe assesi në rrugë të tjera.

Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm që në Universitetin “Hasan Prishtina” ka shumë për të bërë dhe atë, si në aspektin e kornizës ligjore, të infrastrukturës, e po ashtu edhe në aspektin e stimulimit të shkencës nëpërmjet përkrahjes financiare.

Në këtë kuadër, Kuvendi, Universiteti “Hasan Prishtina” dhe Agjencia e Akreditimit duhet t’i koordinojnë punët nëpërmjet një organi të përbashkët dhe ta fillojnë punën në krijimin e kornizës së mirëfilltë ligjore në funksion të krijimit të një ambienti për punë të qetë dhe pa presione politike, zhvillimit të Universitetit “Hasan Prishtina”, tejkalimit të krizës dhe përcaktimit të qartë të kriterëve për avancime dhe punë shkencore.

Në këtë kuadër, ngrehim një pyetje për trajtim: a është e mundur që në vazhden e krijimit të kornizës ligjore për avancim dhe zhvillim të shkencës të ngrihet kualiteti shkencor i revistave shkencore kosovare? A ka mundësi që kjo të bëhet nëpërmjet përkrahjes institucionale dhe financiare? Pse të mos i kemi edhe ne revistat tona shkencore me recensione anonim, ashtu siç i kanë shtetet fqinja?

Të nderuar kolegë deputetë,

Fjalën time dua ta vazhdoj duke cituar pjesë nga një shkrim i zonjës Lularta Aliu, drejtoreshë në ‘Bridge Education Abroad Institute’, institut në SHBA, botuar në gazetën ditore “Epoka e Re”, më 5 shkurt të këtij viti. Citoj: “Thuajse të njëjtit që sot shfaqen para ekranit të thirrur si ‘shpëtimtarë’ të universitetit, si dhe në bazë të protestave për faturat e fryra të KEK-ut një vit më parë dhe çdo protestë tjetër, duke kërkuar përmbysjen e pushtetit”. E solla këtë citat të zonjës së nderuar, sepse një vit më parë kisha të njëjtin mendim kur deklarova, po në këtë sallë, se kush ishin ata që ishin në ballë të organizimit të atyre protestave. Ndoshta nuk është momenti, por më duhet të them për hir të opinionit se shumë nga zëdhënësit e protestave të një viti më parë për faturat e fryra të KEK-ut, tani janë të punësuarit e KEDS-it si zëdhënës të tij.

Po ashtu, dua t’ia kujtoj opinionit dhe gjithë studentëve protestues se njëri nga organizatorët e bashkangjitur në protestën e tyre është edhe Shpend Kursani, i biri i punonjësit të UDB-së, Bashkim Kursani, i cili me të vëllanë e tij, Vllaznimin, këta bijtë e Nazmiut gjithashtu UDB-ashë, e mbytën dajak rininë studentore të asaj kohe, vetëm se po kërkonte dije e liri për shqiptarët nën ish-Jugosllavi.

Ky pasardhës i Kursanëve le të më demantojë nëse nuk qëndrojnë këto që i them siç u mundua të më demantojë një vit më parë.

Ai mund të më demantojë vetëm në rast se mohon se është i biri i Bashkim Kursanit. Ata Kursanët e vjetër nuk kanë mundur ta ndalin realizimin e idealit Marie Shllakut, dhe as tani këta Kursanë të rinj nuk do të mund ta shkatërrojnë Universitetin “Hasan Prishtina”, siç edhe e kanë marrë detyrë ta bëjnë.

Po vazhdoj me citatin e zonjës Lularta Aliu: “Po kush ishin pjesëtarët e shoqërisë civile? Çfarë raporti kishin apo kanë me mbështetjen e Prishtinës dhe studentët e tij? Sa kishin kontribuar ata apo familjet e tyre në ngritjen dhe ruajtjen e UP-së dhe sa nga ata e kanë thënë më se një herë publikisht se ky universitet duhet të mbyllet?”, vazhdon citati.

“Pa dashur të përmendim emra, nuk duhet shumë mund për të kuptuar se kjo lagje e kritikuesve kronikë ndaj universitetit janë pikërisht ata apo bijtë e atyre, që s’bënë asgjë të mirë për universitetin dhe as për Kosovën. Madje, ka nga ata që asnjë ditë nuk u ka shkelur këmba në UP, por që kanë kryer shkolla private të palicencuara në Kosovë.

Janë po ata që kur e marrin megafonin hedhin helm e vrer kundër universitetit, studentëve dhe profesorëve, kundër këtij institucioni të arsimit të lartë, themelet e të cilit janë ndërtuar mbi gjakun e qindra e mijëra të rinjve e të rejave, burra, gra e pleq.

Prandaj, këtu shtrohet pyetja se a duhet t’i dëgjojmë këta palaçot e ashtuquajtur ‘shoqëri civile’, në emër të së cilës thirren dhe ushqehen. Unë mendoj se jo. Është mirë të mendoni edhe ju për të mirë e universitetit dhe mbarë institucioneve publike”. Përfundon citati. Faleminderit!

KRYETARI: Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Kur flasim për Universitetin Publik të Prishtinës, e nesër edhe për universitete tjera publike anembanë Kosovës, debati duhet të zhvillohet në nivelin akademik, sepse universiteti mund të mbrohet vetëm kur aktorët flasin me kompetencë akademike, duke mos përjashtuar asnjë palë të interesuar për debat të mirëfilltë, duke inkuadruar edhe entitetet akademike ndërkombëtare.

Ndërsa sa u përket zhvillimeve të fundit rreth publikimeve me një përzgjedhje të diskutueshme në revista shkencore me qasje të hapur, do të thotë publikime elektronike, duhet shtruar këtë sqarim profesional, që shpresoj jep mundësi të kuptohet gjeneza e kësaj ‘hallakame’.

Autori i listës së publikimeve, të cilat kanë mundësi të jenë potencialisht grabitqare, të mundshme grabitqare, ose kanë gjasa të jenë grabitqare, është Xhefri Bill, bibliotekist në bibliotekën e Universitetit ‘Colorado Damper’.

Këtë listë ai e ka bërë në vitin 2012. Për këtë listë, ai thotë: “Kjo është një listë e diskutueshme e publikimeve, e revistave me qasje të hapur, do të thotë elektronike”. Thotë: “Ne rekomandojmë që punëtorët shkencorë, dijetarët, t’i lexojnë kritikën në dispozicion, vlerësimet dhe përshkrimet e dhëna dhe pastaj ata vetë vendosin për veten e tyre nëse dëshirojnë që t’i paraqesin punimet e tyre për publikim, që të shërbejnë si redaktor, ose të jenë në bordet editoriale të këtyre revistave”.

Ai e thotë edhe këtë: “Ne shpresojmë gjithashtu që komisionet recensuese për avancime dhe promovime vetë duhet, ose mund të vendosin se sa e rëndësishme apo jo është vlerësimi për artikujt e botuar në këto revista, publikime elektronike, në kuadër të

standardeve të tyre institucionale, të cilat duhet të caktohen varësisht nga konditat gjeokulturore të vendit respektiv”.

Gjithashtu, duhet nënvizuar, thotë Xhefri Bill, se me kalimin e kohës, revistat i ndryshojnë praktikat e tyre të biznesit dhe të botimit. Kjo listë e standardeve do të duhej të përditësohej në masën më të mirë të mundshme, por mund të mos e pasqyrojë zgjerimin e papritur, të paraportuar, ose të panjohur të kësaj liste.

Atëherë shtrohet një pyetje logjike dhe arsyeshme: A e ka bërë hapin më të vogël Universiteti i Prishtinës që të bëjë kodifikimin e standardeve që përcaktojnë se çka është me vlerë për revistat për të botuar, që pastaj punëtorët shkencorë të mos anatemojnë, por të botojnë vetëm në listën e parapercaktuar?

Me Statutin e Universitetit të Prishtinës, për stafin akademik, nëse duhen të avancohen, u kërkohet që të kenë publikime vetëm në revistat me recension ndërkombëtar, më së paku në ISSN-në, që është një numër serik standard ndërkombëtar, numër unik tetëshifrorë, që përdoret për t’i identifikuar revistat. E në revista të tilla në botë me ISSN, sipas të dhënave deri në vitin 2011, janë diku rreth 1 623 566 anëtarë.

Qendra e ISO-standardeve, që mban regjistrin e ISSN-së, është në Paris. Shtrohet pyetja: Nëse këto revista janë me potencial grabitqar, me gjasa grabitqare, atëherë si ka mundësi që këto janë futur në regjistrin e ISSN-së në Paris? Si punëtor shkencor, po e theksoj edhe një herë: na kërkohet që të punojmë dhe të botojmë në revista të jashtme me recension ndërkombëtar, sepse ne nuk kemi arritur që ta kemi edhe një revistë të vetme me ISSN.

A duhet tash ne të merremi me analizat e këtyre revistave dhe përditësimit të standardeve të tyre, apo të fokusohemi në punimin që ai të jetë në nivelin e duhur?

Si mund t’i gjykojmë ata të cilët kanë botuar në këto revista, të listës së Bellit, kur asnjëherë nuk e patëm një listë se ku lejohet dhe ku nuk lejohet për të botuar. Nëse ato janë të pajisura me ISSN-në dhe kanë borde editoriale, çka mund të kërkojmë tjetër? A mos ndoshta duhet t’i kontaktojmë revistat e tilla dhe t’i bëjmë edhe pyetjet: Ej, a jeni ju grabitqarë? A jeni mashtrues? A jeni ju të rrejshmit? Ose, a jeni revista korreptive shkencore? Me fjalë të tjera, jemi dëshmitarë që të gjithë, në një formë si kjo, apo tjetër, jemi pre e krimit kibernetik, që paraqitet si një problem global.

Edhe një fjali rreth kualitetit të revistave. Ka revista që në fillim kanë kritere të lehta, jo aq të ashpra, sigurisht për të tërhequr sa më shumë të interesuar për të botuar dhe me kalimin e kohës kriteret arrijnë standarde të dëshiruara dhe anasjelltas.

Lidhur me punimin tim, “Information Technology and digitalization of the Kosova economy, market and competition”, për cilësinë e punimit të publikuar, le të flasë bota akademike, vendore dhe ndërkombëtare. Pra, kërkoj publikisht të analizohet dhe të vlerësohet nga një komision recensues, qoftë vendor, apo ndërkombëtar. Unë e mbaj përgjegjësinë për cilësinë e punimit.

Shpresoj që debati i sotëm do të fokusohet rreth gjetjes së alternativave më të mira për tejkalimin e situatës së krijuar. Faleminderit!

KRYETARI: Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kosova është ende shtet i brishtë që ta përballojë vetëm gjatë muajit janar gjithë këtë debat publik që është bërë: debati për çështjet fetare, me shumë të panjohura, për shërbimet sekrete, po ashtu me improvizime dhe spekulime, për universitetet me shumë probleme, për legjitimitetin e Qeverisë dhe për zgjedhjet e parakohshme, për problemet sociale dhe për protestat e paralajmëruara, madje edhe sot.

Me hapjen e këtyre temave u krijua një sistem i shantazhit publik, i kombinuar nga individë, grupe të caktuara të interesit, dhe nga disa media të shkruara elektronike, e autorët e një sistemi të tillë janë në prapaskenë.

Ky është një shpërqendrim i vëmendjes nga zgjidhja e problemeve të shumta që po e përcjellin stabilizimin dhe konsolidimin e shtetit të ri e demokratik të Kosovës.

Debati i sotëm është një debat i vonuar dhe i amnistuar politikisht për institucionin e themeluar nga ky Kuvend, i cili ka mandat dhe obligim ligjor që të përkujdeset për krijesën e vet.

Në mungesë të përkujdesjes së duhur të këtij Kuvendi, grupi i studentëve protestues e ka iniciuar këtë problem, të cilin tani ky Kuvend duhet ta marrë parasysh seriozisht dhe ta zgjidhë.

Problemet në këtë universitet u desh të iniciohen nga gazetarët virtualë të disa medieve, për veprimtarinë shkencore të disa profesorëve, ku për çudinë tonë aty u gjetën edhe emrat e drejtuesve të tij.

Ne duhet t'i falënderojmë publikisht mediet dhe studentët që e kanë marrë këtë nismë për ta ndaluar një praktikë të keqe, të instaluar në universitet gjatë këtyre 14 vjetëve.

Në emër të idesë së dijes akademike nuk duhet askush t'i mbikëqyrë këto universitete. Është krijuar hapësirë që partitë politike për motive politike, nga viti '99 e kanë shtrirë ndikimin në universitet, duke vendosur grupe paralele politike.

Për ta futur në dorë udhëheqjen e universiteteve, politika ka avancuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, me njerëz të dëgjueshëm, me dije modeste, me tituj të fituar me procedura të përshpejtuara.

Se politika është implikuar në universitet tregojnë shembujt e ndërrimit të roleve nga të njëjtit njerëz, të cilët po shëtitin nga universiteti në këtë Kuvend, në Qeveri e sërish po

kthehen në universitet. Një shembull tjetër është te Fakulteti i Mjekësisë, njëri ndër fakultetet më të mëdha në vend, në të cilin menaxhimi nuk është zoti që të qëndrojë madje as 6 muaj.

Kësaj gjendje i ka kontribuar edhe fakti se Kosova nuk ka plan strategjik të zhvillimit, ndërsa ajo në të njëjtën kohë i ka 6 universitete, ku e kemi një konkurrencë për të futur në to, madje të jetë si të jetë, pa diploma, pa kritere, vetëm që të jetë aty dikush.

Për të qenë korrekt, duhet ta pranojmë faktin se problemet 14-vjeçare të akumuluar aty u kanë rënë në kohë njerëzve pa përvojë, të cilët edhe po të duan nuk kanë mundësi t'i zgjidhin këto probleme, madje për më keq - ata këto probleme vetëm mund t'i shtojnë.

Ky Kuvend duhet të kërkojë që politika të heqë dorë nga universiteti dhe puna edukative e shkencore t'u lihet në dorë personave kompetentë. Ky Kuvend duhet të kërkojë nga Rektorati që ta luajë rolin që e ka dhe të mos lejojë që të shndërrohen në zëdhënës të grupeve virtuale me interesa klanore përtej të cilave Kosova nuk duket fare.

Ky Kuvend duhet t'i sugjerojë universitetit që t'i mbajë shpejt zgjedhjet në të gjitha nivelet, me qëllim që ky problem të mbyllet siç është më së miri nëpërmjet rrugëve legale e institucionale. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Ne si subjekt politik kemi përcjellë me shqetësim të madh ngjarjet dhe skandalet e njëpasnjëshme në Universitetin e Prishtinës, të cilat kulmuan me skandalin e fundit të publikuar në media, ku u dëshmuar me fakte se një numër i caktuar i stafit akademik të Universitetit të Prishtinës, përfshirë edhe vetë rektorin Ibrahim Gashi, janë të përfshirë në mashtrime dhe janë avancuar me tituj akademikë në mënyrë anti-statutare, përkatësisht në mënyrë të jashtëligjshme.

Veprimet e rektorit Gashi me rastin e publikimeve të tij në fantom-revistën shkencore paraqesin shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 9 dhe të nenit 185 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, si dhe shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 13 dhe 14 të Kodit të Etikës të stafit akademik të Universitetit të Prishtinës.

Po ashtu, meqë tashmë është dëshmuar që 3 nga gjithsej 5 publikimet e rektorit Gashi janë të pavlefshme, atëherë mbajtja e titullit akademik “Profesor i rregullt” nga rektori Gashi është në kundërshtim të plotë me nenin 175 (pika 1, nënpika 1.2.1) të Statutit të Universitetit të Prishtinës. Përveç kësaj, duke pasur vetëm 2 publikime të vlefshme (nëse janë) në revista shkencore ndërkombëtare, atëherë edhe mbajtja e titullit akademik “Profesor i asociuar” nga rektori Gashi është në kundërshtim të plotë me nenin 176 të Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Andaj, bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e sipërpërmendura, por edhe në ato fakte e argumente tashmë publike, Lëvizja “Vetëvendosje” u bën thirrje organeve gjegjëse që ta kthejnë ligjshmërinë në Universitetin e Prishtinës. Më konkretisht:

Lëvizja “Vetëvendosje” i bën thirrje Senatit të universitetit që në përputhje me nenin 173 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, si dhe bazuar në kërkesat e nenit 175, 176 dhe 177 për titujt akademikë, rektorit Ibrahim Gashi t’i hiqet titulli akademik “Profesor i rregullt” dhe “Profesor i asociuar”, meqë formalisht, jo edhe moralisht, ai mund ta mbajë vetëm titullin akademik “Profesor asistent”.

Përmbajtja e rrejshme lidhur me kushtet e parapara në Statutin e Universitetit të Prishtinës për kushtet që duhet t’i përmbushë stafi akademik është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 26 paragrafi 4 të Ligjit për arsimin e lartë, ngase në këtë dispozitë në mënyrë eksplicite kërkohen kushtet që ndërlidhen me publikimin e punimeve shkencore në revistat me recension ndërkombëtar.

Pas vërtetimit të publikimit të punimeve të rektorit në revistat fantome, i njëjti nuk përmbush kushtet për emërimin në cilësinë e stafit akademik, në mënyrë të drejtpërdrejtë bie edhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 27 paragrafi 3.1 të Statutit të UP, ku janë përmendur në mënyrë eksplicite kushtet që duhet t’i përmbushin kandidatët për postin e rektorit.

Me vetë faktin e të gjitha këtyre parregullsive dhe shkeljeve ligjore dhe statutore, mbajtja e postit nga rektori është në kundërshtim me përgjegjësinë e tij të përkufizuar në nenin 26, paragrafi 1.1, ku ai vepron në emër të Universitetit të Prishtinës dhe e përfaqëson atë në të gjitha relacionet.

Kjo përgjegjësi e rektorit cenohet me vetë faktin e shkeljeve ekzistuese, gjë e cila e vë në pikëpyetje kredibilitetin përfaqësues të një institucioni kaq të rëndësishëm akademik në vend.

Sipas kësaj, evident është dyshimi i bazuar se ai me dashje dhe me vetëdije e ka dërguar punimin në publikim në revistën për të cilën është dashur ta dijë se çfarë kredibiliteti ka, dhe me këtë e ka kryer edhe veprën penale të mashtrimit dhe legalizimit të përmbajtjes së rrejshme. Kjo ngase qëllimi ishte mashtrimi dhe shtrembërimi i organeve kompetente lidhur me përmbushjen e kriterëve, të cilat paraprakisht secili kandidat për postin e rektorit i ka ditur, në bazë të konkursit të shpallur dhe bazuar mbi dispozitat statutore.

Në fund, nëse rektori Gashi do të shpëtojë diçka nga vetja e vetë, i ka mbetur vetëm një shans, kuptohet, përveç dorëheqjes - le të dalë publikisht dhe le të tregojë se cilët janë ata qeveritarë dhe deputetë të pozitës me të cilët ka pasur bashkëpunim për regjistrimin e studentëve, konkretisht pra për shitjen e indekseve. Shembull një indeks në Fakultetin e Mjekësisë është shitur me mijëra euro. Ky është turp, kjo është për të të ardhur keq.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryesues!

Zëvendëskryeministër,

Ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky debat parlamentar është i nevojshëm, jo vetëm duke u bazuar në zhvillimet e tanishme në Universitetin e Prishtinës, por të kthehemi në retrospektivë - shumë herë edhe në Kuvend ka pasur diskutime nga deputetë të ndryshëm sa u përket zhvillimeve në universitet.

Në radhë të parë, besoj se ne të gjithë pajtohemi plotësisht që politika duhet të jetë jashtë universitetit.

Pikërisht nga ky pozicion dhe mbi këtë parim, nuk mendoj se duhet të bëhemi shkaktarë për të iniciuar ndonjë agjendë të tillë, në mënyrë që qëndrimet tona sot të reflektojnë mesazhe për shkarkime apo përfshirje të politikës në sferën dhe në natyrën e problemeve akademike.

Si rrjedhojë, unë konsideroj se këto probleme duhet të zgjidhen brenda instancave të universitetit me ç'rast i jap mbështetje punës së një komisioni përkatës që është ngritur si pasojë e shqetësimeve të fundit që kanë dalë në publik.

Në anën tjetër, ne inkurajojmë që debati i filluar të vazhdojë edhe më tutje, si dhe i njëjti t'i përfshijë të gjitha problemet që e karakterizojnë këtë fushë, por që ky debat të jetë i orientuar drejt zgjidhjeve të mundshme në mënyrë institucionale dhe assesi të shërbejë si një rast për të ndërtuar agjenda politike e mediatike, siç po i shohim ditëve të fundit.

Ne jemi duke parë edhe instrumentalizimin e organizatës studentore nga parti politike, që mendoj se është i dëmshëm dhe papërgjegjësi e madhe.

Unë i kam parë edhe vetë rekomandimet e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, që në esencë njëra prej tyre është krejtësisht e politizuar.

Është hipokrizi e llojit të vet nëse e bëjmë përgjegjës të vetëm strukturën e tanishme që e udhëheq Rektoratin e Universitetit të Prishtinës. Kjo strukturë është emëruar tash e një vit e disa muaj, më duket. Këta i kanë trashëguar problemet e dy dekadave me radhë në Universitetin e Prishtinës.

Mendoj se nuk është rektori Gashi problemi i Universitetit të Prishtinës. As zgjidhja e problemit nëse ai largohet nga detyra e tij.

Problemet aty janë të trashëguara, prandaj kërkohet një qasje shumë me përgjegjësi e të gjithë mekanizmave vendimmarrës në zgjidhjen e problemeve aty.

Me shumicën e problemeve të aktualizuara tani, ky universitet përballët që nga vitet e '90-ta e këndej. Shumica nga ne aty i kemi përfunduar studimet dhe jemi graduar me grada shkencore deri në nivelet më të larta. Shumë nga politikanët, si të pozitës, ashtu

edhe nga opozita, vazhdojnë të punojnë si mësimdhënës në këtë universitet edhe sot. Shumë personalitete nga pozita dhe opozita mbajnë nga disa vende pune, e një prej tyre është edhe mësimdhënie në këtë universitet.

Duke pasur parasysh angazhimet e shumta të këtyre personaliteteve, unë të paktën nuk bindem se prioriteti i tyre mbi të gjitha është cilësia për t'iu afruar studentëve, apo shkenca, por pagat dhe mëditjet janë motivi i tyre aty.

Mendoj se në Universitetin e Prishtinës duhet të ndodhë njëlloj kontrolli në të gjitha nivelet, të krijohen komisione të nevojshme brenda kornizave ligjore dhe të merren me të gjitha çështjet diskutabile në universitet dhe çdokush ta marrë vlerësimin apo edhe ndëshkimin për veprimtarinë e zhvilluar.

Të kontrollohen dhe të hetohen nga organet përkatëse të gjitha aktivitetet që tani janë bërë publike, e që ka ndodhur në këtë universitet që nga vitet e '90-ta e këndej.

Ne si deputetë, mendoj se është mirë sa më shumë të fokusohemi te ligjet që e rregullojnë këtë fushë, që ato të jenë në përputhje me standardet bashkëkohore dhe për zbatimin me përpikëri të tyre të kujdesen të gjithë mekanizmat përkatës në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputeti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, kryesues!

Zoti zëvendëskryeministër,

Zoti ministër,

Kolegë të nderuar,

Unë kam qenë njëri ndër ithtarët e hapjes së universiteteve anembanë Kosovës, kështu që për këtë arsye në njëfarë forme edhe jam i thirrur të flasë në këtë seancë, seancë e cila, me sa unë kam vërejtur, ka një interesim të madh nga stafi i Universitetit të Prishtinës dhe gjithandej.

Kjo nuk do të thotë se debati në këtë seancë nuk është në nivel, veç po ju paralajmëroj se ka një interesim shumë të madh çfarë thonë deputetët e zgjedhur për këtë problem, që tani doli në sipërfaqe.

Unë nuk do të jem shumë pretencioz dhe nuk guxoj të them që jam aq i mençur sa të jap solucione të lumtura.

Sidoqoftë, më lejoni që ta nis këtë debat me një fragment që e ka Viktor Hygo. Fragmenti ka të bëjë me dialogun ndërmjet engjëllit dhe djallit. Dialog, debat, kundërshti e përjetshme, fundi i fundit. Edhe engjëlli i thotë djallit se nuk ka dilemë se unë do ta fitoj konfrontimin me të, 'sepse unë jam mirësia vepruese', po përdor pak termin më të sofistikuar. Ndërkaq djalli tha, 'e pra, unë do të fitoj dhe më lejoni një herë në ymër timin të jem i sinqertë, që të tregoj se si'. 'Të mirën tënde, tha, mirësinë tënde vepruese, do ta kthej në institucione'. Ky është dialogu i Viktor Hygosë.

A mos po e vë unë një pikëpyetje mbi institucionet? Nuk guxoj ta bëj këtë gjë, sepse jam një mbështetës i institucioneve.

Unë, në anën tjetër, nuk guxoj t'u jap 'bjanko' parapagim institucioneve. Sa institucione kemi parë edhe ne duke rënë, duke u bërë shkrumb e hi, në qoftë se nuk u janë përgjigjur kërkesave të zhvillimit të shoqërisë.

Pra, rrofshin institucionet! Por, qe besa jo, në qoftë se nuk ka një integritet njeriu që i udhëheq ato institucione. Në fund të fundit, edhe shkencor, në rastin konkret.

Dhe, në qoftë se nuk ka një forcë menaxhuese kreative, edhe të vendosur, a mund të themi se i kemi këto kualitete në qarkullim Kosovë, në institucionet çfarë është Universiteti i Prishtinës? Për fat të keq, unë nuk mund ta pohoj një gjë të tillë.

Unë pajtohem me ministrin e nderuar, të cilin me të vërtetë nuk e konsideroj oponent, në këtë rast, se edhe ky mund të jetë në hall sa edhe të tjerët. Pajtohem me ministrin që tha nuk mund t'i zhveshi nga politika. Kjo është e vërtetë, por në qoftë se rektor bëhet një njeri me pedigree të PDK-së, LDK-së, a "Vetëvendosjes", ai automatikisht heq dorë i të qenët partizan dhe partia nga e cila ai shkon kënaqet, thotë: "ja pra një kuadër imi se si bëhet krejtësisht i pavarur dhe është në shërbim të institucionit".

Partia do të duhej në këtë formë për të gjetur kënaqësi e jo duke shfrytëzuar në çdo moment. Në këtë aspekt në Kosovë një pavarësi e tillë pothuaj është absurde për ta kërkuar, po shihen edhe zhvillimet e fundit. E nga ana tjetër unë e di që tha njëri prej deputetëve të PDK-së që janë probleme të trashëguara, kjo është e vërtetë. Vetë kur kam qenë i ri dhe axhami edhe unë kam pasur të këtilla peripeci të pashpjegueshme në universitetin atëherë, që ishte pjesë funksionale e sistemit jugosllav, këtu në Prishtinë.

Po pikërisht me Kosovën e lirë do të duhej të kishim një konsensus të padebatueshëm të gjitha partive politike që të bëhemi një staf për të qenë atje, menaxhues. Dhe unë po ju garantoj, natyrisht ju që jeni aty i njihni më mirë kualitetet, pra që jepni mësim, por unë si shikues i jashtëm, unë e di shumë mirë se ka individë fenomenal që kanë integritet shkencor edhe integritet njerëzor, po ata janë si maca nen sofër ndaj njerëzve që mundohen për të hyrë në shkencë me agresivitetin politik, zonja dhe zotërinj, këta, këto janë dy natyra të ndryshme.

Në qoftë se agresiviteti është i mirëseardhur në politikë, në shkencë dhe në këto institucione është katastrofal. Edhe unë për ta thënë shqip do të bëja kritere shkencëtarit ose shkencëtares që i skuqet hunda ose qafa, hiqe, gjëje atë që i strukturuar, që nuk reagon, që ka parimet shkencore, objektivitetin edhe të shkojë tutje. Me këto zhvillime të tanishme, unë kisha për të reaguar, natyrisht këto janë fenomene në shoqëri edhe duhet të përballemi me to.

Me thënë të drejtën kisha për të reaguar me tërë potencialin që e kemi, sepse shikoni mund të kemi dy zhvillime këtu, në qoftë se njerëzit që sarrakuqen hunda edhe qafa, unë kam parë kuazi-shkencëtarë në Kosovë që u sarrakuqet hunda dhe qafa, nuk lëshojnë pe.

Atëherë, varianti tjetër është një revolucion kulturor si në Kinë, me thënë të drejtën asnjëra prej këtyre varianteve nuk na përshtatet në qoftë se dëshirojmë të jemi të përgjegjshëm.

Kështu që në këtë aspekt, ka edhe njëfarë lloj shpirtgjërësie të pajustificueshme. Njeriu i pushtetshëm, më i pushtetshmi në Kosovë ndoshta do ta nderojë dikë, po i thashë edhe ministrit atë ditë kur e patëm nderin me qenë në komision, këtu, unë s'kam mund ta kuptoj asnjëherë pse t'i them unë liderit tim faleminderit që më bëre ministër. Ai nuk m'i kryen mua punët më ai, unë jam përgjegjës. Kurrfarë faleminderit nuk ia di pse më bëri ai ministër, për fat të mirë edhe s'kam pasur rastin me qenë asnjëherë ministër, por sidoqoftë po supozoj.

Unë e marr barrën, nuk m'i kryen më kryeministri më punët. Edhe te rektori kështu është. Epo tash, shikoni çka ndodh puna, në qoftë se unë si kryeministër e nderoj rektorin dhe ai tash mendon se ka për ta mbrojtur njeriu i fuqishëm dhe partia e fuqishme, e unë po ju them zonja dhe zotërinj, në qoftë se njeriu nuk ka integritet, as marinsat amerikanë s'mund ta mbajnë në këmbë se lë më një kryeministër ose një parti e fortë.

Në këtë aspekt unë po ju lus që të bëjmë maksimumin që të dalim nga kjo krizë, sepse sinqerisht po ju them nuk po dua për ta sulmuar absolutisht asnjë politikë, por ai Këshill drejtues, unë në qoftë se kuptoj diçka dhe po kërkoj falje në qoftë se e kam gabim këtu, ai Këshill drejtues zakonisht bëhet si kontribuues e jo si totalisht çoroditës edhe në politikat kadrovike, regjistrimit etj. etj.

Do të thotë, shiko a po e marrim Këshillin drejtues si shfytyrim total i asaj çka është Këshill Drejtues në institucionet simotra anembanë botës?

Pa marrë parasysh a kemi kërkuar ne secili prej nesh ndonjëherë favore nga rektori edhe nga Këshilli drejtues, ne i themi faleminderit, na ke bërë nderin, po nuk mund të themi që ke bërë nderë. Do të thotë, ajo që konsiderohet si kontribuues për institucionin, kështu është Këshilli drejtues... kontribuues i fuqishëm edhe material. Këtu në fakt është përfitues... që këto janë shfytyrime që kam frikë se nuk është shenjë i mirë dhe unë po ju lus, do të thotë në qoftë se ka pasur njëfarë shije kjo partiake fjalimi im, me të vërtetë po kërkoj falje, sepse nuk e kam ndërmend për t'u paraqitur ashtu. Ky është thesari më i madh që ka Kosova, Universiteti i Prishtinës dhe do të duhej që të gjithë maksimalisht të kujdesemi, ta ruajmë, ta kultivojmë edhe ta shpëtojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Eqrem, 12 minuta ke folur! Emilija Rexhepi nuk është. E ka fjalën Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Problemet në Universitetin e Prishtinës janë nga politika, vijnë nga politika dhe tashmë ato probleme nuk janë mbyllur, vetëm brenda Universitetit të Prishtinës, kanë dalë hapur dhe askush më nuk mund t' i fsheh këto probleme edhe pse janë munduar mjaftë për ta

fshehur ose ta fshehin atë po ndodh dhe tashmë të mos të lodhen më shumë ta tentojnë të njëjtën gjë.

Por, është momenti besoj që të hapet rruga, të lirohet rruga që të fillojë zgjidhja e këtyre problemeve që janë grumbulluar. Në fakt, Universiteti i Prishtinës është stërkequr bash njëjtë, ama bësh njëjtë sikur që është stërkequr politika në Kosovë, sikur se është stërkequr qeverisja në Kosovë.

Universiteti i Prishtinës nuk është vetvetiu në këtë gjendje të cilën ndodhet tash, nuk është shkaktuar vetëm një sëmundje e momentit e cila mund të tejkalohet lehtë edhe pa dhimbje. Problemet janë serioze dhe këto probleme u kanë shkaktuar edhe deri më tash dhimbje shumë njerëzve, të cilët assesi nuk kanë arritur t'i realizojnë të drejtat e tyre, qoftë si studentë, qoftë si studiues në UP. Por, problemet kanë ardhur nga politika dhe vetëm nga politika, përzjerja e pandalshme e politikës në UP është shkaktari kryesor i kësaj gjendje të stërkeqjes.

Normalisht politika po ashtu ka gjetur njerëz shumë të vullnetshëm, super të vullnetshëm në Universitet të Prishtinës për t'i shërbyer me besnikëri të keqes, për t' i shërbyer grupeve të caktuara në parti të caktuara politike dhe asnjëherë në asnjë moment këta njerëz nuk kanë dashur as mendojnë bile se çfarë dëmi po shkaktojnë. As që e kanë lodhur kokën për pasojat që dalin prej manipulimeve të panumërta që janë bë ndër vite, stërkeqja e UP-së nuk është e sotme, besoj se në këtë pajtohemi të gjithë ose shumica prej nesh. Nuk është diçka që ka ndodhur për herë të parë dhe tash të themi ne “auu, këtë nuk e kemi pritur”.

Unë besoj se shumë gjëra tashmë po tentohen të lidhen më një emër e ai është rektori Ibrahim Gashi. Besoj se kjo qasje është e padrejtë dhe është qasje jo e duhur. Nëse problemi i UP-së është një person, atëherë kjo qenka zgjidhja më e lehtë në botë që mund të ndodhë dhe me këtë person përfundon, por këmbëngulja e rektorit që të mos japë dorëheqje është e pashpjegueshme. Kjo nuk ka asnjë lloj kuptimi, sepse rektori me dorëheqjen e tij bashkë me ekipin e tij do ta lironte rrugën, do ta hapte rrugën për të filluar një proces shumë më i gjerë edhe shumë më i gjatë i zgjidhjes së problemeve që janë grumbulluar në UP.

Organet udhëheqëse të UP-së po ashtu janë politike, sepse gjithçka nën këtë qeverisje është politike dhe gjithçka nën këtë qeverisje u shërben interesave të caktuara të partive të caktuara politike. Edhe këta që normalisht duhet të largohen, sepse nuk ka kuptim të vazhdojnë më tutje.

Sidoqoftë, qasja politike ndaj UP-së nuk po përfundon vetëm këtu dhe vetëm me një ose me dy parti të caktuara politike, për këtë situatë të cilën jemi po shihet qartë se ka filluar edhe një parti tjetër politike, e cila duket se po e sheh këtë situatë si një rast që nuk duhet ta lëshojë, si një rast që duhet ta shfrytëzojë për vota për ta vendosur agjendën e vet politike dhe që të tria bashkë, asnjëra prej këtyre partive nuk kanë dallim në logjikën e vet, por kanë dallim vetëm në metodat që i përdorin për ta vendosur agjendën e vet politike.

Politizimi i UP-së po bëhet edhe nga brenda mureve të Rektoratit, por edhe nga jashtë mureve të Rektoratit. Dorëheqja e rektorit dhe ekipit të tij të ngushtë do të mundësonte që edhe sot në këtë debat në Parlament të Kosovës, të mos e përcjellë logjika e fushatës, sepse po vërehet të paktën në bindjen time se gjithçka po mendohet për më shumë vota në zgjedhjet parlamentare, të cilat janë më afër se që mund të mendojë dikush.

Logjika e bërjes fushatë parazgjedhore në situatën e rëndë të cilën ndodhet UP-ja është logjik e gabuar, logjikë që nuk po e ndihmon dhe nuk e ndihmon zgjidhjen e problemit të rëndë që kanë ndodhur aty, sikurse zgjidhjen e problemeve të rënda që janë në krejt qeverisjen në Kosovë.

Problemi më i madh në Kosovë është se nuk ka qeverisje dhe nëse e shohim këtë besojmë se e keni tepër më të qartë se për çka dhe për çfarë lloj probleme po flasim, një qeveri megalomane, e stërmadhuar prej numrit të dikastereve, stërhaxhuese prej shpenzimeve që bëjnë. Kjo logjikë është zhvilluar edhe është zgjeruar edhe në institucionet tjera duke e përfshi edhe Universitetin e Prishtinës.

Edhe për fund, gjatë këtyre ditëve kemi parë diçka për të cilën unë nuk mund ta shoh si të pranueshme, logjika e sjelljes edhe e sulmeve deklarative ndaj Policisë së Kosovës edhe në rastin e protestave që lidhen me Universitetin e Prishtinës.

Është shqetësuese për mua qasja politike tash që shfrytëzohet situata në universitet për ta sulmuar Policinë e Kosovës. Roli i policisë edhe në këtë protestë, sikur në protestat tjera asnjëherë nuk duhet të ndërlidhët me motivin ose me motivet ose edhe me legjitimitetin e kërkesave të protestuesve.

Pavarësisht, motivit që kanë protestuesit, pavarësisht kërkesave e legjitimitetit të kërkesave, policët kanë një detyrë më specifike ta bëjnë. Nuk besoj se në këtë situatë duhet shfrytëzuar momentin që ta drejtojmë gishtin ose ta përbaltim uniformën e shtetit. Tek e fundit, ata janë njerëz që kanë të njëjtat halle si ne, kanë edhe mungesë të ujit, edhe shtrenjtim të rrymës, edhe gjithçka, prandaj nuk është adresë e përgjegjësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Po vazhdoj pothuajse aty ku e la parafolësi, por jo me të njëjtën qasje. Po flas për përfshirjen e policisë në kampusin e Universitetit të Prishtinës.

Dhe, kur flasim për përfshirjen e policisë që ka ndodhur ose për nevojën e mos përfshirjes në këtë polici, kjo nuk nënkupton që ne nuk e duam Policinë e Kosovës, përkundrazi ne e duam fort, por e duam aty ku e ka vendin dhe ne po mendojmë që në këtë situatë Policia e Kosovës nuk e ka vendin në kampusin e Universitetit të Prishtinës.

Për dy arsye kryesore, por jo për të vetmet. Arsyeja e parë është se nuk është krijuar asnjë situatë e sigurisë për të intervenuar policia në kampusin dhe as kudo tjetër dhe sikur të

ndodhte kjo protestë kudo qoftë në kampus, qoftë në sheshin “Nëna Terezë” nuk do të duhej dhe nuk është e nevojshme që të ndërhynte policia për shkak se asnjë situatë e tillë për të ndërhyrë policia nuk është krijuar deri më tani dhe shpresojmë që të mos krijohet.

Dhe arsyeja e dytë është që ndërhyrja e policisë në kampusin e universitetit është edhe shkelje e Ligjit për arsimin e lartë. Shiheni mirë, njëkohësisht është edhe shkelje e Ligjit për Policinë e Kosovës.

Pra, këto janë dy arsytet dhe jo të vetmet. Me sa kam parë deri më tani edhe nga protestuesit edhe nga qytetarët, policia nuk është fyer, përkundrazi madje edhe u janë dhuruar lule nga protestuesit. Por dua të them një gjë tjetër, po mendoj që ministri i Arsimit, në këtë rast do të duhej së paku të reagoonte ose të kërkonte që nga institucioni nën domenin e të cilit është, të largoheshin policia, pra ministri i Arsimit do të duhej të kërkonte nga Qeveria që të largonte policinë nga universiteti.

Edhe mendoj që deri më tani nuk ka ndodhur kjo ose do të duhej së paku që të shprehte shqetësim me praninë e Policisë Speciale në kampus.

Nëse mendon Qeveria që do ta mbrojë rektorin me polici speciale, nga studentët, Qeveria e ka gabim. E ka gabim për dy arsye për shkak se edhe nuk mund ta mbrojë, por edhe nuk ka nevojë ta mbrojë sepse askush nuk e ka sulmuar fizikisht as Rektoratin e as rektorin. Por, studentët, protestuesit, shoqëria civile kërkojnë thjesht dorëheqjen e një rektori të përfshirë në një situatë të apostrofuar nga të tjerët.

Përfshirja dhe prezenca e policisë speciale do të duhej të shënonte një shqetësim shumë të madh jo për faktin se ne nuk do të duhej të kishim njësi speciale, por për faktin që nuk ka nevojë njësi speciale dhe është e paligjshme prezenca e njësisë speciale në kampusin e Universitetit të Prishtinës. Në anën tjetër, edhe nuk ka qenë e nevojshme as në aspektin operativ që të përfshihen këto njësi, do të mjaftonte nëse do të kishte nevojë, do të mjaftonte për siguri që kompania private e sigurisë e cila e ka kontratë me Universitetin e Prishtinës, do të ishte më se e mjaftueshme të ishte prezent jo për të menaxhuar situatën, por të ishte prezent në rast nevojë në objektet apo në hapësirën e kampusit të Universitetit të Prishtinës.

Përveç kaq ashtu siç e ka imazhin kjo Qeveri, po vazhdon që fotografinë e këtij imazhi të keq ta pasurojë edhe me pamje tjera. Nuk besoj që e keni harruar, të nderuar deputetë, edhe imazhin e protestave tjera kur policët nuk mjaftohen vetëm me arrestime e dhunë ndaj protestuesve, të cilët kanë të drejtë, por të njëjtit madje edhe udhëheqësit e kësaj policie e vënë këmbën mbi kokat e protestuesit. Besoj që ky imazh ju kujtohet shumë prej juve këtu, këmba dhe çizmja e komandantit të policisë mbi kokën e një protestuesi të shtrirë në Sheshin “Nënë Tereza”.

Ky nuk duhej të ndodhte as atëherë, nuk duhet të ndodh as tani, por mbi të gjitha ky është imazhi i Qeverisë aktuale të Kosovës. Kjo është fotografia e kësaj Qeverie e cila përdor policinë speciale, përdor Policinë e Kosovës për qëllime krejt politike dhe jo për qëllime operative dhe në shërbim të ruajtjes së rendit dhe qetësisë.

Kemi ardhur në një situatë ku fizikisht po të shohim protestën, fizikisht në mes Rektoratit dhe studentëve, është policia. Pra, policia po e ndan Rektoratin dhe studentët, së paku ministri nëse s'ka disponim Qeveria do të duhej që t'i bashkonte Rektoratin dhe studentët dhe ta hiqte nga atje policinë, njëkohësisht edhe të bënte thirrjen e njëjtë, njëzëshëm me protestuesit në protestë.

Për fund, rektorit në situatën më të mirë do t'i preferoja të jepte dorëheqje edhe nëse dorëheqja e tij do të duhej patjetër të ishte e guximshme, madje dorëheqja e tij së paku do ta zbuste situatën nëse do ishte një dorëheqje e guximshme, për shkak se e di që rektorit i duhet njëfarë guximi, e guximi që i duhet rektorit është të flasë më shumë se sa ka folur deri më tani e sidomos të flas më shumë për presionin që i ka ardhur nga politika, nga deputetë të caktuar, nga Qeveria dhe për presionin i cili ka qenë ndërhyrje e vazhdueshme edhe në punën e tij.

Pra, nëse do të shpëtojë diçka rektori nga ajo që ka ndodhur së paku le të bëhet pak trim, le të japë dorëheqje dhe le të flas. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Skënder Hyseni.

SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministri Buja tha se, po citoj: "Universitetit duhet t'i kthehet kredibiliteti". Nuk kam si të mos pajtohem me këtë konstatim. Vetë konstatimi se duhet kthyer kredibiliteti në universitet, konstaton vetvetiu se universitetit i ka rënë kredibiliteti.

Dhe, këtu absolutisht më e vogla e punës që mund të bëhet si fillim për t'ia kthyer kredibilitetin Universitetit është që të përfillen me saktësi dhe të materializohen kërkesat, përkatësisht rekomandimet, të cilat me elokuencë i lexoi deputetja Lirije Kajtazi.

E një nga rekomandimet kyçe ishte që rektori së bashku me Këshillin drejtues të jap dorëheqjen sa më shpejt që të jetë e mundshme dhe me këtë akt t'i hapet rruga një procesi pak më afatgjatë për normalizimin e gjendjes në universitet. Është bërë modë, pothuaj është bërë klishe që të thuhet: "politika nuk guxon të ndërhyjë aty e këtu". Dhe unë këtu sërish po pajtohem me kryetarin e Kuvendit Krasniqi, që pak më herët tha se si grupacion politik çdo parti, çdo grupacion politik ka edhe politika adekuate arsimore, të cilat përpiqet t'i transmetojë përmes mekanizmave përkatës dhe nuk ka asgjë të keqe nëse në kuadër të politikave partiake arsimore, përpiqemi të bëjmë përmirësimet e duhura në procesin dhe sistemin arsimor përgjithësisht.

Përpos dorëheqjeve që janë një akt i domosdoshëm për të filluar atë që është nevojë akute në universitet, sot, unë kujtoj që në bazë të mësimave të nxjerra nga përvoja e deritashme, duhet urgjentisht të fillojë edhe amendamentitmi, përkatësisht ndërrimi i statutit të universitetit.

Sepse, mësimet e nxjerra, leksionet e deritashme flasin për nevojën e ndryshimeve të caktuara në statut në mënyrë që ajo që po synojmë, një normalizim i gjendjes në

universitet edhe të ndodhë. Unë do të marr vetëm një shembull, statuti përcakton kritere ose dispozita të caktuara, kërkojnë nga profesorët që të kenë 2-3 punime si autorë të parë në revista me renome dhe kredibilitet shkencor dhe arsimor ndërkombëtar. E tashti, unë kam dilemë nëse një dispozitë e tillë është e domosdoshme, është e qëndrueshme dhe e dobishme, sepse shihni një dispozitë e tillë mund të ftojë dhe të dërgojë në mediokritet të pashmangshëm dhe të bëjë që profesorë të caktuar të botojnë edhe atje ku askush nuk lexon revista, absolutisht me kredibilitet totalisht të dyshimtë, edhe shkencor, edhe profesional.

Prandaj, të ikim nga klishtë, t'i lëmë anash klishtë dhe të merremi me problemin real. Problemi real është që Universiteti i Prishtinës sot është katandisur në një gjendje të padurueshme dhe ajo gjendje duhet të fillojë të kthehet për së mbari dhe ky fillim duhet të jetë dorëheqja edhe e rektorit edhe e Këshillit drejtues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të respektuar kolegë deputetë.

E mirëpres debatin e sotëm lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës dhe sigurisht që ditët e fundit të gjithë po bashkëjetojmë me këtë situatë të rënduar. I përkrah po ashtu, të gjitha iniciativat e studentëve të shprehura në protesta lidhur me çështjet të cilat u takojnë atyre për të reaguar.

Roli i studentit në jetën universitare është e pakontestuar, kur ky qëllim nuk keqpërdoret nga grupet e caktuara për interesa të ndryshme dhe disa të kamufluara nën OJQ dhe një pjesë të shoqërisë civile. Studentët kanë nevojë të dinë për të gjitha angazhimet rreth qasjes në revistat shkencore dhe në këtë drejtim kishte me qenë shumë e mirëseardhur një qasje e tillë nga studentët.

Studentët kanë nevojë të adresojnë kërkesa për kushte shumë më të mira, për shfrytëzimin e bibliotekave. Kam pritur që moti një reagim të tyre për ushqim më cilësor në mensë dhe këto kërkesa do të jenë kushti themelor për studime normale për çdo student. Para kërkesave për të përfshirë shumë reagime politike në këto ngjarje që po ndodhin, do të kishim dashur që studentët t'i shohim duke kërkuar nga profesorët e tyre mbajtje të ligjëratave me rregull dhe cilësi të ligjërit, mbajtje të afateve të provimit dhe shpalljen e rezultateve me kohë.

Ne e dimë faktin që në disa fakultete mbahet provimi dhe deri në afatin e radhës, nuk dalin as rezultatet. Kemi të dhëna që studenti duhet të presë me muaj edhe deri në një vit që të gjithë anëtarët e Komisionit recensues t'i japim nënshkrimin e referatit të dorëshkrimit të temës së diplomës. Kemi të dhëna pra që studentët duhet të presin me muaj të tërë për të pritë anëtarët e komisioneve që t'i caktojnë datat e tyre për mbrojtjen e temave, a nuk janë këto vërtet brenga reale dhe preokupim i studentëve të universitetit?

Mirëpo, në anën tjetër, në asnjë rast nuk është e lejuar dhe as e rregulluar me ligj dhe statut të institucionit, që studentët të japim vlerësime të avancimit të asistentëve dhe profesorëve të tyre. Kjo është edhe shkak se studentët nuk janë ekuivalent me kapacitetet e tyre intelektuale dhe akademike për këtë çështje dhe ky kriter nuk vlen në Kosovë, por vlen në gjithë botën.

Si deputete e këtij Kuvendi, në çdo kohë do t'i përkrah debatet, por edhe protestat e studentëve për çështje të cilat janë brengë e studentëve që lidhen me interesat për jetën e tyre studentore. Por, po ashtu besoj që organet kompetente do të kryejnë punën e tyre lidhur me dyshimet e ngritura kohëve të fundit dhe do të përfundojë hutia popullore se çfarë vërtet po ndodh në universitet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, për diskutim të shkurtër dhe të saktë në idetë tuaja, natyrisht!

Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi. Gëzim, veç një arsytim, mos m'u drejtoni me ndonjë farë qejfi se secili do vetë të flasë i pari, unë e kam një listë, çështja është që LDK-ja i ka 80% të kërkuesve, PDK-ja i ka një 20%, tjerët i kanë ka 2-3 veta, normalisht kanë për të folur më shumë këto dyja që kanë më, se është normale ajo ashtu ndodh. Fjalën e ka Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë të nderuar,

Pa dyshim që debati për universitetin është një debat i cili ka ngjallur kureshtjen jo veç të neve këtu, por gjithë opinionit kosovar dhe institucioni fatkeqësisht i cili është përgjegjës për prodhimin e kuadrove të reja, të cilat në të ardhmen do të udhëheqin me Kosovën, është implikuar në korrupsion dhe skandale të ndryshme.

Shumë herë është përmendur se nuk është mirë të politizohet çështja e këtyre problemeve në Universitetin e Prishtinës, por fatkeqësisht vetë universiteti është i politizuar dhe kjo nuk po ndodh vetëm në vitin e fundit, por nëse e shikojmë në mënyrë analogjike që 15 vjet mbas luftës ne kemi probleme të tilla me Universitetin e Prishtinës. Korrupsioni e ka përfshirë çdo shtresë duke filluar prej studentëve e deri te profesorët e dekanët e tyre, prandaj është një gjendje mjaftë e rëndë dhe mendoj që vetëm dorëheqja e rektorit apo dikujt përgjegjës nuk i zgjedh problemin, ngase sikur të ishte veç deri te rektori atëherë gjithë do të ishim unanim që të japë dorëheqje dhe të zgjidhet problemi, por mendoj që çka do të zgjidhte nëse eventualisht rektori jep dorëheqje kur e dimë që problemet janë më shumë se një dekadë, kanë zënë rrënjë të thella në Universitetin e Prishtinës.

Kemi gjendje shumë të rëndë, kemi numër enorm jashtë listës, jashtë konkursit të studentëve të pranuar në fakultetet të ndryshme, veçanërisht në Fakultetin e Mjekësisë, vite me radhë. Kemi punësim pa kritere, kemi nepotizëm klasik në Fakultetin e Mjekësisë dhe në fakultetet e tjera, kemi dhënie jo të rregullt të provimeve nga ana e studentëve në bashkëpunim me profesorët e tyre dhe më e rënda që është përfolur kohëve të fundit, kemi edhe diploma në mënyrë jo legale të dhëna. Kjo mendoj që është pjesë e hetuesisë ata duhet të merren nëse eventualisht ka dhënie të tilla të diplomave të tilla.

Prandaj, gjendja në universitet duhet të gjithëve të na shqetësojë, të mos kërkojmë që vetëm një figurë të jetë përgjegjëse për këtë, por përgjegjësia është mbi të gjithë klasën politike që 15 vjet mbas luftës që ka lejuar që të vijë universiteti në gjendje të tillë, ngase nga kjo gjendje e tillë e Universitetit kanë përfituar fatkeqësisht edhe një pjesë e mirë e politikës së tashme dhe të kaluara, ku dimë edhe titujt shkencorë mirë se si janë marrë dhe se si janë avancuar.

Prandaj, unë mendoj që duhet të shikojmë të gjithë, të gjejmë një rrugë zgjidhje edhe si institucion legjislativ të jemi krah për Universitetin e Prishtinës dhe të mos kërkojmë vetëm kokën e një personi konkretisht rektori që ai të japë dorëheqje, por të mendojmë për një zgjidhje më afatgjatë ngase dorëheqja e tij unë mendoj që nuk e zgjidh problemin. Kushdo që të jetë aty, nëse e zgjedhim figurën më kredibile në Kosovë është shumë problematike ta zgjidhë problemin që është në Universitetin e Prishtinës më shumë se 10 vjeçar.

Por, duhet një angazhim gjithëpërfshirës dhe mendoj të flasim për apolitikë është jo e drejtë, ngase e dimë që shumë udhëheqës, shumë struktura të cilët vijnë aty, janë prej strukturave të ndryshme politike, por për shkak të ligjit duhet të deklarohen që më nuk janë aktiv në atë parti politike, përndryshe universiteti është i politizuar, vazhdon të jetë i politizuar, por neve si politikë na takon ta ndihmojmë Universitetin dhe mos të fajësojmë figura të ndryshme për faktin se problemet janë gjithëpërfshirëse, janë më masive dhe nuk janë individuale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja pa grup, Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pas gjithë këtyre trazirave që janë duke e lëkundur fort Universitetin e Prishtinës, dikur armën më fortë të Kosovës, debati më në fund u hap edhe në Kuvend. Ne si Kuvend kemi obligim që të kanalizojmë si duhet këtë debat duke u përpjekur të gjejmë zgjidhje racionale dhe të vërteta dhe jo zgjidhje aty për aty, zgjidhje këto të cilat do ta shpëtonin universitetin më të madh dhe kryesor në vend.

Ne e kemi folur shumë në Kuvend për procesin e privatizimit dhe shitjet me çmime të ulëta të aseteve tona, ndërsa nëse shprehem figurativisht kam përshtypjen që universitetin jo vetëm që e shitëm, por e dhamë falas. Tërë pas luftën ia lamë në dorë klaneve të ndryshme të ndikuara nga politika, të cilët nuk ia ditën fare vlerën.

Këta njerëz pozitën në universitet e panë vetëm si një mundësi për një status më të mirë në shoqëri dhe asnjëherë si detyrë të shenjtë ndaj studentëve të tyre. E degraduan aq shumë sa tani është buzë rrënimit total dhe si duket është mbushur kupa apo është hasur në... apo në pikën më të dobët të rezistencës dhe plasën shumë gjëra, shumë gjëra, por sigurisht jo të gjitha. Shtrohet pyetja a është duke u goditur caku? Vërejtja dominuese kohëve të fundit është bërë publikimi në një revistë që po quhet e "rreme" për të cilën janë paguar para dhe që është shfrytëzuar për avancim. Për këtë do ta sqaroj mendimin

tim pas pak, por po pyetem a është menduar deri më sot se bëhet shumë shkencë në Kosovë dhe kemi brumë kulminant shkencor në Universitetin e Prishtinës?

A nuk e kemi ditur se vetë shkenca dhe publikimet shkencore janë në korrelacion të drejtë me zhvillimin ekonomik të vendit, po çuditë me ata që kanë menduar ndryshe.

Ajo që mua mu ka dukur shumë shqetësuese është se në Universitetin e Prishtinës po u epan provimet me para, po u bëkan pranime në shkëmbime parash apo favoresh dhe kam frikën që këto dukuri kaq të rënda do të bien nën hijen dhe harresën e një debati se a kemi të bëjmë me një punim në një revistë të vërtetë apo false.

Në ndërkohë që ka mundësi të shpëtojmë keqpërdorues të mëdhenj që ua humbin vullnetin dhe shpresën edhe atyre studentëve që dëshirojnë të studiojnë dhe të fitojnë dije.

Arrestimi i disa asistentëve, studentëve dhe shkarkimi i një dekani për shkak të dyshimit se kanë bërë korrupsion dhe falsifikim është veprim selektiv i organeve të hetuesisë, respektivisht janë arrestuar vetëm ata që nuk kanë mbështetje politike.

Ka fakultete në të cilat shkeljet janë edhe më të mëdha se sa në Fakultetin e Mjekësisë, prandaj ndjekja duhet të shtrihet deri te shkelësi i fundit. Ne si Lëvizje për Bashkim këtë e kemi thënë edhe në konferencë për shtyp.

Po kthehem te publikimet shkencore. Personalisht janë tema ime e preferuar dhe quaj veten deri diku kompetente të flas për këtë çështje pasi jam autore e parë dhe korrespondente e mbi 10 publikimeve shkencore ndërkombëtare, ani pse këto ditë më të moralshmit dolën ata që nuk publikuan asnjëherë si autorë të parë, madje pati krekosje të ndryshme nga ana e tyre.

Disa gjëra ndjej obligim t'i sqaroj. Revistat me qasje të hapur për herë të parë kanë filluar të aplikohen në fund të viteve të '80-ta. Këto revista nuk kanë përkrahje financiare nga shteti apo nga ndonjë shoqatë dhe mbajnë veten me anë të pagesës së autorit për procesim të publikimit. Madje, vlen të përmendet se shumica e këtyre revistave kanë lirim nga pagesa apo ulje të çmimeve për vendet me ekonomi të dobëta në listën e të cilave gjendet edhe vendi ynë.

Disa revista të tjera mbijetojnë nga shitja e punimit të caktuar apo revistës, por ato para shkojnë te revista dhe jo te autori siç dëgjova në një rast në mediet tona se kinse shkencëtarët e vërtetë jo që japin para për punime, por fitojnë nga ato. Një njeri i cili njëherë në jetë ka publikuar e di se në momentin që pranohet punimi ai duhet të drejtën e tij autoriale t'ia japë shtëpisë botuese. Madje, nëse dëshiron edhe vetë në të ardhmen të përdorë pjesë të atij punimi duhet të kërkojë nga botuesi t'ia lejojë ta përdorë atë.

Duke qenë një vend ku institucionet nuk na përkrahin financiarisht për publikime, unë personalisht iu kam shmangur maksimalisht botimit në revista me pagesë, por jo sepse nuk ka revista me vlerë të lartë shkencore në mesin e të cilave ka disa edhe me impakt faktorë.

Unë jam habitur me çmimet e ulëta që janë përmendur këto ditë në media, në fakt unë kam hasur revista të cilat kërkojnë vlera mbi 1 mijë euro për publikim, por vetëm pasi që të pranohet punimi, jo gjithsesi dorëzimi i parave do të thotë edhe pranim i punimit.

Unë e vlerësoj faktin që shoqëria jonë qenka interesuar që të vlerësohen punimet shkencore, në fakt vetë publikimet e stafit akademik janë ndër faktorët kryesor që ndikojnë në rangimin e universitetit. Nëse nuk jemi të kënaqur me publikime në revista shkencore e ndërkombëtare të nivelit të ulët, atëherë rrjedh nevoja për ndërrime statutare ku do të ngrenë kriterin për marrjen e titujve, duke kërkuar pragun minimal të lejueshëm që të merret parasysh një punim për avancim dhe kjo mund të kuantifikohet, qoftë me impakt faktor, qoftë me ekuivalentin e tij apo me indeksim të revistës gjegjëse.

Dhe, pastaj pasi të caktohen këto kritere nuk ka më vend për çfarëdo individi ,kushdo qoftë ai për të vlerësuar një punim të dikujt, sepse atë e ka bërë një revistë kredibile.

Tek e fundit, kemi kërkuar recensione ndërkombëtare, pikërisht për t'i ikur ndikimeve të brendshme, të cilat bëhen qoftë për të ndihmuar dikë, apo për ta dëmtuar padrejtësisht dikë tjetër. Statuti aktual ka shumë boshllëqe të cilat në vazhdimësi janë keqpërdorur nga shumëkush e ndër ta është edhe rasti i rektorit aktual.

Në saje të këtyre mangësive është përdorur edhe një punim nga një lëmi krejtësisht tjetër. Në anën tjetër statuti i tanishëm ka një avancim krahasuar me atë paraprak pasi që kërkon që kandidati të jetë autori i parë apo korrespondent, por kjo gjë nuk është përfillur në rastin tanimë të mirënjohur të rektorit, por jeni të bindur nuk është përfillur edhe në rastin e shumë profesorëve të avancuar të tjerë.

Prandaj, ndër hapat konkretë që propozojë janë: ndryshimet e menjëhershme statutare në Universitetin e Prishtinës, që do t'i shmangin dualizmat dhe që do të jenë në funksion të përzgjedhjes së stafit akademik sa më cilësor, të cilët do t'i kontribuonin ngritjes së nivelit të mësimdhënies, por edhe vetë rejtingut të Universitetit të Prishtinës.

Për pozitën e rektorit, propozoj të përcaktohet me statut që ai apo ajo të ketë thirrjen e profesorit të rregullt, konsideroj se personat me thirrjen më të lartë akademike kanë edhe integritet personal apo të paktën do të duhej të ishte kështu.

Rektori përpos biografisë së pasur akademike e shkencore, të ketë edhe biografi të pastër, domethënë pa histori për keqpërdorime në të kaluarën. Të mos ndalet hetimi i filluar më herët për aferat korruptive në Universitetin e Prishtinës dhe jam kundër kufizimit vetëm në Fakultetin e Mjekësisë, thujse në këto tjerat po lulëzuaka e mira.

Situata e krijuar sot, por e shtresuar me vite kërkon patjetër ndryshime, mirëpo ndryshimet duhet të jenë në themel e jo sipërfaqësore vetëm për sy e faqe. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar!

Unë e di që është mirë të debatojmë, por edhe 21 deputetë edhe unë kam kërkesa nga deputetë të ndryshëm që të shkohet në pauzë, është kërkesë e disave, por unë si deputet jam të vazhdojmë kështu që na kishim mundur ose në 14 e 30 kur ju thoni një orë edhe renditjen ju e keni atje domethënë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit për propozimin! Do të punojmë deri në 14:00, sepse je ti ose jeni ju ose është Grupi i LDK-së që ka shprehur dëshirë të ndërrohet rendi i ditës që të bisedohet me këtë, bëhuni konsekuent në 14:00 do ta mbarojmë dhe vazhdojmë, le të vazhdojë sa janë.

Çdo njeri që do të diskutojë do ta marr fjalën, është punë e tyre a e flasin shkurt a flasin gjatë, le të mbetet punë e tyre unë nuk e kam ndërmend të merrem me ligjërimin e tyre as me idetë e tyre. Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Mendoj se çështja që po debatojmë sot ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe dhe ne kemi ardhur në një situatë kur domosdo është dashur që të debatojmë me këtë. Vetë ky fakt që ne po e hapim një debat, një situatë që na ka shtyrë, tregon se ka munguar një qasje sistematike në trajtimin e problemeve të cilat nuk janë të reja.

Unë do të flas për tri çështje këtu, për problemet e menaxhmentit dhe udhëheqjes, për problemet e performansës dhe për problemet e etikës.

Vetë mënyra se si janë shpërfaqur problemet në Universitetin e Prishtinës kohëve të fundit, tregon se në të tri këto çështje kemi një krizë shqetësuese. Dhe kjo krizë dëmton shumë rëndë reputacionin e këtij institucioni që ende përmban asetin më të vlefshëm të shoqërisë në kuptimin e kapitalit njerëzor.

Universiteti i Prishtinës ka ardhur në një pikë ku duhen kthesa radikale dhe për t'u realizuar këto kthesa nuk bën të ketë ekuivokë, sjellje politikaneske dhe oportuniste. Shihet qartë se problemet në udhëheqjen dhe zhvillimin e Universitetit të Prishtinës janë shtresuar për shkak të menaxhimit të dobët, sidomos të Rektoratit dhe Bordit. Këtyre dy trupave me përgjegjësi, të cilët në disa mandate të fundit janë zgjedhur me një interferim të fortë dhe orkestrim të partive në pushtet, me një interferim direkt të liderëve politikë dhe logjistikës së tyre, këto organe sot janë të mbërthyera, të ngulfatura nga politika që e udhëheqin koalicionet qeverisëse.

Prandaj, situata nuk zgjidhet nëse udhëheqësit e Rektoratit mundohen që ta mjegullojnë përgjegjësinë e tyre, kur ajo përgjegjësi është në dritë të plotë, shumë e qartë. Kjo situatë, po frikohem se nuk mund të zgjidhet edhe me një qëndrim hezitues të ministrisë për të hyrë atje me inspektorate për të parë ku është shkelur ligji. Unë e kuptoj ministrin që thotë që unë e respektoj autonominë, por ekzistojnë ligjet, ekzistojnë inspektoratet dhe ato kur i shkelin ligjet, ministria i ka kompetencat dhe duhet të veprojë.

Problemi me Universitetin e Prishtinës është i ndërlikuar, sepse ai, në këtë moment, me ligj, ai është universitet publik, por në fakt nuk është as universitet publik, nuk është as universitet shtetëror. Kam frikën se ai sot më shumë është një universitet parapublik ose parashtetëror, dhe këtu është çështja esenciale që na duhet ta shohim. Mu për këtë, duhet të dihet roli i ministrisë dhe nuk mund të ketë hezitime për ta sanuar situatën në bazë ligjit dhe kompetencave që ekzistojnë.

Në këtë situatë, kredibiliteti i Rektoratit dhe Bordit është i tillë sa që, sa më gjatë që këta mundohen të vegjetojnë në këtë situatë, diskreditimi dhe degradimi i universitetit do të jetë më i thellë.

Pra, ta përsëris edhe një herë, Universiteti i Prishtinës është një institucion i ngërthyer dhe i ngulfatur nga grupet dhe interesat e ngushta politike. Shtrohet pyetja se përse po ndodh kështu? Përse është kjo situatë dhe cilat janë pasojat? Arsyeja është, sepse partitë në pushtet e shndërrojnë Universitetin e Prishtinës në një servis për të regjistruar militantë, për të marrë grada akademike për militantët, për të punësuar militantë në stafin akademik dhe administratë, dhe kur kjo bëhet prioritet, kësaj i nënshtrohen edhe të tjerat, edhe kuotat e regjistrimit, edhe zgjidhjet e thirrjet akademike, edhe mënyra e vlerësimit të dijes.

Gjendja e sotme në Universitetin e Prishtinës është pasojë pikërisht e kësaj situatë. Si mund të tejkalohet atëherë kjo gjendje? Nuk duhet pritur që ata që i kanë krijuar këto probleme ta kenë një vullnet të madh të tejkalimit të tyre, por besoj se edhe ata e kuptojnë situatën sot, që duhen kthesa dhe vendime radikale. Kuvendi është themelues i Universitetit të Prishtinës dhe përgjegjës që ta zgjedhë këtë problem.

Prandaj, duhet bërë edhe ndryshime në Statut, që u përmend këtu. Nëse duhet, edhe në Ligjin për arsimin e lartë. Duhet ndoshta të fillohet nga mënyra se si e zgjedhim Bordin, sepse bordi është organi kryesues menaxherial. Bordi duhet të zgjidhet nga Kuvendi, nëse Universiteti i Prishtinës është Universitet Publik. Nëse është universitet shtetëror, atëherë ia lëmë ministrisë krejt përgjegjësinë dhe ministrit, por atëherë ministri nuk mund të thotë që nuk ka kompetenca. Ne duhet këtu të kemi zgjedhje të pastra. Kriteret për anëtarë të Bordit duhet të jenë precize dhe të përbëjnë referenca, edhe akademike, por edhe referenca etike, t'i përmbushin kriteret etike. Kuvendit duhet t'i propozohen anëtarët e Bordit nga një panel, ku mund të ketë edhe ekspertë të njohur ndërkombëtarë.

Ajo që është po ashtu shqetësuese, e mbi të cilën nuk mund të tejkalohet, është që nuk ka një përqendrim në analizën - çfarë performanse ka universiteti, çfarë performanse ka stafi, çfarë suksesi kanë studentët. Studimet zgjatin tepër, kurse dijet vlerësohen në mënyrë jo shumë adekuate. Por, ajo që brengos më së shumti është se nuk ka një sistem të analizës të suksesit. Për këtë nuk ka edhe të dhëna statistikore. Unë jam munduar të gjej të dhëna statistikore. Nuk mund të gjej të dhëna statistikore. Kjo tregon se kjo nuk është brenga e askujt. Nuk ka debat në trupa akademike për suksesin dhe performansën. Nuk ka debat në trupat menaxheriale.

Prandaj, vetë ky fakt tregon se kjo çështje nuk përbën një prioritet për menaxhmetin e UP-së dhe njësisë akademike.

Nëse shihni sot, unë i kam marrë disa të dhëna me mund të madh, ne sot, në dhjetor, sipas të dhënave të Agjencisë së Akreditimit, kemi 100 000 studentë në Kosovë, 64 000 në universitete publike, 36 000 në universitete private. Nëse e shihni buxhetin, nëse e shihni stafin, nëse i shihni këto të gjitha, do të shihni se në këtë situatë është vështirë të ketë sukses.

Veç kësaj, puna kërkimore në Universitetin e Prishtinës është modeste, fragmentare, kryesisht e reduktuar në individë entuziastë. Puna kërkimore nuk është futur si pjesës e obligimeve punuese dhe financohet vetëm me 500 000 euro. Më duket sivjet është 700 000 euro. Kjo është për brengosje, bile as kjo nuk shfrytëzohet, se nuk shkojnë propozime të mira.

Në këtë universitet dhe fakultete nuk ka aktivitete kërkimore. Nuk ka debate shkencore, nuk ka konferenca që organizohen prej fakulteteve, prej universitetit. Nuk ka jetë shkencore. Prandaj, kjo duhet të ndryshohet. Në anën tjetër, kriteret për zgjedhje, siç e përmendi edhe kolegu Skënderi, janë shumë rigorozë. Ne nuk i kemi krijuar kushtet që stafi të aftësohet për t'i përmbushur këto kritere.

Shkurt te etika - rritja e korrupsionit në shoqëri gjatë këtyre viteve të fundit ka marrë fatkeqësisht shpërfaqje të tillë edhe në Universitetin e Prishtinës, te regjistrimet, te provimet, te punësimi. Janë arrestuar 11 asistentë. Po ata asistentë që kanë ndërmjetësuar dhe ata që i kanë dhënë nënshkrimet dhe i kanë dhënë provimet, nuk janë askund, dhe pajtohem me kolegen Bakalli, nuk është kjo vetëm në Fakultetin e Mjekësisë. Prandaj, është një krizë shqetësuese e moralit në Universitetin e Prishtinës, por edhe e institucioneve tjera, të kuptohemi, edhe e institucionet private, edhe institucionet tjera publike.

Plagjiatura është bërë gati normale, njerëzit mendojnë që është normale. Kopjimet e studentëve në provim janë bërë kulturë. Konsiderohet që gati është normale. Intervenimet për provime i konsiderojnë si normale dhe kjo është ajo që ne duhet të shohim se ku jemi dhe tash kjo që po mundohen ta arsyetojnë udhëheqësit e universitetit, këto skandale që kanë dalë, është produkt i kësaj vetëdije.

Prandaj, për fillim, unë propozoj: pajtohem që duhet të shqyrtohen zgjedhjet, por le të analizohen avancimet në fillim, me prioritet, në zgjedhjet akademike të rektorëve, prorektorëve, dekanëve, prodekanëve dhe shefave të departamenteve. Një herë me këta të nisë, mandej shkojmë me të tjerët.

Unë pajtohem se duhet të jemi të kujdesshëm që duke folur këtu në mënyrë kritike për Universitetin e Prishtinës, të mos e devalvojmë edhe punën e qindra pedagogëve të mirë, shkencëtarëve të mirë, të cilët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar!

Tema të cilin e kemi për trajtim është aktualisht nga më shqetësueset, por jo e vetmja, por për momentin nga që është bërë motiv për ta tundë tokën dhe për ta shqyer qiellin me zëra e thirrje nga më të ndryshmet, edhe me zmadhues, natyrisht që tani është bërë mirë që është shtruar edhe në këtë Kuvend.

Sistemi ynë i vlerave të përgjithshme është në krizë dhe kemi një trandje gjithandej të këtyre vlerave. Ky shtet i ri, me brishtësi të reja, e me shprehi edhe të vjetra, joracionale, universitetin dhe çdo institucion tjetër publik, do të mund ta atakonin duke u nisur nga cilësia që prodhon akëcili institucion dhe nga shkalla e përgjegjësisë që i karakterizon stafet menaxheriale.

Kjo mund t'i tipizojë edhe problemet në universitet. Është shfrytëzuar një shkas shkencor, por nuk mund t'i fshehim motivet politike, si gjithnjë, për të krijuar imazhin e ndërtimit dhe të drejtimit të institucioneve. Kërkesa që dëgjohet gjithandej për largimin e politikës nga universiteti është e drejtë dhe logjike, është domosdoshmëri e padiskutueshme, por kjo kërkesë nuk do të duhej të dilte nga spektri politik dhe as mënyra e akuzimeve. Kërkesa duhet të vijë nga asociacione shkencore dhe nga institucioni kompetent për arsimin e lartë.

Nëse këto asociacione dhe ky institucion nuk janë të vetëdijshëm dhe të ndërgjegjshëm për ta bërë këtë kërkesë, natyrisht që do të duhej të gjendeshin mënyra nga shoqëria jonë që të cilësohej ndërgjegjja e tyre dhe të shtrohej doemos kërkesa për ndryshim dhe për ngritje të cilësisë në universitet. Cilësia në universitet është domosdoshmëri të ngrihet në nivel më të lartë. Nëse kjo nuk bëhet, natyrisht që bëhet një atentat në të ardhmen tonë. Nëse i kujtojmë vitet e largëta, më tepër se 1000 vjet, kur është krijuar Oksfordi, dhe më 1088 në Bolonjë së pari, pastaj më 1096 Oksfordi dhe më pas Kembrixhi, ne do të shohim që shoqëritë e tyre nuk mund ta kenë pasur këtë emancipim që e ka shoqëria jonë aktualisht, por këtë shkallë të emancipimit që e kemi tash ne dhe këtë gamë të studimeve që e ka universiteti ynë sot, as në kohën e themelimit të tij dhe as në kohën e historive të universiteteve të më hershme nuk mund të krahasohen, por edhe nuk mund të krahasohet edhe vullneti ynë me vullnetin e tyre në qasje për emancipim dhe për dije, edhe për ndërtimin shoqërisë.

Ata që nuk e kanë cilësinë motivim dhe parimësi, bëjnë një krim që mund ta tipizojmë edhe atentat në ardhmërinë e këtij vendi, sepse krijojmë kuadro profesionale me deficite dhe kuadro pa integritet në të gjitha fushat e dijes dhe thirrjeve që ata fitojnë gjatë studimeve.

Unë e dëgjova me shumë vëmendje shumicën prej diskutuesve. Më bëri përshtypje dhe nuk e kisha në fokus qasjen e deputetit Ramiz Lladrovci, i cili më ngjalli në kujtesë një diçka që është shumë me rëndësi tash për të përplasur, të vënë në fokus emancipimin dhe injorancën dhe vasalitetin e këtij vendi, që gjenden protagonistë për ta ndëshkuar çdo përpjekje emancipuese dhe çdo periudhë emancipimi. Duke qenë në krushqi familja ime me familjen e profesor Ibrahim Berishës, më imponohet e freskët kjo historia e tij dhe e

gjithë bashkëlufëtëtarëve të tij, duke fokusuar me theks të veçantë rolin e një të reje nga Shkodra, Marije Shllaku, e unë gjatë studimeve të mia, për përshëndetjen e saj, nuk mund ta akceptoja se ku e gjente forcën për t'iu kundërvënë një sistemi dhe një kohe çfarë ka qenë e paakceptushme me forcën dhe me gjithë me pakuptimësinë e saj.

Tani, në fund, do të gjej atë që duhet ta them. Duke qenë nxënëse e profesor Atë Gjergj Fishta, ajo ishte e motivuar për gjithçka, por nuk ishte e motivuar dhe nuk e dinte se do të takohej Nazmi Kursanin, me një protagonist të OZNA-s, i cili do të lëshojë rrënjë me bijtë e tij në odë dhe me nipin e tij para...

KRYESUESI: Nuk është tema kjo, o Krasniq!

HALIT KRASNIQI: ... jo është thelbi i temës, Prof. i nderuar, sepse nipi i tij para universiteti, duke bërë tani kërkesa ultimative, të cilat janë përballë dijes dhe emancipimit tonë, përgjithësisht. Është duke e trandur sistemin tonë të vlerave, është duke e sfiduar shoqërinë tonë dhe emancipimin tonë përgjithësisht, prandaj desha ta bëj këtë shembull dhe desha ta sjell këtë fakt, që as nuk e dinë të rinjtë dhe as ata që janë rreshtuar përkrah tij.

Kështu, ne nuk duam të mohojmë që ka nevojë për ta trajtuar avancimin e cilësisë në universitet. Natyrisht që institucioni kompetent edhe të rishikojë edhe spektrin ynë menaxheria çfarë duhet të bëjë, por këtu nuk është kompetencë imja dhe nuk dua ta zgjas më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Problemi themelor i Universitetit të Prishtinës që prej përfundimit të luftës në vitin 1999 ka qenë dhe ende mbetet marrëdhënia e universitetit me pushtetin politik. Çdo pushtet politik deri sot, çdo subjekt politik që ka qenë në pushtet, pa përjashtim, ka manifestuar prirje të qartë për ta shfrytëzuar dhe për ta kontrolluar Universitetin e Prishtinës.

Pushteti politik e ka perceptuar dhe trajtuar universitetin si instrument të ndikimit, prandaj nuk është e rastësishme që një prej proceseve kryesore që e ka prodhuar kjo marrëdhënie instrumentale janë një mori profesorësh që janë bërë zëvendëskryeministra, ministra e zëvendësministra, në njërën anë, por edhe një dyzim politikanësh pushtetarë që kanë hyrë si profesorë universitarë, në anën tjetër.

Profesorët janë bërë pushtetarë duke qenë argatë të Qeverisë, kurse qeveritarët janë bërë profesorë duke qenë sundimtarë të universitetit. Kjo është arsyeja kryesore pse Universiteti i Prishtinës është tjetërsuar nga statusi i tij autentik. Statusi i universitetit duhet të jetë institucion i prodhimit shkencor dhe i prodhimit të dijes kritike, por ashtu që të përmbushet ky status duhet të realizohet një parakusht fundamental, e ky është që pushteti t'i largojë duart nga universiteti.

Universiteti është prodhimi shkencës, e jo farkëtim i apologjetëve të Qeverisë. Në anën tjetër, nëse e kemi parasysh vetë strukturën organizative të Universitetit të Prishtinës, vërehet qartë që konstruktimi i kornizës së funksionimit është projektuar për t'i shërbyer kontrollit politik. Qeveria ushtron ndikim përcaktues në Këshillin Drejtues dhe në këtë mënyrë organit kyç të Universitetit të Prishtinës, pra këtij institucioni, i është pamundësuar ushtrimi i funksionimit të parimit të autonomisë dhe kështu struktura udhëheqëse e UP-së goxha shumë është kthyer në marionetë të pushtetit politik.

Si pasojë e instrumentalizimit të vazhdueshëm politik, në Universitetin e Prishtinës ka ndodhur një krizë e thellë e integritetit profesional. Integriteti profesional kërkon që titujt shkencorë të merren në mënyrë të ndershme. Tash doli që duke filluar prej të parit të Rektoratit e deri te plot profesorë mund të ketë pasur mashtrime sa i përket kredibilitetit të punimeve shkencore, të cilat ata i kanë prezantuar për ta justifikuar edhe mbrojtjen e titujve, por edhe pozicionin e tyre si profesorë universitarë. Kjo është një krizë morale e përmasave mjaft dramatike.

Një çështje mjaft problematike, e cila me siguri që duhet të trajtohet më seriozisht nga organet e drejtësisë, është dukuria e përfitimeve të paligjshme materiale nëpërmjet shërbimeve brenda Universitetit të Prishtinës. Ka rrjete të brendshme kriminale në Universitetin e Prishtinës të lidhura edhe me strukturat e pushtetit politik, të cilët merren me regjistrimin e paligjshëm të studentëve në universitet, me falsifikim të notave, me blerjen e notave, me blerjen edhe të çmimeve të ndryshme ndërkombëtare, siç pati bërë rektori i mëparshëm Rugova, pastaj me përpilimin e magjistraturave dhe doktoraturave për një shumë të caktuar parash, e kështu me radhë.

Përveç dëmit që i shkaktohet shoqërisë, në përgjithësi, dhe vlerave tona, skandalet në Universitetin e Prishtinës e kanë edhe një efekt tjetër tejet negativ. Këto skandale me siguri që do ta hedhin edhe një hije të zezë në procesin e akreditimit ndërkombëtar dhe njohjes të Universitetit të Prishtinës në botë si institucion që prodhon diploma dhe tituj shkencorë e akademikë objektivë dhe të ndershëm. Në fund të fjalës sime, po e shfrytëzoj rastin që edhe një herë t'ia bëj një thirrje ministrit të Brendshëm, Bajram Rexhepi, sepse tash sapo e morëm lajmin, përderisa ne jemi këtu duke debatuar për Universitetin e Prishtinës, ai me siguri që i ka urdhëruar forcat e Policisë të ushtrojnë dhunë mbi protestuesit e qetë dhe paqësorë. Ne i bëjmë thirrje ministrit që ta shfrytëzojë autoritetin e tij për ta larguar Policinë e Kosovës nga hapësirat e Universitetit të Prishtinës.

KRYESUESI: Kryeministri e kërkon fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Faleminderit deputetë të nderuar,

Dëshiroj që këtij debati sot, të iniciuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës, t'i kontribuoj edhe unë si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Është shumë mirë që Kuvendi si themelues i Universitetit të Prishtinës ka debatuar edhe më herët, por debaton edhe sot, pasi jemi dëshmitarë se Universiteti i Prishtinës sot është një temë e një debati, edhe politik, edhe shoqëror.

Ne të gjithë, me gjenerata të tëra, jemi krenuar dhe krenohemi me Universitetin e Prishtinës, që ka qenë edhe më tepër se sa vetëm institucion shkencor, në një formë a në formën tjetër, një lëvizje edhe për lirinë e Kosovës, se gjithçka ka lindur, është zhvilluar aty. Pa dashur që të vihem në mbrojtje të askujt, por dhe të marr anë në këtë drejtim, një gjë është e vërtetë: sot Universiteti i Prishtinës i është nënshtruar një presioni politik të paparë, që mund të them, që e kemi përjetuar vetëm në vitet më të vështira të ekzistencës, mund të them lirisht prej se ka ekzistuar. Një presion të tillë nuk e ka përjetuar vetëm në ato vite.

Sot, kundër Universitetit të Prishtinës është ngritur, po e them me përgjegjësi të plotë, brumi i njëjtë i vitit 1989, kur ne studentëve në grevën e 1 tetorit, të minatorëve në nëndhe të Kosovës, na thoshin “Shtrembërojeni kapuçin se kurr gjë nuk po i ndodh Kosovës!”, ndërsa këtu fillonte gjenocidi. Na thoshin nuk po ndodhin ndryshime kushtetuese, disa ndryshime elekuente. E vetëm për një ditë, nga ajo politikë janë vrarë mbi 30 veta, në janar të ‘90-tës. Pas atyre deklaratave, të flasë brumi i njëjtë!

Politika dhe Universiteti - Universiteti është produkt i Kuvendit të Kosovës. Unë nuk dëshiroj të zbres në nivelin e diskutimeve se a ka qenë Universiteti më mirë në ‘74-tën, a pas çlirimit të Kosovës. Le të mbetet në opinionin e secilit. Por, edhe një gjë është e vërtetë, sot Universiteti i Prishtinës i është nënshtruar një presioni nga politika, nga aktorë me qëllime politike. Sot, Universiteti i Prishtinës është shndërruar në një adresë të fillimit të fushatës elektorale, 2014. Kjo është e vërtetë.

Prandaj, do të ishte jo e ndershme dhe e pamoralshme të mos thuhet gjërat ashtu siç edhe janë. E ritheksoj, në asnjë rrethanë, nuk jam këtu për ta mbrojtur askënd, nuk jam ai që e bën verifikimin e këtij punimi, ose të atij punimi, botimin e këtij ose atij botimi, në çfarëdo reviste, kushdo që e ka bërë. Por, nëse jemi të sigurtë, ne, si njerëz të politikës së Kosovës, atëherë le t’i marrim përgjegjësitë edhe ne si politikë, të gjithë, pa dallime.

Unë e çmoj iniciativën e LDK-së për debat në Parlamentin e Kosovës, por në të njëjtën kohë ftoj që të bëhemi të përgjegjshëm të gjithë, të sigurtë, por edhe pak moralë, nëse ka mbetur në politikën kosovare, në këtë çështje, këto ditë. Le të ngrihemi të gjithë mbi interesat personale, grupore, partiake dhe mbi fushatën elektorale.

Nuk është politika në Universitetin e Prishtinës e sotme. Lëre deri në vitin ‘89, por nga ‘90 e tutje. Ju e dini shumë mirë. Ne duhet çmuar dhe respektuar shumë ata njerëz që kanë mbijetuar, duke e mbajtur gjallë universitetin, ata studentë, të gjithë, pa dallim, me sakrificë të jashtëzakonshme. Por, jemi dëshmitarë të asaj që nga viti ‘91, mund të ndalemi edhe në vitin ‘90, kur në një formë a në formën tjetër, edhe thjesht u pavarësuan si Universitet i Prishtinës, ka pasur edhe të tillë që kanë qenë në politikë, janë marrë me politikë, janë sjellë rreth politikës, njerëz të fuqishëm, po flas nga ‘90-ta, fare pa pasur fakultet, kanë kryer magjistratura. Që kanë qenë edhe në Kuvendin e vitit 1992 e tutje, që kanë qenë edhe në Kuvendin e Kosovës nga viti 2001, e që deri sot janë në Kuvendin e Kosovës. Deputetë që pa fakultet fare kanë kryer magjistratura tani! Pa shkollë fillore kanë kryer fakultet! Ju e dini shumë mirë.

Ju e dini se ka mjaftuar që dikush nga politika të jetë i fortë, flas nga '90-'91, dhe të avancohet drejt në doktor shkence, në mënyrë fare jomeritore. Thjesht, këta tituj dhe këto gradime për njerëzit e politikës, jo të gjithë, nuk po them, dhe ju e dini shumë mirë secili nëpër partitë politike. Secili le të ndalet te partia e vet politike, ose i kanë pasur miqtë në universitet, dhe liderët apo lidërsipin në parti, që kanë qenë të ndërlidhur me njëritjetrin.

Avancimi i titujve shkencorë, marrja e titujve, avancimi i gradave, apo titujve shkencorë, më tepër kanë qenë mund të them lirisht tubime elektorale në universitet prej '90-'91, se sa një mbrojtje dinjitoze shkencore, marrje e titujve shkencorë. Janë bërë njerëzit e politikës edhe akademikë pa merita shkencore dhe me plagjiatura të konfirmuara. Ky është turp! E tani këtu nuk ka moral kur flitet nga politika për universitetin, në veçanti për këta që po flas. Unë nuk do të flas me emra. Nëse dëshironi flasim deri në mëngjes. Po flas për të gjitha partitë politike, secili le ta gjejë veten. Secili individ, nuk po flas për të gjithë deputetët, por po flas për njerëzit e institucioneve të Republikës së Kosovës nga vitet '90-'91 e deri këtu, për individë, e ata më të zhurmshëm janë sot.

Nëse është bërë akademik me plagjiaturë, nuk ka fare moral. Duhet t'i vijë turp të flasë. Nëse është bërë doktorë shkence me plagjiaturë, në tubim elektorale nëpër fakultete, duhet t'i vijë turp këtu të flasë. Nëse është bërë magjistër pa fakultet, dushet t'i vijë turp këtu të flasë. Nëse thjesht ka kaluar në fakultet pa shkollë fillore, duhet t'i vijë turp të flasë për Universitetin e Prishtinës.

E raste të tilla ka. I kemi këtu, në të gjitha partitë. Flitni! Tregojuni qytetarëve! Prandaj, kërkoj prej jush të gjithëve mbështetjen në propozimin tim si kryeministër i Qeverisë së Kosovës, që të kërkojmë sot, qoftë deklaratë, qoftë rezolutë, qoftë çka dëshironi të gjithë të bashkuar, si skenë politike, nëse nuk kemi frikë për njerëzit që kemi brenda partive tona politike dhe nëse kemi guxim ta marrim atë vendim, që të kërkojmë nga që të kërkojmë nga Senati i Universitetit të Prishtinës verifikimin e gjithë titujve dhe gradave shkencore të njerëzve të politikës kosovare nga viti '90 deri në dhjetor të vitit të kaluar, a deri sot.

Jo, ju lutem! Unë nuk po flas për asnjë parti politike dhe për asnjë individ me asnjë motiv. Unë po flas për një kriter, për një standard, që duhet të përfshihen të gjithë, pa dallim. Le ta mbështetim të gjithë në mënyrë unike si politikë kosovare. Le ta lëmë fushatën elektorale anash. Le ta mbështetim Senatin e Universitetit të Prishtinës për verifikimin e të gjithë titujve dhe gradave shkencore 1990/'91, ku të doni ndalemi, e deri sot. Pastaj, jemi të sinqertë me opinionin publik. Edhe për akademinë nëse dëshironi, unë mund të flas. Tash është i hapur debati, tash po flasim, vazhdojmë për sa të keni qejf, ngase pyetët edhe për akademinë.

Ju kisha ftuar për vëmendje se shumë interesat, është realiteti i hidhur, që e kemi. Në një rast, në një ndejë, personalisht si kryeministër i vendit, e kam pyetur njërin nga kryeakademikët kosovarë, që ka qenë udhëheqës i Akademisë së Kosovës, se si po ndodhin këto avancime në baza partiake në akademi, komplet gati njëpartiake. Dhe, ju nuk mund të imagjinoni se çfarë përgjigje kam marrë. Përgjigja ishte se është bërë

kryetar komune dhe ka fituar goxha shumë vota. Përgjigjja ime ishte se filan kryetari i komunës realisht ka më shumë vota, atëherë bëjini të dytë. Edhe atë që ka fituar më së shumti vota, mbi 80%, edhe këtë që mezi ka fituar në një qytet të madh. Përgjigjja ime ishte më tepër për humorin e hidhur që ndodhte. Pra, kriter ishte që ka fituar në filan komunën dhe i ka miqtë e shokët aty.

Unë e çmoj shumë çdo akademik dhe botën akademike. Por, por e prezantoj një bisedë krejt kolegjiale, por si kryeministër, kur në pyetjen time e kam marrë një përgjigje shumë të singertë. Por, të ndalem në temë. Pra, propozoj formimin apo mbështetjen me një rezolutë, deklaratë, çfarë të dëshironi, që t'i japim Senatit të Universitetit të Prishtinës për verifikimin e të gjithë titujve dhe gradave shkencore të njerëzve të politikës kosovare prej 1990 deri sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Unë nuk i komentoj kurrë diskutimet nga kjo pozitë, por mua më duket që njëra nga rekomandimet është pikërisht kjo, sa e di unë. Fjalën e ka Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar, faleminderit!

Mendoj që kryeministri, me gjithë qëllimin e mirë, nëse e ka pasur në fillim, pastaj devijoi e doli jashtë asaj për çfarë doli, besoj ta japë mendimin e vet. Së pari, po ju them - lexojeni rekomandimin. Njëri nga rekomandimet është kjo, dhe nuk ka nevojë fare për ta afatizuar. Le të shkojnë edhe për më herët, kush ka mundësi le të verifikojnë edhe para '91-shit. Si LDK, nuk e kemi asnjë problem. Atë gajle nuk e kemi.

Është rekomandim yni, zoti kryeministër, nuk të paskan treguar. Nuk është kurrfarë risie kjo, domethënë e kemi futur në rekomandime.

Pastaj, unë mendoj, zoti kryeministër, që qëllimi ynë LDK, unë nuk e kam ndërmend t'u arsyetohem juve, por po e them para qytetarëve, është që kur ngrihet debati për një çështje, duhet të ngrihet në institucionin që është kompetent dhe nuk ka organ më kompetent se sa ky Kuvend për t'i debatuar shqetësimet që janë ngritur rreth Universitetit të Prishtinës. Dhe, ne konform kësaj e kemi bërë kërkesën dhe kësaj po sillemi. Ne nuk mund të mbetemi po ashtu imunë, ndërkohë që ka edhe protesta të qytetarëve, të studentëve, ka shqetësime dhe për të gjitha është ky Kuvend t'i shqyrtojë dhe t'i debatojë. Asgjë nuk ka elektorale, asgjë nuk ka partiake, por ka, mbi të gjitha, institucionale dhe të rëndësishme për vendin tonë.

Prandaj, ajo që e thoni ju është shumë interesante, sepse edhe ne na bën përshtypje, disa që nuk kemi magjistruar. Bash do të jemi të interesuar se kush janë ata që nuk kanë shkollë fillore dhe e kanë kryer fakultetin. Kjo është shumë interesante, pasi janë bërë në këtë periudhën e fundit qeverisëse, është mirë të dihen këta. Hapur si LDK po e them - është mirë të dihet kush janë këta njerëz, që në çfarëdo forme, në mënyrë abuzive kanë magjistruar, kanë doktoruar, sepse ata nuk i duhen këtij vendi. Ata njerëz, më vjen keq ta them, nuk i duhen shkencës sonë, sepse së pari e kanë marrë pa merita. Prandaj, ne nuk e kemi asnjë problem që për këtë të debatohet, të diskutohet.

Ne i kemi dhënë rekomandimet shumë të qarta, e kemi thënë fjalën tonë dhe deputetët tanë do ta japin deri në fund kontributin dhe unë zoti kryesues nuk do të doja që ta devijojmë debatin në diçka tjetër. Edhe për të tjerat, kur të doni bëjmë debat. Faleminderit!

KRYESUESI: Kryeministri, meqë e ke përmendur. Replikë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Po, zoti Beqiri! Unë i kam rekomandimet e LDK-së këtu. Kjo që unë propozova nuk qëndron në rekomandimet tuaja.

KRYESUESI: Është variant tjetër!

KRYEMINISTRI: HASHIM THAÇI: Ok-ej, në rregull! Se a ka fushatë a jo, le ta vlerësojë vetë opinioni, por edhe ju e dini se ka fushatë, i nderuar Beqiri. Se a ka aktorë dhe qëllime politike, le ta vlerësojë vetë opinioni.

Se a jeni të interesuar në këtë periudhë kohore, në atë periudhë, unë nuk jam duke u ndalur në asnjë periudhë të caktuar kohore, se nuk dëshiroj të vër në siklet asnjë parti politike, se të gjitha kanë kaluar nëpër periudha të ndryshme, sidomos partitë e mëdha, që e kanë pasur pushtetin, edhe të tjerët që kanë qenë pjesë e koalicioneve të partive të mëdha, apo që e kanë udhëhequr edhe Qeverinë.

Unë nuk dëshiroj të ndalem vetëm në një kategorizim që ju e përmendet, për aq sa është e rëndë, nëse dikush nuk e ka kryer filloren, e ka kryer fakultetin, ose e ka kryer magjistraturën pa fakultet, apo doktoraturën pa magjistraturë, por më e rëndë është nëse dikush u bë akademik me plagjiaturë të konfirmuar tanimë.

Prandaj, duhet të hyhet nga fillimi e deri në fund. Nuk qenka zoti Muhamet Mustafa këtu, se kishim diskutuar edhe për periudhën para '91-shit. Po, në kohën e Titos, pse jo! Në të gjitha periudhat, nëse dëshironi.

Ne si Parti Demokratike, por edhe si Qeveri e Kosovës, edhe si koalicion, nuk i ikim asaj përgjegjësie. Unë nuk jam duke e mallkuar asnjë periudhë kohore, se secila periudhë e historisë që e kemi kaluar ka qenë një stad i avancimit të çështjes sonë kombëtare. Edhe e universitetit. Por, edhe një herë theksoj, do të ishte e turpshme të kërkoj diçka nga të tjerët, kur ne vetë, që gjithë ditën po flasim për këtë çështje, mundohemi të jemi anash, si të pastër, apo si të kristaltë. Jo! Edhe në Kuvendin e Kosovës, edhe në institucionet e Kosovës, mund të them se degraduesit më të mëdhenj të Universitetit të Prishtinës kanë qenë njerëzit e politikës kosovare, të graduar me tituj të pamerituar dhe me plagjiatura tani më të konfirmuara. Po! Me emra ju i dini, secili nëpër partitë e veta le t'i shikojë, që janë bërë edhe doktorë shkence, edhe magjistra, edhe akademikë në tubime elektorale.

KRYESUESI: Po nuk bëhet dialogu kështu! Zoti kryeministër, mbaroje e pastaj...

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: ...prandaj, edhe një herë propozoj dhe ju ftoj të gjitha partitë politike, në një periudhë të caktuar kohore, jo të mbështetet Senati për

formimin e një komisioni, e ku ta di unë. Se për të mos ndrequr punë, bëje atë komision edhe asgjë, por për t'i dhënë kohë. Tash është shumë lehtë në mënyrë elektronike. Shumë lehtë është verifikimi, kuptimi i një liste firmuese apo avancuese për njerëzit e politikës kosovare.

Një listë, mund të them lirisht, që do të jetë bartëse e verifikimit të këtyre çështjeve, të titujve dhe gradave shkencore, prej nivelit të fakultetit deri në nivel akademiku. Për të gjithë, pa dallime. Urdhëro zoti Beqiri, mbështete! Kjo është në interesin e gjithë Kosovës, të arsimit kosovar.

KRYESUESI: Pasi ta përmendi emrin, një fjali, se dokumenti ekziston dhe nuk kemi nevojë. Ismet Beqiri, 1 minutë!

ISMET BEQIRI: Së pari, janë disa rekomandime që po të propozoj t'i mbështetësh ato. E nëse mungon edhe ajo pjesë, e shtojmë edhe një pjesë. Këto janë rekomandimet tona dhe asgjë që i kontribuon të mirës së vendit, ne nuk e kundërshtojmë. Të gjitha i mbështetim.

Prandaj, këto janë rekomandimet që i kemi bërë, i mbështetni ju këto, edhe ne do t'i mbështetim.

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Unë e kërkoja fjalën në formë replike ndaj asaj që tha kryeministri në ikje. Ajo që e thotë kryeministri, mendoj se është simptomatike në dy aspekte, që e shpërfaq mënyrën se si ky mendon politikisht, edhe karshi sistemit arsimor dhe universitetit në përgjithësi.

A e dëgjuat me vëmendje kur e tregoi këtë anekdotën, bisedën e tij private me këtë kryeakademikun, dhe kur i thashë që përgjigjja që kishte qenë 'pse e keni bërë personin X akademik?', tha se ka fituar shumë vota, atëherë bëjeni edhe këtë tjetrin që ka fituar shumë vota. Pra, nuk i paskan penguar procedura, por i paska penguar se njëri qenka i LDK, tash ku po e do edhe një të PDK-së ta bëjë një kryetar komune, i cili ka po aq vota.

Pra, a po e shihni problemin që, në fakt, këtu është garë kush po merr më shumë, kush po e përdor më shumë pushtetin politik për të marrë më shumë pushtet edhe në botën akademike, jo për ta rregulluar atë, dhe këtu është njëri prej problemeve. Edhe çështja e dytë që e përmendi, kur iu referua brumit, se me atë u referohej përgjithësisht protestuesve, mbase edhe protestuesve individualisht, siç bëri edhe zotëri Lladrovci, dhe tha i njëjti brumë që na ka rënë neve studentëve kur protestonim, tash po kërkon ta shkatërrojë universitetin.

Këto çka bëri kryeministri, është që në fakt e shpërfaqti një të vërtetë tjetër - që kërkesat e studentëve, edhe atëherë, edhe sot janë të mira, mirëpo kryeministri nga brumi i protestuesit studentor që ka qenë, që po thotë se ka qenë, tash e ka ndryshuar pozitën. Tash është bërë ky brumi tjetër, që i rrah studentët, i rrah protestuesit dhe ua mohon atyre

kërkesat e veta. Mendoj që kjo fjalë e kryeministrit e kishte për qëllim vetëm ta zhvendosë vëmendjen nga ajo për çka po flasin ne këtu për universitetin.

Është e vërtetë që problemet në universitet janë të shtresuara. Është e vërtetë që kërkon një nismë shumë të qartë në kohë për ta rregulluar atë, mirëpo ne këtu po flasin qëllimisht për një problem akut që e kemi me rektorin e këtij universiteti dhe pastaj, natyrisht, që duhet të ndërmerren masat për pastrimin e universitetit në përgjithësi. Por, kjo pozitë e kryeministrit dhe e Qeverisë aktuale, që...

KRYESUESI: Nuk ka replikë për kryeministrin, se ai është i zoti, e bën replikën vetë. Mbledhjen e vazhdojmë në orën 15:30.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Kymete Bytyçi.

KYMETE BYTYÇI: I nderuar kryetar!

Ministër,

Kolegë deputetë,

Gjendja e cila mbretëron në Universitetin e Prishtinës është krijuar që nga viti 1999 e tutje për shkak të ndërhyrjeve politike partiake në zgjedhjen e menaxhmentit dhe më vonë edhe dirigjimit direkt të tyre nga njerëzit që sot janë në pushtet.

Ne jemi dëshmitar se njerëzit e politikës pa kurrfarë bagazhi shkencor kanë marrë titullin “doktor shkence” dhe të njëjtit sot janë profesorë universitar. Si rrjedhojë e kësaj, sot Universiteti i Prishtinës gjendet në gjendje alarmante, të cilën nuk e duron dot shoqëria jonë. Fakti se udhëheqja aktuale me çdo kusht tenton të mbeten në udhëheqje të universitetit dhe përkundër protestave dhe reagimeve të qytetarëve, tregon se kjo udhëheqësi nuk është e denjë për të udhëhequr me këtë universitet, sepse përveç të tjerave i mungon edhe ana humane dhe morale, e cila pjesë duhet të jetë pjesa kryesore e një shkencëtari të mirëfilltë. Duke qenë në këtë situatë konsideroj se udhëheqja aktuale duhet të dëgjojë zërin e shoqërisë dhe të protestave, të japë dorëheqje dhe t’i japë rrugë një hetimi të gjithanshëm të dhënies së titujve shkencorë dhe avancimit të personalitetit akademik në këtë universitet.

Po ashtu, është e turpshme dhe udhëheqja e universitetit tanimë ka filluar që me deklaratat e ulëta t’i sulmojë profesorët dhe familjarët e tyre, të cilët kanë mendime ndryshe nga udhëheqja aktuale e Universitetit të Prishtinës. Kjo është e tmerrshme për universitetin më të madh publik të vendit. Dorëheqja e rektorit është pika e parë, por është edhe e Këshillit Drejtues me vonesë nëse nuk i ndërmerr hapat për shkarkimin e rektorit duke u mbyllur në strofull sikurse nuk po ndodh asgjë, pra jashtë normave në Rektoratin. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Aleanca, radhën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit kryetar, se deri tash topi i pingpongut u hodh prej PDK-së, LDK-së dhe anasjelltas, e u anashkaluam pak.

Po bëhen më shumë se 14 vjet që nga përfundimi i luftës në Kosovë dhe Universiteti i Prishtinës ende vazhdon të vuajë nga një varg problemesh të ndryshme si rezultat i të cilave kualiteti i studimeve në Universitetin e Prishtinës vazhdon të mbetet i pakënaqshëm.

Problemet më të mëdha në Universitetin e Prishtinës janë mosimplementimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit, mungesa e punës praktike, mungesa e literaturës adekuate të studimeve, vlerësimi jo objektiv i mësimdhënësve dhe raportet jo të mira studentë dhe profesorë.

Universiteti duhet të ndjekë rrugën evropiane. Kjo rrugë nuk është e lehtë, është pritur të bëhet punë më e madhe e Qeverisë dhe e shtetit dhe të vazhdojnë përpjekjet për krijimin e kushteve, të vazhdojë reforma dhe në të të përfshihen të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë. Në këtë përfshirje është pritur më shumë reformim i Universitetit të Prishtinës në njërin nga institucionet më reprezentative të Republikës së Kosovës. Reformat, edhe pse janë pjesë e punës dhe angazhimeve të të gjithë pjesëmarrësve në Universitetin e Prishtinës, po zhvillohen ngadalë, bashkë me zhvillimin e brishtë të shumë segmenteve të tjera të shoqërisë e shtetit duke krijuar një gjendje tjetër jo të pritur të një imazhi tjetër.

Gjendja e krijuar në Universitetin e Prishtinës po i dëmton reformat, po e dëmton imazhin e një institucioni të lartë arsimor, siç është Universiteti i Prishtinës. Reforma në Universitetin e Prishtinës duhet të jetë çështje e universitetit e zbatimit të Ligjit të arsimit të lartë e normave universitare dhe zbatueshmërisë së tyre, duhet të jetë çështje e udhëheqjes në të gjitha nivelet në strukturën qeverisëse dhe menaxhuese e mësimdhënësve dhe të jetë çështje e studentëve.

Universiteti i Prishtinës është më i vjetri institucion publik i arsimit të lartë në Kosovë dhe dekada me radhë ishte në funksion të dijes kërkimore dhe shkencore, të zhvillimit të lëvizjeve studentore në faza të caktuara historike, në funksion të çlirimit, të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

Gjendja në Universitetin e Prishtinës sot nuk është krejt vetëm çështje rektori as nuk është krejt vetëm çështje Senati, por as nuk është krejt çështje keqpërdorimesh, abuzimesh, rritjesh të numrit të studentëve as edhe vetëm çështje botimesh në revista fiktive e të rreme. Por, janë të gjitha këto çështje bashkë, është gjendja që e shohim vetë, janë këto gjëra që ndodhin para syve tanë dhe edhe më shumë.

Është gjendja e krijuar nga shkaktarët brenda dhe jashtë Universitetit të Prishtinës. Shkaktarë i patjetërsueshme i gjendjes në Universitetin e Prishtinës është lidhja që ka universiteti me politikën, përkatësisht me para politikën e cila udhëheq dhe menaxhon me të.

Regjistrimi i studentëve pas afatit doli të jetë veprim korruptues dhe degradues i vazhdueshëm. Zbulimi i këtyre veprimeve ka reflektuar në imazhin e Universitetit të Prishtinës dhe ashtu të zbehur që do të duhej të reflektonte drejtpërdrejt në udhëheqjen duke filluar nga rektori. I vetmi kundërveprim që do të neutralizonte zbehjen e madhe të këtij imazhi do të ishte dorëheqja e rektorit dhe e gjithë stafit përgjegjës, qoftë edhe si akt moral.

Punësimi, angazhimi dhe avancimi i profesorëve mbeten disa çështje të pazgjidhura mirë brenda Universitetit të Prishtinës. Çështje të tilla jo vetëm të pazgjidhura mirë dhe ashtu siç janë, janë të degraduara nga shumë anë, si në administrim, në zgjedhje dhe siç del tani për mejdani edhe në rizgjedhje. Angazhimi i profesorëve në Universitetin e Prishtinës si bashkëpunëtorë të jashtëm në shumë raste është dëshirë e plotësuar ndaj dikujt, është nepotizëm.

Avancimi akademik, sa është çështje e ndjeshme akademike dhe universitare, është edhe përgjegjësi dhe ndërgjegje, është çështje shkence, vërtetësie, etike dhe profesionale dhe duke qenë kështu, duke qenë ngritje profesionale dhe akademike me dimensione të gjera kulture, shkencore dhe pedagogjike kërkohet të ketë qasje edhe administrimi ligjor të mirëfilltë.

Zhvillimet e fundit në Kosovë, përkatësisht ato në Universitetin e Prishtinës janë të përmasave shqetësuese për të tashmen dhe të ardhmen e vendit dhe të shoqërisë sonë. Siç dihet edhe nga e kaluara jo shumë e largët, Universiteti i Prishtinës ka qenë promotor i intelektualizmit, burim i dijes dhe simbol i rezistencës. Këtë vlerë nuk mund askush ta nëpërkëmbë, sepse kjo është një vlerë e përbashkët e jona e ndërtuar me shumë mund dhe sakrificë nga gjenerata të tëra. Keqpërdorimi, instrumentalizimi, politizimi dhe posaçërisht cenimi i pavarësisë së Universitetit të Prishtinës është e papranueshme dhe këto fenomene duhet të ndalohen sa më parë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Për ta rrënuar të ardhmen e një shoqërie së pari duhet të shkatërruar arsimi dhe shëndetësia, kjo ka ndodhur tek ne prandaj edhe kjo është arsyeja pse po diskutojmë sot.

Instalimi i trafikimit të dijes nëpërmjet partizimit të shkollës shqipe në përgjithësi e në veçanti me Universitetin e Prishtinës, shkallën alarmante e ka arritur me këtë Qeveri e cila mban meritën kryesore për këtë gjendje.

Në një shkallë kaq të lartë të partizimit të UP-së është tepër vështirë të gjendet filli për të nisur normalizimin e jetës që do të nënkuptonte kultivimin e dijes në këtë institucion. Ai tashmë është kapur kështu nga struktura injorantësh dhe mediokratësh që thirrjet akademike i kanë marrë duke u mbështetur ekskluzivisht në thirrjet si persona të dal nga lufta apo nga politika apo njëherësh nga të dyja.

Për fillimin e normalizimit dhe për nisjen e luftës kundër shembujve të këqij të dijes së pari duhet krijuar vullnetin politik tek njerëzit që udhëheqin me institucionet që kanë përgjegjësi për këtë çështje. Ky vullnet politik mjerisht mungon. Qeveria e Kosovës, institucionet që ajo drejton duke përfshirë këtu edhe universitetin dhe gjithë sistemin arsimor janë zhytur vetë në korrupsion, mashtrime dhe falsifikime.

Ne i kemi sirtarët plot me strategji të ndryshme edhe kundër korrupsionit dhe në të njëjtën kohë korrupsioni dhe mashtrimi vlon pikërisht në këto institucione. Në vendin ku gjykatat dhe Ministria e Punëve të Brendshme lëshon vetë dokumente të falsifikuara, aty ku ari, provat, paratë dhe drogat vidhen në stacionin e policisë, aty ku Ministria e Brendshme vlon nga skandalet e njëpasnjëshme dhe falsifikimet, nuk mund të presim që në universitet të kemi standarde të tjera nga ato që i ka Qeveria.

Ne e kemi universitetin ashtu siç e kemi Qeverinë. Ngjarjet e ditëve të fundit, lajmet për publikime të punimeve shkencore në revista komerciale që qëllim të vetëm e kanë përfitimin dhe jo publikimin e njohurive shkencore dhe gradimin akademik në Universitetin “Hasan Prishtina” në bazë të këtyre publikimeve, pra janë bërë gradime, flet për një gjendje shumë alarmante në të cilën ndodhet jo vetëm universiteti, por i gjithë arsimi.

Ngjarjet e fundit janë vetëm maja e akullnajës. Mendoj që nuk ka asnjë rëndësi nëse “akademiku” filan fisteku ka ndonjë afërsi me lëvizjen “Vetëvendosje”, apo Lidhjen Demokratike të Kosovës, nuk ka gjithashtu asnjë rëndësi nëse studentë të caktuar mund ta ndjejnë veten më afër njëres apo tjetres parti, nëse janë anëtarë në këtë apo atë formacion politik, nëse janë të majtë apo nëse janë të djathtë.

Politika është për mua niveli më i lartë i reflektimit për jetën, kush nuk merret me politikë nuk merret me jetën. Do të ishte krejt pakuptim nëse studentët e Kosovës do të bënin përjashtim nga studentët e vendeve tjera të botës dhe nuk do të merreshin me jetën e sidomos me atë pjesë të jetës që ka të bëjë me të tashmen dhe të ardhmen e tyre.

Sidoqoftë, “studentët e Vetëvendosjes”, siç i quajti udhëheqja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, arritën fitoren e parë duke mobilizuar ligjërues, profesorë, publicistë dhe shumë qytetarë që t’i bashkëngjiten të bërit politikë për gjendjen në arsim. Madje ata nxitën edhe vetë Lidhjen Demokratike të Kosovës të iniciojë këtë debat parlamentar, pra çështja që shtrojnë studentët është shumë relevante. Marrja me problemet e arsimit nuk është e drejtë e rezervuar për Parlamentin, por edhe për asnjë formacion politik duke përfshirë këtu edhe Lëvizjen “Vetëvendosje”, duke mos përjashtuar këtu as Lidhjen Demokratike të Kosovës, e as partitë tjera dhe qytetarët.

Nuk kam asnjë dyshim që sukcesi i dytë do të jetë dorëheqja apo shkarkimi i rektorit Gashi. Kjo dorëheqje nuk e ndryshon gjendjen në arsim, nuk krijon bazamentin për ndryshim, por është më tepër një simbol i shkëputjes nga falsifikimi, blerja e titujve akademikë dhe një fillim i ri ku dija, por jo dëshmia e rrejshme për dijen është vlerë. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri, replikë në diskutimin e Faton Topallit.

ISMET BEQIRI: Zoti Topalli, unë të kisha këshilluar të mos e devijosh atë çka e ka thënë në fjalën e saj, në emër të LDK-së, zonja Kajtazi. Ne nuk kemi thënë askund që janë studentë të “Vetëvendosjes” dhe mos spekulohet.

Domethënë është mirë të jesh korrekt edhe ta përcjellësh si e kemi thënë ne. Ne nuk duam t’i ndajnë studentët as të “Vetëvendosjes”, as të LDK-së, as të partive tjera, nuk e keni as ju këtë të drejtë. Po ashtu, nuk qëndron ajo që ju ose studentët “tuaj” tash e paskeni nxitur LDK-n ta kërkojë debatin. Mos flisni gjëra të pavërteta, sepse në këtë debat, më 24 janar e kemi kërkuar dhe shiko datat kur kanë filluar protestat. Prandaj, nuk është mirë për ta shfrytëzuar tash rastin e vërtetë për ta devaluuar gjithë këtë debat edhe gjithë këtë shqetësim që e kemi edhe ne, ta zbehni këtë shqetësim nëse mund ta zbehni ju apo dikush tjetër shqetësimin tonë si deputetë, por edhe të studentëve edhe të gjithë atyre që janë të pakënaqur me gjendjen në Universitetin e Prishtinës.

Prandaj, mos i devijoni ato që po i thoni duke iu referuar Lidhjes Demokratike të Kosovës, sepse asnjëra nuk qëndron.

KRYETARI: Kundër-replikë, Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Është dëgjuar disa herë nëpër media ku studentët të cilët kanë dalë në protestë të jenë akuzuar, se sipas tyre qëndron Lëvizja “Vetëvendosje”.

Këto që thashë për Lidhjen Demokratike të Kosovës që më shumë një lavdërim, i cili i merr parasysh kërkesat e studentëve edhe i bën debat. Gjithashtu, një sukses i cili e mobilizoi gjithë shoqërinë këtu në Kosovë që të debatojmë për temën e arsimit.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Poštovani predsjedniče,
Kolege poslanici,
Poštovani građani,

U potpunosti podržavam inicijativu poslanika, koji su podneli zahtev o skupštinskoj raspravi, o dešavanjima na Prištinskom Univerzitetu, problematiku koji sam ja iznela u ovom parlamentu pre dve godine a tiče se zloupotrebe službenog položaja određenih profesora na edukativnom fakultetu u Prizrenu, u nastavi na bosanskom jeziku, nije shvaćena ozbiljno od strane nadležnih pravosudnih organa ni obrazovnih institucija.

Protiv pojedinih profesora, koji nisu kvalifikovani za predmete, koji predaju studentima, već tri generacije, podignute su i krivične prijave, ali sve se to nekako zataškalo. Imamo slučaj profesora doktora Šefika Bajmaka.

Jedna od čelnih osoba na edukativnom fakultetu na bosanskom jeziku je i dalje gospodin Sadik Idrizi, bivši ministar zdravlja, koji zauzima visoko mesto na listi za korupciju,

ocenjenu od strane agencije za antikorupciju, gospodina Hasana Pretenija. Naši građani su svedoci, jer smo tu listu videli na nacionalnoj televiziji RTK.

Skrećem pažnju rektoru univerziteta, da formira komisiju koja će preispitati stanje edukativnog fakulteta i fakulteta biznisa u Peći na bosanskom jeziku. Da kontroliše diplome profesora koji drže nastavu našim studentima na bosanskom jeziku. Da preispita zašto su sa tog fakulteta izbačeni profesori i doktori poput Mehmeta Mete i profesori, koji su nam dolazili iz regiona, iz Sandžaka, Bosne Hercegovine i Makedonije, do pomognu bošnjačkoj zajednici sa moralnog aspekta u interesu očuvanja bosanskog jezika i nastave.

Zbog čega određeni profesori poput Sadika Idrizija i Shefika Bajmaka već celu deceniju drže samo dva smera na edukativnom fakultetu u Prizrenu, a to su osnovni program i predškolsko vaspitanje.

Gospodo, mi smo mala zajednica, koja za deset godina stvorila produkciju učitelja i nastavnika i za nekoliko godina imaćemo više učitelja nego što ćemo imati studenata. Zašto se progami ne rotiraju u zavisnosti od potreba zajednice? Zašto 14 godina posle rata nemamo program istorije, geografije, ekonomije, prava i drugih smerova? Dali ćemo čuvati ta dva smera, koja sada imamo, samo da bi se pojedini profesori zadovoljili i to koristili za svoje lične interese?

Drugo o čemu sam želela da govorim jesu rezervisana mesta za studente manjinskih zajednica pri universitetu u Prištini. Velika je zloupotreba a sumnjamo da ima i mita i korupcije, konkretno samo za prošlu godinu bilo je upisano 105 primljenih studenata. Zahtevam da se proverí dokumentacija svih upisanih studenata, da se provere potvrde određenih političkih subjekata manjinskih zajednica o nacionalnom identitetu studenata kao dokaz koji je priložen u dodatnu dokumentaciju.

Akcent stavljam na medicinske smerove, na opštu medicinu, farmaciju, stomatologiju, ali posebno na arhitekturu, ekonomiju, prava političke nauke i ostale smerove.

Poštovani kolege poslanici, ne smemo dozvoliti da se visoko školsko obrazovanje politizuje, jer ćemo tako stvoriti loš ugled u društvu, ne samo u našoj državi nego i u regionu, a samim tim ćemo našim studentima uskratiti demokratsko pravo na edukaciju, što smatram na to da nemamo absolutno pravo. Zahvaljujem!

KRYETARI: Fjalën e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Zoti ministër,

Të nderuar zonja deputete,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Arsimi, mësimdhënia, studimet dhe hulumtimet në Kosovë ndodhen në krizë të thellë profesionale, etike dhe morale. Sot më duhet të kufizohem dhe të flas vetëm për Universitetin e Prishtinës, i cili siç po vërehet edhe nga skandalet e njëpasnjëshme ditëve

të fundit e zaptuar nga manipulues të fshehur nën petkun pseudo-akademik dhe të cilët e kanë katandisur këtë institucion aq të rëndësishëm të vendit si mos keq.

Për më shumë se 40 vjet traditë, Universiteti i Prishtinës ka kaluar në disa faza. Në vitet e para të themelimit, Universiteti i Prishtinës është konsideruar si një institucion që kishte për qëllim ofrimin e mundësisë për arsim të lartë të shqiptarëve të Kosovës edhe pse kishte mungesë kuadros. Universiteti i Prishtinës vazhdoi të zhvillohet në një institucion që kishte për mision emancipimin jo vetëm arsimor, por politik e shoqëror të shoqërisë së Kosovës.

Kështu gjatë viteve të '90-ta Universiteti i Prishtinës u shndërrua në një institucion të rezistencës dhe kjo fazë e lidhi e fatin e UP-së me fatin e Kosovës. Faza pas vitit 1999 e ka gjetur Universitetin e Prishtinës pa një mision të qartë. Edhe pse shumë prej nesh kemi pritur dhe shpresuar se Universiteti i Prishtinës në këtë fazë të rëndësishme të shtet ndërtimit të Kosovës të shndërrohet në pararojë të dijes, shkencës dhe të emancipimit shoqëror, politik e kulturor të vendit.

Fatkeqësisht, UP-ja sot gjendet në krizë të thellë morale dhe profesionale. Universiteti i Prishtinës është në krizë morale, sepse drejtuesit dhe një pjesë e stafit akademik të këtij institucioni në vend se të përgatisin profesionalisht dhe moralisht gjeneratat e ardhshme të cilat do të udhëheqin me politikën, ekonominë, sistemin gjyqësor dhe shoqërinë civile të vendit, fokusohen në keqpërdorimin e pozitës së tyre për të përfituar personalisht.

Në Universitetin e Prishtinës sot gradimi bëhet në shumicën e rasteve në mënyrë të jashtëligjshme, legjitimohet mashtrimi dhe vjedhja akademike, publikohen rrejtshëm dhe ndahen grada pa asnjë kriter. Rastet e fundit për të cilat kanë njoftuar mediet vazhdimisht, duke publikuar në revistat e rrejtshme për t'u ngritur në pozitën e profesorit të rregullt në UP është shembull shumë përshkrues për mashtrimet akademike që ndodhin në Universitetin e Prishtinës.

Edhe pse natyrisht duhet të potencohen se këto raste janë vetëm maja e Ajsbergut. Universiteti i Prishtinës është po ashtu në një krizë profesionale për shkak se është shndërruar në një institucion mësimdhënës siç janë shkollat dhe ka neglizhuar dimensionin e rëndësishëm hulumtues e shkencor. Misioni i UP-së, universitetit më të madh dhe më të rëndësishëm në Kosovë, sipas statutit përfshin: avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës. Dhe, ndër të tjera synon të krijojë standardet më të larta në fushën e kërkimeve shkencore, mirëpo, Universiteti i Prishtinës është bërë njëllloj stacioni treni pa tren, pra vendi i shkencës ku nuk zhvillohet shkenca.

Natyrisht se prej një universiteti ku avancohen në gradën e profesorit të rregullt me punime skandaloze në revistat të rreme, avancimi i dijes, ideve kreative dhe shkencës nuk mund të ndodhë.

Në Kosovën e kapur nga grupet joformale arsimimi, studimi e shkenca të cilat përbëjnë parakushte për zhvillim të përgjithshëm shoqëror, fatkeqësisht nuk po trajtohen si prioritet kombëtare. Politika dhe njerëzit e partive në pushtet ia kanë zënë vendin

dijetarëve e punëtorëve të shkencës në administrimin dhe zhvillimin akademik të UP-së. Kështu tani aty s'ka mbetur më vend për shkencën si profesion, por vetëm për klientë të partive në pushtet, të cilët sillen si sharlatanë e pseudoshkencëtarë dhe e dëmtojnë imazhin e dijes kosovare anekënd botës.

E për më keq ata pa shkencëtarë dhe mësimdhënës në UP, të cilët ngritin zërin për manipulimet që vazhdimisht ndodhin në UP, për nivelin e ultë të studimeve, hulumtime, kërcënohen me ndëshkime nga drejtuesit e këtij institucioni. Kërcënimet e tilla së fundi bëri edhe Rektorati politik.

Përkundër skandaleve të njëpasnjëshme ka pak politikanë në Kosovë që kanë dhënë dorëheqje nga pozita e tyre. Në këtë logjikë po shërbehet edhe menaxhmenti aktual i UP-së i cili është katandisur në një kopje të keqe të një shtese të klasës politike aktuale. Për më shumë duke pasur parasysh këtë gjendje në të cilën është sjell UP-ja unë propozoj për krijimin e një Këshilli kombëtar për verifikimin dhe ndarjen e thirrjeve akademike si organ i përhershëm i cili do të verifikojë së pari vërtetësinë e të gjitha diplomave dhe thirrjeve akademike të stafit akademik të UP-së dhe rezultatet e këtij verifikimi të jenë publike dhe transparente.

Të iniciohen propozimet për modifikimin e paketës ligjore që ka të bëjë me arsimin në përgjithësi e posaçërisht me atë të arsimit të lartë si dhe me statutin dhe aktet tjera normative të Universitetit të Prishtinës duke garantuar autonomi për njësitë e UP-së, rritje e transparencës në përgjithësi e posaçërisht garantimin e transparencës së zgjedhjes dhe punës shkencore mësimore të stafit akademik, demokratizimin e të gjitha strukturave të UP-së, parandalimin e ushtrimit të ndikimit nga politikat ditore.

Që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Universiteti i Prishtinës, të ndërmarrin hapa konkret në mbrojtjen e standardeve të publikimeve shkencore dhe sigurimin e transparencës së punës së secilit anëtar të komunitetit akademik.

Të përmirësohet infrastruktura ligjore dhe administrative për nostrifikimin e diplomave të fituara brenda dhe jashtë vendit në mënyrë që të mos vazhdohet të njihen diplomat e dyshimta dhe të lëshuara pa asnjë kriter.

Të nderuar deputetë,

Kolege deputete,

Ne kërkojmë me ngulm një konsensus të gjerë politik që të lejohet arsimi në Kosovë në përgjithësi dhe arsimi i lartë në veçanti, të zhvillohet ashtu siç duhet i pandikuar nga politikat ditore dhe nga interesat personale të disa politikanëve, të cilët për shkak të ambicieve të tyre të paepura për klientelizëm, pushtet dhe legjitimitet të rremë intelektual.

Për fund më lejoni të theksoj se pasaporta e Republikës së Kosovës për Evropë nuk është as thëngjilli, as Qeveria aktuale e saj, pasaporta e Kosovës duhet të jetë Universiteti i Prishtinës si një institucion kredibil, profesional që e ndërton dhe i kontribuon ndërtimit të demokracisë dhe mirëqenies në Kosovë. Faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Fjalën e ka Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Diku para nja 2 mijë vjetësh thuhet, ngjarja diku zhvillohet në territoret e sotshme të Palestinës, një marangoz, një zdrukthëtar po shëtiste dhe po lëvizte dika edhe e sheh një turmë të egërsuar me plot xhepat me gurë që dëshirojnë ta mbysin një femër, të cilën e kishin zënë në tradhti bashkëshortore.

Ajo quhej Maria Magdalena dhe ai marangozi, të cilin për hatër të Partisë së Drejtësisë po e quaj hasreti Isa, i pyet ata - thotë: “për çka po e dënoni këtë femër”, thotë “ e kemi zënë në krim bashkëshortor dhe kjo duhet të dënohet”, thotë “cili është mendimi yt?” Ai e merr një shtagë edhe nënvizon diçka shkruan në tokë edhe thotë: le të fillojnë le ta gjuajnë të parët ata që asnjëherë në jetë nuk e kanë bërë këtë krim personalisht. Unë jam i bindur që këtë krim, sepse tash është e ditur botërisht se rektori mashtrues është zënë në flagrancë, ai e ka bërë tradhtinë e ka bërë krimin, pra ai është zënë me një vepër për të cilën do të duhej po mendoj nëse do të kishte pak moral të largohej atë ditë kur është bërë publike.

Por një betejë shkencore që nisi para disa ditëve në Universitetin e Prishtinës, prej një grupi të studentëve dhe të profesorëve, pra për ta mposhtur paditurinë në këtë institucion për fatin tonë të keq dhe për fatin e keq të studentëve, gradualisht rrëshqiti në një betejë të pastër politike.

Fitues padyshim në tërë këtë rrëmujë është veç Ibrahim Gashi, një person, për mendimin tim, pa ndonjë vlerë intelektuale, kurrë në jetë nuk do ta kishte menduar që kundër tij të ngritët i gjithë spektri opozitar politik me në krye pronarin e tavernës së rakisë “Dardha”, zotin Veton Surroi.

Sipas të gjitha parametrave, rektori Gashi është fitues, qoftë edhe nëse tash vendos të japë dorëheqje për gjë unë dyshoj, ta them për ta zhbllokuar situatën. Pra, po vijmë në një ditë që tash ai prej një mashtruesi ordiner politik të marrë rolin e një personi që ngritët mbi situata duke e zhbllokuar krizën.

Unë nuk besoj që emërimi politik i Gashit është krimi më i madh në këtë situatë, krimi më i madh është se ai është i padijshëm e si i paditur që është duke u zënë në vështirësi shkencore, normalisht që në mendje kishte vetëm një rrugëzgjidhje, të mashtronte dhe të falsifikonte.

U rrek që për qëllime të thjeshta përfitimi brenda natës të kalonte prej një historiani, padyshim të dobët, në një xehetar komik. Dhe kur disa profesorë të guximshëm e të ndershëm e profesionistë vendosën që ta ngritin zërin për krimin e rektorit dhe plot të tjerëve, atëherë u futën në lojë fundamentalistët e Lëvizjes “Vetëvendosje” me skenarin që e kishin përgatitur tashmë në tavernën e rakisë “Dardha” me pronarin e këtij shërbimi hotelier, zotin Veton Surroi.

Betejën për botimet false të rektorit mashtrues e shndërruan në një betejë në mes të tyre dhe të Qeverisë dhe për ta ngritur në nivel edhe më të lartë hipokrizinë e sollën nga deti të pensionuarin e popullit zotin Veton Surroi, që aktualisht ishte i angazhuar me veprimtari hoteliere që t'i prijë marshutës bashkë me të gjithë familjen e tij.

Nuk kishte si të ndodhte më mirë se kaq për rektorin Gashi. Tash atij i mbetet vetëm të hap rrugë dhe ta përcjellë debatin e protestat prej pozitës së viktimës, sepse një mashtrues këtë punë e ka. Ka kohë që këtu në Kuvendin e Kosovës, unë personalisht e kam ngritur çështjen e edukimit. Këtu, diplomat, të nderuar kolegë deputetë, këtu kryhen shkollat për të dalë në facebook, pra qëllimi aktual i diplomimit në Universitetin e Prishtinës nuk është dija, por është postimi i fotove në facebook. Pra, qëllim është facebook-i, diploma pasojë, ajo vjen si rrjedhojë e një korrupsioni ose çka di unë.

U arrestuan disa studentë, nuk është arrestuar asnjë profesorë, nëse ata i paskan blerë notat, kush i ka qitur ato nota, a i kanë qitur studentët a i kanë qitur profesorët?

Faik Konica kur kthehet 1920, vjen në Shqipëri dhe viziton pak universitetin, po mendoj shkollën ai e quan “Akademia e Matit” që prodhon kuadro sikur bukë furre, e këtu unë mendoj që kjo është “Akademia e Llapushnikut” me gjithë respektin për atë fshat i cili ka dhënë jashtëzakonisht shumë, mirëpo unë nuk mendoj që rektori është përfaqësuesi më i denjë i atij fshati.

Kjo me rektorin sipas meje është thjeshtë njëra hallkë, sepse nuk do të kishte rektor që do t'i rezistonte presionit nëse ta zëmë ministri i Arsimit do të ishte i pari që do të kërkonte prej tij që të hapte rrugën. I kemi 100 raste nëpër botë sot ku njerëz ministra dhënë dorëheqje për shkak të plagjiaturave, ministri gjerman i Mbrojtjes, presidenti hungarez dhe një numër i madh i pafund i njerëzve që largohen për shkak të plagjiaturës. Nuk e kam ndërmend për ta mbrojtur unë këtë krim, por kjo gjë nuk ka se si të ndodhë, sepse sipas mendimit tim është ministri Ramë Buja ai që i pari do të duhej ta lëshonte pozitën që mban për një jo kompetencë flagrante.

Pra, problemi i arsimit për t'u zgjidhur duhet të fillojë jo prej UP-së, por prej çerdheve e shkollave fillore e atyre të mesme. Në vend të kësaj, shkollat e mesme e ato fillore tash janë shndërruar në arena të dhunës dhe vrasjeve, kurse ministri flet për profesorata, kampusa e terma të tjerë pa kurrfarë efekti në diturinë e nxënësve.

Dhe, kjo shkon në mënyrë vertikale deri te Akademia e Shkencave të Kosovës, që siç dihet tash është shndërruar pothuajse de facto në një filial të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në këtë Akademi gati-gati nuk mund të bëhesh nëse nuk ke qenë anëtar i devotshëm i Partisë Komuniste të Jugosllavisë e më vonë edhe anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Nuk është veç Rektorati që po vuan prej krizës morale sa i përket falsifikimeve dhe mashtrimeve, dyshime të tilla janë ngritur edhe për anëtarë të Akademisë së Shkencave. Unë nuk mendoj që ne sot me një seancë njëditore do të mund ta zgjidhim një ‘kurshllus’ që po zgjat tash e 25 vjet dhe tash sot ne t'ia vëmë pikën.

Unë e përshëndes absolutisht idenë që këtu ka nevojë të debatohet edhe më shumë edhe të merremi vesh se si të fillojmë për së mbari punën në Universitetin e Prishtinës, pajtohem me kolegun Zemaj, sepse nuk janë minierat, ka vende që nuk kanë resurse natyrore, ka vende si Tajvani që nuk prodhojnë pothuajse asgjë, përveç kuadro njerëzor. Pra, ne nëse nuk e përmirësojmë këtë nivel tonin, atëherë kohë të gjatë do të diskutojmë se kush më shumë e kush më pak po bën plagjiaturë në Universitetin e Prishtinës dhe në të gjitha institucionet e dijes. Faleminderit!

KRYETARI: Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Është e qartë nga ato që po i dëgjojmë nga disa deputetë këtu që në fakt s'qenka problemi te universiteti e as te rektori, po qenka problemi te një iniciativë e disa subjekteve politike për ta nisur fushatën në universitet, ose që po na e bëka UDB-a. Pra, këto i dëgjova këtu nga deputetët e koalicionit qeverisës, përfshirë kryeministrin e fatkeqësisht edhe nga deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Pra, nuk qenka problem këtu që e kemi një rektor që qartazi ka falsifikuar, që ka vjedhur punime të të tjerëve dhe i ka botuar në emër të vetin, vetëm sa për t'u graduar, nuk qenka problem edhe ai korpus i stafit akademik të Universitetit të Prishtinës, profesorë të ndryshëm të cilët po ashtu u zbuluan se kanë bërë të njëjtën gjë e të cilët po arsyetohen se nuk e paskan ditur se kjo nuk bën, pra nuk e paskan ditur se kjo nuk qenka në rregull, nuk e paskan ditur që nuk bën t'ia marrësh dikujt tjetër punimin dhe për t'ia qitur emrin tënd dhe ta botosh në një revistë që na doli tash fantome.

Por s' qenka problem kush janë ata studentë që po dalin në protestë edhe qenka problem kush po do të fitojë politikisht prej kësaj shtate, pra këtë po e thonë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryeministri i Kosovës, deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e kështu me radhë.

Problemi është jashtëzakonisht i qartë në Universitetin e Prishtinës, por kjo nuk nënkupton që zgjidhja për të është shumë e lehtë dhe e shpejtë. Pra, natyrisht që problemet në Universitetin e Prishtinës, këtu besoj jemi dakord të gjithë, janë shtresuar për një kohë të gjatë. Po mendoj që Qeveria me këtë distancimin e saj kaq perfid për të thënë, që "vëlla këto janë probleme që i kemi trashëguar dhe rrjedhimisht nuk kemi çka të bëjmë me to", është një mënyrë për t'i ikur përgjegjësisë, sepse nuk mund të themi që politikën qeveritare nuk kanë pasur përgjegjësinë për atë se kah po shkon universiteti.

Ta zëmë që nuk ka ndërhyrë fare në format çfarë kanë ndërhyrë këta në universitet, ta zëmë që nuk i kanë futur deputetët të njohshmit dhe anëtarët e partisë së vet me magistratura e doktoratura fallc nëpër universitet, edhe po të kishte qenë kjo e vërtetë, atëherë vetë mënyra se si këta e udhëheqin politikën mbi arsimin në përgjithësi, natyrisht që reflektohet pastaj edhe në arsimin e lartë dhe natyrisht, që reflektohet edhe në gjendjen të cilën e kemi në universitet.

Pra, duke u nisur nga buxheti që këta e ndajnë për arsimin, duke u nisur nga mënyra se si i shpenzojnë ato para, duke u nisur nga politikat që këta i bëjnë dhe duke u nisur nga fakti që Këshillin Drejtues e kanë gjysmën të vetin, kjo nënkupton që këta kanë gisht shumë në universitet. Dhe, tash, ta kemi këtu ministrin e Arsimit, i cili e dëgjon debatin, pra mbase edhe duhet ta lavdërojmë që po rri këtu ta dëgjoj se të tjerët as s'po vijnë ta dëgjojnë, po i cili nuk flet gjatë tërë debatit, sikur të kishte qenë ministër i Infrastrukturës, kur po flasim ne për universitetin, kjo është e pakuptimtë, sepse ministri nuk është që s'ka përgjegjësi, ministri nuk është se s'ka kompetenca dhe pushtet për ta bërë një intervenim tash në këtë mënyrë se si po udhëhiqet ky universitet dhe çfarë po ndodh në të.

Po, t'i kthehemi çështjes, problemi është se si duam ta zgjidhim këtë problem që e kemi në universitet, çfarë duhet të bëjmë ne si Kuvend, këtu diskutojmë dhe do t'i votojmë, do t'i miratojmë me gjasë disa rekomandime.

Por, a janë këto rekomandime të nevojshme dhe të mjaftueshme? Unë mendoj se rekomandimet janë të nevojshme, nuk janë të mjaftueshme. Duhet ta kemi të qartë se nuk janë të mjaftueshme, mirëpo si nismë është e domosdoshme, sepse nuk bën të bëhet asgjë në këtë Universitet të Prishtinës duke pasur Ibrahim Gashin rektor. Kjo është pika e parë.

Njeriu i cili është zënë se ka falsifikuar dhe i cili është ose do të jetë në krye të cilitdo komision që formohet për verifikimin e atyre që kanë ndodhur në universitet, nuk mund që ta garantojë një punë profesionale të atij komisioni kur të themelohet edhe kushdo që e themelon.

Prandaj, kjo është pika 1 e domosdoshme që duhet bërë, e pastaj janë edhe masat tjetra emergjente, afatshkurta t'i quaj ashtu, që do të duhej të aplikoheshin në universitet, në mënyrë që të zgjidhet problemi në universitet. Mirëpo, me masa afatshkurta, të jemi të gjithë të sinqertë, nuk do të mund të bëjmë asgjë, sepse gjendja në universitet kërkon përkushtim afatgjatë të të gjitha institucioneve të Kosovës, për ta bërë universitetin atë që ai duhet të jetë, pra universitet i dijes, universitet i shkencës dhe çka është më me rëndësi universitet i prodhimit.

Ne këtu, prandaj po e shtroj këtë si çështje, duhet ta diskutojmë më gjerësisht se çfarë duam ne nga sistemi arsimor, çka presim ne nga sistemi arsimor. Qeveria na ka treguar se çfarë pret. Qeveria e do sistemin arsimor, veçanërisht universitetin, ku e mbush me studentë të cilët tenton t'i bëjë të dëgjueshëm, ku i ka diku mbi 20 milionë euro buxhet që ia ndan universitetit dhe pastaj i merr përmes njerëzve të vet aty dhe ku përgjithësisht e përdor për fushatat e veta politike në Kosovë.

Por çfarë po do shoqëria prej universitetit, kjo është çështje që duhet të diskutohet. Dhe, ne nuk mund të kemi sistem cilësor dhe funksional arsimor po qe se këtë sistem njëherë e përgjithmonë nuk e konstruktojmë në atë mënyrë që ai ta ndihmojë, ta inkurajojë dhe ta pajisë me kuadro edhe sistemin ekonomik, sistemin e prodhimit që duhet të ndërtohet në Kosovë.

Pra, lidhja e dijes, e sistemit arsimor me planin afatgjatë ekonomik të vendit është e domosdoshme dhe kjo nënkupton pastaj që do të duhej të kishim edhe fakultete apo shkolla të larta apo quani si të doni, të shkencave aplikative. Pra, të mos përfundojmë vetëm në një universitet, i cili prodhon iluzion, kinse po i shkollojmë të rinjtë tanë kur e dimë që në fakt aty njeriu shumë më shumë ka gjasa ta humbë dijen që e ka, për shkak të ndërhyrjeve të profesorëve diskutabil, se sa që mund të fitojë dije të re.

Natyrisht, unë nuk kisha dashur të keqkuptohem, nuk po them që studentët e Universitetit të Prishtinës janë të dobët dhe të këqij, ka shumë studentë të mirë në Universitetin e Prishtinës, as nuk po them që të gjithë profesorët e Universitetit të Prishtinës janë të pavlefshëm, ka shumë profesorë në Universitetin e Prishtinës që e meritojnë të jenë aty, madje-madje meritojnë shumë hapësirë në sferën akademike.

Mirëpo, ja që në Universitetin e Prishtinës, sikur në institucionet tjera publike, një grusht i vogël njerëzish me pushtetin absolut që e kanë përmbi të dhe me lidhjet e forta që i kanë me politikën e veçanërisht në Qeveri, po e manipulojnë universitetin dhe po e kthejnë atë kah interesat e tyre. Dhe, kjo duhet ndaluar dhe kjo duhet ndaluar me secilën masë të mundshme demokratike.

Pra, kjo duhet ndaluar nga Kuvendi, po domosdoshmërisht kjo duhet të jetë brenga kryesore e protestuesve, studentëve që po protestojnë sot, sepse ata po e bëjnë këtë për ta bërë një universitet më të mirë për vendin. Pra, edhe njëherë po i bëj thirrje këtu, Qeverisë, ministrit të Brendshëm po edhe kryeministrit, që mos ta dërgojnë policinë në kampusin e universitetit, t'i lënë studentët ta kryejnë obligimin e vet si studentë dhe ta ngrenë zërin kundër çfarëdo shkeljeje të të drejtave dhe interesave të tyre që u bëhet, sepse universiteti mund të jetë universitet tamam vetëm nëse është i studentëve dhe i askujt tjetër. Këtë po e kërkojnë këta studentë që po protestojnë sot dhe këtë duhet Qeveria e Kosovës, shoqëria e Kosovës në përgjithësi, t'ua mundësojë.

Pra, nëse duam universitet të mirëfilltë atë duhet ta bëjmë universitet me interes të studentëve për t'i pajisur këta studentë me diploma që vlejnë diçka. Aktualisht në Universitetin e Prishtinës, në universitetet tjera që po i hapim gjithandej nëpër komunat e Kosovës ne vetëm po krijojmë diploma padije. Pra, ky pushtet po e përdor pushtetin jo për të krijuar dije, por po e përdor pushtetin për të vlerësuar se çka konsiderohet dije dhe çka jo. Dhe, kjo është e papranueshme, sepse pushteti politik, pushteti institucional që e kemi këtu në Kosovë, nuk ka të drejtë që ta marrë mandatin, siç po duan të na marrin që ta vlerësojnë se çka konsiderohet dije në Kosovë dhe çfarë nuk konsiderohet dije.

Prandaj është e domosdoshme që këto rekomandime, të cilat në njëfarë mënyre janë paraqitur nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, po pastaj janë bashkërenduar, të them ashtu edhe me Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” janë të domosdoshme të miratohen, në mënyrë që të paktën ta hapim rrugën për ndërhyrje të masat emergjente që do të duhej ta nxirrnin universitetin nga kjo situatë dhe pastaj të mendojmë mirë e mirë se çfarë duam ne vërtet të ndërtojmë në Kosovë në aspektin e jetës akademike dhe çfarë Universiteti Publik të Prishtinës, po edhe të komunave tjera ku janë hapur, duam t'i kemi dhe për çfarë arsye. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Se në çfarë gjendje është sot Universiteti i Prishtinës më së miri do ta pasqyroja nëpërmjet përshkrimit dhe interpretimit të dy momenteve të paraqitura kohëve të fundit gjatë funksionimit të tij.

Momenti apo pamja e parë ka të bëjë me pamjet filmike të shfaqura ditë më parë në televizionin jo vetëm të Kosovës, por thuaja në tërë botën, në të cilat shihen me qindra policë kosovarë, të pajisur me helmeta, mburoja, jelekë mbrojtës, siç pajisen policët për gjendje lufte, që ishin vendosur rreth e rreth mureve të Rektoratit, për të siguruar objektin dhe hyrjen e veturës së zezë zyrtare të rektorit të Universitetit të Prishtinës.

Pamje këto shqetësuese që për shumëçka u ngjanin ngjarjeve dhe zhvillimeve të viteve të '90-ta, kur ne mësimdhënësit së bashku me studentët e dëbuar padrejtësisht nga objektet e Universitetit, kërkonim dhe tentonim të ktheheshim brenda tyre, kurse policia serbe e armatosur deri në dhëmbë na zmbrapste duke përdorur dhunën në mënyrën më barbare.

Momenti i dytë ka të bëjë me numrin e madh të mesazheve telefonike me përmbajtje dhe karakter korruptues, të shkëmbyera nga dy pseudo kuadro të reja, pra nga asistentë të Universitetit të Prishtinës, të publikuara në "Kohën Ditore" më 20.12.2013, në artikullin me titull "regjistrime me listë të jashtëligjshme", ku ndër të tjera hasen edhe SMS me përmbajtje të këfillë, citoj: "... Lema mua Filozofikun, po çka po bën për Mjekësi", mbylli citatin, ku siç kuptohet fjala është për regjistrime të paligjshme në këto dy njësi të universitetit. Pastaj, SMS-i tjetër, citoj: "Unë fola me atë dostin për atë regjistrim, ai burrë - tha, kerrin "Golf" jam duke e shitur. Tha 4 600 euro, më shumë s'po m'i bën, e tha tjetër nuk kam. E mua, personalisht më tha, ta jap dhuratë një I-phone 3", përfundoj citatin.

Edhe pse në artikullin e larttheksuar ka edhe shumë e shumë mesazhe të kësaj natyre, unë nuk do t'i trajtoj të gjitha, por duke bërë një analizë të këtyre dy momenteve, do të jap një konkluzion mbi gjendjen shqetësuese të universitetit.

Nga përmbajtja e këtyre SMS-ëve shihet se universiteti është i futur në korrupsion dhe ndonëse është Universitet Publik, nuk është edhe aq shumë në interes të publikut, sepse qytetari, prindi kosovar, për ta regjistruar fëmijën e vet në studime e veçanërisht në Fakultetin e Mjekësisë, duhet ta shesë veturën, duhet ta dhurojë I-phonin e nganjëherë edhe kjo nuk mjafton, sepse ata që janë të ndërlidhur me regjistrime të paligjshme, janë të pangopshëm dhe janë në gjendje, që prindërve të gjojë t'ua rrjepin edhe lëkurën e trupit.

Andaj, kur prindi, qytetari i rëndomtë ngopet me padrejtësi të tilla, është e natyrshme që të protestojë e kësisoj vjen deri tek pamjet shqetësuese, në të cilat institucioni i lartë

arsimor duhet të mbrohet me forca të mëdha policore nga protestuesit dhe qytetarët e pakënaqur.

Jam i sigurt se krijuesi dhe intelektual i kosovar zhgënjehet dhe ndjehet i fyer kur sheh se në çfarë gjendje ka ardhur sot universiteti më i madh i Kosovës, universiteti ynë më i vjetër, për të cilin ky popull ka derdhur shumë mund, shumë djersë, lot dhe gjak. Prandaj, me plot të drejtë, qytetari dhe intelektual ynë sot shtron pyetjen se kush e solli në këtë gjendje Universitetin e Prishtinës?

Sipas një vlerësimi të përgjithshëm, Universiteti i Prishtinës ka ardhur në këtë gjendje për shkak të ndërhyrjeve të vazhdueshme, në mënyrë të planifikuar dhe sistematike të politikës, e posaçërisht të partisë që është aktualisht në pushtet, që ka ndërhyrë në funksionimin, strukturat dhe menaxhimin e këtij universiteti.

Se ky vlerësim është i saktë, pra që partia në pushtet ndërhyr dhe ka synim jo ta mbikëqyrë, por të udhëheqë dhe komandojë me Universitetin e Prishtinës, më së miri tregojnë zgjedhjet e dy rektorëve të fundit të tij.

I pari është zgjedhur pas dërgimit të SMS-ëve politikë, për çka opinioni i gjerë e pagëzoi “SMS-rektori”, kurse i dyti është zgjedhur si rezultat i kalkulimeve ministrore ndërmjet partive që janë në koalicion qeverisës. Kështu, politika gradualisht dhe në mënyrë të sigurt ka lëshuar rrënjët e veta në tempullin e dijes, sepse duke zgjedhur të parin e universitetit, duke caktuar miqtë dhe përkrahësit e tyre politikë në organet menaxhuese të universitetit, në postet më të larta, si rektor, prorektor, anëtarë të Këshillit drejtues, interferojnë drejtpërdrejt në zgjedhje dhe funksionimin e njësive akademike. Kësisoj, politika ka gishtë apo lirisht mund të thuhet e vë vulën e vet në përzgjedhjen e personelit akademik, regjistrimin e studentëve, zgjedhjen e stafit menaxhues të njësive akademike, përzgjedhjen e personelit administrativ, zgjedhjen e udhëheqësve të organizatave studentore, ndarjen e studimeve të doktoratave, ndarjen e tenderëve për investime dhe shërbime në universitet dhe thuaja se në të gjitha çështjet vitale të punës dhe funksionimit të universitetit, sepse është e logjishme që ata udhëheqës që zgjidhen sipas direktivave të partive politike, nuk do të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe sipas bindjeve dhe aftësive të tyre profesionale, por do të veprojnë sipas direktivave dhe interesave të partisë politike që i ka vendosur në postin udhëheqës.

Shkurt e shqip thënë, gjendja e rëndë e Universitetit të Prishtinës është pasojë e ndërhyrjes flagrante dhe të vazhdueshme të partisë në pushtet në të gjitha sferat e fushëveprimi të tij.

Andaj, si deputet i këtij Kuvendi dhe si profesor i Universitetit të Prishtinës, me dëshirë që të kemi një universitet, i cili paraqet tempullin e dijes, ku garojnë studimi dhe shkenca, i cili do të prodhojë kadro për tregun e punës të regjionit dhe Evropës, përkrahu në tërësi rekomandimet e ushtruesit të kërkesës për debat, e sidomos rekomandimin që Qeveria, respektivisht partia në pushtet të heqë dorë nga kontrollimi i paligjshëm që ka vënë mbi UP-në.

Thellësisht jam i bindur se qytetarit, prindit, studentit, mësimdhënësit kosovar i nevojitet dhe do t'i ofrojë shërbimet e duhura vetëm universiteti i depolitizuar. Andaj, të gjithë ne, për të mirën e shkencës, dijes dhe shoqërisë kosovare, duhet të angazhohemi për të larguar politikën nga Universiteti e assesi nuk duhet të synojmë që të largojmë ndikimin e një partie, për ta zëvendësuar atë me ndikimin e një partie tjetër. Për të realizuar depolitizimin e Universitetit të Prishtinës, mendoj se ky Kuvend duhet të themelojë një komision apo një këshill, në të cilin do të marrin pjesë ndër të tjerë edhe profesorë, ekspertë të arsimit, përfaqësues të universitetit, përfaqësues të MASHT-it, i cili do të rishqyrtojë edhe njëherë Ligjin mbi arsimin e lartë dhe statutin e UP-së, në mënyrë që këto dy akte normative të ndryshohen dhe plotësohen, me qëllim të favorizimit dhe avancimit të aspektit dhe lirisë akademike dhe të mënjanimit të dispozitave, me të cilat mundësohet që politika përmes eksponentëve të saj të komandojë me këtë tempull të diturisë.

Fatkeqësisht, Universiteti i Prishtinës nuk lëngon vetëm nga ndikimet politike, por si pasojë jo vetëm e presioneve politike, por edhe e rrethanave të tjera të cilat janë të pranishme në shoqërinë kosovare, në Universitetin e Prishtinës është mjaft i theksuar edhe korrupsioni, i cili haset në një në procesin e regjistrimit të studentëve, për fat të keq në fakultete të caktuara, si pasojë e korrupsionit në vazhdimësi pranohen më shumë studentë se sa që kërkohen me konkurs, herë-herë dërgohen lista shtesë nga individë apo qarqe të caktuara.

Korrupsion ka edhe në procesin e vlerësimit dhe notimit, korrupsion ka edhe në procesin e punësimit, sikurse të personelit administrativ, ashtu edhe të atij mësimor, ku fatkeqësisht sot në universitet kemi shumë e shumë raste që është pranuar personeli mësimor, i cili nuk i plotëson kushtet ligjore, por që për shkak të ndikimit politik apo korrupsionit janë pranuar edhe pse para lufte as në ëndrrat më të mira të tyre nuk kanë mundur ta shohin veten në pozitën e mësimdhënësve të universitetit, por ja që studimi dhe punësimi me rënie të lirë i ka bërë ata profesorë.

Për këto dhe shumë arsye të tjera përkrahu edhe rekomandimin tjetër, sipas të cilit kërkohet nga organet kompetente duke filluar nga Agjencia Kundër Korrupsion, që është duke u marrë me korrupsionin në universitet, pastaj policia, prokuroria dhe gjykatat, që t'i hetojnë dhe ndriçojnë kryerësit e të gjitha llojeve dhe formave të veprimit të kundërligjshëm, që janë paraqitur në këto 14 vjetët e pasluftës në universitet, kurse kryerësit e tyre të vihen para drejtësisë dhe të ndëshkohen, konform dispozitave në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIPI MUJA: I nderuar kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Unë desha të jem i shkurtër, por meqë pash që shumëkush foli shumë, ndoshta edhe unë nuk e teproj për të folur shumë.

Në fillim, kur thashë që të ndërrohet edhe titulli, emërtimi i këtij debati, që për ne do të ishte më i qëlluar si deputetë, të flasim për arsimin në tërësi, që këtu nuk jam duke dëgjuar, por po flitet vetëm për Universitetin e Prishtinës, në veçanti.

Kjo tregon që ka një pretendim që tanimë është i qartë nga disa militantë të LDK-së, nën emrin e edukatorëve dhe nga militantizmi i “Vetëvendosjes” i patronizuar nga disa studentë, të cilët mbrojnë agjendën e tyre dhe të cilët duan me dhunë të arrijnë të bëjnë një ndryshim.

Unë i takoj jo në mesin e studentëve të themeluesve të Unionit të Pavarur, po jam në mes të pesë themeluesve të Unionit të Pavarur dhe ne kur thërrisim në demonstrata nuk rrinim nga 100 ose 200 persona, sepse nuk ishim mercenarë ne, po kishim një motiv, ai motiv na lidhte për të ruajtur tempullin e universitetit, për t’i ruajtur vlerat kombëtare, për të arritur vlerat më të larta, të cilat ne sot po i gëzojmë.

Unë po dëgjoj këtu shumëçka duke folur, por askush deri më tani, përveç ndërrimit të rektorit ose heqjes së asaj strukture dhe se çka do të ndodhë më tutje, a do lihet ndonjë boshllëk, apo jemi duke u përzier në institucionet e universitetit me dije apo pa vetëdije, me interes apo për qejf të dikujt, nuk jemi duke e kuptuar dhe nuk jam duke e parë nga asnjë deputet këtu.

Sot, më befasoi edhe prononcimi i një personi të cilit i ngritëm në këmbë dhe vlerësoj më lart se sa çdo intelektual tjetër në Republikën e Kosovës dhe në tërë trevat shqiptare, ai është akademik Rexhep Qosja. Unë desha t’ua lexoj tërë fjalimin e tij, prononcimin, por është pak i gjatë dhe do ta lus sekretarinë, që t’ua shpërndajë në procesverbal dhe nga kjo të merrni shumëçka si pjesë e platformës, për çka ne duhet ta thërrasim edhe një seancë tjetër. Por, do ta lexoj vetëm hyrjen.

Akademik Rexhep Qosja i ka dalë në mbrojtje rektorit Ibrahim Gashi, duke thënë se të gjithë ata që po bëjnë fushatë kundër rektorit Ibrahim Gashi, duke akuzuar si të dërguar politikisht për rektor të universitetit e nuk bëjnë fushatë as protestë, as demonstratë, as nuk thonë fjalë kundër ish-kuadrove të Milosheviqit në pushtetin e dikurshëm të Kosovës, që kanë arritur të bëhen prijës partie, kryetarë të ndonjë qyteti të Kosovës, deputetë në Kuvendin e Kosovës a ministër në Qeveri, a këshilltar Presidence. Shembull i tillë më ofendues për Kosovën është pikërisht Isa Mustafa i Lidhjes Demokratike, zoti Beqiri, se me një varg bashkëzyrtarësh të kohës së Milosheviqit.

Prandaj, kjo tregon që edhe institucioni më i lartë, Akademia e Shkencave, e cila duhet të jetë si avangardë udhëheqëse e çdo devijimit në fushën e edukimit të Republikës së Kosovës, sot është e kapur dhe është e humbur pa autoritet, që të japë edhe një komunikatë të vetme për cilësinë e zhvillimit të arsimit në përgjithësi.

Ne, studentët, të cilët sot i financon taksapaguesit e Kosovës, duan ta rrënojnë Rektoratin, sepse kanë marrë misionin. Unë i uroj që ta rrënojnë se është objekt ashtu- kështu pak i vjetër, ndoshta e ndërtojnë një më të ri në të ardhmen, por duhet menduar a do të mund ta ndërtojmë?

Ky Rektorat është bërë me mund të madh dhe këto goditje janë marrë në vitin '81, janë marrë në vitin '89, kur ne na kanë nxjerrë me dhunë nga edukimi i rregullt, janë marrë me dhunë, kur ne kemi luftuar për çlirimin e Kosovës, ndërsa tash nuk kemi një përgjegjësi së paku çka do bëjmë më tutje. Këta aktivistë të “Vetëvendosjes”, e vogël ke qenë, Albulenë ti atëherë kur jam marrë unë me to, kështu që këta aktivistë të “Vetëvendosjes” që në një mënyrë mundohen të quhen sikur “avangarda e kombit” apo mbrojtësit, tregon vetë kuantiteti i pjesëmarrësve, mënyra përçarëse që është futur brenda universitetit, një grup mbron, tjetri sulmon, grupi institucional pavarësisht çfarë janë, bëjnë... Universiteti, institucionet mbledhin, shkruajnë deklarate mbrojtëse, që kërkojnë kohë për vlerësimin e kësaj situatë, ju nuk po doni t’i jepni mundësi, por po doni ta realizoni, që në kuptimin e plotë të fjalës, me formën e dhunës, çfarë e keni zgjedhur është një fushatat paraelektorale, e cila mundohet ta plotësojë edhe fushatën afirmative të UDB-ashëve të para disa ditëve të cilët u kërkuan sot të identifikohen, qoftë këtu në Parlament, qoftë në të infiltroar në parti të ndryshme, nga partia ku jam unë ose në parti të tjera dhe ne t’u japim mundësi vlerave të cilat vërtet vyejnë për rininë tonë.

Ne nuk kemi kohë edhe nuk kemi guxim ende dikush që të dalë të thotë, ja këto janë listat e gazetave ku vlerësohen. Edhe të themi kjo, kjo, kjo, kjo është bërë si miratim, që duhet të vlerësohen. Në Fakultetin e Mjekësisë, i them edhe Times, edhe të tjerëve që janë mjekë, te Pionieri kanë botuar disa pedagogë edhe sot i kam parë edhe në televizor, ku kanë thënë edhe dje kanë thënë që këta pedagogë të ri kanë vjedhur, ndërsa ne kur kemi botuar edhe punimin të “Pionieri” ka paraqitur si indeks.

Prandaj, ne duhet të jemi të kujdesshëm të vlerësojmë, t’i japim mundësi institucioneve, të cilat duhet t’i vlerësojmë. Ne pse jemi deputetë, nuk na jep askush të drejtë të ngrihemi edhe intelektualisht ta vlerësojmë dikë, sepse ndoshta nganjëherë s’jemi të barabartë. Faleminderit!

(Debat në sallë)

KRYETARI: Ne nuk e autorizojmë Administratën të nxjerrë shkrime prej gazetave. Fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Zoti ministër, se paska mbetur veç një,

Të nderuar kolegë,

Unë ç’është e vërteta nuk do të lexoj fjalimin që e kisha përgatitur ngase po shoh se këtu më shumë është problem qasja se sa argumentimi të cilin ne po e shtrojmë, pavarësisht ku pajtohemi apo s’pajtohemi.

Asnjë deputet deri më tash nuk e tha dhe s’besoj që do ta thonë edhe deri në fund, se jemi të kënaqur me këtë gjendje që e kemi në universitet. Mund të mos pajtohemi kur themi se cila është shkalla e politizimit, ose cilat janë dyshimet për korrupsion në regjistrim, në avancime, gradime, mund të dallojmë, por besoj se nuk dallojmë që gjendja është e keqe dhe se ka degraduar përtej mase.

E kisha fillimisht një ide edhe unë ngjashëm sikur disa kolegë, të citoj diçka, t'i lavdëroj disa apo t'i kritikoj disa. Po, a di ku ishte problemi më i madh? Problemi më i madh, se në fund konkludoja se gjendja në universitet po mbetet e njëjtë, nëse ne vazhdojmë të lavdërojmë dikë që na pëlqen ose të kritikojmë dikë që s'na pëlqen.

Dhe, në fund të këtij debati, ka për t' u shtrua pyetja, cili është konkluzioni dhe cili është hapi i parë? Pse po i ikim asaj, pse po i ikim që ta vendosim hapin e parë në fund të këtij debati?

Unë e di, se njeriut mund t'i pëlqejë kur e ka mirë, kur e ka dikë aty, nëpërmes të cilit kryen një punë, por mos të harrojmë bre, mos të harrojmë, se tepër i rëndësishëm është universiteti, interesi i studentit dhe interesi i këtij vendi dhe nganjëherë duhet të dalim edhe nga vetvetja.

Unë nuk po përshkruaj tash të gjitha ato të meta, të cilat veç janë thënë, por ka dy momente që unë dua të ngre si shqetësim të veçantë. E para, derisa ne këtu afër nesh po diskutojmë për këto të meta në Universitetin e Prishtinës, çka mendoni se çka do të ndodhë me ato universitete që kemi gjuajtur nëpër qytete. Brenda dy vjetësh, nëse kështu vazhdohet, qasja sikur në këtë universitet, kemi për të folur për merimanga.

Shqetësimi i dytë, është ajo që unë dëgjova mbrëmë dhe parmbremë që filloi, qoftë ai menaxhmenti, Këshilli Drejtues filloi t'i thotë disa kritika, me vend apo pa vend, për disa profesorë që ishin kritikë.

E para, cila ka qenë kompetenca e menaxhmentit, të mos lejoj gjëra, për të cilat tash po tregojmë, se ky profesor qenka avancuar në mënyrë jo meritore, të gjithë ata që kritikua, pra, çka, kush? Cila është kompetenca e Këshillit Drejtues, a i mbikëqyr menaxhmenti pastaj senati si organi më i lartë akademik? Çka kanë bërë ata deri tash? Dhe del nga kjo konkluzioni, se kanë toleruar derisa janë treguar të dëgjueshëm. Ruana zot, dje folën, u doli emri në gazetë dhe në televizion.

Edhe sa janë të tillë, që sot po rrinë urtë e ata s'ua përmendin emrin? Shumë shqetësuese është kjo. Dhe, kjo tregon që nuk po dëshirojmë as hapin e parë ta bëjmë, ta tejkalojmë këtë situatë.

Unë e di se kjo gjendje nuk është pasojë e mungesës së ligjit. Ne kemi lënë vend dhe ministri është këtu kur i kemi thënë ministrit - nga ju presim shpejt ta inicioni amendamentimin e Ligjit për arsimin e lartë, ngase ka shumë kompetenca në Këshillin Drejtues, duhet të fuqizohet Senati. Dhe, ka iniciativa, shpejt, presim, Mirëpo, vetëm të ishte zbatuar ligji, këto ligje që i kemi, s'kishte për të ardhur situata deri këtu.

Ne tani flasim për punimet shkencore, obligimet, autori i parë, autori i tetë, kush e ka ndalur universitetin nëse ka parë se ka pak potencial arsimor dhe njerëzit detyrohen, ndoshta që po themi tash, të botojnë edhe aty në çfarë gazete, reviste dhe nuk dihet. Kush e ka ndalur, pse sot arsyetohen?

Dhe, e dini se kjo gjendje ka qenë vazhdimisht, mund të thotë dikush, po çka ndryshoi këto njëzet ditë? Unë po ua them çka ndryshoi.

Të gjithë e kemi ditur që kjo është gjendje e vështirë dhe kemi pritur që kjo të ndryshojë, por kur doli që i pari i universiteti, jo s'është fushata, po atëherë kur doli se i pari i Universitetit ka probleme të kësaj natyre, njerëzit i kanë humbur shpresat. Nuk avancohet procesi në Universitet me të parin, i cili nuk mori guximin të dalë e të thotë: "kam apo s'kam punim, unë heq dorë nga ky punim dhe kam mjaft punime që më mbrojnë apo s'kam punime, kam konsekuencën".

Respekt për një mësimdhënës që ka dalë dhe ka thënë: "unë heq dorë nga ai punim". Dhe, një profesoreshë që ka thënë: "pa dijeninë time është bërë". Njerëz jemi, është bërë pa dijeni, në rregull është. Çka tha rektori? A doli e tha: "unë heq dorë nga ky punim dhe i kam edhe kaq punime"? Jo, po fshihet. Pastaj, Këshilli Drejtues, cilat janë kompetencat e Këshillit Drejtues, çka bëri Senati dhe u krijua ai rrethi vicioz.

Përndryshe, shtrohet pyetja: Universiteti e ka autonominë e vet, çka duam ne në një debat të tillë? I panevojshëm, në dukje të parë, mirëpo cilat qenë idetë e universitetit, organeve të universitetit? Asnjë. Ata nuk do të dalin nga kjo situatë, ata e dinë pse. Ata dinë pse dhe sigurisht ju garantoj se as ligji as patriotizmi nuk i pengon, por u pengojnë relacionet që kanë ndërtuar: "unë ty, ti mua" dhe ata s'dalin prej asaj.

Unë kam pritur më shumë nga ministria, sepse edhe ka Inspektoratin edhe i ka katër anëtarë në Këshillin Drejtues dhe nuk ka reflektuar. Unë mund të kuptoj që i duhen 45 ditë për t'i vlerësuar të gjithë profesorët, për ta vlerësuar të parin e universitetit, duhen veç dy orë, sepse nga historia në gjeologji duhen veç dy orë, për ta kuptuar çka është ajo.

Me një datë historike nuk bëhet punimi dhe kjo ka qenë ai zhgënjimi i të gjithëve: "eh, sot po dorëzohem". Nuk ka përparim në universitet me të parin e universitetit, meqë nuk jemi të sigurt çka. Unë nuk po kualifikoj, a është a nuk është fajtor. Por, kjo duhet shpejt të vendoset. Prandaj, kjo është sfida kryesore - çka tash më tutje? Unë thërras në një konsensus. Unë mendoj se janë disa çështje madhore që kërkojnë konsensus. Të mos bëhet siç e thashë unë. Por, hajt t'i bëjmë konkluzionet e tilla që nesër të fillojë ndryshimi i kësaj gjendjeje dhe të fillojmë, se sa për sa kohë atje do të normalizohet së paku gjendja. E shihni nuk po flasim për performansën, nuk po flasim për nivelin e arsimit, s'po flasim kur Universiteti i Prishtinës do të hyjë në 100 universitete më të mira të botës. Ne po flasim vetëm që aty njerëzit të mos kenë nevojë të paguajnë para për t'u regjistruar, ose për ta marrë notën, ose për doktoratura, ose për punime shkencore.

Prandaj, unë mendoj që nëse ata mund të dalin nga ai tresh, nga ai rreth vicioz, po shihet që ministri, duke e respektuar në një fazë autonominë tepër gjatë, nuk i ka bërë veprimet që duhet, ndërsa ne si Parlament vërtet duhet ta tregojmë përkushtimin dhe nxitjen tonë që të kemi konkluzione, të cilat do ta ndryshojnë këtë gjendje.

Nëse dikush më thotë se ky rektor e ka kredibilitetin e nevojshëm dhe ky do të mund ta çojë procesin lart, atëherë më demanton në bindjet e mia.

Si do që të jetë, të nderuar deputetë, nga të gjitha grupet parlamentare, pa dallime, unë nuk do të nxitem as nga diskutimet paraprake, as gjendjen që e kemi, por unë po nxitem nga nevoja e madhe, nga dëshira e madhe që në universitet të fillojnë ndryshimet. Por, cilat ndryshime? Të mos jetë ajo që po e them unë. Hajt urdhëroni cili prej juve, cilido, t'i propozojë ato ide, të cilat mund të implementohen dhe të flasim pas një muaji se filloi e mbara në Universitetin e Prishtinës dhe të mos lejojmë që gjërat e tilla të na përsëriten nga universitetet nëpër shtetet tjera, të cilat unë jam i bindur se kanë me qenë edhe për shumë shkallë më dobët se ky universitet. Përndryshe, nëse kështu e tolerojmë këtë universitet, i presim edhe tjerat, atëherë çfarë kemi bërë? Ne i kemi degraduar edhe këto diploma që i kemi, fatkeqësisht.

Ndërsa thirrja retroaktivisht se të gjithë jemi të këqij, kujt i ndihmon? Kujt i ndihmon nëse nga një gjendje që e kemi tash, ne fillojmë të themi të gjithë jemi të këqij. Ai është dëmi më i madh, është mungesa më e madhe e vullnetit politik që të bëhet diçka më e mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Haut Haradinaj e ka fjalën. Nuk është. Deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Poštovani poslanici,

Baš kod dnevnog reda u kojoj govorim odnosi se na Univerzitet u Prištini, međutim kao i puno puta do sada od strane ne manje poslanika spomenjene se Univerziteti u Prizreni i u Peći, smerevi, nastava i nastavne osnobe na bosanskom jeziku.

Pominjena nastava i profesori svakodnevno se sreće sa velikim brojem problema kao što su kadrovski problemi, koji su direktno u vezi sa otvaranjem i akreditovanjem novih smerova, nostrifikacijom doktorskih diploma i drugih.

Kriminalne radnje i korupcija, koja su pominjena, ukoliko postoje i ukoliko neko ima dokaza za to, absolutno se slažem da je trebao odmah prijaviti, rešavati takve probleme na sudu, a ne za ovom govornicom ovrle spominjati to, verovatno samo u cilju prikupljana političkih poena. A koliko saznajemo, neki od poslanika su tužili neke od profesora Univerziteta koji su i sami završili, pa su izgubili na sudu zbog nedostatka dokaza. Što se tiče profesora, doktora Mehmeta Mete, uvaženog ekonomista u bošnjaka, na njega čeka Univerzitet u Peći na kome može regularno aplicirati i prijaviti se kao profesor za oblast u koju je doktor nauka, za šta se mi sami zalažemo. Hvala!

KRYETARI: Deputetja Nazane Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe çka duhet t'i ndodhë kësaj Qeverie që të thotë boll më. Kur një popull është i arsimuar, ai ka të ardhme të sigurt, por një popull ka në krye të institucioneve më të

rëndësishme njerëz që falsifikojnë titujt e tyre akademikë, atëherë kjo e vë në pikëpyetje të ardhmen e vendit të vet.

Sigurisht se kjo është e patolerueshme, sigurisht se kjo është skandaloze, sigurisht se kjo është kulmi dhe fundi i një qeverisjeje të papërgjegjshme dhe kundër vetë shtetit dhe së ardhmes së fëmijëve tanë.

Revistë fiktive apo jofiktive, pak rëndësi ka kjo. E rëndësishmja dhe e keqja qëndron në tentimin e rektorit për të shërbyer me hapa joligjorë, për të provuar dhe tentuar ta manipulojë botën akademike, e me të edhe të gjithë ne.

Si ka forcë e guxim rektori Gashi të marrë veprim të tillë dhe përkundër të gjithë këtyre skandaleve, ai nuk e gjen forcën, qoftë edhe morale, të dalë e të kërkojë falje publike dhe të dorëhiqet, edhe pse tani është shumë vonë, tani kur kemi reagime anembanë botës akademike, brenda e jashtë vendit, se ky skandal nuk kapërdihet nga askush. Tani është koha e shkarkimit të menjëhershëm, e largimit jo vetëm nga rektori, por edhe nga procesi mësimor i këtij rektori dhe jo vetëm, por së bashku me kompaninë e tij, të cilët janë duke e dhunuar inteligjencën e secilit prej nesh.

Askënd nuk e mbyl paturpësia, thotë një fjalë popullore, por ku është etika dhe kodi moral i rektorit Ibrahim Gashi? Në fakt, ai është duke luajtur fshehtas me të gjithë ne intelektualët brenda e jashtë vendit.

Në botën e civilizuar, ku pretendojmë të shkojmë, e për ku e kemi gojën plot, po të ndodhë të përvidhej një gabim sado i vogël, qoftë edhe një publikim dhe avancim i pamerituar, do të dorëhiqeshin, jo vetëm rektori, por edhe bordet e ministrat.

Te ne, jo vetëm që nuk ndodh një gjë e tillë, por përkundrazi del rektori dhe mbrojtësit e tij dhe arsyetohen me ‘opera sapuni’, duke shfajësuar jo vetëm atë, por edhe shumë e shumë tjerë që janë në gjurmët e tij. Deri kur kështu?

Me të vërtetë nuk e dimë se çka duhet të ndodhë tjetër në Universitetin e Prishtinës, i cili ka qenë sinonim i rezistencës, sakrificës edhe mburrjes kombëtare për ne të gjithë, të katandiset në këtë gjendje, duke filluar nga pranimi i tejrritur i numrit të studentëve e pa asnjë kriter dhe pa asnjë arsye, duke vazhduar me nepotizmin që po e ngulfat Universitetin e Prishtinës, duke e shndërruar në pronë të familjarëve, të ilakeve, farefisit në emër të filan-fistekut, duke avancuar kuadro akademike me recensime famoze dhe futuristike, që shpesh ngjajnë në filmat fantastiko-shkencorë, por të zhanrit tragjik.

Karshi këtyre problemeve kaq skandaloze, Ministria e Arsimit rri duarkryq dhe bën sehir, duke sjellë në kokë fabulën e dhelpres, së cilës i digjej bishti, e ajo u lut që të jetë ëndërr.

E gjitha kjo na shtyn të mendojmë se mos vallë ata që duhet të veprojnë e kanë mizën nën kapuç, apo s’e kanë guximin dhe kurajën që të veprojnë për ta stabilizuar këtë gjendje. Nëse jo për çfarëdo arsye të paditursë, apo mosguximit, do të ishte e udhës të kërkojnë ndihmë akademike e ligjore, qoftë nga brenda apo jashtë shtetit.

Politizimi i tejskajshëm i arsimit që nga parauniversitar e deri te rektori, politizimi i unioneve të studentëve, grupimeve e shoqatave të universitetit, përfshirë avancimet pa kriter, edhe me preferenca partiake e politike, e sjell këtë që po e vuajmë ne sot.

Ta shohësh në këtë gjendje Universitetin e Prishtinës dhe të rrih duarkryq që nga MASHT-i e deri te intelektual i fundit, është vetëvrasje kolektive.

Universiteti i Prishtinës u ka mbijetuar gjendjeve e pozitive shumë më të rënda në deceniet e kaluara, por ato ishin të imponuara nga jashtë dhe nga ato forca destruktive që donin të na rrënonin si komb dhe si shtet, por të sillesh ndaj Universitetit të Prishtinës në këtë gjendje nga brenda është të bësh vetëvrasje edhe më keq, të tentosh t'ua vrasësh të ardhmen fëmijëve tanë.

Shumëçka mund të improvizohet deri në arritjen e standardeve apo edhe qëllimeve, por të mundohesh ta improvizosh arsimimin, e në veçanti atë universitar, është të tentosh të shkatërrosh me dorën tënde të tashmen e të ardhmen e rinisë tënde, shtetin dhe popullin tënd. Zgjidhje ka, edhe atë me shumë sukses. Largimi dhe jo dorëheqja e këtij rektori së bashku me bordin që e kanë sjellë atë dhe stafin e tij, ndriçimi i të gjithë titujve dhe avancimeve brenda natës, vlerësimet edhe nga studentët për punën dhe ligjërimin e pedagogëve të tyre dhe sa më larg duart e politikës dhe të partive nga universiteti.

Duhet gjithsesi të bëhet edhe rihartimi i Statutit të universitetit dhe harmonizimi me standardet e shteteve përparimtare.

Rektor, a të ka mbetur më fytyrë të dalësh para studentëve në të ardhmen? Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Justina Shiroka-Pula.

JUSTINA SHIROKA-PULA: Faleminderit, kryetar!

Përsëndetje për ministrat dhe kolegët deputetë,

Në ditët e fundit, Universiteti i Prishtinës u bë temë, jo vetëm aktuale, por edhe akuzuese.

Ky institucion arsimor dhe shkencor po kritikohet nga shumë individë, studentë dhe aktorë të tjerë. Po kritikohet ndoshta me të drejtë, por ndoshta edhe pa ndonjë bazë analitike profesionale shkencore.

Universiteti i Prishtinës ka rreth 60 mijë studentë, kurse vetëm në Fakulteti Ekonomik, i cili është një ndër fakultetet më të mëdha, i ka 14 mijë studentë në një hapësirë të tipit rreth 3 500 metra katrorë. Kjo do të thotë se ngarkesa për hapësirë është 4 studentë për një metër katror. Nënkuptohej që kjo ngarkesë do të ndikojë edhe në cilësinë e studimeve.

Gjithashtu brenda institucionit mungojnë edhe institucionet kërkimore, të cilat do të ishin në funksion të rritjes dhe të përmirësimit të cilësisë së punimeve kërkimore dhe shpresoj që në të ardhmen këto institute kërkimore të funksionalizohen sa më shumë.

Në anën tjetër, të mos harrojmë se nga viti 1990 jemi angazhuar që arsimi universitar të mbahet gjallë përkundër shumë problemeve të grumbulluara gjatë dekadave, ku edhe tani po ballafaqohet me sfida të rënda arsimore, profesionale, hulumtuese dhe etnike.

Angazhimi i stafit akademik në këto vitet e fundit ka për qëllim arsimimin, zhvillimin dhe modernizimin e pedagogëve dhe të studentëve sipas plan-programeve më të avancuara ndërkombëtare dhe ngritjen në universitete më prestigjioze në botë.

Në Universitetin e Prishtinës, shumica e pedagogëve janë pranuar, zgjedhur, rizgjedhur dhe avancuar sipas Statutit të universitetit, që deri më tani kanë qenë disa, si për shembull statuti i fakulteteve në vitin 1996, pastaj statuti i përkohshëm i universitetit, statuti i vitit 2004 dhe tani ai i vitit 2013.

Në këto statute varësisht nga vitet ndryshojnë kriteret dhe kushtet e pranimi dhe avancimit të kuadrit universitar, që do të thotë se kriteret për avancim të një profesori para 15 dhe 20 vjet ndryshojnë dukshëm nga kriteret për avancim të studentëve, të akademikëve, profesorëve dhe asistentëve në vitet e fundit.

Zhvillimet e fundit rreth publikimeve në Universitetin e Prishtinës, të apostrofuara me një përzgjedhje të diskutueshme në revistat shkencore, po referohen si lajm i aludimeve se revistat janë të dyshimta.

Nëse hiqet dyshimi mbi to dhe ato dalin të jenë revista të mirëfillta, a do të jetë prapë lajm për faqen e parë të gazetave dhe kronikë e parë e edicionit të lajmeve në televizion?

Rezymimi i pafajësisë deri në dëshminë e saj është parimi më i çmueshëm se e drejta për të dyshuar dhe për ta botuar ndryshimin si të vërtetë.

Para së gjithash dhe mbi të gjitha, ne profesorët jemi viktimë të skemave mashtruese, por edhe të paformuar, por që po përpiqemi ta pastrojmë reputacionin tonë të brendshëm dhe atë prej më se një viti, e jo pse ndonjë gazetar e ka hedhur hapin e radhës.

Ajo çfarë nuk na duket e hijshme është që po përdoremi për të bërë lajm për shpresë, që shpesh jep mundësi ta kuptojmë gjenezën e kësaj situate sinkronizuese.

Ne mbajmë përgjegjësi për veprat tona, por refuzojmë të trajtohem si kriminelë kur jemi viktimë të krimit të revistave grabitqare, lakmitare, të cilat janë bërë një industri botërore.

Ne refuzojmë t'i përçmojmë punimet shkencore të publikuara në revista me integritet të dyshimtë derisa të dëshmohet se ato revista nuk janë të pranura ndërkombëtarisht.

Standardet ISSN, ISBN dhe impak-faktori janë disa prej indikatorëve që janë tregues i parë i ekzistimeve dhe karakterit shkencor të revistave.

Të drejtën për të aplikuar për kriterin ISSN dhe të pajiset me këtë kriter është qendra e ISO-standardeve, që mban regjistrimin e ISSN-së në Paris, që do të thotë se edhe

Universiteti Publik i Tiranës, i Tetovës dhe i Prishtinës nuk e kanë asnjë revistë deri më tani me standardin ISSN, që në këtë mënyrë nënkupton që të gjithë profesorët dhe asistentët janë të obligueshëm dhe detyrohen t'i botojnë punimet e tyre profesionale, empirike dhe punime të ndryshme në revista, të cilat mund të kenë qasje.

Arsye pse disa revista etiketohen të dyshimta nga disa persona lidhen me paraqitjen e dyfishtë të profesorëve në dy a më shumë borde edituese si editor më gjerësisht në fushën e studimeve, që përfshin kritere të ngjashme, të cilat mund ta zvogëlojnë rejtingun e revistave dhe të publikimeve që llogariten si punime shkencore.

Na mbetet që në kuadër të universitetit, apo edhe të fakulteteve përkatëse të përcaktohen kritere dhe lista e revistave të mundshme, në të cilat do të botohen punime shkencore, profesionale dhe empirike, ndërsa sa u përket botimeve aktuale të theksuara kinse në revista lakmitare, u mbetet etniteteve arsimore dhe ekipit recensues ta përcaktojnë nivelin e kualitetit shkencor.

Pra, kur flasim për Universitetin Publik të Prishtinës, debati duhet të zhvillohet në nivel akademik, sepse ai mbrohet vetëm kur aktorët flasin për kompetencat akademike, duke mos e përjashtuar asnjë palë të interesuar për debat të mirëfilltë, duke inkadruar edhe entitetet të ndryshme, si dhe ato ndërkombëtare.

Mendoj se kritika ndaj Universitetit të Prishtinës nga një grup i studentëve, pedagogëve dhe organizatave joqeveritare për depolitizimin e universitetit, për mua është pak e pakuptimtë, sepse pikërisht kjo ftesë për protestë vjen nga subjektet politike nëpërmjet klubeve të tyre politike në universitet. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Amir Ahmeti, por dije që deputetët pa grup duhet të presin goxha shumë. Urdhëro, e ke fjalën.

AMIR AHMETI: Faleminderit, kryetar!

Unë do të mundohem të flas shkurt, konciz dhe me të vërtetë, pas një debati kaq të gjatë, menjëherë pas miratimit të procesverbalit, kjo është e vetmja pikë të cilën e kemi diskutua gjatë tërë ditës sot dhe plotësisht pajtohem me deputetin Ferati, i cili tha se të gjithë jemi duke u marrë me akuza dhe kundërakuza, por askush nuk është duke folur për thelbin e debatit, për thelbin e problemit, ose çfarë pastaj.

Kjo situatë në Universitetin e Prishtinës nuk është e krijuar vjeshtën e kaluar, kur u zbuluan manipulimet në regjistrimin për doktoraturë të disa studentëve në Universitetin e Prishtinës, e as edhe në fakultetet tjera, por kjo gjendje në Universitetin e Prishtinës qëndron prej pasluftës e deri sot, sepse vazhdimisht ka pasur manipulime në regjistrim nëpër fakultete, por madje edhe te marrja e gradave akademike.

Të gjithë rektorët e Universitetit të Prishtinës prej pasluftës e deri sot janë zgjedhur me ndikimin politik dhe si rezultat nëse sot ne kërkojmë që ky rektor të japë dorëheqje, a do ta zgjidhë problemin? Kur ne deri tash diskutuam dhe vërtetuam se shumë profesorë në Universitetin e Prishtinës i kanë gradat e tyre akademike të kontestueshme, atëherë kush

do të bëhet rektor i universitetit pas këtij rektori? Për këtë arsye, mendoj që ne duhet të kërkojmë përgjegjësi, e jo të bëjmë akuza e kundërakuza dhe ato përgjegjësi duhet të fillojnë prej Ministrisë së Arsimit, e pastaj te Senati, Këshilli Drejtues, e mandej edhe te rektori.

Për të mos e zgjatur shumë, unë do të ndalem te rekomandimet, me ç'rast e përshëndes Grupin Parlamentar të LDK-së që e ka iniciuar këtë debat, por jo detyrimisht pajtohem me të gjitha rekomandimet. Fillimisht pajtohem me rekomandimin e dytë, ku thuhet: Organet kompetente të kërkojnë përgjegjësi dhe t'i vënë para drejtësisë të gjithë pjesëmarrësit në veprimet e tyre të kundërligjshme në Universitetin e Prishtinës.

Po ashtu, edhe me rekomandimin e katërt, ku thuhet: Të vlerësohet përgjegjësia e Ministrisë së Arsimit në të gjitha këto zhvillime në Universitetin e Prishtinës.

Por, nuk pajtohem me rekomandimin e tretë, i cili thotë: Të respektohet Statuti i Universitetit të Prishtinës. Statuti i Universitetit të Prishtinës ekziston dhe ai nuk është respektuar. Nëse ne kërkojmë prapë të respektohet, domethënë po kërkojmë diçka të kotë, sepse ai nuk respektohet nëse ne nuk kërkojmë nga organet përgjegjëse që ta gjejnë përgjigjen pse nuk është respektuar Statuti i universitetit.

Po ashtu nuk pajtohem edhe me rekomandimin e pestë, i cili thotë: Ministria e Arsimit, së bashku me Universitetin e Prishtinës, t'i përcaktojë politikat e regjistrimit. Politikat e regjistrimit janë të përcaktuara, por ne vetëm duhet të kërkojmë respektimin e këtyre politikave të regjistrimit në Universitetin e Prishtinës.

Dhe, në fund, pajtohem edhe me rekomandimin e deputetit Zemaj, i cili do t'i shqyrtonte të gjitha këto thirrje akademike të kontestuara, në mënyrë që ne ta zgjedhim problemin për afat të gjatë, e jo vetëm problemin që tash ka ndodhur prej vjeshtës së kaluar e deri më sot. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Xhafer Tahiri e ka fjalën.

XHAFER TAHIRI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës,
Të nderuar deputetë,

Më lejoni që ta filloj këtë prezantim timin, duke iu drejtuar edhe studentëve dhe kolegëve të universitetit dhe të gjithë qytetarëve me atë që ky debat i sotëm dhe rekomandimet që do të dalin janë të rëndësishme, sepse Universiteti i Prishtinës, shkenca dhe arsimi janë përtej ndasive nëpër partitë politike.

Prandaj, edhe ju ftoj sot, ju të nderuar deputetë, por edhe studentët dhe mësimdhënësit që t'i përkrahin këto rekomandime që do të dalin nga ky debat i sotëm.

Universiteti i Prishtinës është më shumë se sa thjesht një institucion i arsimit të lartë në Kosovë. UP-ja është institucioni simbol i Kosovës së re. Pra, ky universitet, bashkë me studentët dhe mësimdhënësit e tij duhet të vazhdojë të mbetet gardian i lirisë sonë individuale e kolektive dhe i zhvillimit tonë ekonomik.

Por, sot në universitet studentët nuk mund të studiojnë në kushte normale. Mungon përkrahja për studiuesit, nuk ka institute kërkimore shkencore që do të prodhonin studime orientuese për zhvillimin ekonomik e shoqëror të qytetarëve të këtij vendi, mungon përkrahja për revistat shkencore që do të duhej t'i ketë universiteti.

Sot, kjo udhëheqje e universitetit, në vend që të krijojë kushte për formimin e individit të lirë e të pavarur si themel i kësaj shoqërie, kërkon të kenë studentë e mësimdhënës që janë të nënshtruar ndaj tyre.

Burimet kryesore të zhvillimit ekonomik në Kosovë sot janë energjia dhe mineralet, por ironikisht universiteti nuk ia kushton vëmendjen e duhur përgatitjes së kuadrove për këta resorë të zhvillimit ekonomik.

Kjo situatë në UP është e papranueshme për një shoqëri që mëton të bashkohet me shoqëri të demokracive perëndimore.

Prandaj, rektori mashtrues dhe ministri i Arsimit, po ashtu mashtrues, duhet të shkojnë që tani. Më mirë tani, sepse dikur bëhet vonë.

Degradimi i proceseve në UP është reflektim i degradimit të përgjithshëm që u ka ndodhur institucioneve publike në këtë vend, me një Parlament si ky, me legjitimitet të munguar, dhe me një Qeveri të papërgjegjshme, e dalë nga zgjedhjet e vjedhura.

Por, kthimi i normalitetit në proceset në UP nënkupton fillimin e kthimit të normalitetit dhe agjendës zhvillimore në të gjitha institucionet tjera publike të kësaj shoqërie.

Në fakt, edhe u takon universitetit, studentëve e mësimdhënësve aty që të jenë prijatar në këtë drejtim.

Duhet thënë se kjo gjendje në UP nuk ka filluar me këtë rektor. Vetëm kujtojeni rektorin që ishte para tij. Prandaj, dorëheqja e tij sot është hapi i parë drejt kthimit në normalitet të proceseve në UP.

Njëkohësisht, ndërhyrja e partive politike me metoda anarkiste në proceset në UP vetëm sa e bën më të rëndë situatën aty.

Qeveria sot dhe në të ardhmen, pavarësisht nga partia politike që do ta udhëheqë atë Qeveri, duhet të heqë dorë nga mania për ta kontrolluar universitetin. Tempulli i dijes nuk mund të kontrollohet. Universiteti gjithmonë do të ketë mision të thjeshtë, por jetik - krijimin e individit të lirë në mendim, në veprim e në gjykim.

Kur e them këtë, unë dua ta bëj dallimin ndërmjet universitetit dhe rektorit mashtrues të universitetit, apo ministrit jokompetent për arsim.

Prandaj, unë sot, këtu, them se jam krenar që kam qenë student i Universitetit të Prishtinës. Nga bankat e këtij universiteti unë kam pasur fatin e madh që t'i ndjek

studimet posdiplomike në universitete me renome në Evropë dhe në SHBA. U mbetem njëkohësisht për jetë mirënjohës mësimdhënësve të mirëfilltë që janë në këtë universitet.

Unë përfundimisht do të jem shumë i lumtur nëse dy vajzat e mia nesër zgjedhin që të jenë studente të këtij universiteti, por pa një rektor mashtrues dhe pa një ministër po ashtu mashtrues. Faleminderit!

KRYETARI: Si duket, edhe në universitet duhet të ketë një kod etik, edhe në Parlament gjithashtu. Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje ministër,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Fjala që iu servua më së shumti qytetarëve tanë sot në Parlament, por edhe ditëve të fundit në media e në vazhdimësi është fjala ‘krim’: krim ekonomik, krim financiar, krim arsimor, krim shëndetësor, krim politik, krim urbanistik e tjera. Jam e bindur se është fjala që më së paku duan ta dëgjojnë qytetarët e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Para pak kohe, ne në Kuvend e miratuam Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Do të thoni ju, çka ka lidhje kjo me temën e debatit.

Mendoj që ka shumë lidhje. Ne si Kosovë ende po i vuajmë pasojat e viteve ‘90-ta e deri sot në çdo segment të jetës, edhe në ekonomi, edhe në arsim, edhe në shëndetësi, e kudo tjetër.

Shtrohet pyetja: Me miratimin e këtij ligji, a do të ndalet kaosi urbanistik? A do të ndërpriten ndërtimet pa leje? Është obligim i përgjegjësve që ta trajtojnë këtë temë dhe të merren në të.

Do të shtroj një pyetje të radhës: A kuptojnë çka do me thanë vlerë e parasë në kohë? Nejse, as kjo nuk është temë sot. A e dimë çka është pra vlera e dijes në hapësirë dhe kohë? A i meritojnë titujt shkencorë, akademikë të tillët që, bie fjala, kanë magjistruar duke e trajtua Shaban Polluzhën si armik, e kanë doktoruar duke trajtua Shaban Polluzhën si patriot? Edhe kjo le t’u mbetet kohës dhe shkencës ta vërtetojnë që është shkencë, plagjiaturë, a çfarë është? Apo, eksperti i ekonomisë në kohën e planifikimit socialist, i specializuar si ekonomist i mirë, a duhet sot të diskutohet dhe të vihet në pikëpyetje dija e tij si ekonomist? Nuk pretendoj të marr përgjigje.

Mendoj që ne po i hapim shumë punë vetes, në kërkim të një zgjidhjeje më të mirë. A është e gatshme Kosova ta vërë para vetes dhe të hapë shumë fronte dhe të mohojë gjithçka që është ndërtuar deri më tash dhe të shohë gjithçka në prizmin negativ? Po merremi me pasojën, e jo me shkakun.

Shihni çfarë klime u servohet qytetarëve tanë - tentohet që gjithçka që është ndërtuar të mohohet. Janë bërë shapi e sheqeri bashkë. Ku na shpie kjo klimë depresive që mendoj se

u servohet qytetarëve? Pedagogë, akademikë plagjiatorë, rektorë mashtrues, çlirimtarë tradhtarë, deputetë hajna, ministër i korruptuar, gjyqtarë i korruptuar e tjera e tjera! A është kjo fytyra reale e Kosovës? A është Kosova jonë, të cilën e kemi dëshiruar?

Të nderuar deputetë,

Dihet që edhe në vendet më demokratike protestat janë shprehje e vetëdijes për pakënaqësi që lidhen direkt me jetën e qytetarit. Por, a duhet që pakënaqësitë të keqpërdoren nga politika, e të shkojë aq lart sa të degradojë deri në vandalizëm, siç kemi pasur rastin ta shohim më herët dhe tash.

Të papranueshme janë sjelljet vandale siç është ngjyrosja e i-ish rektorit në një ceremoni të Universitetit të Prishtinës, demolimi apo shkatërrimi i mbishkrimit të Universitetit të Prishtinës, përdhosja e shtatores së patriotit Hasan Prishtina në ambientet e Universitetit të Prishtinës duke i vënë shami të zezë. Mendoj që është ogurzezë, është e papranueshme, e çka jo? ‘Mos ma prek Hasan Prishtinën’, thuan vargjet e këngës së rapsodit Sali Mani, i cili ma kujton kohën e viteve të ’90-ta. Mos ma merrni për folklorizëm këtë gjë.

Por, ka qytetarë dhe shumica e atyre shohin në këtë prizëm. Format e protestës dihet se si duhet të jenë, për ta fituar simpatinë e atyre që s’kanë qenë shumë në ngjarje e rrjedhë sesi po shkon situata në universitet, ose kudo qoftë.

Ne kemi mekanizma ligjorë dhe duhet të ndërtojmë edhe mekanizma institucionalë, të cilët i kemi, por duhet t’i forcojmë, të merren me të gjitha defektet, edhe ato të trashëguara e deri sot. Jo rruga, jo bllokimi, jo aktet vandale!

Në fund, partitë politike larg duart nga universiteti! Njëra nga kërkesat e protestuesve ishte ‘Pushteti larg duart nga universiteti!’, duke u ruajtur këtë që politika duhet të ndërhyjë. Jo pushteti, por politika larg dua nga universiteti! Lëreni universitetin të prodhojë dijetarë, e jo mjeshtër demolues. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Alma Lama. Nuk është këtu. Atëherë deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë jemi kah fundi, do të flas shumë shkurt, sepse mendoj që në kuadër të këtij debati, të cilin e ka iniciuar Lidhja Demokratike e Kosovës, u tha mjaft nga deputetët e të gjitha grupeve parlamentare, dhe mendoj që Grupi Parlamentar i LDK-së e ka dhënë rekomandimin me të cilën edhe deputetët tjerë u pajtuan pothuajse shumica, në përgjithësi, që rektori Gashi duhet të japë dorëheqje për shkak të skandaleve, të cilat kanë ndodhur tashmë aktualisht.

Por, meqë edhe ministri është këtu i pranishëm, u tha edhe nga një deputet, këtu për çështjen e ministrisë dhe ministrit, në përgjithësi - para disa ditësh ministri ka deklaruar se kjo është përgjegjësi e Këshillit Drejtues dhe njëkohësisht kjo është një përgjegjësi e Senatit. Por, unë konsideroj që këto skandale tash momentale, të cilat kanë ndodhur, por edhe skandale tjera më herët, edhe në Fakultetin e Mjekësisë, por edhe në fakultete tjera,

mendoj që edhe ministri nuk mund t'i ikën përgjegjësisë për shkak se nëse ai direkt nuk ka pasur mundësi, ose nuk ia lejon ligji që të përzihet direkt në Universitetin e Prishtinës, janë mekanizmat institucionalë, e kemi Ligjin për inspektorat dhe në skandalet të cilat kanë ndodhur deri më tani është dashur që ministri, në këtë rast, dhe menaxhmenti i Ministrisë së Arsimit t'i dërgojë inspektorët për të verifikuar dhe njëkohësisht për ta konstatuar gjendjen reale se çfarë po ndodh në Universitetin e Prishtinës dhe njëkohësisht se çfarë ka ndodhur deri më tani në disa fakultete, të cilat kanë qenë të evidentuara, sidomos Fakulteti i Mjekësisë dhe disa të tjera.

Po ta shikojmë edhe raportin e Auditorit, në të cilin janë dhënë edhe të gjeturat gjatë vitit 2012, ka shumë të gjetura dhe ka shumë shkelje, të cilat janë paraqitur në Universitetin e Prishtinës dhe konsideroj që në këtë rast inspektorët është dashur ta japin kontributin e vet, por është dashtë që ministri në këtë rast të sugjerojë dhe njëkohësisht t'i marrë hapat konkretë sado pak për ta zbatuar ligjin, i cili është në fuqi.

Prandaj, konsideroj se shkeljet e shumta në aspektin e buxhetit sidomos, sepse nuk është vetëm skandal ose shkelje të cilën e ka bërë rektori në atë revistë, por keqmenaxhim konsiderohet edhe paraaja publike, të cilën ky Kuvend i Kosovës ia ndan Universitetit të Prishtinës dhe nga Auditori janë paraqitur shumë shkelje të rënda dhe konsiderojmë që në këtë rast ministri duhet të insistojë me çdo kusht që jo vetëm, por pos kësaj reviste joefektive, në të cilët kanë dhënë edhe rektori, edhe shumë profesorë tjerë, por përgjegjësinë duhet ta marrë rektori në këtë rast edhe me menaxhimin e parasë publike, sepse "Koha Ditore" i paraqet vërejtjet e tilla, prandaj duhet që medoemos edhe rektori, edhe dekanë tjerë, por njëkohësisht edhe përgjegjësit në Ministrinë e Arsimit të japin dorëheqje. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Dua ta përsëris vazhdimisht që e pëlqej debatin, jam për debat, dëshiroj të jem pjesë e tij, por, megjithatë, më duhet ta ripërsëris një konstatim që në debatin tonë diçka s'është në rregull.

Shumë kashtë e byk, e pak grurë del prej debateve tona. Ndoshta nga vetë qasja që të bëjmë debat për debat, edhe s'mund të dalë ndryshe në fund.

Ka një qasje disi ekseseve, improvizuese me debatet. Duhet të ndodhë diçka që pastaj të gjithë të angazhohen dhe të diskutojnë për të gjitha çështjet.

Shikoni tash, gjendjen në universitet ne e kemi pasur kështu siç e kemi pasur edhe para një muaji, edhe para gjashtë muajve, edhe para një viti. Por, nuk e kemi shtruar në mënyrë të rregullt. Nëse tollovitet diku diçka, atëherë ndizen bateritë, ndizen pra motorët dhe bëhet politikë.

Mirë, është edhe kjo e natyrshme. Po ku po na shpie e tëra kjo? Shikojini temat që janë shtruar sot në debat. A mund të futen këto të gjitha në kallëpin e situatës që është krijuar dhe kemi ne institucione, e kemi komisionin përkatës e tjera, dhe krejt ato, në njëfarë mënyre, janë jashtë loje. Është do të thotë një defekt këtu te ne, ndoshta ky defekt edhe i prodhon situatat e tilla, të cilat nëse nuk i marrim siç duhet, ne vazhdimisht do të jemi në bisht të ngjarjeve. Jo t'i trajtojmë ato në vazhdimësi institucionalisht, në mënyrë sistematike, por të presim që të tollovitet diku diçka e pastaj të bëjmë politik, kush mbledh poenë politike e tjera.

Gjendja në universitet ka qenë jo e mirë edhe me këtë mandat, edhe para këtij mandati, edhe me një qeveri, edhe me qeverinë tjetër. Nuk është shtruar siç duhet dhe prandaj kemi vend për vërejtje, për kritika e tjera.

Po, çka po kërkojmë tani? Është krijuar një situatë e tendosur me protestën. Do trajtuar ajo siç duhet, por nuk besoj se institucionet tona, Kuvendi ynë tash duhet të jetë në njëfarë mënyre nën influencimin e një situatë politike, që edhe mund të ketë arsye, mund edhe të hidhet oksigjen, mund edhe të përdoret në forma të ndryshme dhe përshtypja e përgjithshme është që këtu janë përzier të gjitha motivet, prej atyre më sublimë, më parimore, më dashamirëse, edhe prej atyre profitore, politike dhe jo vetëm politike.

Dhe, çka ndodh me imazhin e vendit tonë, me imazhin e universitetit e të arsimit tonë? Ne i ankohemi botës që s'po na trajton siç duhet, kurse ç'është e vërteta, ne edhe në diskutimin që e kemi këtu e nxijmë përtej mase edhe fytyrën jo aq të ndritshme të sistemit tonë arsimor, por jo edhe ashtu siç po e paraqesim. Nuk besoj se i ndihmojmë zgjidhjes së çështjes në këtë mënyrë.

Unë, për të mos u zgjatur, dëshiroj të ndalem te rekomandimet, zonja e zotërinj.

Dhe, më vjen keq që duhet ta përsëris, për të satën herë, e kam thënë të njëjtën çështje edhe kur është proceduar prej grupit tim parlamentar.

Na mungon një analizë, një dokument në bazë të të cilit ne do të diskutonim, si zakonisht. Janë do rekomandime që janë politike, por nuk kanë synimin për t'u krijuar në një zgjidhje në të cilën do të mund të pajtoheshim, edhe kur e kemi vullnetin e përbashkët për të ndryshuar diçka për të mirë.

Shikoni, ju lutem, me gjithë respektin që kam për deputetët që e kanë nënshkruar, edhe për propozuesin e saj.

Një, Qeveria të heqë dorë nga kontrolli i paligjshëm që e ka vënë mbi universitetin. Nëse Qeveria ka vënë kontroll të paligjshëm mbi universitetin, atëherë është tepër pak të themi le të heqë dorë dhe kurrëgjë kurrëgjë. Dhe, cila është përgjigjja që pritet, që të dalë Qeveria dhe të thotë - unë po heq dorë prej kontrollit të paligjshëm. Nëse është kontroll i paligjshëm, përgjegjësia është shumë më e madhe se sa kjo që ushtrohet.

Për më tepër, nga përdorimi i tij si vend akomodimi për të njohshmit e tjera. Mund të ketë edhe raste, por një herë duhet të hulumtohet, të konstatohet dhe pastaj të vihet pikat mbi 'i'.

Të respektojë autonominë e universitetit! Po nëse heq dorë nga kontrolli i paligjshëm, që nënkuptohet, që edhe të nënkuptojë, është njëfarë tautologjie, dhe kështu me radhë.

Rekomandimi i dytë - Organet kompetente të kërkojnë përgjegjësi dhe t'i vënë para drejtësisë të gjithë pjesëmarrësit në veprime të tyre të kundërligjshme. Çka nëse ne e miratojmë një rekomandim të tillë? Pse na duhet një rekomandim i tillë? Këtë e thotë Kushtetuta, e thotë ligji, e thotë çdo rregullore, prandaj mund të themi le të sundojë ligji, le të zbatohet ligji dhe jemi në rregull. Kurse, edhe nëse e miratojmë, s'kemi bërë gjë. Nëse ka anomali konkrete, le të kërkohet përgjegjësia konkrete, po jo vetëm t'i përsëritim të njëjtat gjëra siç themi.

Dhe, kështu është edhe në paragrafin 3, siç u konstatua me të drejtë, të respektohet Statuti, po e kërkon Kuvendi.

Ose, të vlerësohet përgjegjësia e MASHT-it. Kush ta vlerësojë përgjegjësinë e MASHT-it? Ky Kuvend është ai që duhet ta vlerësojë. Dhe, si e vlerësojmë ne, i themi dikujt - le të vlerësohet përgjegjësia e MASHT-it. Nëse ka vend për ta vlerësuar përgjegjësinë e MASHT-it, duhet të formohet një komision. Ne e kemi një komision që e mbulon këtë fushë. Le ta bëjë ky komision punën e tij.

Prandaj, zonja e zotërinj, le të përpiqemi ta krijojmë një praktikë të rregullt parlamentare siç funksionon në botë. Nëse konsiderohet se në një fushë ka probleme, ka anomali, dhe kjo është e vërtetë e pakontestueshme, bëhet një trup që e bën një raport. Ai pastaj punon disa muaj, nuk e improvizon, i propozon Kuvendit rekomandime dhe rezolutën e duhur dhe pastaj masat konkrete me të cilat ndërtohet një qëndrim i përbashkët dhe kështu edhe funksionojmë institucionalisht, edhe rregullohen problemet.

Përndryshe, nëse lejojmë ne që situatat të instrumentalizohen, krijojmë precedentë të rrezikshëm - çdo rektor do të kërkohet të ndërrohet në këtë mënyrë. Dhe, nuk ka rëndësi në këtë rast a ka a s'ka përgjegjësi. Krijohet terreni që gjithçka të politizohet, të instrumentalizohet dhe në vend se t'i vëmë vetullat, si të thuash, t'ia nxjerrim sytë çështjes.

Unë prandaj nuk jam dakord me këtë qasje që e kemi dhe qëndrimi im është si edhe përpara. Angazhohem për një qasje konstruktive, të përgjegjshme dhe besoj ajo do të na bashkonte, e jo të na ndante në çështje të cilat, deshëm a s'deshëm, kemi interes të përbashkët dhe besoj kemi edhe kundrim të përbashkët. Kemi edhe qasje të përbashkët. Janë fëmijët tanë, është e ardhmja e vendit tonë, e imazhit të vendit tonë.

Unë propozoj dhe them që kjo t'i bartet komisionit, atje të harmonizohen qëndrimet dhe të evitohet mundësia që ne ta bëjmë 'hajt-pak' Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për nënkryetarin, ministrat dhe deputetët,

Sot para nesh si kuvendarë e kemi vënë këtë pikë në rend të ditës dhe mendoj se është shumë e rëndësishme dhe e ndjeshme.

Ministri Buja në fjalën e tij tha se a ka institucion publik që nuk ka pak ngjyrë politike.

I nderuar ministër,

Unë të them që jo pak ngjyrë politike, por politika këmbë e krye është futur në universitet. Universiteti është vënë nën kthetrat e politikës. Vetë zgjedhja e rektorit është politike. Apo ju me gjuhën tuaj mund të thoni se edhe rektori ka qenë pak politik. Ju e dini shumë mirë këtë gjë, sepse jeni pjesë e institucionit dhe jeni edhe njëri ndër përgjegjësit. Dhe, pse nuk e merrni guximin e të thoni për hir të qytetarëve, të paktën për hir të tyre, në mos jo për ne, se universiteti e ka humbur kredibilitetin. Universiteti është i politizuar. Nuk ka cilësi në universitet, ka rënie të tij. Vendi ynë ka nevojë për një universitet të papolitizuar, të pakorruptuar, që nxjerr kuadro të afta për ta drejtuar këtë vend. Dhe, mendoj se në ndërgjegjen e juaj ju e ndjeni këtë, por nuk mendoj që do ta thoni.

Respekt për profesorët profesionalë dhe parimorë në universitet, po kur po flasim për grada shkencore, doktorë shkencash përplot me bollëk, kush me meritë e shumëkush pa të.

U tha më herët që kredibiliteti i votave u paskësh dhënë mundësinë për t'u pajisur me tituj shkencorë dhe u tha që është turp.

Po, të nderuar kolegë, unë them që gratë e politikanëve kanë fituar tituj shkencorë falë votave të burrave të tyre. Dhe, ato janë mësimdhënëse në universitete. U japin mësim studentëve tanë. Prandaj, të gjitha këto diploma të dyshimta duhet të verifikohen.

Në Universitetin e Prishtinës, ministër, ka profesorë që në institucionin ku punojmë pra kanë sjellë diploma të falsifikuara. Unë këtu e kam një dokument me vete që një profesor, filan profesoreshe, e ka sjellë një dokument të rrejshëm se është doktor shkence dhe ka doktoruar diku në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Mirëpo, dokumenti që e kam thotë që Ministria e Punëve të Jashtme ka dërguar shkresën e Universitetit Shtetëror të Tetovës, se filan profesoresha nuk ka doktoruar në universitetin tonë. Dhe, kjo madje, po aq për sa kam informata, është graduar dhe është edhe prodekane diku nga universitetet e hapura rishtazi, dhe mendoj që jo se do të duhej të verifikoheshin vetëm diplomat në Kosovë, por edhe ato jashtë Kosovës, dhe të vendeve të tjera.

Prandaj, krerët e institucioneve për të cilët po flasim në këtë situatë të krijuar do të duhej të lëshonin pe.

Unë nuk do të flas për integritetin personal të krerëve të UP-së. Nuk e kam ndoshta edhe atë të drejtë, dhe nuk është strumbullari i gjithë këtyre problemeve rektori Gashi me kolegët e tij në krye. Aq më keq që problemet janë zinxhir.

Pse nuk po bëhen aq të ndershëm? Sa shembuj të tillë kemi edhe në shtetet e Evropës. Fjala vjen për popuj, të cilët nuk tolerojnë gjëra të tilla. E te ne nuk është krijuar kjo kulturë. Atëherë ne nuk do të duhej të habitemi pse të tjerët nuk na trajtojnë të barabartë. Morali politik nuk i pranon këto fenomene, madje aq më pak i meriton ky popull. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu.

BLERTA DELIU: Faleminderit, kryetar!

U diskutua shumë për protestën, do të thotë arsye e vetme pse kjo protestë po devijon është pikërisht përpjekja e politikës për ta organizuar protestën dhe e disa të tjerëve që ta marrin bajrakun në këtë protestë.

Kjo përpjekje e marrjes së pushtetit nëpërmjet universitetit nga subjektet politike është forma më e ulët, më jodemokratike dhe më jocivilizuese.

Universiteti i Prishtinës është tempulli i dijes, e jo vendstrehim për ata që më së paku e kanë vendin aty. Përpjekja që nëpërmjet një pingpongu ndërmjet palëve përgjegjëse duke garuar se cilët kanë më shumë faj, pozita apo opozita, më duket se po i ngjan paraprakisht një lufte të humbur të një gare zgjedhore të filluar shumë herët. Universiteti duhet të jetë në duart e pronarëve të vërtetë, e që ata janë studentët që duan të nxënë dije dhe profesorët e ndershëm që duhet ta shpërndajnë këtë dije.

Një pjesë të fjalimit po e dorëzoj, sepse është bërë shumë vonë dhe u thanë shumë gjëra.

KRYETARI: Diskutuesi i fundit për sot nga deputetët është Arsim Bajrami, pastaj është fjala e kryeministrit. Deputet, përpiku më shkurt!

ARSIM BAJRAMI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Zoti ministër i Arsimit,

Të nderuar deputetë,

Jo rastësisht jam paraqitur i fundit, edhe pse kisha vendosur para seancës që në shenjë proteste për gjendjen e krijuar ndoshta edhe të abstenoj për faktin se ka një konceptim të gabuar të gjendjes, por edhe një konceptim të gabuar për mënyrën se si të tejkalohet kjo gjendje.

Mendoj se pritjet në opinion nga kjo seancë janë pretencioze, pak më të mëdha ndoshta situata e krijuar, që është shumë e rëndë, opinionin ka pritur shumë nga kjo seancë, por ne duhet ta kemi të qartë se çka mund t'i ndihmojë Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, stabilizimit të gjendjes dhe si ne mund të kontribuojmë si deputetë që gjendja të futet në

një normalitet, për shkak se problemet janë konceptuale, strukture, janë probleme jo vetëm të momentit, por të tri dekadave të fundit.

Që nga viti 1980, universiteti ynë ka qenë edhe një trampolinë politike dhe fatkeqësisht po vazhdon të jetë i tillë. Dhe, çka kërkohet prej nesh? Kërkohet që ne si Qeveri, si Kuvend, të shohim se çka ne mund të bëjmë që universiteti t'i kthehet misionit të vet akademik, sepse, të nderuar kolegë, me standardet e Bashkimit Evropian, me standardet e Bolonjës, me standardet e zonës evropiane të arsimit të lartë edhe vetë debati në Parlament për çështje të universitetit është një ndërhyrje politike. Është e vërtetë se Parlamenti është themeluesi i universitetit, siç ka themeluar edhe institucione tjera shkencore me ligj, sepse institucionet janë themeluar me ligj, por kjo nuk është e vërtetë se tash universiteti, akademia, institucionet tjera duhet t'i raportojnë Kuvendit.

Çka ne mund të bëjmë, çka ne mund ta ndihmojmë universitetin? Të gjithë e kemi gojën plot fjalë 'autonomia e universitetit'. Është diçka e shenjtë, është diçka më e vjetër se sa edhe vetë demokracia. Si ta bëjmë konceptin e autonomisë së universitetit një koncept të vërtetë dhe çka ne mund të ndihmojmë si Parlament në rishikimin e kornizës ligjore, që kjo autonomi të funksionojë? Sepse askund në botë, të nderuar kolegë të nderuar, së paku unë që i kam vizituar mbi 100 universitete, askund në botë kuvendet, qeveritë nuk zgjedhin dhe nuk shkarkojnë rektorë.

Unë kam qenë viktimë e një shkarkimi në vitin 2004 nga një grup paramilitarësh i një partie politike dhe në shenjë proteste nga ajo kohë unë s'kam dhënë asnjë prononcim sa i përket universitetit, sepse trendi ka qenë i vazhdueshëm dhe ka qenë i pakënaqshëm.

Unë mendoj se ne tash duhet ta racionalizojmë debatin, sepse pritjet nga ky debat janë pretencioze dhe angazhohem për tri-katër segmente.

E para, angazhohem që ne të kërkojmë prej universitetit t'i marrë të gjitha masat që t'i menaxhojë krizat aktuale, që janë kriza të momentit, por që janë kriza permanente dhe kërkojmë nga mekanizmat e universitetit, Senati, rektori që të merren me zgjidhjen urgjente të problemeve, duke e përshirë vlerësimin e shpejtë dhe të menjëhershëm të problemeve me botimin e punimeve në revistat fiktive apo revistat kontestuese me rishikimin eventual të gradimit pa limite kohore, gradimit sidomos të njerëzve që kanë qenë në pozita udhëheqëse, jo vetëm në pozita udhëheqëse në universitet, por edhe në institucione shtetërore dhe pa limit kohor, s'kemi nevojë të limitohen nga '99 e nga '90, për këdo që vlerësohet, por ky vlerësim le të jetë akademik, jo politik. Të mos e bëjmë gabimin e shteteve komuniste kur qeveritë dhe parlamentet kanë ndërhyrë. Ne i kemi shembujt më të këqija të shteteve fqinja dhe e kemi parë se kushdo që ka futur duart në zgjedhjen e personelit akademik apo të udhëheqësve s'ka qenë me perspektivë. Na kujtohen praktikat në shtetet fqinja, i kemi të freskëta.

Çështja e dytë, ne kërkojmë dhe unë po i drejtohem ministrit të Arsimit tani. I di përgjegjësitë e ministrit të Arsimit. Po kërkoj që ministri i Arsimit t'i vërë në funksion të gjitha kapacitetet monitoruese të rregullsisë, kualitetit dhe cilësisë së punës në universitet. Ne të gjithë e kemi përshëndetur hapjen e universiteteve publike. Është një e arritur, por

ne kërkojmë që ministria brenda kapaciteteve ligjore, brenda mekanizmave që ka, të shohë se çfarë cilësie kanë këto universitete. A duhet të vlerësohen këto universitete vetëm nga Agjencia e Akreditimit, apo duhet të funksionojë një sistem i brendshëm i vetëvlerësimit? Është e pafalshme për Universitetin Publik dhe nëse studentët duhet të protestojnë, duhet të protestojnë për këtë gjë, që nuk ka një rol të studentëve në matjen e kualitetit të punës. Studentët nuk po na shprehin pakënaqësi për kualitetin e ligjëratave, për korrektësinë e profesorëve, për rregullsinë e profesorëve, për literaturën, për ambientet, por studentët po merren me politika madhore të zgjedhjes dhe shkarkimit të rektorëve.

I nderuar ministër,

Po ju njoftoj se sivjet asnjë njësi akademike apo njësitë akademike ku unë kam qasje nuk ka bërë vlerësim të kualitetit të studentëve. Këtë standard e kanë ndërtuar kolegjet private. Në kolegjet private nuk mund profesori të mos vlerësohet dhe të mos jepet mendimi i studentit për aspektet pozitive dhe negative. Universiteti Publik në një mënyrë ende sillet si monopol, sillet si pozitë monopoliste dhe kjo është e pafalshme dhe ministria juaj është e obliguar që ne në Kuvend një herë në 6 muaj të na sjellë raport për kualitetin e arsimit të lartë dhe ne kemi të drejtë ta dimë çfarë arsimit të lartë ne po prodhojmë dhe a po realizohet ëndrra për përfshirjen tonë në procese të Bolonjës. Studentët duhet të ankohen për këto gjëra.

Çështja e dytë - ne nuk kemi çare pa hyrë në rishikim të kornizës ligjore, sepse disa momente në Ligjin për arsimin e lartë dhe në status po na riciklojnë gjithmonë kriza, jo vetëm kur zgjidhet rektori ,por edhe kur zgjidhen dekanët, dhe ne duhet ta pranojmë që ky mekanizëm që rektori e dekanët zgjidhen nëpërmjet Këshillit Drejtues nuk është një mekanizëm që mundëson lirinë akademike dhe autonominë akademike të universitetit.

Ne e dimë që kompozicioni aktual i katër anëtarëve të ministrit është kompozicion legal që e kemi ndërtuar me ligj, mirëpo po ju garantoj se deri sa të jetë ky provizion gjithmonë do të ketë ndërhyrje në zgjedhjen e rektorit e të dekanëve, dhe jona është që të kërkojmë rishikimin e Ligjit për arsimin e lartë, rishikimin e statutit, dhënien e plotë të autonomisë që universiteti ta zgjedhë rektorin. Universiteti ka forma ta zgjedhë rektorin, ose nëpërmjet Senatit, ose nëpërmjet votimit të drejtpërdrejtë nga stafi akademik dhe nga asistentët. Unë vetë kam qenë monitorues i zgjedhjes së rektorit të Universitetit të Kalabrisë në Kozencë të Italisë dhe atë rektor e kanë zgjedhur të gjithë profesorët dhe asistentët, sepse edhe ata kanë pasur probleme me mënyrën si zgjidhet dhe kjo do të na mundësojë që dekanët, rektori, prorektorët të zgjidhen me kredencialet e plota akademike nga vetë stafi akademik.

Në kohën kur unë kam qenë student, është ditur kush do të jetë rektor, kush do të jetë dekan, sepse ka pasur një lloj rendi, ka pasur një lloj performanse që është dashur plotësuar. Kështu që unë mendoj se debatin duhet ta racionalizojmë. Ky nuk është një debat për shkarkimin apo zgjedhjen... Ne s'e kemi zgjedhur, as nuk mund ta shkarkojmë rektorin. Ne mund të kërkojmë prej organit tonë që na jep llogari, e që është Qeveria e Kosovës, që Qeveria e Kosovës ta rishikojë kornizën ligjore, Projektligjin e arsimit të lartë, të hyjë një rishikim substancial, Statutin e universitetit dhe si Parlament t'i evitojmë

të gjitha pikat apo nenet që po riciklojnë kriza dhe në një mënyrë ta ndihmojmë universitetin që t'i ketë kapacitetet e veta vendimmarrëse.

Kështu që ne tani, meqenëse jam i fundit, mendoj se ne duhet pak të rezonojmë në mënyrë pak më racionale. Ne i patëm disa rekomandime të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike dhe unë angazhohem që rekomandimet të jenë sa më konsensuale. Unë angazhohem që grupet parlamentare duhet të takohen dhe t'i harmonizojnë këto rekomandime dhe të provojnë të arrihet një konsensus. Nuk kemi të drejtë të kontribuojmë në përçarjet e mëtejshme në universitet. E jona është t'i menaxhojmë krizat, e jona nuk është t'i nxjerrim njerëzit të protestojnë, por t'i amortizojmë protestat dhe të tregojmë se ky shtet ka institucione dhe këto institucione dinë të marrin përgjegjësi ligjore dhe kushtetuese dhe dinë të kontribuojnë që gjendja atje të stabilizohet. Nuk është oborri i Rektoratit arenë politike, por është arenë akademike, është arenë e studentëve dhe ne kërkesat legjitime të studentëve duhet t'i marrim në konsideratë dhe ato kërkesa duhet të reflektojnë në qëndrimet e këtij Kuvendi, në mënyrë që të dalim me zgjidhje sa më racionale. Do të ishte fatale në qoftë se ne në Parlament nuk arrijmë ta ndihmojmë universitetin në këto periudha, do të thosha krize, të vlimeve politike.

Do të ishte jashtëzakonisht keq në qoftë se edhe ne e përdorim këtë debat si debat edhe për nevoja elektorale. Ky debat duhet të racionalizohet, sepse bëhet fjalë për një institucion të shenjtë, për një institucion nga i cili 90% kemi dalë. Unë po e shoh gati 1/3 e anëtarëve të Parlamentit që i kam pasur studentë dhe mendoj se ne kemi përgjegjësi që të gjithë, edhe si studentë, edhe si profesorë, edhe si njerëz që i kemi fëmijët tanë, që i kemi familjarët tanë në atë universitet, të jemi në nivel të përgjegjësisë, në nivel të një qasjeje racionale dhe ta gjejmë një zgjidhje, e cila do ta ndihmojë universitetin, do t'i lërë universitetit kohë të mjaftueshme që ai të reflektojë, të merren të gjitha masat për riparimin dhe sjelljen e gjërave në rend. Nuk mund ta bëjmë atë në qoftë se edhe ne tash biem në inercionin e zhvillimeve rreth universitetit, por t'ua lëmë një kohë të arsyeshme mekanizmave të universitetit dhe të kërkojmë që ata mekanizma të bëhen funksionale, të kërkojmë nga Qeveria, e cila na jep llogari neve si Parlament që ajo të procedojë me rishikimin e kornizës ligjore dhe t'ia japim universitetit autonominë e plotë në zgjedhjen e rektorit, në zgjedhjen e dekanëve dhe zgjedhja e rektorit e të dekanëve dhe prorektorit të mos jetë një fushëbetejë politike ndërmjet partive, por të jetë një produkt akademik...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë, por llogariteni pak edhe kohën!

ARSIM BAJRAMI: Pra, kemi obligim të punojmë dhe të rezonojmë për 70-80 mijë studentë sa i kemi. Janë studentët që meritojnë shumë më shumë. Janë e ardhmja e këtij populli dhe janë një gjeneratë shumë inteligjente, janë një gjeneratë që meriton më shumë.

Në qoftë se ne si Kuvend nuk jemi pak më racionalë, nuk jemi pak më kritikë dhe nuk marrim gjasa, atëherë i zhgënjejmë dhe e bëjmë një mision shumë të keq karshi kësaj gjenerate, e Kosova është pikërisht në duart e kësaj perspektive.

Andaj, i nderuar kryetar, unë angazhohem që grupet parlamentare të takohen, që të mos dalim me një votim, i cili do të mbivotojë. Ia vlen të humben edhe dy orë ndoshta në harmonizim dhe të arrijmë një konsensus, sepse pritjet e opinionit janë jashtëzakonisht të mëdha. Opinioni pret që ky debat do të mundësojë që gjërat të stabilizohen dhe të zgjidhen në të mirë të universitetit, në të mirë të studentëve që protestojnë.

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Unë dua të bëj një ndërhyrje. Parlamentit kurrkush s'mund t'ia marrë të drejtën për të debatuar për problemet në shoqërinë tonë. Por, ne deputetët s'mund të themi se jemi pa përgjegjësi, qofshin ne si legjislaturë, qofshin legjislaturat tjera. E kemi miratuar një ligj për formimin e një këshilli drejtues. Kur e kemi bërë këtë është dashur të precizojmë saktë kush mund të jetë anëtar i atij këshilli drejtues. Ne s'e kemi bërë. Dhe, shumica e anëtarëve të Këshillit Drejtues nuk e kanë përgatitjen e duhur akademike. Dhe, unë mendoj që në organe të tilla duhet të shkojnë njerëzit që e kanë një përvojë të gjatë në fushën e arsimit, e njohin mirë atë dhe natyrisht edhe kanë grada akademike.

Çështja tjetër - ne e kemi një agjenci të akreditimit. Kush e udhëheq atë agjenci? Unë mendoj se kur bëjmë përzgjedhje të tilla, futim në ligj gjëra të tilla, pasi i kemi këto defekte që po na ndodhin, duhet ta përshkruajmë edhe kush mund të jetë në atë agjenci të akreditimit. Dhe jo ministri apo dikush tjetër ta çojë kënd t'i teket në këta mekanizma që kërkojnë një përgjegjësi, edhe profesionale, edhe politike, të them edhe kombëtare. Dhe, në shumicën e rasteve edhe ne vetë kur po i miratojmë ligjet, nuk po jemi të vëmendshëm se vërtet çka po miratojmë dhe si do të zgjidhen ata njerëz në atë organ aq përfaqësues. Fjalën e ka kryeministri, zoti Thaçi. Dhe, në fund, grupi që e ka iniciuar debatin.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë do t'i them dy gjëra që i përmendi edhe kryetari Krasniqi, të cilat i mbështes plotësisht dhe e mbështes plotësisht fjalën e akademik Bajramit. Por, desha të them se të gjitha vendimet për ecurinë e punës, procedurat, zgjedhjet, rizgjedhjet, emërimet janë bërë me rekomandimet dhe me vendimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, prandaj edhe pretendimi për ta hedhur fajin diku tjetër nuk qëndron.

Natyrisht se përgjegjës, në një formë apo formën tjetër, për krejt sistemin arsimor, megjithëse unë e mbroj fuqishëm se sistemi arsimor në Republikën e Kosovës është më i avancuar se në shumë vende të rajonit, dhe ky vlerësim është edhe i ekspertëve edhe vendorë, edhe ndërkombëtarë, prandaj nuk është mirë të gjuhet vetëm baltë, se nuk është në interesin e kurrkujt hiç.

Mund dikush të mendojë sot po e fiton ndonjë poen politik, por një dëm e bën më të madh se sa poenët politike që mund t'i fitojë, dhe nuk fiton as poenë politike.

Ne i kemi lexuar edhe rekomandimet. Në fakt, këto nuk janë rekomandime, këto janë një draft-aktakuzë Universitetit të Prishtinës dhe si të tilla nuk kalojnë.

Prandaj, i ftoj të gjitha grupet parlamentare që të ulen e të bisedojnë dhe t'i gjejnë formulimet adekuate që çojnë drejt një zgjidhjeje të çështjeve të hapura dhe të diskutuara. Vlerësoj nga shumica, sinqerisht.

E kam theksuar edhe paradite, por po e theksoj edhe sot pasdite, do ta ritheksoj edhe kur të jetë e nevojshme. Sot presion mbi universitetin bëhet nga brumi i politikës së vitit 1989, kur është suprimuar autonomia e Kosovës. Pretendohet për vënien e masave të dhunshme në universitet nga individë me qëllime të pastra elektorale politike, qofshin të ndonjë adrese politike, qofshin te njerëz të dështuar në procesin elektoral politik dhe sot bëjnë zhurmë poshtë e lart.

Në të njëjtën kohë kemi edhe debat apo diskutime që pretendojnë të shesin moral në këtë Kuvend, pikërisht një moral akademik, duke mos pasur fare akademizëm.

Kemi edhe të tillë që pretendojnë ta mashtrojnë opinionin publik me deklarime kinse në emër të kauzës së madhe, e që në fakt vetë janë të involvuar në plagjiatura të pastra të konfirmuara. Prandaj, sistemi në universitet apo universiteti, unë ju ftoj të gjithëve të diskutojmë për tërë sistemin e arsimit kosovar. Edhe për Akademinë e Shkencave, edhe universitetin, edhe institutet, sepse tek e fundit Parlamenti i Kosovës të gjitha këto i ka themeluar, edhe akademinë, edhe universitetin, edhe Institutin e Historisë, edhe atë Albanologjik, edhe institucionet tjera. Le t'i diskutojmë shumë hapur, të gjitha, pa dallim, por me vullnet të mirë. E jo me pretendime elektorale linçuese të njëanshme, sepse edhe unë kam të drejtë të pyes: si ndihet zoti Hamiti si akademik që është anëtar i Akademisë së Shkencave, ku janë edhe Tito, edhe Sinan Hasani, e ka qenë i propozuar edhe Rrahman Morina. Kurrë s'janë larguar dhe përjashtuar ata dy njerëz. Çfarë titujsh kanë pasur ata për t'u bërë anëtarë të Akademisë së Shkencave? Si ndihet zoti Hamiti kur sot është konfirmuar plagjiatura akademike e individëve të caktuar aty, pasi po e sulmoni partinë në pushtet. Unë vetëm po kërkoj sqarim dhe po pyes.

Zoti Mustafa, pyeti tha se parapolitika, apo si e formulove, në universitet? Zoti Mustafa, nuk është më koha e autonomisë së 74-tës, kur Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, apo Lidhja Socialiste e Popullit Punonjësit të Kosovës ka diktuar në arsim.

Tjetra? Dihet shumë mirë se shumë njerëz edhe që jeni këtu keni qenë mentorë të njëritjetrit në titujt shkencorë dhe gradimet shkencore. Do të kisha pasur dëshirë të ishte miku Eqremi, legjenda e shkencës shqiptare, pasi është edhe mentori i tij këtu politik, prandaj ju ftoj të jemi korrektë, të sinqertë, të përgjegjshëm, ose të flasim konkretisht për të gjitha deformimet dhe degradimet që kanë ndodhur nga niveli më i lartë deri në nivelin më të ulët të arsimit. Faleminderit!

KRYETARI: Sabri Hamiti e ka fjalën, replikë, se i është përmendur emri.

SABRI HAMITI: Zoti kryeministër,

Ti po ma bën një pyetje që me të vërtetë s'ka sens. Ti i përmende dy emra njerëzish...

(Ndërhyrje: Tre i kam përmendur!)

... që janë në akademi. Dy a tre, nejtë s'është me rëndësi. Dhe, s'e di, ajo pyetje s'ka sens të më bëhet mua. Ata njerëz kanë qenë anëtarë të akademisë, janë zgjedhur qysh janë zgjedhur, dihet kur janë zgjedhur, kush i ka zgjedhur, kështu që s'kam bash kurrfarë komenti. Se çdo koment do të ishte i kotë, i pavlerë, pa lidhje, kështu që...

Ajo është punë tjetër, e cila s'është në dorën time, as t'i zgjedh, as t'i heq, kështu që me të vërtetë unë nuk shoh sens në përgjigje dhe s'kam përgjigje.

KRYETARI: Ministri Ramë Buja e ka fjalën. Atëherë, e kemi kryer debatin. Ministër, e doni fjalën ju?

MINISTRI RAMË BUJA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë dua të ju falënderoj për debatin. Ajo pjesë e diskutimit, në të cilën nuk hyjnë as 53 785 studentë dhe 1 059 profesorë, mendoj që ky kontribut i bisedimeve tuaja do të vlejë, pa dyshim. U tha që ministri po hesht dhe nuk po e flet asnjë fjalë. Unë konsideroj se ka rend të të folurit dhe unë mendova që të marr fjalën pikërisht në fund për t'i thënë disa gjëra që konsideroj se është e nevojshme për t'i thënë dhe, nëse dikush, meqë u dëgjuan zërat se duhet të shkojë edhe ministri, puna më e lehtë dhe më e vogël është kjo punë për të shkuar ministri. Nëse ka zgjidhje të problemeve me shkuarjen e ministrit, ministri shkon pa asnjë telashe, por problemi është që po shkon një ministër, nuk e kam hall se kush do të vijë, por nuk do të zgjidhet problemi. Dhe, nëse do të ketë zgjidhje problemi, unë jam i gatshëm pa pikë problemi ta bëj atë punë. *(Ndërhyrje: Unë ju kam dëgjuar kur keni folur, i nderuar...!)*

KRYETARI: Ju lutem, e kërkon fjalën me mikrofon!

MINISTRI RAMË BUJA: ...atëherë, së paku një kulturë elementare e dëgjimit kur flet dikush tjetër.

Çështja është se nëse kemi faj ne si Ministri e Arsimit, kemi faje vërtet, sepse kemi themeluar edhe 5 universitete tjera, dhe i kemi bërë 6, kemi sjellë në Kosovë hiç më pak se 158 tituj shkencorë, që nuk i ka pasur as nuk i ka kush në rajon, dhe po ju them kështu pak, jo pak por miqësisht, m'i keni frikuar, m'i keni 'shashtritur' ata të Shqipërisë, se isha para 3 ditësh dhe ishin të gatshëm ta marrin shembullin absolutisht dhe komplet, përveç njësimin të kurrikulës me kurikulën tonë, të na pasojnë edhe në të gjitha zgjidhjet e problemeve edhe për arsimin e lartë, por nëse e kanë dëgjuar këtë debat, vështirë se mund të na pasojnë.

Çështja e ligjit, unë po ju them, e kam thënë në Komisionin Parlamentar, Ligji për arsimin e latë është përpunuar, është draft-amendamentuar në ministri dhe me sugjerimin e Komisionit Evropian dhe të USAID-it është thënë 'ndaleni se kemi sugjerime për t'ju sjellë'. Përndryshe tash e 4 muaj ne si ministri e kemi kryer këtë punë dhe mund ta ridebatojmë.

Çështja e Statutit po kështu mund të ndryshohet dhe ne e japim kontributin tonë dhe e kemi thënë dhe e kemi bërë draftimin e këtij akti. E kam kërkuar me qiri e me pishë

kompetencën time për ta shpallur të paqenë konkursin e doktoratave kësaj radhe. Sa keni dhënë ju, deputetë të nderuar, me ligjin? Nuk e kam atë të drejtë. E kam kërkuar, por nuk e kam gjetur. E kam dërguar Inspektoratin për t'i inspektuar të gjitha ato mundësi që të inspektojnë në universitet, por jo në çështje akademike. Nuk ka të drejtë Inspektorati i Ministrisë së Arsimit ta bëjë këtë gjë, por të tjerat i ka inspektuar dhe nuk e kam gjetur atë mundësi që të shpallë çështjen e shpërdorimit që ka ndodhur, ose në fakt të ndërhyrjeve në mes rrugë për këto doktorata.

Megjithatë, i kam motivuar dhe inkurajuar gjithmonë me kompetencën ligjore që kam që të gjitha punimet e magistraturës master e të doktoratës të publikohen, të botohen ku ka mundësi, të plasohen dhe të dihet kush si dhe çka ka bërë. Dhe, jam ithtar i asaj që edhe e kam deklaruar sa herë, po e deklaroj edhe para jush, t'i respektojmë institucionet, ta bëjnë punën e vlerësimit ata të komisioneve që janë formuar dhe pastaj, ama bash askush të mos falet. Askush të mos amnistohet, sepse nuk kemi arsye ta falim askënd, as për ta mëshiruar askënd.

Unë megjithatë ju falënderoj për krejt këtë kontribut, por sinjerisht po ju them që 53 785 studentë sot nuk besoj të ndihen mirë për faktin e debateve që janë zhvilluar këtu, por po dua të besoj që është kontribut për pjesën e Ekzekutivit dhe të Gjyqësorit që të ndërmarrë atë që duhet ndërmarrë dhe ju them - mbase figuracion, nuk është mirë që të përdoret shumë këtu në Parlament, por nëse janë 1 059 pedagogë në Universitetin e Prishtinës, një 1 000 garantoj me jetë e shpirt që janë të mirë.

Prandaj, po ju them që prej listave ose disa rremave të mos shihet mali është mëkat. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zot kryetar!

Unë në fillim po ju informoj që ne me dy subjekte tjera opozitare i kemi harmonizuar rekomandimet tona. Nëse dëshiron edhe nga opozita dikush t'i harmonizojë, atëherë na e jepni pauzën ju dhe i harmonizojmë, nëse dëshirojnë. Unë po them, zoti kryetar, që u diskutua dhe u fol, edhe u fye ky Kuvend, edhe ne si deputetë nga zoti kryeministër.

Vendimet janë marrë nga Kuvendi. e thotë. E vërtetë janë marrë të nxirren ligjet dhe të nxjerrim ligje, por nuk do të thotë nëse njerëzit që janë të thirrur dhe në bazë të atij ligji që janë zgjedhur, kërkohet përgjegjësi nga ata që ju duhet t'i mbron. Prandaj, këtu duhet bërë dallimin. Nuk e ka zgjedhur Kuvendi i Kosovës rektorin aktual, që asgjë personale nuk kemi. As rektorin paraprak. Kuvendi nuk i zgjedh rektorët. E krijojnë infrastrukturën, por ne gjatë gjithë diskutimeve është argumentuar se gjendja nuk është e mirë dhe një ndër përgjegjësit, në mos përgjegjësi kryesor është ai dhe Këshilli Drejtues për ne, për gjendjen që është aktualisht në universitet.

Po ashtu, në asnjë mënyrë nuk mund të na thoni se janë të trashëguara. Nëse problemet janë të trashëguara, a do të thotë që nuk duhet të zgjidhen? A do të thotë që edhe ata që

vijnë pas jush në Qeveri t'i trashëgojnë këto edhe asnjëherë këtë trashëgimi pra të keqe, të punëve të këqija, të mos gjejë zgjidhje? Këto janë gjëra të paqëndrueshme.

Rekomandimet janë publike, asnjë aktakuzë nuk është këtu.

Zoti kryeministër, jeni kryeministër i vendit, mos e merrni rolin e prokurorit të thoni që ne po bëjmë aktakuzë. Edhe duhet bërë aktakuzë gjithë atyre që janë të involvuar në punët që s'duhet t'i bëjnë, ose që e kanë shkelur ligjin. Kuvendi nuk është gjykatore, e ju po doni në një mënyrë ta shndërroni në gjykatore, sepse ju po thoni që kemi bërë aktakuzë. Kjo është e paqëndrueshme dhe nuk është e vërtetë, se ne as nuk jemi sjellë gjatë gjithë këtij debati kësioj dhe as rekomandimet nuk janë të tilla.

Ky Kuvend ka të drejtë të bëjë rekomandime, ka të drejtë edhe si grup parlamentar, ne edhe kolegët tjerë, dhe kësioj po sillemi.

Është e drejtë e jona a do të dilnim edhe në protestë, apo jo. Ne dëshirojmë që institucionet tona t'i zgjidhin problemet, por nuk u mohohet e drejta as studentëve t'i shprehin pakënaqësitë. Këtë të drejtë nuk e keni as ju, as askush tjetër, të ua mohojë të drejtën t'i shfaqin pakënaqësitë studentët, qytetarët, kur ato janë, sipas tyre të bazuara, dhe ne jemi përfaqësuesit e tyre. Ne deputetët me vota të qytetarëve jemi këtu dhe ne po flasim si deputetë. Edhe subjektet politike i përfaqësojmë.

Prandaj, nuk është mirë të na akuzoni, sepse ju keni bërë sot akuzë. Absolutisht akuzë kur thoni se këtu ka aktakuzë, dhe kjo nuk qëndron. Dhe, plagjiatura - po nuk je ai ti që e konstaton kush ka bërë plagjiaturë. Pikërisht po kërkojmë që edhe komisioni, është rekomandimi, por nuk e keni lexuar, lexojeni! Edhe komisioni që është formuar nga Senati le të merret me të gjithë ata që i kanë bërë këto shkelje, por mos e merrni për vete këtë punë, se nuk mund t'i dilni zot as ju, as s'e kemi detyrë këtë punë ta kryejë Kuvendi. Por, ne e kemi obligim të kërkojmë së pari një akt moral, që është dorëheqja, atyre njerëzve dhe ligji ekziston, statuti ekziston. Le të procedohet më tutje ashtu siç parashihet me rregulla, me ligje, dhe në këtë rast me statut.

Por, absolutisht nuk pranojmë gjëra të tilla dhe po hyni në gjëra personale, po i fyeri njerëzit. Po i fyeri, zoti kryeministër, dhe unë mendoj se nuk është absolutisht korrekte.

Për fund, unë zoti kryetar i Kuvendit, të drejtën tonë e kemi me Rregullore. Ne i kemi rekomandimet tona, të cilat do t'i lexojë zonja Lirije. Unë e mora fjalën edhe për këtë, për të thënë se i kemi harmonizuar. Nëse dëshirohet të harmonizohen, janë 5 minuta punë, jo dy orë punë. Se analizat ne për gjendjen në universitet nuk e kemi ndërmend t'i bëjmë, le t'i bëjnë organet kompetente, por ne si Kuvend kemi të drejtë të japim rekomandime dhe asnjëri prej këtyre rekomandimeve nuk është për mendimin tonë në dëm të universitetit, por është në drejtim të stabilizimit të gjendjes.

Prandaj, në fund, zoti kryetar, unë kërkoj që të harmonizohen, nëse dëshirojnë të harmonizohet diçka nga këto që ne i kemi, ne tri grupe parlamentare i kemi të

harmonizuar dhe do të kërkojmë një pauzë hiç më shumë se 15 minuta për t'i votuar. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri,

Unë sot jam këtu për t'u koncentruar vetëm në debatin dhe çështjet që i mendoj unë - në debatin që është zhvilluar sot dhe çështjet se si unë i mendoj dhe nuk jam në mbrojtje të askujt, të asnjë udhëheqësi, të asnjë institucioni dhe individi. Por, unë, nga perspektiva ime, kam të drejtë të dal në mbrojtje të universiteti dhe të jap mendimin tim për sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës.

Nëse ti e merr këtë fyerje, është çështje e reflektimit tuaj, por nuk është fyerje. Nëse ti mendon, nëse ju mendoni që tërë ditës hidhni baltë mbi partinë në pushtet, mbi parti ë numër një në Kosovë, atëherë edhe ne kemi të drejtë t'i themi gjërat ashtu si i mendojmë ne, sepse gjatë tërë ditës nuk janë ndalur diskutimet tuaja, të grupit të juaj parlamentar, kundër njerëzve të Partisë Demokratike të Kosovës, kundër Partisë Demokratike të Kosovës.

Pyetjet e mia ishin shumë legjitime. Unë e di se ky Kuvend nuk ka votuar që Titoja dhe Sinan Hasani të jenë anëtarë të Akademisë së Shkencave të Kosovës. Por, unë e kam një pyetje për ju: Çka ju pengon ju t'i japim mbështetje Senatit të Universitetit të Prishtinës për verifikimin e të gjithë titujve dhe gradave shkencore të njerëzve të politikës? Shkojmë në dash deri te profesor Mustafa prej '74-tës e tutje, ose e nisim nga '90-'91 e deri sot, deri te akademiku Hamiti. Çfarë të pengon? Pse nuk i jep mbështetje kësaj? Po kërkon tash konsensus njëanshëm?

(Ndërhyrje: ISMET BEQIRI: Po kërkoj konsensus veç nëse do. Nëse do, është e drejtë juaja. Ne i kemi tonat, urdhëroni i harmonizojmë, ne kemi të drejtë t'i hedhim në votim...)

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: ...prandaj, partnerët e koalicionit nuk hyjnë në agjendën e njëanshme. Nëse i jepni mbështetje dhe tregoheni kooperativë, atëherë unë e ftoj Grupin Parlamentar, partnerët e koalicionit, uluni, diskutoni, merruni vesh, e keni mbështetjen e plotë edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Sa u përket titujve dhe gradave, është mirë që dikë e rrokë, e dikë nuk e rrokë. Më vjen keq që ndoshta po personalizohem, por pasi edhe ju gjatë tërë ditës u drejtuat në drejtim të Partisë Demokratike të Kosovës, mund të them lirisht se bartëse e plagjiaturës politike shkencore, shoqërore në Kosovë, jeni ju Lidhja Demokratike e Kosovës, bartësit që jeni duke i prezantuar këtu. Nëse dëshironi me shifra dhe fakte, flasim edhe për plagjiaturat e konfirmuara, e që duhet të ju vijë turp të flitni këtu për sistemin e arsimit me ata tituj, me ato grada, me atë akademizëm të falsifikuar e të dëshmuar, e të publikuar. Dhe, tash pretendoni të shitni moral para opinionit publik. Kjo nuk shkon! Nuk shitet! Nuk do të ndodhë kurrë! Faleminderit!

KRYETARI: Ismeti ka të drejtë në replikë.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar i Kuvendit!

Unë nuk mund të besoj që rektori nuk është i PDK-së. Tash e vërtetove që është. Nuk jemi marr ne me PDK-në, ne jemi marrë me gjendjen në universitet, me rektorin dhe me gjendjen e këshillit dakord. E para, zoti kryetar, ne si Grup Parlamentar kërkojmë nga ju që rekomandimet tona t'i hidhni në votim, është e drejtë e jona, se këta nuk po duan. Sipas kësaj, nuk po duan. Ju mos hyni në agjenda, por as ne nuk hyjmë në agjendat tuaja.

Absolutisht, sa u përket agjendave, ne i kemi rekomandimet, zoti kryetar, dhe kërkojmë që të lexohen ato dhe është e drejtë e deputetëve t'i votojnë, ose të mos i votojnë.

KRYETARI: Ismet, kur ta dhashë fjalën është dashur t'i lexosh rekomandimet. Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë ju ftoj grupet parlamentare të uleni dhe të merren vesh, ta ndërtoni një konsensus. Unë nuk përmenda emër dhe nuk jam në mbrojtje të askujt si individ apo bartës të institucionit. Është juaja se a besoni, është i këtij apo i këtij subjekti politik, ky apo ai individ. Por, nëse hidhni baltë gjatë tërë ditës kundër një subjekti politik, atëherë shikojeni edhe veten pak në pasqyrë dhe shikojeni shumë mirë.

Sa i përket përgjigjes së zotit Hamiti, se e përmendi, tha 'nuk kam përgjigje', realisht vetëm mospërgjigja e tij është përgjigje në pyetjen që unë e parashtrova se nuk ka moral për përgjigjen në këtë Parlament për deformimet që kanë ndodhur edhe më herët. Faleminderit! Ju ftoj që të merreni vesh dhe të ndërtohet konsensusi dhe nëse janë të njëanshme nuk do të...

KRYETARI: Debati ka përfunduar, ju lutem! Ismet Beqiri e ka fjalën për t'i lexuar rekomandimet.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar, më lejoni t'i lexoj rekomandimet.

Ne e kemi iniciuar debatin dhe në konsultim me kolegët e nderuar deputetë. Ne i kemi harmonizuar rekomandimet dhe është e drejtë e tri grupeve parlamentare tash mund të them, nëse më lejojnë kolegët të them kësisoj, që kërkojmë nga ju edhe të votohen, përkatësisht t'i hidhni në votim. Rekomandimet janë këto:

R E K O M A N D I M E

1. Rektori dhe Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës e ka humbur kredibilitetin për të udhëhequr me Universitetin e Prishtinës. Rektori i Universitetit "Hasan Prishtina", zoti Ibrahim Gashi, dhe anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të japin dorëheqje dhe t'i shërbejnë procesit të normalizimit në Universitetin e Prishtinës.

2. Të vlerësohet përgjegjësia e ministrit dhe e Ministrisë të Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë për mospërcjelljen me kohë të zhvillimeve në Universitetin e Prishtinës dhe mosmarrjen e masave ligjore në kohën e duhur.

3. Qeveria të heqë dorë nga kontrolli i paligjshëm, që ka vënë mbi Universitetin e Prishtinës dhe nga përdorimi i tij si vend akomodimi për militantët e saj politikë, si dhe të respektohet autonomia e plotë e universitetit. Kësaj do t'i ndihmonin ndryshimet e domosdoshme në Ligjin e arsimit të lartë dhe në Statutin e Universitetit të Prishtinës.

4. Organet kompetente, duke përfshirë edhe Prokurorinë, të kërkojnë përgjegjësi dhe t'i vënë para drejtësisë pjesëmarrësit në veprimet e kundërligjshme në Universitetin e Prishtinës.

5. Të respektohet Statuti i Universitetit të Prishtinës për zgjedhjen dhe gradimin e stafit akademik dhe të revokohen zgjedhjet dhe gradimet e pamërituara dhe në kundërshtim me procedurat ligjore. Ata që duan ta dëgjojnë rekomandimin e pestë, ky është ai rekomandim që po kërkohet, edhe u tha këtu në formë pak më ndryshe - nëse ju konvenon rekomandimi i pestë, ishte shumë i qartë.

6. Komisioni i emëruar nga Senati për shqyrtimin e revistave në të cilat ka publikuar stafi akademik i Universitetit të Prishtinës, ta informojë në baza të rregullta Komisionin Parlamentar për Arsim, që bukur gjatë është ky komision.

7. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, së bashku me Universitetin e Prishtinës, t'i përcaktojnë politikat e regjistrimit në përputhje me kapacitetet akademike, fizike dhe financiare të UP-së, dhe të harmonizuara me kërkesat e tregut të punës, dhe

8. Të mos mërkëmben profesorët dhe shkencorët që janë pjesë e Universitetit të Prishtinës, të cilët kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë punë të mirëfilltë akademike shkencore. Të gjitha aktorët e përfshirë në këtë proces duhet të angazhohen ta ruajnë kredibilitetin dhe integritetin e mësimdhënësve në UP.

Zoti kryetar, unë ju lus që këto rekomandime tona t'i hidhni në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, deputeti Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit kryetar!

Unë i kisha kërkuar 5 minuta pauzë, në mënyrë që të provojmë t'i harmonizojmë qëndrimet, përndryshe ynë Grupi Parlamentar do ta lëshojë seancën. Realisht, gjatë tërës kohës është tentuar dhe po tentohet që të politizohet kjo çështje. Politizohet skajshmërisht në aspektin negativ. Çështja tjetër është se po tentohet të merren kompetencat e Senatit të Universitetit të Prishtinës. Nuk mund t'i marrë dikush kompetencat e Senatit, siç nuk mund t'i marr askush kompetencat e këtij Parlamenti. Realisht, ai është kompetent për të marrë vendime dhe unë kërkoj, në emër të Grupit Parlamentar 15 minuta pauzë dhe të provojmë t'i harmonizojmë ato çështje.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e propozon akademik Arsim Bajramin që të marrë pjesë në këto harmonizime, përndryshe ne e lëshojmë seancën. Faleminderit!

KRYETARI: Ju grupet tjera, a jeni për 15 minuta pauzë për t'i harmonizuar, apo jo? Visar!

VISAR YMERI: Kryetar!

Ne konsiderojmë që nga ajo që u dëgjua këtu, pra edhe nga deputetët e PDK-së në këtë rast, nuk po them të koalicionit qeverisës, që harmonizim këtu nuk ka. Nuk mund të ketë, në fakt, sepse çka po kërkohet nga këta është që të vazhdojë kjo gjendje, e çka po kërkohet nga ne është që të ndërmerren masat urgjente, në mënyrë që të përfundojë kjo gjendje. Dhe, nuk mund tash të arrijmë konsensus ndërmjet një shkeljeje flagrante në universitet dhe kërkesës këtu pastaj për t'u pajtua për këtë.

Kështu që ne konsiderojmë që pauza është e panevojshme dhe propozojmë që të hidhen në votim tash këto rekomandime që i lexoi kryetari i Grupit të LDK-së, në mënyrë që deputetët të deklarohen për ose kundër me votën e tyre, varësisht siç e kanë qëndrimin karshi tyre.

KRYETARI: Daut Haradinaj e ka fjalën!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

E kam kërkuar fjalën dy-tri herë gjatë ditës, por kryesuesi i seancës nuk ma dha të drejtën. Ne jemi të gatshëm të votojmë për propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Si zakonisht, PDK-së i urojmë dalje të qetë, domethënë nuk ka nevojë për shqetësim, por jemi për shkarkimin e rektorit sa më urgjentisht që është e mundur, si edhe të Bordit.

Faleminderit po ashtu nënkryetar që nuk ma dhe fjalën kur foli kryeministri gjatë ditës.

KRYETARI: Ndoshta më mirë! Koalicioni për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne jemi që këto rekomandime të harmonizohen, përndryshe e lëshojmë seancën.

KRYETARI: Lidhja Demokratike, Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Është shumë e qartë që nuk ka gatishmëri për harmonizim, sepse qëndrimet ishin shumë të qarta dhe ne e thamë - i lexuam rekomandimet tona, këta asnjë rekomandim nuk e kanë sjellë. E kanë pasur materialin dhe kanë pasur mundësi ta bëjnë këtë, por po shihet serioziteti në këtë punë. Ne..., Urdhëro!

(Reagime nga salla)

...zoti kryetar, unë i lexova rekomandimet.

KRYETARI: Mirë! Do të thotë, shumica e grupeve janë për votim. Ne i votojmë. Ju lutem! Numri i deputetëve të pranishëm? Do të thotë, me Hyden 51 deputetë jemi, që do të thotë nuk kemi kuorum.

Vazhdojmë nesër në orën 10:00.

* * *

E premte, 7 shkurt

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 6 shkurt

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E vazhdojmë seancën e filluar dje. Nuk kemi kuorum për votim, prandaj vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ministrin nuk e kemi këtu.

Të nderuar deputetë!

Të gjitha pikat në vazhdim janë ligje që kërkojnë prezantim nga ministrat e Kabinetit qeveritar. E kemi këtu vetëm një ministër, të tjerët nuk janë. Megjithatë, nëse jeni dakord edhe ju që jeni këtu, meqë s'mund të votojmë, e bëjmë dhe një pauzë prej 30 minutash dhe kërkojmë nëpërmjet Administratës të vihet kontakti me Qeverinë që të vijnë ministrat t'i prezantojnë ligjet. Pra, një pauzë prej 30 minutash.

(Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.)

KRYETARI: Kartela janë 67, por prania fizike sa është? 56. Kurse 69 është prania elektronike!

Do të thotë, i kemi 56 deputetë në sallë. Nuk e kemi kuorumin për ta filluar punën. Dëgjoni mirë, se është vit elektorale dhe do të kemi kërkesa për debat: ata që kërkojnë debate, le t'i përgatitin mirë rekomandimet para se të fillojë debati, se debati duhet të zhvillohet mbi rekomandime. Kushdo prej cilitdo grup që ka amendamente në rekomandimet që i dorëzojnë grupet parlamentare për debat vijnë para seancës. Seanca nuk mund, siç i kemi tani dy praktika, kanë dalë krejt rekomandime tjera nga propozuesi dhe nga koalicioni qeverisës.

Kjo formë e rekomandimeve dhe e amendamentimeve nuk ndodh në asnjë Kuvend të botës, siç ne po e bëjmë. Është mirë, edhe nëse nuk e kemi në Rregullore, ta shikojmë si është praktika parlamentare. Praktika parlamentare është që fillimisht dorëzohen rekomandimet, grupet parlamentare i japin të vetat dhe pastaj votohen ato, e jo kështu siç është vepruar dhe siç po veprohet në Kuvendin tonë.

Tash dikush mund të thotë “po, s’e kemi praktikuar”. Ta nisim ta praktikojmë ajo që është më e mira.

Megjithatë, nuk e kemi kuorumin. Sa veta janë? 65. Mirë!

Atëherë, unë kërkoj, pasi edhe opozita i ka bërë rekomandimet e veta, disa rekomandime i kish edhe pozita, le t’i harmonizojnë nëse munden, dhe pastaj të merremi me votimin e tyre.

Realisht, për të qenë si duhet, për të shkuar sipas rregullit, të dyja palët rekomandimet e reja që i kanë duhet t’i dërgojnë në Zyrën për Parashtresa dhe ajo t’ua shpërndajë deputetëve. Kjo do të ishte rregulla dhe procedura zyrtare e dorëzimit të një dokumenti.

Ministrat përsëri s’i kemi këtu. Nëse jeni dakord, e kemi një çështje që mendoj që duhet ta kryejmë, se vonesa çon në atë që ndoshta shumëkush s’e dëshiron nga opozita. Nëse vonohemi 30 ditë, me ligj është, për të mos me e dërguar, pikën e 10-të e kemi më duket: *Zgjedhja e Organit të Pavarur Përzgjedhës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit*.

Unë po ju përkujtoj që ligji thotë “brenda 30 ditësh, nëse nuk kryhet kjo, ata konsiderohen të zgjedhur”. Prandaj, konsideroj që zgjedhja e këtij organi sot është e domosdoshme.

Dhe, nëse jeni dakord, unë po lexoj atë që është imja. A jeni që ta votojmë këtë pikë të rendit dhjetë. Urdhëro! Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Nuk ka asnjë arsye që të mos procedojmë edhe me votimin e rekomandimeve që i kishim në seancën e kaluar. Ne me shkrim, por tash është nga PDK-ja, është shefi i tyre. Ky le të thotë, na i kanë dhënë me shkrim rekomandimet e tyre. Nëse dëshirojnë, kemi kuorum, t’i harmonizojmë dhe ta vazhdojmë punën.

Nuk jemi ne që të shkojmë të votojmë diçka, pavarësisht prej urgjencës, pa e kryer një pikë që kemi mbetur pa e përfunduar, zoti kryetar.

Dje është kërkuar të harmonizohet teksti i rekomandimeve, sot nuk po kërkojnë. Tash, unë po ju drejtohem, kërkojeni pra harmonizimin, propozoni çfarë keni për të propozuar dhe ne i kemi propozimet tona.

Nëse gjejmë gjuhë të përbashkët për t'i harmonizuar, i harmonizojmë për 10 minuta, nëse s'gjejmë, zoti kryetar, është praktikë, i hidhni në votim rekomandimet e harmonizuara apo të paharmonizuara. Në këtë rast, nëse s'ka harmonizim, i hidhni një nga një për ato që mendohet. Le ta japë votën secili.

Prandaj, dje është kërkuar kësisoj, ka qenë arsyetimi që s'po duan t'i harmonizojnë. Ne jemi të gatshëm, le të propozojnë çka të duan, ne i kemi rekomandimet tona dhe t'i votojmë. Pastaj, shkojmë edhe në pikën që po e thoni ju. Faleminderit!

KRYETARI: Unë ua jap fjalën grupeve parlamentare, kryetarëve i grupeve parlamentare. Por, edhe një herë po them, realisht, mënyra se si ne kemi punuar me këto rezoluta, që aty për aty kanë dalë, mendoj që këtë, edhe ju duhet ta kërkon, duhet ta kërkojmë të gjithë që të ndërpritet dhe ta ndjekim rrugën për të nxjerrë dokumente që e kanë fuqinë për t'u realizuar pastaj, jo vetëm sa për të kapërcyer nëpër to.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka kryetari i Grupit, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë së pari dua ta përshëndes reflektimin pozitiv të shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së. Grupi Parlamentar edhe dje ka kërkuar që ne t'i harmonizojmë qëndrimet tona, përkatësisht rekomandimet duhet ta reflektojnë debatin në Parlament. Deputetët nuk kanë qenë unikë në qëndrime dhe në propozimet që i kanë dhënë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së absolutisht edhe dje është deklaruar, po deklaroj edhe sot në emër të grupit, dhe lirisht edhe në emër të koalicionit, se jemi për të bërë verifikimin dhe për t'i shkuar kësaj çështjeje deri në fund.

Por, jemi kundër masave të dhunshme në Universitetin e Kosovës. Absolutisht! Prandaj, ne i kemi propozuar me shkrim disa rekomandime.

Në anën tjetër, unë pajtohem plotësisht me atë që po kërkon ju, se në rastin kur ndryshojnë rekomandimet, janë tetë ditë afat që ne na ka ndodhur kur kemi propozuar diçka është kërkuar dhe ne e kemi respektuar afatin tetëditor që t'i marrin deputetët, t'u shpërndahen dhe pastaj ato të dalin në votim.

Prandaj, unë kërkoj që rekomandimet tona të jenë në përputhje me ligjin, në përputhje me ruajtjen e pavarësisë së Universitetit të Kosovës, që të gjithë jemi për të. Prandaj, të harmonizohen dhe të dalin qëndrimet tona të përbashkëta. Për këtë ne kemi qenë, jemi dakord.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka, në emër të Grupit të "Vetëvendosjes", kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Konsideroj që ky diskutimi për atë se a duhet t'i përfillim apo jo procedurat, më së pari s'është diskutim që duhet bërë në Kuvend. Natyrisht, që Kuvendi duhet t'i përfillë përherë procedurat. Mirëpo, këtu kemi shumë precedentë dhe shumë një historik të diskutueshëm, sa i përket kësaj çështjeje, po flas për këtë legjislaturë, meqenëse e kam përvojën në këtë legjislaturë. Nuk di për të tjerat.

Ne kemi pasur jo vetëm rekomandime të debateve, të cilat e kanë pësuar njëlloj transformimi, por kemi pasur madje edhe amendamente të ligjeve, të cilat kanë dalë aty për aty në seancë dhe janë votuar pastaj, gjë që është praktikë hala, mendoj unë, më e rrezikshme dhe më e komplikuar se sa kjo.

Natyrisht që secili grup parlamentar, kur e bën një kërkesë për debat, e paraqet njëlloj propozimi të rekomandimeve, të cilën pastaj ka gatishmëri ta modifikojë sipas kërkesave të grupeve të tjera, pra për ta marrë një votë sa më të gjerë në Kuvend.

Të insistojmë tash se do të kemi unanimitet të 100%-të për këtë çështje, mendoj që është iluzore, sepse s'do ta kemi kurrë. Prandaj, unë konsideroj që nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, ose i koalicionit qeverisës, siç iu referua zoti Grabovci, ende nuk kemi dëgjuar se cilat janë rekomandimet që këta po duan t'i harmonizojnë. Pra, çka po harmonizojmë?

Rekomandimet e harmonizuara tashmë ndërmjet tri grupeve parlamentare janë publike. T'i dëgjojmë edhe këto të tjerat dhe pastaj po e bëjmë një pauzë 5, 10, 15 minuta, sado të jetë nevoja, po e bëjmë një tentim të ri të harmonizimit, nëse ka çka të harmonizohet, dhe pastaj po vijmë në seancë, të harmonizuar apo të paharmonizuara, po i votojmë ato rekomandime, të cilat janë për t'u votuar.

Dhe, pastaj natyrisht deputetët le të vendosin se në cilën anë duan të votojnë, për shkak se kjo shtyrje e vazhdueshme e këtyre rekomandimeve dhe këtij debati mendoj që vetëm sa e prodhon edhe një vështirësi të re në Universitetin e Prishtinës, i cili po pajtohem të gjithë se nuk është as për së afërmi në gjendjen normale.

Dhe, në këtë drejtim, konsideroj që është detyrë e këtij Kuvendi që sot ta zgjidhë këtë çështje ashtu siç mendon Kuvendi, e Kuvendi mund të votojë për ose kundër, dhe pastaj të vazhdojmë me pikat tjera, të cilat, po pajtohem me ju, që janë të rëndësishme e që ishte dashur të kryhen sot.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi i Aleancës mendon se situata është goxha e qartë sa u përket rekomandimeve të para, ose rekomandimeve të harmonizuara ndërmjet tri grupeve parlamentare opozitare. Ato kanë ndodhur dje dhe në fund të seancës nuk kemi pasur kuorum që t'i votojmë ato rekomandime dhe sot tashmë po paralajmërohet për shkak se ekzistimi i rekomandimeve të tjera prej koalicionit qeverisës, për shkak se ato rekomandime nuk i kemi parë dhe nuk i kemi lexuar.

Deputetët nuk i kanë ato rekomandime. Është e rrugës, besoj, që këto rekomandime të lexohen, së pari që deputetët t'i dinë, e pastaj të kërkohet 10-15 minuta pauzë, për të tentuar që t'i harmonizojmë ndërmjet dy grupeve të rekomandimeve ose dy drafteve të rekomandimeve.

Përndryshe, besoj që duhet të kthehemi e të votojmë, edhe nëse nuk janë të harmonizuara dhe nuk besoj se do të duhej që ne tashmë të kalojmë në pika tjera të rendit të ditës, pa e kaluar një temë, e cila është vërtet me rëndësi dhe në të cilën kanë mbetur vetëm për t'u votuar rekomandimet.

Tërë ditën dje kemi pasur debat për këtë. Është tepër e kuptueshme që duhet të kalojmë në votim, sepse kjo është me rëndësi. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne jemi për zgjidhjen e problemit të krijuar në Universitetin e Prishtinës. Përndryshe, kërkojmë harmonizimin e rekomandimeve.

KRYETARI: Nuk kemi më të lajmëruar për fjalë. Adem, a po i lexoni rekomandimet e juaja? Fjalën e ka Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Kryetar,

Unë jam i gatshëm t'i lexoj rekomandimet, po unë thashë se rekomandimet duhet ta reflektojnë debatin, jo qëndrimet e Grupit Parlamentar të PDK-së, as të grupeve tjera të veçanta, por këtu të harmonizohen dhe pastaj nëse arrijmë që këtu të dalim me një qëndrim unik, të lexohen ato të cilat janë të përbashkëta. Jo, të dalim me qëndrime, ne tonat, ata të vetat, por t'i harmonizojmë paraprakisht, pastaj vazhdojmë më tutje.

KRYETARI: A po dilni për t'i harmonizuar, Ismet? Ti e Ademi merreni vesh kollaj. Urdhëro, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Mua po më vjen mirë që po kujton se është ashtu, por ne këtë punë bashkë s'e kemi nisur me Ademin, shefin e grupit. Ju e thatë shumë mirë, dje zëri i fuqishëm i tyre ka qenë që ne i kemi rekomandimet, t'i harmonizojmë. Ju kërkuat t'i lexoj, nuk i lexoi. Nëse deputetët pajtohen, ne jemi tri grupet parlamentare, normalisht të opozitës, edhe krejt dalim. Nuk është problem, pa jua lexua hiq, nëse harmonizojmë - çka harmonizojmë? Ne pas 10-15 minutave vijmë ju tregojmë.

Edhe unë, zoti kryetar, pastaj, të mos e përsëris, po më vjen keq ta them edhe një herë, është shumë e qartë, janë shumë ligjore dhe të gjitha procedurat janë respektuar. I hedh në votim të harmonizuarat dhe tekstin tjetër që nuk mund ta harmonizojmë, që e kemi bërë ne, sepse rekomandimet tona janë lexuar edhe në fund të debatit dhe nuk janë rekomandime të punuara në shtëpi, por si rezultat i debatit të organizuar dje.

Kështu që ne e kemi gatishmërinë që, përkundër faktit që nuk u lexuan, ne dalim, harmonizojmë çka të mundemi, çka s'mundemi - ne e kemi tekstin. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Urdhëroni, dilni nga 10-15 minuta dhe kthehuni ju kryetarët e grupeve. Ne të tjerët vazhdojmë.

Regjia, bjeri le të kthehen deputetë në sallë, përveç grupeve që kanë për t'i harmonizuar rekomandimet. Të tjerët të kthehen për t'i votuar disa çështje që janë të nevojshme t'i votojmë.

Sa e kemi tani praninë në sallë?

(Ndërprerje nga regjia)

Në sallë i kemi 65 deputetë. Nëse jeni dakord, votojmë për:

10. Zgjedhja e Organit të Pavarur Përzgjedhës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarët e Organit Shqyrtues të Prokurimit

Qeveria e Republikës së Kosovës, mbështetur në dispozitat e Ligjit për prokurimin publik, Kuvendit ia ka parashtruar propozim-vendimin për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që t'i propozojë anëtarët e Organit të Pavarur Përzgjedhës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës i ka propozuar Kuvendit tre gjykatës për anëtarë të Organit të Pavarur Përzgjedhës.

Të pranishëm e kemi numrin adekuat. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 53 vota për, 2 kundër dhe 8 abstenime, Kuvendi i emëroi anëtarët e Organit të Pavarur Përzgjedhës për zgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, në këtë përbërje:

- Valdete Daka, nga Gjykata Supreme e Kosovës,
- Asllan Krasniqi, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe
- Nebojsa Boriçi, nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Kërkohet nga anëtarët e Organit të Pavarur Përzgjedhës, mbështetur në nenin 100, pika 4, të Ligjit për prokurimin publik ta shqyrtojnë propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesve dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e njëmbëdhjetë:

11. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare u është shpërndarë deputetëve.

Kërkoj nga ju që me ngritje dore të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike. Kush është për? Kundër nuk ka.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

12. Propozimi i Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Propozimi i Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare u është shpërndarë deputetëve.

Kërkoj nga ju që me ngritje dore ta miratojmë këtë kërkesë. Faleminderit! Kundër nuk ka.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Kërkoj që Administrata ta përgatisë votimin për pikën e nëntë të rendit të ditës.

Fjalën e ka kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Edhe opinionimi i gjerë po e sheh që nuk ka gatishmëri. Ju po e shihni sa deputetë të partive në koalicion janë në sallë.

Sa i përket harmonizimit, me aq pompozitet dhe fjalë të mëdha dje që u thanë, po shihet se kjo s'është e vërtetë fare.

Ne u takuam, zoti kryetar, u munduam t'i harmonizojmë dhe si grupe parlamentare të tri subjekteve politike ishim dakord që të futen së paku 2 pika që i kanë rekomanduar këta partnerët e koalicionit qeveritar, mirëpo tash po e them hapur - nuk jemi pajtuar për pikën e parë dhe këmbëngulësia që pika e parë të hiqet, që e dini të gjithë dhe po ua përsëris, është: Rektori dhe Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës e kanë humbur kredibilitetin për të udhëhequr me Universitetin e Prishtinës. Rektori i Universitetit "Hasan Prishtina" zoti Ibrahim Gashi dhe anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të japin dorëheqje dhe t'i shërbejnë procesit të normalizimit në Universitetin të Prishtinës, është rekomandim i cili ka dalë edhe nga debati dhe ne nuk pranojmë normalisht për ta larguar.

E çka thonë të tjerët, le ta thonë vetë, sepse zoti Vataj, në mos gabohem, foli në emër të grupit, përkatësisht i paraqiti qëndrimet e grupit të tyre parlamentar, prandaj zoti kryetar

unë propozoj, se si do të veprojnë këta është punë e tyre, që t'i votojmë rekomandimet që i kemi këtu. Unë ju tregoj se cilat pika janë të harmonizuara, ndërkaq qëndrimet e Grupit Parlamentar të PDK-së i thotë ai që është kompetent.

Nëse jeni dakord, unë do ta kisha lexuar për çfarë jemi marrë vesh, e pastaj qëndrimin e tyre, apo po e dëgjoni qëndrimin e Partisë Demokratike?

A bën t'i lexoj?

KRYETARI: A e keni bërë tekstin përfundimtar që të na e sillni?

ISMET BEQIRI: Po! E kam tekstin, po e lexoj, pastaj e punojmë.

KRYETARI: Mirë, u bë! Urdhëro, lexoje!

ISMET BEQIRI: Do të thotë, i paharmonizuar dhe qëndrimi ynë është për pikën e parë, i tri grupeve parlamentare, LDK, "Vetëvendosje" dhe AAK, që e lexova.

Pika e dytë, është: Të vlerësohet përgjegjësia e ministrit dhe Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë për mospërcjelljen me kohë të zhvillimeve në Universitetin e Prishtinës dhe mosmarrjen e masave ligjore në kohë të duhur.

Në vend të pikës 3, duke aluduar që shumë po ngatërrohet, e 's'ka politika gisht e Qeveria', ne jemi dakorduar atëherë që kjo pikë të hiqet, pa kurrfarë problemi për ne të hiqet. Dhe kemi vazhduar më tej.

Te pika e katërt, është: Organet kompetente, duke përfshirë edhe Prokurorinë, të kërkojnë përgjegjësi dhe t'i vënë para drejtësisë pjesëmarrësit për veprimet e kundërligjshme në Universitetin e Prishtinës.

Dhe, pastaj është pesë: Të respektohet Statuti i Universitetit të Prishtinës për zgjedhjen dhe gradimin e stafit akademik dhe të revokohen zgjedhjet dhe gradimet e pamërituara dhe në kundërshtim me procedurat ligjore.

Dhe tash, pikën gjashtë e kemi futur si propozim të tyre, dhe është kështu: Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrë hapa konkretë dhe sa më parë t'i procedojë plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit për arsimin e lartë në kontekstin e krijimit të një baze ligjore të qëndrueshme për depolitizimin e Universitetit të Prishtinës.

Në një mënyrë, kjo ka qenë edhe te ne, por jemi dakorduar dhe OK. Këtë formulim të tyre ta futim në këto rekomandime.

Pastaj është po ashtu një kërkesë që ishte edhe dje, e që s'e kemi kundërshtuar, dhe është ajo që përsëri do ta futim në rekomandim, njëra që ka qenë më herët, e që është: Komisioni i emëruar nga Senati për shqyrtimin e revistave në të cilat ka publikuar stafi akademik i UP-së ta informojë në baza të rregullta Komisionin Parlamentar për Arsim.

Dhe, e kemi një pikë, një rekomandim, që e ka propozuar grupi nga koalicioni qeverisës: Kërkohej nga komisioni i krijuar nga Senati, sipas fushave përkatëse që kanë për qëllim hetimin e të gjithë titujve në kontekstin e respektimit të procedurave ligjore për të gjithë bartësit e funksioneve në Universitetin e Prishtinës që nga viti 1990.

Bile, ne e kishim idenë se bën edhe prej themelimit të universitetit. Asnjë problem s'është. Po, në fund u dakorduar që të jetë prej vitit 1990.

Këto janë dy pikat që u pajtuam të futen rishtas nga ato që i propozuan partnerët e koalicionit qeverisës. Dhe, pikat tjera mbeten të njëjta.

MASHT-i, së bashku me UP-në t'i përcaktojnë politikat e regjistrimit në përputhje me kapacitetet akademike, fizike dhe financiare të UP-së dhe të harmonizuara me kërkesat e tregut të punës; të mos nëpërkëmben profesorët dhe shkencëtarët që janë pjesë e Universitetit të Prishtinës, të cilët kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë punë akademike të mirëfilltë shkencore; të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces duhet të angazhohen ta ruajnë kredibilitetin dhe integritetin e mësimdhënësve në Universitetin e Prishtinës.

Prandaj, kolegë të nderuar, po e shihni, të gjitha këto pika janë të harmonizuara dhe ishte një pajtim, përpos pikës së parë, dhe, zoti kryetar, unë mendoj, nëse ka kuorum, janë të gjitha kushtet që këto rekomandime të hidhen në votim dhe qëndrimi ynë është - do të dëshironim sot të ndodhë nëse ka kuorum, por edhe kurdo që të vazhdojë seanca, ne këto qëndrime i kemi dhe ky është qëndrimi i tri grupeve parlamentare - Lidhjes Demokratike të Kosovës, "Vetëvendosjes" dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Sigurisht se edhe do t'i bëjmë me shkrim, nëse sot s'ka kuorum dhe do t'i keni ashtu siç e kërkuat edhe ju në Administratë. Faleminderit!

KRYETARI: Një problem gjithsesi e kemi, se nuk i kemi përpara rekomandimet. Fjalën e ka kërkuar, në emër të Partisë Demokratike, kryetari i Komisionit për Arsim, Ramë Vataj.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne, si të themi, i kemi rekomandimet që janë në njëfarë mënyre të njëjtat me grupet tjera parlamentare të opozitës, përveç pikës së parë. Dhe, të ju them të drejtën, më mirë janë të formuluarat tonat se tuajat. Kështu që, edhe ato që i keni thënë...

(Ndërhyrje)

Jo, unë po e shoh, edhe bukurshkrimi mungon, se le më formulimi. Kështu që, ne e kemi arsyen...

(Ndërhyrje)

Po, mirë de! As radhitja nuk është bërë mirë, kështu që mos...

Le të dalim te thelbi: Ne mendojmë që pika e parë është e papranueshme, sepse kjo është cenim i lirisë akademike që mbrohet me ligj, cenim për të kërkuar shkarkim të një...

(Ndërhyrje)

Ajo është në njëfarë mënyre. Ti kur rekomandon të japë dorëheqje, dorëheqja është morale.

(Ndërhyrje)

Atëherë, deri te dorëheqja vjen kur bëhet ekzaminimi i fakteve dhe këtë e vlerëson komisioni, atëherë shkarkohet. Por, me Statut të universitetit, neni 31, janë të rregulluara se si përfundon mandati i menaxhmentit apo i rektorit para kohe. Dhe, nëse kjo vlerësohet, domethënë nëse kjo vlerësohet nga komisioni kompetent që është themeluar nga Senati, atëherë është Senati dhe Këshilli Drejtues që e bëjnë këtë punë, e jo ne të kërkojmë. Pra, nëse zbatohen të gjitha këto pika që ne i kemi dhënë.

Po, ju jeni më në thelb. Problemet në Universitet janë mbledhur që moti dhe nëse kërkojmë të verifikohen të gjitha diplomat dhe avancimet prej vitit '90, kjo e zgjedh edhe problemin, e drejton punën. Nuk po flasim për emër apo menaxhmentin e tanishëm, apo ministrin e tanishëm. Unë do t'jua lexoj të gjitha rekomandimet dhe opinionin le të vlerësojnë, se ju nuk bindeni, që janë të formuluar bukur dhe qartë, përveç pikës së parë, që ne mendojmë se e cenon autonominë akademike të universitetit, që është e garantuar me ligj. Të tjerat janë të gjitha të njëjta. Kur thonë 'të heq dorë Qeveria nga kontrolli politik', me çfarë instrumenti e matni që paska kontroll. Kur të zbatohet ligji, që ne do të merremi vesh, atëherë mund të them që është hequr kontrolli.

(Ndërhyrje)

Rekomandimet e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike janë këto:

- Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon zgjidhjen e shpejtë dhe urgjente të gjendjes së krijuar në Universitetin e Prishtinës,
- Kuvendi i Republikës së Kosovës kundërshton fuqishëm politizimin dhe keqpërdorimin për efekte elektorale të pakënaqësive të krijuara në kohë të fundit në Universitetin e Prishtinës,
- Kuvendi i Kosovës përkrah autonominë e plotë akademike të Universitetit të Prishtinës dhe përfshirjen e Kosovës në procesin e Bolonjës, zonën evropiane të arsimit të lartë,
- Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrë hapa konkretë dhe sa më parë të procedojë plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për arsimin e lartë, në kontestin e krijimit të një baze ligjore të qëndrueshme për depolitizimin e Universitetit të Prishtinës,

- Të iniciohen ndryshmet e Statutit në universitetit dhe në kornizën përcjellëse janë të nevojshme. Këto ndryshime të mundësojnë zgjedhjen e rektorit, prorektorëve dhe bartësve të funksioneve nëpër fakultete ekskluzivisht nga stafi akademik dhe ridefinimi i rolit të Këshillit Drejtues dhe Senatit të Universitetit të Prishtinës,
- Mbështetet krijimi i komisioneve nga Senati që kanë për qëllim hetimin e të gjithë titujve në kontestin e respektimit të procedurave ligjore për të gjithë bartësit e funksioneve në Universitetin e Prishtinës që nga viti 1990,
- Mbështetet puna e komisioneve të krijuara për vlerësimin e kualitetit të punimeve dhe revistave që janë pjesë e debatit të fundit për gjendjen në Universitetin e Prishtinës. Këto janë zgjidhje afatgjate, nuk po flasim për emra.
- Qeveria dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të monitorojnë cilësinë e studimeve në Universitetin Publik dhe kolegjet private dhe të ndërmarrin të gjitha masat ligjore për evitimin e parregullsive.

Le të vlerësojë opinionin. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

E thashë edhe më herët, shihet qartë që në nuk pajtohem për rekomandimin e parë dhe është shumë e qartë, sepse u tha të gjitha rekomandimet tjera, duke i përfshirë edhe dy që i kanë propozuar, i kemi inkorporuar në tekst, dhe të gjitha kushtet janë plotësuar që këto të votohen nëse ka kuorum. Nëse nuk ka kuorum, unë do t'i dorëzoj me shkrim dhe në seancën e radhës unë kërkoj që ato të votohen, dhe nuk mund të vazhdojë seanca, sepse është rregull, me pika tjera, aq më tepër kur nuk e ke asnjë ministër për pikat që i kemi.

Dhe, ne nuk pranojmë të shkelet Rregullorja dhe të kalojmë në diçka tjetër, para se të kryhet ky obligim sipas Rregullores, prandaj ne, nëse nuk ka kuorum, edhe këtë anën tjetër formale, siç u kërkua, me ato të harmonizuarat që unë i lexova, sepse kështu u morëm vesh, dhe jo këto që i lexoj zoti Rama në emër të Grupit, që kështu kanë menduar se i kanë më të mira, i kanë të rregulluara më estetikisht, ma stilistike. Ajo është punë tjetër, por ne u morëm vesh se këta janë Qeveri, i kanë kompjuterët më të rinj sigurisht, por ne u morëm vesh për ato që unë i lexova, me përjashtim të pikës së parë.

Dhe si të tilla, zoti kryetar, unë me shkrim do t'jua dorëzoj juve dhe Administratës. Nëse sot nuk ka kuorum për t'i votuar dhe për ne sigurisht nuk ka asnjë kusht që të vazhdojë seanca me pikat tjera trendit të ditës dhe si e tillë, nuk mund të jemi pjesë e seancës. Faleminderit!

KRYETARI: I kemi 61 deputetë. A jeni dakord që të shkojmë në votim? Urdhëro! Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Siç po shihet, për pikën e parë nuk janë marrë vesh, mirëpo edhe për pikat tjera ka mosmarrëveshje sa jam kah e shoh, sepse diçka tjetër lexoi zoti Beqiri, diçka tjetër zoti Rama.

Sidoqoftë, ne deputetët nuk i kemi këto rekomandime në formë të shkruar. Vetëm po na lexohen dhe u përzien në të njëjtën kohë këto rekomandimet tjera, prandaj propozoj që në formë të shkruar t'i kemi të gjithë rekomandimet të përputhura dhe për seancën e radhës të hidhen në votim.

KRYETARI: Mirë! Unë kërkoj që rekomandimet t'i dërgohen Zyrës për Parashtrës, ajo pastaj t'ua shpërndajë deputetëve dhe në seancën e ardhshme t'i votojmë.

Tani i kemi 59 deputetë. Pikat e radhës janë ligje në lexim në lexim të parë dhe pa praninë e Qeverisë, ne nuk mund të shkojmë. Qeveria mungon dhe ne e mbyllim seancën. Për vazhdimin e seancës, Kryesia me shefat e grupeve parlamentare vendos të hënën.

Mirupafshim!

* * *

E martë, 11 shkurt

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 6 dhe 7 shkurt

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ministra,

Vazhdojmë me punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, filluar më 6 shkurt 2014.

Prani fizike i kemi 76 deputetë. Konstatoj se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës për sot:

Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 6 dhe 7 shkurt 2014, mirëpo në mungesë të kuorumit procedimi me votim është shtyrë për sot.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri, që ta marrë fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do t'i lexoj rekomandimet që kanë dalë pas dy seancave, por që ndërkohë ka pasur zhvillime në universitet dhe rekomandimet tona janë këto:

1. Të vlerësohet përgjegjësia e ministrit dhe e Këshillit Drejtues të UP-së për mospërcjelljen me kohë të zhvillimeve në Universitetin e Prishtinës dhe mosmarrjen e masave ligjore në kohë të duhur;
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrë hapa konkretë dhe sa më parë t'i procedojë plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit për arsimin e lartë dhe të Statutit të Universitetit të Prishtinës për të krijuar një bazë ligjore të qëndrueshme për depolitizimin e UP-së;
3. Organet kompetente duke përfshirë edhe prokurorinë të kërkojnë përgjegjësi dhe t'i venë para drejtësisë pjesëmarrësit në veprimet e kundërligjshme të UP-së;
4. Të respektohet statuti i Universitetit të Prishtinës për zgjedhjen dhe gradimin e stafit akademik dhe të revokohen zgjedhjet dhe gradimet e pamerituara në kundërshtim me procedurat ligjore;
5. Kërkon nga komisioni i krijuar nga Senati, që sipas fushave përkatëse të bëjë hetimin, përkatësisht verifikimin e të gjithë titujve në kontekstin e respektimit të procedurave ligjore për të gjithë bartësit e funksioneve në Universitetin e Prishtinës që nga viti 1990;
6. Komisioni i emëruar nga Senati për shqyrtimin e revistave në të cilat ka publikuar stafi akademik i Universitetit të Prishtinës, të informojë rregullisht Komisionin Parlamentar për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;
7. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, bashkë me Universitetin e Prishtinës t'i respektojnë politikat e regjistrimit në përputhje me kapacitetet akademike, fizike dhe financiare të UP-së të harmonizuara në kërkesat e tregut të punës;
8. Të mos nëpërkëmben profesorët dhe shkencëtarët që janë pjesë e Universitetit të Prishtinës, të cilët kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë punë akademike të mirëfilltë shkencore.

Të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces duhet të angazhohen që të ruajnë kredibilitetin dhe integritetin e mësimdhënësve në UP. Unë i ftoj deputetët t'i votojmë këto rekomandime! Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit të Partisë Demokratike të Kosovës, Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Së pari ne kemi një situatë, e dimë të gjithë se çfarë është në institucionin më të rëndësishëm të dijes, që është krijuar kohët e fundit. Para se ne të kalojmë në votim, unë kisha kërkuar prej ministrit që të na japë një informatë se çka mendon ky, a ka hartuar ndonjë strategji për të dalë nga kjo situatë e krijuar? Dhe, pas dëgjimit të informatës nga ministri, ne këto rekomandime të cilat i lexoi shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, janë të paharmonizuara, të dalin përfaqësuesit e grupeve parlamentare me gjakftohtësinë më të

madhe, me kujdesin më të madh, të bëjnë harmonizimin e rekomandimeve në të mirën e Universitetit të Prishtinës, për të dalë nga kriza në të cilën ka rënë ky institucion dhe pastaj ne si deputetë jemi dakord që të votojmë.

KRYETARI: Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Me të vërtetë nuk po e kuptoj këtë, OK, pjesën e parë edhe le të thotë ministri cila është se si, ligji i përcakton të gjitha, edhe situatat e krijuara do të duhej t'i përcaktojë, se si të dilet nga situata.

Ne herën e kaluar kanë qenë dy shefa të grupeve parlamentare dhe ka qenë zoti Vataj dhe dy rekomandime të PDK-së janë të inkuorporuara në tekst. Dhe, pika e parë është hequr dhe është riformuluar, ashtu siç e lexova dhe ne më nuk kemi çka harmonizojmë, sepse vërtet nuk jam duke i kuptuar këto qëndrime të paarsyeshme.

Hera e parë ka qenë çështja e pikës së parë, s'jemi harmonizuar se s'ka pasur pëlqim, tash ajo pikë nuk ekziston dhe më për Grupin Parlamentar të LDK-së nuk kemi çka harmonizojmë. Dhe, unë ju lus, mbas gjitha atyre ju i hidhni në votim këto rekomandime, po e them të harmonizuara, nuk është kjo punë inatesh, nuk jam kah e kuptoj këtë punë, sepse e kemi sqaruar dhe zoti Vataj ka qenë dhe dy pikë janë të rekomandimeve të tyre janë futur dhe e gjithë problematika ka qenë te pika e parë, ndërkohë ka pasur zhvillime. Janë edhe dy kolegët e mi këtu, zoti Ymeri dhe zoti Ramadani që mund ta konfirmojnë është apo s'është kështu siç po e them unë. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Grabovci, shkurt!

ADEM GRABOVCI: Kryetar!

Edhe unë po u bëj thirrje juve dhe të gjithëve, ne ditën e premte e kemi pasur një dokument tjetër. Prej ditës së premte kur s'kemi mundur t'i votojmë këto rekomandime dhe deri më sot në Universitetin e Prishtinës kanë ndodhur ndryshime, prandaj e bëjnë të domosdoshme, vetvetiu na diktojnë rrethanat e reja, realiteti i ri i krijuar në këtë institucion, që ne të ulemi me gjakftohtësinë më të madhe, me dashamirësinë më të madhe për këtë institucion, që të bisedojnë së bashku, t'i harmonizojnë qëndrimet në të mirën e këtij institucioni.

Nuk kam unë kurrfarë inati me askënd, por unë po kërkoj me mirëkuptim, në të mirën e universitetit të ulemi, të mendojmë dhe të bimë një qëndrim të përbashkët dhe të ndihmojmë daljen nga kjo situatë kaotike në të cilën gjendet sot Universiteti i Prishtinës, fatkeqësisht.

KRYETARI: Po ju tregoj deputetëve, debati është kryer. Unë vetëm edhe kryetarëve të grupeve që lajmërohen, se të tjerëve s'ua jap fjalën. Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të "Vetëvendosjes", Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Konsideroj që duhet t'u lejohet grupeve parlamentare të shprehen në këtë debat, përkundër faktit që ka njëlloj harmonizimi të rekomandimeve që i kemi përpara.

Së pari duhet ta them që është shumë e qartë dhe mendoj shumë e mirë që studentët e organizuar në protestat e tyre e detyruan rektorin që të japë dorëheqje dhe kjo dorëheqje pastaj u përçoll edhe nga dy prorektorët goxha problematikë dhe nga disa prej anëtarëve të Këshillit Drejtues, gjë që është mirë që ka qenë pjesë e rekomandimit të parë të Kuvendit që nuk u votua atë ditë.

Pra, janë studentët ata që detyruan këtë dorëheqje që i hap rrugë pastaj një procesi të mirëfilltë të pastrimit të universitetit edhe nga mashtruesit edhe nga falsifikatorët, por edhe nga ndikimet e pushtetit në të.

Çështja e dytë është që këto rekomandime që i kemi përpara janë ato të së premtes, përveç pikës së parë e cila gjatë fundjavës e humbi objektin. Pra, humbi objektin sepse edhe rektori dhe një pjesë e konsiderueshme e Këshillit Drejtues, tre anëtarë të Këshillit Drejtues dhanë dorëheqje, që ka qenë rekomandimi apo kërkesa e parë për t'u votuar në Kuvend.

Të tjerat janë ashtu siç kanë qenë dhe këto janë rrjedhojë e debatit që është mbajtur në këtë Kuvend gjatë tërë ditës së enjte. Rrjedhimisht, rekomandimet duhet të vihen në votim dhe pastaj të vendosë secili deputet individualisht, ose secili grup parlamentar, çfarë qëndrimi do të kenë karshi këtyre rekomandimeve.

Konsideroj që këto insistime të Grupit Parlamentar të PDK-së për unanimitet në rekomandime janë të paarsyeshme, sepse natyrisht secili do ta ketë të drejtën pastaj të votojë si të dojë për to. Ne e kemi bërë jo vetëm një, po dy tentime të harmonizimit të këtyre rekomandimeve dhe ato të dyja kanë rezultuar të pasuksesshme. Ç'është e vërteta, në tentimin e dytë, disa prej pikave, dy sosh nga rekomandimet e paraqitura aty për aty të PDK-së janë marrë parasysh dhe janë futur në këtë listë rekomandimesh që e kemi përpara. Dhe, këto janë rekomandime të cilat i ka prodhuar, prapë po e them, debati dhe duhet të hidhen në votim.

Ministri mund ta mbajë një fjalë nëse ka çfarë thotë për strategjinë, por konsiderojmë që Kuvendi duhet të dalë me këtë rekomandim, në mënyrë që ta udhëzojmë ministrinë, përveç tjerash t'i ndërmarrë edhe këta hapa për ta sanuar gjendjen në universitet. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, Burim Ramadani e ka kërkuar fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, ne grupet parlamentare jemi dakorduar ose i kemi harmonizuar këto rekomandime. Normalisht se rekomandimi i parë i cili ka qenë të premtën tashmë gati është përmbushur dhe si i tillë nuk mund të jetë pjesë e rekomandimeve të sotme. Por, ajo që besoj se nuk ka nevojë fare për debat, sepse debati është përfunduar javën e kaluar dhe rekomandimet janë këto. Të gjitha rekomandimet janë të harmonizuara.

Është e vërtetë, të paktën në bindjen time se paska avancim të pozicionit të shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së, i cili sot tha se ka krizë në UP. Dhe realisht, ajo që nëse kanë rekomandime të tjera do të duhej t'ia tregonin edhe Parlamentit po edhe qytetarëve, se cilat janë rekomandimet tjera, sepse këto rekomandime janë të harmonizuara edhe me Grupin Parlamentar të PDK-së.

Prandaj, unë nuk besoj se duhet të vazhdojmë më tutje, por duhet të kalojmë menjëherë në votim, sepse këto rekomandime janë të harmonizuara nga të gjithë. Faleminderit!

(Debat në sallë)

KRYETARI: Nuk ka replikë këtu secili grup e ka mendimin e vet, nuk ka nevojë për replikë. Ministër, urdhëro merre fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Unë sot veç do t'ju informoj për rrjedhat në universitet dhe për pjesën e veprimit strategjik, nëse mund ta quajmë se ma lejon ligji ta bëj, unë do ta ndërmarr gjithsesi dhe ju mund të rekomandoni diçka që mund të ma lehtësoni punën për veprim. Dhe, ju e dini që rektori ka dhënë dorëheqje, siç është vepruar dje edhe me pjesën e katërshe që e çon Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë te Këshilli Drejtues në universitet dhe ka mbetur pjesa e pesëshe që është nga universiteti.

Dhe në fakt ajo pesëshe është pa funksion tanimë, sepse duhet me Statut të universitetit të jenë gjashtë për të marrë vendime dhe për ta bërë hapin që duhet bërë të radhës. Dhe, nëse do të duhej thënë se çfarë ka ndërmend ministri të bëjë, unë do të veproj konform ligjit dhe pikës gjashtë të ligjit dhe kjo pikë më ngarkon që të marr hapat që janë të domosdoshëm për t'i marrë në këto rrethana të jashtëzakonshme.

Dhe, këto rrethana të jashtëzakonshme janë që unë mbase një version që mund t'ua preferoj që të më autorizoni mbase duke më ngarkuar akoma më shumë që të realizojmë duke më dhënë mundësinë ta sugjeroj Senatin, që ta zgjedhë kryesuesin e Senatit si ushtrues detyre dhe pastaj të mbetet brenda Senatit gjithçka, gjersa unë të përcjellë më së largu të premtën ligjin për t'u amendamentuar në Qeveri dhe besoj Qeveria këto ditë, në mos të hënën, do ta përcjellë për Kuvend dhe pas ligjit, që tanimë e kemi gati, duhet të përcjellim statutin e përplotësuar, që e kemi po kështu gati ne si ministri dhe kjo kohë e menaxhimit nga vetë Senati dhe kryesuesi i Senatit, që nënkupton ushtrues detyre të rektorit, do të jetë mundësia që të menaxhojë universitetin, gjersa Kuvend di ta bëjë punën e vet, besoj të përshpejtuar për ta realizuar ligjin dhe statutin më vonë.

Kjo do të ishte mundësia për t'u bërë tash hapat e nevojshëm të kësaj natyre në universitet. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri i merr obligimet e veta, nuk mund sigurisht të dalë përtej ligjit. Ligjin e ka dhe ne kërkojmë ta zbatojë ligjin.

I dëgjuam rekomandimet, janë të harmonizuara mes grupeve parlamentare të opozitës, jo edhe të koalicionit. Debat i ka përfunduar, ju kam treguar më herët.

Të pranishëm janë 91 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 48 deputetë, e përsërisim edhe një herë, 93 kartela janë të vendosura. Edhe një herë shkojmë në votim

Praninë fizike kemi 93 deputetë përgatituri për votim. Ky është votimi i fundit për rekomandimet. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Prej 95 deputetëve prezencë fizike, 53 kanë votuar për, asnjë kundër, 3 abstenime, që do të thotë nuk kalojnë rekomandimet.

(Debat në sallë)

Shiko, ne e kemi vendimin e Gjykatës, i cili ka thënë që nuk kalon, nëse merret ai vendim, nuk kalon.

Merreni vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ai kërkon që të jenë se paku 61 vota që të jetë valid votimi. Nuk është imja, është e Gjykatës.

(Debat në sallë)

Nuk kemi për të votuar me emra. Unë nuk mund t'i detyroj deputetët të votojnë. Dy herë e përsëritëm votimin, nëse doni e përsërisim dhjetë herë, po nëse nuk arrihet numri 61, votimi nuk është valid.

Ne i kemi tri forma të votimit, votimin me ngritje dore, me elektronikë dhe votim të fshehtë. Votim tjetër ne nuk kemi as në Rregullore.

Ku e mbështetni atë që po kërkon, emrat?

(Debat në sallë - ndërprerje incizimi)

Jo, jo, dëgjoni! Ne e dimë që i kemi kaluar ligjet edhe shumëçka tjetër para vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese ka kërkuar, që së paku 61 deputetë të marrin pjesë në votim dhe ata votojnë edhe për edhe kundër edhe abstenojnë. Mirëpo, në këtë rast ne dy herë votuam dhe asnjë rast nuk e patëm numrin 61. Do të thotë, kjo është.

Edhe njëherë, tri herë po e përsërisim.

Po, ne mund ta përdorim edhe atë, po njësoj është. Ai kur s'do me u deklarua, çka... ajo po dihet, votimi është publik.

Edhe njëherë përgatituni, e treta e vërteta! Edhe njëherë lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Prezentë janë 100 deputetë. Përsëri 53 deputetë kanë votuar për, 4 kundër, të tjerët nuk kanë votuar.

Mirë, ne e morëm një shpjegim profesional dhe nëse ka ndonjë rrugëdalje nga shpjegimi profesional, ne e rikthejmë këtë në votim.

Deputetët e rinj që nuk e kanë lexuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese i kisha sugjeruar ta lexojnë, e pastaj le të flasin.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Fadil Ismajli, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të nderuar,

Kolegë ministra,

Duke u bazuar në përfundimin e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, si dhe në bazë të kërkesës së Qeverisë së Kosovës për përfshirje në programin legjislativ, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 4/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik si Ministri sponsorizuese gjatë hartimit të këtij projektligji ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe publike me institucionet përkatëse, sipas procedurave të përcaktuara me Rregulloren e punës së Qeverisë.

Ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e nenit 25, paragrafëve 8, 9 dhe 10 të shtojcës së këtij ligji ku propozojmë që të gjitha lutjet dhe dokumentet përcjellëse të paraqiten në gjuhën shqipe ose serbe, ndërsa përkthimi i tyre në gjuhën angleze bëhet nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ndonëse praktika e pranimit të parashtresave nga Gjykata sipas dispozitës së nenit të lartpërmendur mendohet të jetë diskriminuese, pasi kërkesa të tilla dhe barra e përkthimit në gjuhën angleze u ngarkohet qytetarëve, duhet të shoqërohet nga një përkthim në gjuhën angleze.

Ndikimi i financiar me këto ndryshime do të jetë diku 96 mijë euro, andaj, me miratimin e këtyre ndryshimeve të propozuara qytetarët do të përfitojnë përmirësim të situatës së vendosur nga gjykata, me qëllim që të pengohet praktika e tanishme dhe mënjanimi i çfarëdo pagese për qytetarë për qasje në Gjykatë, si dhe eliminimi i barrës së përkthimit që u ngarkohej qytetarëve.

Në fund, lidhur me çështjet e referuara më lartë, ju paraqes për miratim Projektligjin për ndryshimin e Ligjit 4/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në mbledhjen e mbajtur më 28 janar e ka shqyrtuar në parim këtë projektligj dhe të njëjtin e rekomandon për miratim, në parim.

Dëshiroj të shfrytëzoj rastin dhe praninë e ministrit të them që është e nevojshme që ky ligj dhe ligjit tjetër për AKP-në të trajtohet në Kuvend, pra, të shikohet mundësia të ndryshohen. Për sa u përket këtyre ndryshimeve këto janë krejtësisht teknike mendoj, në ndërkohë që kemi informacione që në Dhomën e Posaçme ka një numër të madh të lëndëve që presin dhe AKP-ja po ashtu ka raportuar te ne se është një ngarkesë e madhe në këtë Dhomë, për trajtimin e lëndëve që duhet të përshpejtohen dhe si rrjedhojë kemi edhe një numër të madh të njerëzve që ankohen, punëtorët për pagesa e tjerë, e tjerë...

Zoti ministër, do të ishte mirë, ne jemi të gatshëm si komision, për ta trajtuar edhe ligjin tjetër, nëse ju e vlerësoni, meqenëse në qershor do të keni situatë të re ku edhe anëtarëve të tjerë të Bordit do t'u skadojë mandati, kishte qenë mirë që sa më shpejt të jetë e mundur, të shikoni mundësinë, propozimin, meqenëse keni qenë edhe më herët sponsorues ju si ministri të plotësimit ndryshimit të këtyre ligjeve në paket, që t'i sillni ato në komision, sa më shpejt që ju t'i sillni, ne do të jemi të gatshëm t'i trajtojmë ato. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Para dy vjetësh në Komision për Zhvillim Ekonomik erdhën tri ligje që kanë të bëjnë me AKP-në. Qysh atëherë LDK pat kundërshtuar shumë nene të këtij ligji, me ç'rast ishte në qendër të kritikës si nga vendorët, po ashtu edhe nga ndërkombëtarët.

Ligji bazik për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme për çështje që kanë të bëjnë me AKP-në ka shumë referenca në rregulloret e UNMIK-ut, si Rregullorja 2002/12, 2005/48 dhe 2003/13. Pesë kolegjet e specializuara kanë nga një gjyqtar ndërkombëtar dhe dy vendorë dhe numri i gjyqtarëve ndërkombëtarë në Kolegjin e Apelit është tre, ndërsa vendorë dy.

Por, tash kur është përfunduar pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës, ky ligj në veçanti, por edhe ligjet tjera do të duhej të pësonin ndryshime që do të reflektonin një situatë të re në terren. Prandaj kur e pamë se në Kuvend është sjell ndryshim- plotësimi i këtij ligji, shpresuam se do të mund të bënim ndryshime substanciale, të nevojshme që këtë ligj t'ia përshtatim nevojave tona si shtet.

Ajo që Qeveria dërgoi në Kuvend, në fakt është vetëm kërkesa për një buxhet shtesë të nevojshëm për përkthime në anglisht. Kjo Dhomë e Veçantë është krijuar për ta forcuar efikasitetin e zgjidhjeve të lëndëve që kanë të bëjnë me AKP-në, pasi gjykatat tona të cilat janë të ngulfatura me numër të madh të lëndëve janë treguar joefikase.

Por, në vend se kjo Dhomë të jetë shumë efikase duke pasur parasysh numrin shumë të vogël të lëndëve, ajo u tregua edhe më joefikase. Numri i lëndëve të zgjidhura është minimal dhe kjo gjykatë në asnjë mënyrë nuk e ka arsyetuar krijimin e vet e as pagat me të cilat paguhen këta gjyqtarë.

Për këtë mosefikasitet kemi diskutuar edhe në Komisionin për Zhvillim Ekonomik dhe si pasojë e kësaj shumë punëtorë kanë mbetur pa e marrë 20%-shin e tyre për shkak pikërisht të këtij mosefikasiteti të kësaj Dhome të Gjykatës. Prandaj do të ishte shumë normale, po që se këtë ligj ta kthenim mbrapsht në Qeveri dhe të kërkonim plotësimin e tij me çështje substanciale e jo vetëm me çështjen e përkthimit në anglisht. Por, për të mos humbur kohë dhe për t'u bërë e mundur që qytetarët të mos shpenzojnë për përkthime në gjuhën angleze, ne si Grup Parlamentar i LDK-së do të votojmë për këtë ligj dhe menjëherë do të kërkojmë sjelljen e ligjit të ri të plotësuar.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme për çështje që kanë të bëjnë me AKP-në, në fakt është një ligj që i ka vetëm tri nene dhe ligj i cili kërkon buxhet shtesë prej 96 mijë euro për këtë Dhomë, në mënyrë që të bëjë përkthimin në gjuhën angleze të dokumentacionit nga palët.

Në Kosovë janë dy gjuhë zyrtare, shqipja dhe serbishtja dhe turqishtja në përdorim zyrtar. Dhe, duke pasur parasysh se anglishtja nuk është gjuhë zyrtare, palët që parashtrojnë kërkesa në këtë Dhomë, nuk janë të obliguar t'i përkthejnë me shpenzime të veta dokumentacione të ndryshme, gjë e cila ishte edhe kundër kushtetuese dhe nga LDK-ja është tërhequr vëmendja në njërën nga seancat e mëparshme.

Dëshiroj të shfrytëzoj këtë rast e të tërheq vëmendjen edhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me AKP-në. Qeveria do të duhej që urgjentisht të sjellë ligjin e ri për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme me ndryshime substanciale dhe të bazohet në ligjet tona e

jo në rregulloret e UNMIK-ut, si dhe numri i gjyqtarëve të jetë në dobi të gjyqtarëve vendorë.

Gjithashtu, duhet të rishikohet edhe AKP-ja dhe mënyra e menaxhimit të fondit të privatizimit, fond ky ku një pjesë e madhe e saj po mbahet në Bankën Qendrore pa asnjë kamatë dhe i cili fond falë inflacionit, tashmë është më i vogël për 2,5% për këtë shkak e plus edhe për shkak të pagesave të mëdha që po ndodhin, të cilat po i përdor AKP-ja.

Para dy vjetësh në Komision për Zhvillim Ekonomik, LDK-ja ka kushtëzuar votën e saj pro tri ligjeve, që kanë të bëjnë me AKP-në, me kërkesë që ky fond të përdoret për projekte investive. Prandaj, ky fond i cili është marrë nga qytetarët tanë dhe është tërhequr nga qarkullimi në Kosovë, në njërën anë po degradohet dhe po vetë shpenzohet e në anën tjetër po pengon zhvillimin ekonomik të Kosovës, pasi nuk është bërë pjesë e zhvillimit ekonomik.

Dhe e fundit, të cilën dëshiroj të tërheq vëmendjen, për të satën herë në këtë Kuvend, është bordi i pakompletuar i AKP-së, i cili po ndikon në pengimin e pagesës së 20%-shit për punëtorët. Prandaj duke i pasur parasysh të gjitha këto, shihet që ligjet që kanë të bëjnë me AKP-në do të duhej të sillleshin në Kuvendin e Kosovës dhe të bëhet një amendamentim substancial, ndërsa për këtë ligj me këto tri nene, falë kërkesës së qytetarëve ne do të votojmë për dhe menjëherë do të kërkojmë një amendamentim të duhur të këtij ligji.

KRYETARI: Fjalën e ka, në emër të Partisë Demokratike, deputeti Shaip Muja.

SHAIPI MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka debatuar për Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe ka adresuar kritika të veçanta lidhur me efikasitetin e kësaj Gjykate, e cila në një mënyrë deri më tani nuk ka dhënë përgjigje të duhur në kohë dhe nuk shihet një zgjidhje edhe e afërt e këtyre problemeve.

Propozimet të cilat janë dhënë për ndryshimin e këtij ligji janë propozime teknike, të cilat mendoj që ndoshta edhe nuk kanë qenë aq shumë substanciale për të ardhur, sepse janë administratat e gjykatave, të cilat duhet t'i respektojnë nga aspekti Kushtetues edhe gjuhësinë e vendit nga ku jemi duke u trajtuar. Dhe, në këtë mënyrë Partia Demokratike në parim i përkrah këto ndryshime teknike, sepse ndoshta do të jetë pak më lehtësuese për çështjen e qytetarëve, mirëpo nuk e shoh prapë si një dobi që një gjykatë e cila ka mbetur nga një marrëveshje e trashëguar, tani e tuje duhet të jetë pak më efiçiente dhe të jetë në nivel të detyrës.

Kërkesat e ndryshme, të cilat i trajton kjo gjykatë edhe në relacion na Agjencia Kosovare e Privatizimit, duhet të shihen me seriozitet gjatë leximit të dytë, për një mundësi të amendamenteve dhe të tjera me ligj. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin “Vetëvendosje”, kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Sjellja e këtij plotësim-ndryshimi të Ligjit për Dhomën e Veçantë, nenet të cilat ndryshohen, unë mendoj shpërfaqin problemin që kemi me këtë ligj në dy rrafshe për pikat për të cilat po flasim.

Rrafshi i parë është se si ligji në formën e vet origjinale paska qenë në kundërshtim me Kushtetutën edhe me ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë. Dhe, ky është njëri prej problemeve, pra që janë obliguar palët, që t’i drejtohen një gjykate vendore në një gjuhë e cila nuk është gjuhë zyrtare në Kosovë, pra në gjuhën angleze.

Dhe, në rrafshin e dytë kjo paraqet edhe një shpërfaqje tjetër, problemin që ka ngritur disa herë Lëvizja “Vetëvendosje”, të futjes së kategorisë së ndërkombëtarit në strukturën, në skeletin, të them ashtu, legjislativ të Kosovës, që është i bartur me këtë ligj, që është i bartur me Ligjin për AKP-në dhe me ligjet tjera, të cilat u ndryshuan sipërfaqësisht gjatë procesit të përmbylljes së mbikëqyrjes së pavarësisë, por të cilat mbetën si njëllë mbeturine e kësaj mbikëqyrjeje dhe të cilat janë aktive dhe vazhdojnë të jenë aktive në sistemin gjyqësor të Kosovës. Natyrisht që ky ndryshim është i mirëseardhur, por është jashtëzakonisht pak, krahasuar me problemet që Kosova i ka me këtë Dhomë të Veçantë dhe përgjithësisht me procesin e privatizimit edhe mënyrën se si funksionon dhe ka funksionuar AKP-ja.

Mendojmë që Dhoma e Veçantë duhet të transformohet rrënjësisht, në mënyrë që ajo të jetë më e aftë, më efiçiente në kryerjen e shumë përgjegjësive që i janë veshur me ligj dhe të cilat ajo nuk po arrin t’i kryejë ose qëllimisht po i prolongon dhe po i bllokton.

Ka shumë ankesa të punëtorëve, ka shumë protesta të punëtorëve, ka madje ankesa edhe nga AKP-ja për mënyrën se si funksionon kjo gjykatë dhe mënyrën se si këta i bllokojnë shumë prej vendimeve, veçanërisht të pagesës së 20% dhe vendimeve tjera, që do të ishin vendime për fondin e privatizimit, që AKP-ja ka tentuar t’i marrë disa herë.

Nuk po them që vendimet e Bordit të AKP-së kanë qenë përherë në interes të Kosovës, por edhe ato vendime të pakta, të cilat do t’u shërbenin ndoshta punëtorëve të Kosovës me 20%, fabrikat e të cilëve janë shitur në mënyrë goxha jotransparente, edhe ato po bllokohen tash, veçanërisht nga Dhoma e Veçantë, siç kanë thënë edhe anëtarët e Bordit të AKP-së.

Në këtë drejtim, konsiderojmë që është e domosdoshme që Qeveria të bëhet shumë më e përgjegjshme karshi kësaj çështjeje dhe të merret me problemet substanciale që i ka ekonomia e Kosovës, e jo vetëm të mjaftohet vetëm me disa ndryshime sipërfaqësore, të cilat prapë po e them që janë të mirëseardhura, mirëpo absolutisht të pamjaftueshme për atë se çfarë po ndodh në Kosovë.

Është plotësisht e drejtë ajo që po ndodh aktualisht me shumë punëtorë të fabrikave të privatizuara, siç e kemi pasur rastin të shohim në Gjilan, siç e kemi pasur rastin të shohim disa herë në Fabrikën e Tubave, me punëtorët e Fabrikës së Ballkanit, e kështu me radhë, dhe pakënaqësitë e tyre karshi procesit të privatizimit. Dhe, mendojmë që këto do të duhej të ishin protesta, të cilat duhen përkrahur për shkak se këta punëtorë janë ngritur për të drejtat e tyre që po ua shkelin institucionet e Kosovës vazhdimisht dhe me përgjegjësi dhe njëra prej këtyre institucioneve që po ua shkel këto të drejta është edhe Dhoma e Veçantë, e veçanërisht AKP-ja dhe Bordi i saj, por më së shumti natyrisht Qeveria e Kosovës në mënyrën se si funksionon dhe nën hijen e syve që këta e kanë ose mosinteresimi, moskokëçarja totale që këta e kanë karshi këtyre të drejtave të punëtorëve, të cilat janë të sanksionuara me ligjet në Kosovë.

Në këtë drejtim, do t'u kisha bërë ftesë edhe një herë Qeverisë dhe AKP-së që t'i përfillin të gjitha kërkesat e punëtorëve, të cilat kanë bazë ligjore dhe të cilat janë paraqitur në shumë raste, edhe këtu në Kuvend, veçanërisht me Fabrikën e Tubave, veçanërisht pastaj me Fabrikën e Ballkanit të Suharekës, dhe fabrikat tjera, punëtorët e të cilave kanë filluar ta shprehin pakënaqësinë.

Pra, duhet ta drejtojmë natyrisht fondin e privatizimit kah një fond zhvillimor i Kosovës, nëpërmjet të cilit do të investohej drejtpërdrejt në rritjen dhe përkrahjen e prodhimit në Kosovë dhe ta kemi një fond i cili po mbahet për t'i paguar kreditorët fiktivë, të cilët kjo Dhoma e Veçantë vazhdimisht po shkon duke i pastruar dhe, në anën tjetër, për t'i mbajtur ato si njëllaj paraje në dispozicion për Qeverinë aktuale të Kosovës për t'i shndërruar ato në para publike, siç e ka tendencën kjo, dhe për t'i përdorur ato për investime jashtëzakonisht të gabuara që kjo Qeveri po i merr.

Pra, po e them edhe njëherë, Lëvizja "Vetëvendosje" do ta përkrahë këtë ndryshim-plotësim të ligjit, mirëpo kjo është absolutisht e pamjaftueshme dhe e shpërfaqjoseriozitetin, ose moskuptimin e seriozitetit që kjo Qeveri e ka për rrethanat ekonomike në vend.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti nënkryetar!

Ministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah plotësim-ndryshimin e këtij projektligji dhe do t'i kisha veçuar dy arsye kryesore.

E para, Dhoma e Veçantë ka dështuar në shpërndarjen e 20% dhe e ka goditur një klasë, klasën punëtore, e cila duhet të mbrohet dhe ka mbrojtur disa njerëz që s'duhet të mbrohen. Do të thotë, këtu punëtorët, përveç që janë larguar nga puna, përveç që s'kanë përfituar asgjë, u është vonuar edhe pagesa e 20% me vite të tëra, kështu që duke e pasur dhe duke e llogaritur inflacionin për vite ka sjellë në atë situatë që ai 20% të mos ketë më asnjëfarë vlere.

Prandaj, në këtë aspekt, Dhoma e Veçantë ka dështuar.

Një problem tjetër është edhe fondi për arsye se sa gjysma e Buxhetit të Kosovës, fondi për privatizim është i ngrirë dhe ato mjete, le që nuk dihet dedikimi i tyre, por në këtë moment, kur ekonomia e Kosovës ka nevojë për mjete xhiruese, ato mbeten të bllokuara.

Këto janë dy arsyet kryesore, të cilat duhet të ndikojnë në plotësim-ndryshimin dhe të realizohet së pari 20% sa më shpejt që të jetë e mundur për punëtorët dhe ky fond të jetë aktiv për ekonominë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Koalicionin Kosova e Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për ministrin,

Përshëndetje për deputetët,

Duke marrë parasysh se pasur pas përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, pas miratimit të atyre ligjeve, ne e kemi pasur një draftim të këtij ligji, së bashku me Ligjin për AKP-në dhe Ligjin për ndërmarrjet publike, ministër, meqë je këtu, kërkoj nga ju që në kohën sa më të shpejtë ta bëni edhe Ligjin për AKP-në, që të bëhet kompletimi i të gjitha ligjeve, të cilat atakohen edhe me Ligjin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në rast se e shohim projektligjin i cili ka ardhur, mund të themi se kurrfarë ndryshimi nuk ka në këtë projektligj, ministër, me përjashtim të përkthimit. Besoj se do ta sillni edhe Ligjin e AKP-së, kur dihet se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka probleme mjaft dhe çështja e moszgjidhjes së atyre problemeve me investitorët, me punëtorët, do të jetë çështje shumë e ndjeshme dhe besoj që Qeveria është në dijeni.

Njëkohësisht, prej Kuvendit këtu, ministër, apeloj që t'i thoni kryeministrit t'i sjellë emrat e AKP-së, kur dihet se AKP-ja funksionon akoma pa bord dhe pa drejtor menaxhues, kështu që të mos presim rezultate edhe nga AKP-ja edhe pas miratimit të këtyre ligjeve.

Në parim, Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje, mirëpo këtu duhet të kenë ndryshime tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin "6+", Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar "6+" e ka shqyrtuar këtë projektligj në parim për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe për AKP-në.

Gjithsesi që ne pajtohemi me shqetësimet të cilat i ngritën kolegët apo parafolësit dhe në parim e përkrahim këtë projektligj, këtë plotësim-ndryshim, ndërsa kontributin tonë do ta japim gjatë punës në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka në emër të grupit të tjerë. Fjalën e merr deputeti Ramë Vataj. Nuk është këtu. Atëherë Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, për Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur dhe Peticione kemi pasur kërkesa të shumta nga punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuara në lidhje me përkthimit e dokumentacionit, sepse e gjithë barra binte në punëtorë, edhe ashtu tanimë pa të ardhura personale.

Ne i kemi bërë kërkesë ministrisë përkatëse si komision që ky nen të ndërrohet dhe i falënderohem shumë që e kanë marrë parasysh dhe natyrisht se e përkrahim këtë ndryshim. Sa i përket vlerësimit të ndikimit financiar, thuhet se në vit do të ketë nevojë të përkthehen deri në 8 000 faqe dhe kjo arsyetohet me përkthimin e një faqeje, që në tregun aktual është 12 euro dhe thuhet se kjo do të kushtonte 96 000 euro.

Unë mendoj se Dhoma e Posaçme nuk do t'i përkthejë këto dokumentacione në këtë mënyrë, mirëpo me punësimin e katër përkthyesve, bile-bile me një rrogë me të ardhura deri në 1 000 euro kjo do të kushtonte përgjysmë më pak, 48 000 euro. Andaj, mendoj se kjo do të ketë një buxhetim më të vogël se që është thënë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja e zotërinj deputetë

S'mund të mos e mbështes ndryshimin e propozuar, i cili siç po del ka qenë edhe rekomandim i deputetëve këtu, por me sa më kujtohet ka qenë edhe rekomandim i Avokatit të Popullit.

Është një ndryshim pozitiv, por ajo që më bëri ta marr fjalën është fakti që është pak i pazakonshëm ky ndryshim. Le të jetë edhe pozitiv, që s'është relevant dhe nuk është i natyrës së punës, as të ministrisë, as të Dhomës së Posaçme.

Së paku nuk është i rëndësishëm së tillë që të bëhet ndryshim në vete. Për më tepër, sugjerohet një racionalizim i aspektit gjuhësor dhe prandaj duhet të mbështetet. Por, shtrihet çështja: a rregullohen çështjet gjuhësore në secilin ligj, për secilën çështje, veç e veç? Ne e kemi një ligj për përdorimin e gjuhëve dhe mendoj që referenca te ky ligj është zgjidhja që duhet të jetë standarde në të gjitha rastet, me përjashtim, u mor vesh, të rasteve kur imponohet një nevojë e veçantë.

Për më tepër, edhe në këtë kontekst, me lehtësi po çimentohen disa formula, që në pamje të parë duken pozitive, prezantohen si diskriminim pozitiv, por në të vërtetë në praktikë po dëshmojnë se edhe teprimi me pozitivitet kthehet ndonjëherë në problem.

I ashtuquajturi “diskriminim pozitiv” në raport ndërmjet komuniteteve dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë kthehet në diskriminim të vërtetë, në diskriminim negativ, dhe unë mendoj duhet të jemi të lirë më në fund që t’i adresojmë këto çështje. Pse Kosova duhet të jetë veç botës? Pse të mos i praktikojmë ne standardet që zbaton e gjithë bota? Natyrisht me një fleksibilitet të shtuar ndaj të drejtave të pakicave, por pa e çuar në absurd, sepse duke e quar në absurd rrezikojmë ta diskreditojmë atë.

Por, çështja e dytë që desha të theksoj, zonja e zotërinj, është fakti që u theksua edhe prej kolegëve deputetë parafolës, fakti që Qeveria dhe ministria, do të dëshiroja që edhe vëmendja e ministrit të jetë e pranishme këtu, e injorojnë faktin se jo vetëm agjencia, por edhe Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme përballat me mangësi e anomali të shumta. Unë po e theksoj vetëm një fakt. Ajo është tani e mangët, me sa e di unë. Nuk funksionon prandaj siç duhet. Pjesa ndërkombëtare e saj, jo vetëm që nuk është e angazhuar sa e si duhet, por në masë të madhe nuk është fare e pranishme. Për pasojë, është ai fenomeni që e theksuan deputetët - i lëndëve të shumta të grumbulluara.

Dhe, për pasojë pastaj të kësaj ka shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, të një numri të madh të qytetarëve, që dëmtohen për shkak të këtij defekti. Është e pakuptueshme, zoti ministër, që ministria i injoron problemet substanciale, funksionale, që janë në këtë fushë dhe merret me një çështje krejt sipërfaqësore, që është linguistike, gjuhësore. Le të jetë edhe e drejtë.

Ka pasoja të drejtpërdrejta konkrete në terren. Dhe, unë dua ta sjell këtu faktin që jo më larg se 2-3 javë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës e miratoi një rezolutë të posaçme për përgjegjësinë e përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare në misione të ndryshme të paqeruajtjes ose paqendërimit, në raport me të drejtat e njeriut që shkelen edhe nga ata.

Asambleja Parlamentare e ka adresuar këtë çështje dhe kërkon përgjegjësinë konkrete nga vendet prej të cilave vijnë përfaqësuesit ndërkombëtarë, edhe kur ata janë burim i shkeljeve të rënda të njeriut. Pse të mos i adresojmë ne? Pse të mos i vëmë në rrugën e zgjidhjes së drejtë?

Për më tepër, siç e theksoi edhe deputetja, edhe mua më ka bërë përshtypje që agjencia dhe Dhoma e Veçantë funksionojnë me një bazë ligjore të tejkaluar, me Rregullore të UNMIK-ut, dhe është diçka që nuk mund të injorohet. Është diçka që duhet të përgatitet. Ministria do të duhej të na i sillte zgjidhjet e përditësuara, si të thuash, të freskuara normative edhe të legjislacionit subsidiar dhe në këtë mënyrë ta tejkalonim situatën absurde në të cilën ndodhemi, që të na çimentohej edhe, si të thuash, ligje e akte nënligjore të një kohe që për ne është tani e tejkaluar.

Ka prandaj dy zgjidhje: ose që ministria ta tërheqë në ripunim këtë ligj dhe ta plotësojë, ta bëjë një ndryshim ligji që e rregullon fushën e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme në tërësi, sidomos në pjesën funksionale të saj, ose varianti i dytë që këtë punë ta bëjë komisioni, por me kushtin që t’i marrë parasysh sugjerimet dhe t’i kthejë në

amendamente që e plotësojnë, ndoshta edhe që e ndryshojnë në tërësi këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Unë e përfaqësoj një grup, i cili ka të bëjë me marrjen apo pranimin e ankesave nga shumë qytetarë, e ato quhen peticione. Shumë qytetarë po i nënshkruajnë këto peticioni, po i dërgojnë në Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe ne si komision po i thërrasim përfaqësuesit e Agjencisë së Privatizimit, po ashtu po marrim informata edhe nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, por deri më tani asnjë zgjidhje e këtyre kërkesave të punëtorëve nuk është bërë.

Po e vazhdoj aty ku e la edhe kolegu im Hyseni, i cili tha se deri më tani kjo Dhomë e Posaçme e Gjykatës Supreme ka funksionuar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut, e cila ka treguar se në shqyrtimin e këtyre ankesave dhe kërkesave nuk ka treguar rezultat, sepse, zoti ministër, në këtë rregullore kanë munguar afate strikte të shqyrtimit të lëndëve të punëtorëve, jo vetëm të dhënies së 20% të punëtorëve, por edhe të çështjeve tjera që lidhen me likuidimin e ndërmarrjeve publike, e ato ju me siguri i dini.

Punëtorët sot kanë kërkesa edhe për pagat, të cilat u takojnë pas privatizimit të ndërmarrjeve publike, e për të cilat duhet të vendoste Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe kjo dhomë e ka një numër jashtëzakonisht të lartë të lëndëve, të cilat as nuk i shqyrton. Unë konsideroj se Kuvendi është organi kompetent, i cili do të duhej që ta monitoronte këtë gjykatë, jo që të ndikonte apo të intervenonte në të, por të japë rekomandime në zbatimin e ligjit. Konkretisht, nëse miratohet ky ligj ashtu siç ka ardhur, nuk po e shoh që çështjet do të zgjidhen shumë shpejt, sepse ky ligj më shumë merret me çështje linguistike, që tash dolën si probleme, e jo me kritere të qarta, të cilat do të duhej të bënin zgjidhje për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Merreni me mend, zoti ministër, edhe AKP-ja, anëtarët e këtij Bordi, kanë ankesa në këtë gjykatë, e kjo gjykatë do të duhej të ishte ndihmëse për AKP-në, ndërsa vazhdimisht po punon në të kundërtën edhe të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, po ashtu edhe për të drejtat e punëtorëve.

Dhe, unë po çuditem se si nuk ka protesta më shumë. Pra, po çuditem me kaq protesta të vogla, duke e marrë parasysh që e drejta e këtyre njerëzve që sa e sa vite shkelet nga mosfunksionimi i kësaj gjykate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit për diskutim, deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me këtë plotësim-ndryshim të këtij ligji ne e shtojmë edhe një komponent, i cili do t'i zvarrisë edhe më shumë lëndët dhe kërkesat që i bëjnë njerëzit që kanë të bëjnë me këtë gjykatë.

Ne i kemi rreth 350 ndërmarrje, të cilat nuk po arrijnë që të likuidohen për shkak të ankesave të shumta që i kanë bërë njerëzit që kanë interes. 45 ndërmarrje janë vetëm nga regjioni i Anamoravës, punëtorët e të cilave ditën e enjte e bënë një protestë në qendër të Gjilanit, ku kërkuan të drejtën e tyre - të zbatohet ligji për kthimin e 20% të parave të tyre që realisht u takojnë dhe për kthimin e 1 deri në 7 rroga, të cilat në bazë të stazhit të punës u takojnë, e që këto para si të ngrira kanë mbetur në sirtarë diku, e që po e humbin vlerën e vet reale vazhdimisht.

Dëshiroj ta theksoj edhe faktin se kësaj gjykate, si të thuash, i ka dalë afati për shkak se kjo është themeluar me një vendim të UNMIK-ut, i cili më tutje vazhdon të mos jetë në Kosovë. Në njëfarë mënyre, kjo është gjykatë politike, e cila në kohën kur është themeluar e ka luajtur rolin e vet për ta mbajtur një gjendje të ngrirë, një 'status quo', e cila do ta kishte çuar vendin deri te një zgjidhje politike me qëllim që këta pastaj të merren me problemet për të cilat janë themeluar.

Domethënë, faktori UNMIK tash nuk është, në njëfarë mënyre kjo ka qenë edhe mund të arsyetohet si një lloj dhome, e cila ka shprehur mosbesim ndaj drejtësisë së brishtë të Kosovës në atë kohë.

Thënë të drejtën, edhe kjo gjykatë, me vetë faktin që po quhet "dhomë", domethënë që nuk është një vend ku zgjidhen probleme. Nuk është themeluar për të zgjidhur probleme, por është themeluar për, si të thuash, për të ndenjur, për t'u marrë me gjëra kotë.

Dëshiroj të kërkoj nga ju që ky projektligj të kthehet se nuk i vyen askujt, ndërsa e rëndësishme është që kjo gjykatë, ose duhet të funksionalizohet, ose duhet që lëndët e saj t'u kalojnë gjykatave të rregullta të Kosovës, domethënë Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju lutem! Deputetë, uluni se do të votojmë! Zotërinj deputetë, dijeni që çdo herë do të votojmë, se ka ligje për herë të parë. Mos harroni, do të votojmë secilën herë, prandaj të mos ju thërras secilën herë.

Janë 72 deputetë. Regjia dhe deputetët bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se 67 kanë votuar për, 1 abstenim dhe asnjë kundër dhe Kuvendi e miratoi në parim këtë Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren të Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi, që para deputetëve ta paraqes dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Zonat hapësinore janë të rëndësishme dhe të domosdoshme për Republikën e Kosovës. Shumë institucione krijojnë të dhëna hapësinore në lëmi të ndryshme, për të cilat janë kompetente dhe përgjegjëse.

Këto të dhëna hapësinore krijohen nga sfera e planifikimit hapësinor, banimit, bujqësisë, pylltarisë, kadastrës, minierave, infrastrukturës, statistikave dhe fushave të tjera të administrimit të tokës. Të dhënat në institucionet përgjegjëse krijohen në forma dhe standarde të ndryshme, ku shpeshherë ka vështirësi për përdorimin dhe këmbimin e tyre midis institucioneve të ndryshme.

Objektivi kryesor i projektligjit është përcaktimi i qartë i përgjegjësisë dhe kompetencave të institucioneve të Republikës së Kosovës që merren me krijimin e të dhënave gjeo-hapësinore. Qëllimi tjetër i këtij projektligji është edhe uniformimi i këtyre të dhënave, në mënyrë që të sigurohet ndërrimi dhe bashkërenditja e këtyre informatave.

Gjatë hartimit të projektligjit janë konsultuar të gjitha institucionet relevante të Republikës së Kosovës dhe partnerët ndërkombëtarë.

Me krijimin e projektligjit bëhet edhe zbatimi i direktivës së Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për krijimin e infrastrukturës për informacione hapësinore në Bashkimin Evropian.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji, ju ftoj që ta votoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin në parim dhe Kuvendit ia paraqet me rekomandimin që të miratohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë te përfaqësuesit e grupeve. Për Grupin e PDK-së, deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës, vlerëson se projektligji i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren e Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës.

Dokumentet bazë për përgatitjen e këtij projektligji janë: udhëzimi i Parlamentit Evropian dhe Këshilli Evropian për krijimin e infrastrukturës për informacione hapësinore në Bashkimin Evropian, si dhe ligjet e veçanta të informacioneve të institucioneve të Kosovës.

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për vendosjen, përditësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës. Grupi Parlamentar e përkrah këtë projektligj, kurse kontributin tonë do ta japim gjatë punës në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pretendimi i Kosovës për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian sjell me vete edhe detyrimin për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me atë të Bashkimit Evropian në fushën e informacionit hapësinor.

Lëvizja “Vetëvendosje” është interesuar në përmbushjen e kriterëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke konsideruar që përmbushja e këtyre kriterëve është interes nacional dhe përmbush nevojat e rëndësishme të qytetarëve të Kosovës. Në këtë frymë, hyn edhe Ligji për infrastrukturën kombëtare për informacionin hapësinor.

Kjo iniciativë është ndërmarrë në Evropë për herë të parë në vitin 2001. Më 14 mars 2007, Parlamenti Evropian i ka miratuar direktivat për sigurimin e infrastrukturës së të

dhënave gjeologjike duke siguruar kështu kornizën ligjore për sigurimin e të dhënave gjeologjike të administratës mbi kufijtë nacionalë.

Ligji për të cilin po diskutojmë ka për qëllim krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor të Republikës së Kosovës. Ne e mbështetim këtë projektligj, sepse ligji ka për qëllim krijimin e infrastrukturës për informacion hapësinor, ndërsa vërejtjet konkrete do t'i japim në komision.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Koalicionin Kosova e Re, Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Mjedisi dhe problemet që lidhen me të nuk kanë kufij. Të dhënat hapësinore të cilat varen nga njohuritë bazë të politikës së mjedisit mbrohen nga organizata të ndryshme.

Infrastrukturat e të dhënave hapësinore, si ajo që ofron direktiva 'inspire' mund t'i shërbejë këtij qëllimi nëse organizatat përgjegjëse për mjedisin për të dhënat gjeografike, gjeofizike dhe socio-ekonomike bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në fushën e shkëmbimit të shërbimeve dhe informacioneve, prej të cilave varet menaxhimi i mjedisit brenda dhe jashtë kufijve.

Të dhënat gjeo-hapësinore janë të nevojshme, jo vetëm për bizneset, qytetarët apo konsumatorët, por edhe për vetë organet publike, në mënyrë që të marrin vendime cilësore. Për krijimin e politikave janë të nevojshme të dhëna të besueshme për ta vlerësuar situatën aktuale dhe zhvillimin e deritashëm. Këto të dhëna përsëri janë të lidhura kryesisht me hapësirën. Direktiva 'inspire' përcakton rregulla të përgjithshme për ta krijuar një infrastrukturë në informata hapësinore në Evropë. Përcakton 34 terma të të dhënave hapësinore në tri sfera, nga ngastrat kadastrale deri te habitatet dhe biotopet.

Direktiva 'inspire' ligjërisht obligon institucionet publike që janë pronarë apo menaxherë të të dhënave në lidhje me hapësirën për t'i bërë këto të dhëna të qasshme në përputhje me specifikimet e kësaj direktive.

Nëse të dhënat lidhen me këtë direktivë, atëherë kërkohet që ato të publikohen si shërbime inspektimi dhe miratimi me qëllim ripërdorimi, si dhe vënien në dispozicion të meta-datave për qëllime krijimi. 'Inspire' nuk kërkon qarkullimin e të dhënave të reja, e lë të hapur mundësinë për t'ua kufizuar qasjen përdoruesve të caktuar ose të vendosë një tarifë për përdorim. Ndërsa, meta-data si term është përdorur shpesh në kontestin e informacionit të të dhënave hapësinore, pra 'inspire' u referohet një lloji të veçantë të të dhënave që shpesh janë të dhëna mbi të dhënat, ose të dhëna që përshkruajnë të dhëna.

Meta-data zakonisht përmban informacion lidhje me përmbajtjen, kategoritë, pronësinë, mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe përpunimin e të dhënave hapësinore etj., për t'i mundësuar përdoruesit potencial t'i shfletojë katalogët pa asnjë kontakt me vetë të dhënat.

Ne si Grup Parlamentar do ta votojmë këtë ligj në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, nënkryetar!

Realisht në Kuvendin e Kosovës është vazhdimësi e një praktike të mirë një aprovim i të gjitha ligjeve të harmonizuara me direktivat e Bashkimit Evropian. Po duket se kjo përmbushje e këtyre kriterëve ose kërkesave nga Bashkimi Evropian në fakt po mbetet në gjysmë, sepse po përkrahet vetëm nga Legjislativi. Sigurisht edhe në këtë rast, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do të votojë pro këtij ligji, mirëpo me kërkesë që ky të mos mbetet një ndër ligjet e shumta në letër, por edhe Ekzekutivi, në këtë rast Ministria e Ambientit, ta marrë obligimin që i njëjti të zbatohet siç është paraparë me agjendën legjislative. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka diskutues tjerë. Ju kisha lutur të uleni! Regjia, gati për votimin e ligjit! Votojmë tash!

Zotërinj deputetë, doni ta votoni ligjin, apo jo? E hedh edhe një herë në votim. Ky është i pavlefshëm, nëse interpretohet siç bëri kryetari më parë. Votimi i pavlefshëm! Atëherë ju lus, e keni ligjin që po e përkrahni të gjithë. A e dini çka po përkrahni dhe pse s'po e votoni? Kaq!

E nxjerr në votim ligjin. 68 deputetë janë të pranishëm. Votojmë tash!

Konstatoj se me 60 vota për, 3 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi që ta paraqesë ligjin.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore ka hyrë në fuqi më 28 janar 2012.

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi shoqërore dhe publike për të cilat ekziston e drejta banesore, apo e drejta e shfrytëzimit me qira për kohë të pacaktuar.

Vlerësohet se numri i kërkesave për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore është në rritje, por disa komisione përgjegjëse nëpër komuna dhe organizata përgjegjëse për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave janë themeluar me vonesë.

Alternativa e rekomanduar është ndryshimi i ligjit aktual për faktin se afati i mbetur ligjor është i shkurtër për t'i përfunduar të gjitha kërkesat dhe kështu po i mohohet kjo e drejtë një numri të madh të bartësve të së drejtës banesore, të cilët nuk kanë arritur të informohen me kohë.

Nga bashkëpunimi me institucionet relevante dhe palët e interesuara ka rezultuar që është e nevojshme të bëhet ndryshimi i ligjit në fuqi, ngase nuk po mund të përmbushet qëllimi i atij në afatin e paraparë me ligj.

Andaj, unë sot propozoj të ndryshohet neni 32, i cili e përcakton afatin e zbatimit të ligjit, ashtu që të shtohet afati për një vit. Ju falënderoj për mirëkuptimin dhe përkrahjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin për të drejtën banesore dhe në bazë të saj që është shqyrtuar kërkojmë që në parim të miratohet ky projektligj.

Ministria kërkon t'i zgjatet afati një neni edhe për një vit dhe ne jemi pajtuar që ky të ecën më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të PDK-së, deputeti Ramiz Ldrovci e ka fjalën.

RAMIZ LADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, vlerëson se projektligji i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren e Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit që ta votojë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIR: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i cili ka për qëllim pra ndryshimin e paragrafit 1 të nenit 32.

Ky plotësim-ndryshim është teknik dhe shtyn afatin e vlefshmërisë. Prandaj, ne e përkrahim dhe do ta votojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e “Vetëvendosjes”, deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ndonëse prona publike, pasuri e pakontestueshme e Republikës së Kosovës është vënë në shënjestër të degradimit dhe shkatërrimit të saj, shitja e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore është proces tjetër paralel, që krahas privatizimit po e degradon këtë kategori të pronësisë së Republikës.

Në njërën anë, Agjencia Kosovare e Privatizimit, e cila në mënyrë të pamëshirshme e ka tjetërsuar pronën publike, një mekanizëm tjetër i quajtur Agjencia Kosovare e Pronës e ka bërë të njëjtën detyrë duke e inkriminuar subjektivitetin e saj në kontestet pronësore, e së fundit edhe me shitjen e banesave për të cilën ekziston e drejta banesore.

Ky mekanizëm, i cili paraqet tipologjinë e administrimit ndërkombëtar të Kosovës, e ka çrregulluar sistemin juridik dhe gjyqësor të Kosovës.

Rregullimi ligjor i sanksionuar me Ligjin numër 04/L-061 nuk e ka përkufizuar një periudhë kohore, e cila do të bënte prerjen definitive me aktet nënligjore të nxjerra sipas legjislacionit diskriminues gjatë periudhës së okupimit të Kosovës.

Kjo lë mundësi që të punësuarit, të cilët u përjashtuan nga vendi i punës, nesër nga përfituesit e regjimit të Milosheviqit t’ua kontestojnë të drejtën e banimit që konsiston me të drejtën banesore.

Dhe, me këtë raport, çuditërisht, edhe sipas rregullimit aktual ndërhyjnë Agjencia Kosovare e Pronës.

Pra, për më tepër, projektligji i propozuar nga Qeveria e Kosovës ka treguar se Qeveria në vend se ta marrë parasysh problematikën, të cilën do të duhej ta shqyrtonte nga rregullimi aktual dhe ai paraprak, ai i nënshtrohet dështimit të qëllimshëm të këtij procesi, i cili ka lënë hapësirë të manipulimit në të shumtën e rasteve, e sidomos ato me elemente etnike të ketë ngjyrimë politike, që mund të ndikojnë në stabilitetin e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

Projektligji në tërësi përmban gjithsej tri dispozita që synojnë të bëjnë plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji aktual për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Kësisoj, në nenin 2 të projektligjit është paraparë ndryshimi i nenit 7, paragrafi 3, ku është përkufizuar afati ligjor për parashtrimin e kërkesës për blerjen e banesës në afat dyvjeçar, pra është propozuar që kjo periudhë të zgjatet për një periudhë trevjeçare.

Ndërsa në nenin 3 të projektligjit është propozuar ndryshimi i nenit 32 të ligjit bazik, sipas të cilit në dispozitat përfundimtare të ligjit bazik do të ceket se me ligj rregullohet shitja e banesave në pronësi shoqërore dhe publike për të cilat ekziston e drejta banesore, apo e drejta e shfrytëzimit me qira për kohë të pacaktuar, e cila është arritur në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet banesore, si dhe duke formuluar paragrafin e ri, në të cilin thuhet se kontratat për shfrytëzimin e banesës sipas Ligjit për marrëdhënie banesore dhe kontrata që është lidhur deri në hyrje në fuqi të ligjit bazik do të jenë të vlefshme deri në tre vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Siç shihet, çështja më kryesore që duhet revidohet në Ligjin për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nuk janë përfshirë me këtë projektligj.

Në këtë kontekst, duke pasur parasysh se e drejta e strehimit është ndër të drejtat themelore të njeriut, ky ligj duhet t'i qaset kalimit pronësor të poseduesit me të drejtë banimi në mënyrë të drejtë pa kurrfarë tendencash të njohjes së shtypjes dhe padrejtësisë që i është bërë popullit tonë gjatë okupimit serb.

Në këtë kontekst duhet ta kemi parasysh se gjatë viteve të '90-ta, kur në Kosovë mbretëronte aparteidi nga Serbia, me ç'rast shqiptarët u dëbuan nga vendet e punës dhe banesat të cilat u ishin dhënë si pasojë e ekzistimit të marrëdhënies së punës.

Ky projektligj, në vend se të shuajë kompetencat e Agjencisë Kosovare për Prona, që sipas nenit 13 të ligjit thuhet se para nënshkrimit të kontratës për shitjen e banesës, shitësi është i detyruar që të kërkojë nga Agjencia Kosovare për Prona që të vërtetojë nëse është ushtruar ndonjë kërkesë për atë banesë në Drejtorinë për Çështjen Pronësore Banesore, e që sipas paragrafit 3 të këtij ligji, në rast të ekzistimit të kontekstit të mundshëm prona që është objekt i shitjes nuk mund të qarkullojë te proceduesi pa e nxjerrë vendimin përfundimtar.

Pra, këtu qëndron edhe padrejtësia, sepse kjo agjenci e ka krijuar një praktikë, e cila bën përjashtim nga standardi i përgjithshëm i zgjidhjes së kontesteve pronësore. Ky rregullim i veçantë konsiston në zhvillimin e procedurës së zgjidhjes së kontesteve sipas rregullave të procedurës administrative.

Pra, në parim, procedura zhvillohet pranë kësaj agjencie dhe vetëm pas nxjerrjes së vendimit të shkallës së dytë brenda këtij institucioni, lënda procedohet në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme.

Në vend se e gjithë kjo procedurë të zhvillohet pranë gjykatave të rregullta dhe në procedurën kontestimore, kjo paraqet problematikën më të madhe që e ka krijuar ky institucion. Me vetë faktin që kjo agjenci i njeh vendimet që janë nxjerrë deri në mars të vitit 1999, kjo është e papranueshme.

Është e papranueshme kur e kemi parasysh se shumë nga të dëbuarit nga vendet e tyre të punës si pasojë e instalimit të masave të dhunës që janë shkaktuar nga suprimimi i autonomisë së Kosovës brenda Federatës jugosllave kanë mbetur edhe pa strehim, duke i dëbuar dhunshëm nga banesat në të cilat ata e kishin të themeluar të drejtën banesore. Në këto banesa u vendosën kolonë serbë që kishin qëllimin sistematik të depopulizimit të popullsisë shqiptare.

Në këtë mënyrë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” këtë projektligj nuk do ta miratojë në parim, duke konsistuar se Qeveria duhet ta sjellë projektligj në të cilin do të përfshihet dispozita, e cila abrogon kompetencën e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe i shfuqizon të gjitha vendimet mbi bazën e të cilave është njohur e drejta e banimit nga organet e masave të dhunshme në Kosovë.

Në rast se ky ligj do të miratohet në parim nga Kuvendi i Kosovës, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do të parashtojë amendamente me të cilat çështjet e lartcekura do të përfshihen në këtë projektligj.

KRYESUESI: Për Grupin Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zonja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, nënkryetar!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta përkrahë këtë plotësim-ndryshim të ligjit, për shkak se konsiderojmë që kjo do t'i kontribuojë procesit të të gjitha atyre rasteve kontestimore, të cilat lidhen sidomos me pjesën e qytetarëve të veriut të Mitrovicës, do të thotë shumicës shqiptare, e cila deri në këtë periudhë është diskriminuar dhe lënë anash dhe në asnjë moment nuk e kanë gëzuar të drejtën për zbatimin e ligjit dhe kthimit të pronave, të cilat kanë pasur të drejtë, qoftë t'i blejnë, ose i kanë poseduar.

Prandaj, konsiderojmë që ky afat shtesë do të ndikojë në përmirësimin ose në rregullimin e kësaj çështjeje, që është fort e dhimbshme dhe që është jetike, sidomos për këtë pjesë të qytetarëve të veriut të Kosovës. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit! Për Koalicionin Kosova e Re, Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Alternativa e rekomanduar është ndryshimi i Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore për faktin se afati ligjor i ligjit ekzistues është i shkurtër për të përfunduar procesi i shitblerjes së banesave për të cilat ekziston e drejta banesore dhe kjo e drejtë po i mohohet një numri të madh të bartësve të së drejtës banesore, të cilët nuk kanë arritur të informohen me kohë për arsye të ndryshme.

Pra, kërkohet që ky afat nga dy të ndryshohet në tre vjet dhe ne si Grup Parlamentar e përkrahim.

KRYESUESI: Nuk ka diskutues tjerë. Në sallë i kemi 75 deputetë. Ju lutem, bëhuni gati regjia dhe deputetë për ta votuar projektligjin. Votojmë tash!

Konstatohet se me 61 vota për, një kundër dhe 6 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren të Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, të propozuar nga Qeveria dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Përfaqësuesi i Qeverisë, ministri Dardan Gashi, si propozues e ka fjalën.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri”, i cili është miratuar në këtë Kuvend vitin e kaluar, kërkon zhvillimin dhe miratimin e planit hapësinor, si dhe i përcakton parametrat themelore për mbrojtjen, zhvillimin dhe përdorimin e përgjithshëm të hapësirës brenda parkut kombëtar.

Parku Kombëtar “Sharri” ka territor me 53 469 hektarë.

E gjithë sipërfaqja e parkut është ndarë në tri zona:

Zona e parë 17,5%, në të cilën veprimet janë maksimalisht të kufizuara.

Zona e dytë 75,4%, në të cilën kryesisht përfshihen pyje dhe kullosa, ndërsa sa i përket kriterit të mbrojtjes është zona me më pak kufizime, dhe

Zona e tretë 7,1%, zona e zhvillimeve të kontrolluara, e cila për nga sipërfaqja dhe përqindja e pjesëmarrjes është më e vogla.

Në kuadër të kësaj zone, pra të zonës së tretë është inkorporuar edhe plani zhvillimor për Brezovicën sipas propozimit të këshillit përkatës ndërministror.

Të nderuar deputetë,

Jam i vetëdijshëm se ky propozim ka nxitur edhe debate e disa kundërshtime.

Më lejoni të shtoj se ashtu siç e kërkon ligji, plani ka qenë në debat publik dhe ne nuk e kemi pranuar asnjë vërejtje serioze.

Po ashtu, më lejoni ta theksoj edhe faktin se para këtij mandati, Kosova kishte afro 25 mijë hektarë territor të parkun nacional, kurse bashkë me ndihmën tuaj dhe me dy ligje që

janë miratuar në këtë Kuvend, Kosova sot ka mbi 100 mijë hektarë park nacional të mbrojtur nga shteti.

Projekti i propozuar përfshin vetëm 3 300 hektarë territor, e nga kjo vetëm një pjesë e vogël, gjithsej 767 hektarë, u është ndërruar destinimi nga zona e parë e parë, e propozuar, në zonën e tretë.

Sipas informatave nga Ministria e Tregtisë, vlera investive e projektit ‘Brezovica’ sillet afërsisht 300 milionë euro, pritët krijimi i qindra vendeve të punës, kurse ndikimi ekonomik afatgjatë në regjion pritët të jetë jashtëzakonisht pozitiv.

Pra, plani synon që ta ndërlidhë mbrojtjen e mjedisit dhe të bjeshkëve tona me zhvillimin e kontrolluar të turizmit, ashtu siç praktikohet në të gjitha vendet e zhvilluara të botës.

Deputetë të nderuar,

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij dokumenti dhe ndikimin pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe të mbrojtjes së mjedisit, ju ftoj që ta votoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Komisionin Funkcional, zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Në komision është bërë një debat i vogël për planifikimin hapësinor për “Sharrin”. Ndërsa nuk është shqyrtuar plani për “Sharrin” dhe këtë e dëshmojmë që në komision kanë votuar pikërisht vetëm për ta shpejtuar procedurën që e kanë kërkuar.

Në dokumentin që e ka sjellë ministria ka shumë mangësi. Mangësitë mund t’i përmendi, për shembull, meqë vetëm thotë: “Masterplani për Brezovicën që është proklamuar që do të investohet është 2013-2022 me 30 mijë euro”, ndërsa qendra turistike ‘Bushit’ në Luboten është me 261 milionë euro.

Zona karakterizohet me shumë veçori specifike që mund t’i shihni edhe në ekran. Ende në plan ekzistojnë çështjet ‘Federata jugosllave’ e asaj kohe kaq shtretër e kaq elemente. Kjo zonë karakterizohet me këto vlera të veçanta, të cilat unë do t’i përmendi, meqë do t’i kemi vërejtjet e Drejtorisë së Parkut, Institutit, të gjithë ata që kanë kërkuar që kjo zonë të mos shkatërrohet se është një nga zonat e mbrojtura me të gjitha ato.

Plani ‘Brezovica’ parasheh shkatërrimin e zonës së mbrojtur, të natyrës e sipërfaqes për afro 4 000 hektarë, ku gjenden vlerat natyrore të rëndësishme, kombëtare dhe ndërkombëtare. Është e mbrojtur me direktivat e BE-së, aty ku gjenden vlerat e biodiversitetit të veçantë natyror, që i takon kësaj zone.

Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e natyrës, te neni 123, Ministria e Mjedisit duhet të angazhohet për mbrojtjen, e jo për këtë plan.

Plani ‘Brezovica’ është në kundërshtim me mbrojtjen strikte, sepse ndikon në shkatërrimin e habitateve dhe zhdukjen e shumë llojeve strikte të mbrojtura të florës,

faunës dhe zogjve që janë të mbrojtur me dispozitat ligjore të Kosovës dhe të Bashkimit Evropian.

Është Ligji i natyrës, direktiva administrative domethënë evropiane për habitatet natyrore të faunës dhe florës, direktiva evropiane për llojet e rrezikuara, udhëzimi administrativ për llojet e egra të mbrojtura, direktiva evropiane për ujin, direktiva evropiane për ekologjinë e të tjera.

Kafshët strikte të mbrojtura aty janë nga kafshët tjera të vlerësohet kaprolli, derri i egër, dhelpra. Zogj të mbrojtur strikt janë: gjeli i egër, shqiponja e artë. Ekskluzivisht ekosistemet që janë të mbrojtura, rrobulli, areni, klerku, panja e bardhë, trëndafili e tjera.

Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e natyrës, neni 47, paragrafi 4, për ekosistemet në zonat e mbrojtura të parkut kombëtar planifikohen vetëm masat e mbrojtura për përparimin e tyre, ndërsa ndalohet shumëzimi ekonomik dhe ndërtimi i tyre.

Qeveria çdo vit investon miliona euro për t'i mbrojtur pyjet. Nëse në një zonë gjendet habitat, vetëm një lloj strikte e mbrojtur e florës, faunës apo zogjve, duhet të ndalohet çdo veprim aktiviteti në atë zonë.

Ndërsa zonat ku planifikohet plani 'Brezovica', me theks të veçantë në zonën A të këtij plani gjenden habitatet e dhjetëra llojeve strikte të mbrojtura.

Për rëndësinë e ndjeshmërisë së mbrojtjes së llojeve strikte të mbrojtura tregon dispozita ligjore, në bazë të cilës për hulumtimet e tyre nevojitet leja, pasi nuk lejohen hulumtimet pa leje, andaj si mundësi që në habitatet e llojeve strikte të mbrojtura të bëhen ndërtime masive të planifikuar në planin 'Brezovica'.

Këtu i kemi të gjitha llojet e planeve të mbrojtura dhe drunjve, pishave, bredhit, panjës, që janë pjesë e mbrojtur.

Me këtë plan, ashtu siç kanë thënë që do të ndërtohet, ose do të realizohet, është një imagjinatë që mund të mendohet, por nuk do të realizohet.

E veçanta është që atje e kemi ujin e humbur, nga ku furnizohen Prizreni dhe Suhareka, një pjesë, me ujë të pijshëm, për shkak se është liqeni me sipërfaqen mbi 2 200 metra në lartësinë mbidetare, Liqeni i Bistrës, Jazhinca, është edhe natyra të cilën ne jemi duke e parë.

Në komision nuk është shqyrtuar kjo. Me gjithë këto vërejtje, ky është një bashkëdyzim i planifikimit hapësinor dhe këtë bashkëdyzim ka tentuar ta bëjë pikërisht edhe me vendimin e saj ministrja më 6 shkurt 2013, kur ka kërkuar në mënyrë joligjore ta ndryshojë këtë plan të zonës së parë. Ajo ka thënë: Prandaj, ju lutem që plani hapësinor i zhvillimit të projektit 'Brezovica' të aprovohet nga komuniteti ndërministror, ta caktoni si zonë të tretë. Ta caktosh këtë pikë ose këtë pjesë si zonë të tretë në mënyrë arbitrare, pa i marrë vlerësimet e ekspertëve të fushave të natyrës, ekspertëve të cilët janë marrë dhe

kanë bërë zonimin atje, është një shkelje e dispozitave, shkelje e ligjeve, shkelje e të gjitha dokumenteve.

Ndërsa këtë e ka mbështetur USAID-i si mundësi të realizimit të projekteve të tyre.

Unë mund të them që kur është ndërtuar Brezovica në vitet e '70-ta si qendër e skijimit, atëherë Serbia ose Jugosllavia e kanë pasur në dorë këtë qendër dhe ka mund ta ndërtojë pikërisht në këtë vend atë ndërtim, atë qendër të skijimit, por ajo e ka mbrojt si tërësi, e ka mbrojtur se i ka pasur ekosistemet, habitatet, florën, faunën dhe të gjitha ato ujërat e humbura.

Prandaj, ajo e ka mbrojtur, kurse ne sot ky Kuvend ta miratojë e ta shkatërrojë këtë pjesë, ta bëjë këtë copëzim kështu, një zonë të veçantë të mbrojtur me direktivat evropiane, unë besoj është një absurd i kohës që të mendohet të shkatërrohet për kinse një investim që do të krijohet. Aty nuk ka investim, aty ka mundësi të ketë vetëm kamerierë dhe kuzhinierë, dhe tjetër asgjë më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Nait, unë ta dhashë fjalën si kryetar i komisionit, siç është rregulli. E ti po thua që komisioni nuk e ka trajtuar. A e ka trajtua, a jo? Veç kaq - po, jo? Regjia Naitit fjalën, se ia bëra një pyetje për sqarim.

NAIT HASANI: Komisioni në debatin që e ka pasur nuk e ka shqyrtuar planin, vetëm ka votuar për planin. Anëtarët e komisionit nuk e kanë shqyrtuar, se nuk kanë pasur kohë për ta shqyrtuar planin në këtë sipërfaqe që e ka pasur.

Plani hapësinor ka ardhur më 13 janar 2014 në komision, më 23 kanë kërkuar ta shqyrtojmë, ta futim menjëherë në seancë. Nuk ka mundësi për 10 ditë, ende pa i mbushur 10 ditë në komision, të shqyrtohet plani. Ne kemi kërkuar bashkë me organizatat tjera që e mbështetin Kuvendin ta shtyjmë, ta shqyrtojmë më mirë këtë plan. Këta nuk kanë pranuar, kanë votuar për të ardhur në seancë. Tash e keni, ju e shihni.

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë te grupet parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së, Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua ta demantoj së pari kryetarin e komisionit, sepse komisioni e ka shqyrtuar planin hapësinor dhe më 7 vota për dhe 1 kundër, me votën e kryetarit, ka kaluar shqyrtimi i planit hapësinor për malin "Sharr". Kështu që ky e ka dezinformuar seancën dhe është gabim, sepse është kryetar i komisionit dhe duhet t'i mbrojë së pari vendimet e komisionit, e pastaj të flasë në emrin e vet. Kështu që e demantoj dhe i thërras krejt deputetët që ta votojnë këtë plan, sepse ka kaluar në komision.

Po flas tash në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, që ndodhet në agjendën e takimit të sotëm, është një dokument shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik për parkun kombëtar “Sharri”.

Drafti i parë i këtij plani hapësinor është publikuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor qysh në vitin 2009. Po ashtu, gjatë vitit 2013 është mbajtur edhe dëgjimi publik. Në dhjetor të vitit 2013 është aprovuar në Qeveri.

Edhe Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, dhe në kuadër të tij edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe miratuar këtë plan hapësinor dhe konsiderojmë që miratimi i tij në seancën e sotme plenare është shumë i rëndësishëm për ta mbrojtur mjedisin dhe për t’u kontrolluar zbatimi i projekteve të ndryshme në kuadër të parkut, duke pasur parasysh se ky plan hapësinor parasheh përcaktimin e zonave të mbrojtjes në kuadër të parkut kombëtar, duke përcaktuar kështu në mënyrë të qartë se në cilat zona lejohen zhvillimet e projektit turistik dhe në cilat zona nuk lejohen.

Grupi ynë Parlamentar është i bindur se ky plan hapësinor do të ndikojë në mbrojtjen e mjedisit, duke lejuar një zhvillim të projekteve me interes të veçantë në formë të planifikuar dhe me një strategji të qartë nga shteti, duke bërë një monitorim strikt të ndërtimeve në zonat e lejuara.

Në këtë plan hapësinor gjithashtu është përcaktuar zona për zhvillimin e projektit ‘Brezovica’, në të cilin planifikohet zhvillimi i një qendre turistike të klasës botërore dhe që mund të shfrytëzohet gjatë gjithë vitit.

Siç e dini, projekti për zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës është shpallur nga Qeveria si projekt me interes nacional dhe kontributi i një projekti të tillë për zhvillimin ekonomik të Kosovës pritet të jetë shumë i madh, duke filluar me investime qindra-milionëshe, mijëra të punësuar dhe ndikim në ekonominë e përgjithshme të vendit.

Prandaj, miratimi dhe përkrahja sa më e gjerë e këtij plani hapësinor nga Kuvendi është më se i rëndësishëm për të hapur rrugën e zhvillimit të projekteve turistike në Brezovicë, Luboten e të tjera, projekte të cilat janë më se të domosdoshme për zhvillimin ekonomik të vendit, por edhe për ta dërguar një mesazh të qartë te investitorët se Kosova është e përgjegjshme dhe i mirëpret investimet që do të kenë ndikim në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve tanë.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, i ftoj gjithë deputetët që ta miratojnë këtë plan. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!
I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, që ndodhet në këtë agjendë të takimit të sotëm, është njëri prej dokumenteve shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik në Parkun Kombëtar “Sharri”.

Ky plan hapësinor ka filluar të përgatitet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor qysh në vitin 2009 dhe tashmë i ka kaluar të gjitha fazat e detyrueshme ligjore, duke përfshirë edhe konsultimet dhe dëgjimet publike, të cilat i ka mbajtur ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Komisioni FunkSIONAL për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ku bëj pjesë edhe unë, tashmë e kemi shqyrtuar dhe miratuar këtë plan hapësinor dhe konsiderojmë se miratimi i tij në seancën e sotshme plenare është shumë i rëndësishëm për t’u hapur rrugë zbatimit të projekteve të ndryshme në kuadër të parkut.

Është e rëndësishme ta kemi parasysh faktin se ky plan hapësinor parasheh përcaktimin e zonave të mbrojtjes në kuadër të pakut kombëtar, duke përcaktuar kështu në mënyrë të qartë zonat në të cilat lejohen dhe nuk lejohen ndërtimet.

Me këtë plan hapësinor gjithashtu është përcaktuar zona për zhvillimin e projektit ‘Brezovica’, në të cilin planifikohet zhvillimi i një qendre turistike të klasës botërore dhe që mund të përdoret gjatë gjithë vitit.

Ky projekt me interes nacional për Kosovën parashihet të ketë ndikim të konsiderueshëm ekonomik, ku parashihet se shuma e investimeve gjatë 10 vjetëve të para do ta arrijë shifrën deri në 650 milionë euro. Ndërsa ndikimi i përgjithshëm ekonomik gjatë tërë kohëzgjatjes së projektit pritet të jetë disa miliarda euro. Gjithashtu parashihet krijimi i rreth 4 000 vendeve të reja të punës.

Komisioni ndërministror, i cili është përgjegjës për këtë projekt, është përkushtuar për vendosjen e disa parametrave për zhvillimin e projektit ‘Brezovica’, parametra të cilët ne konsiderojmë se janë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij projekti, respektivisht përdorimin e kufizuar të tokës dhe ... e detyrueshëm, zhvillim eko-fokus, si dhe vendosja e masave stimuluese për ta minimizuar ndikimin e mjedisit, duke shmangur për aq sa të jetë e mundur ndërtimet në zonat e ndjeshme mjedisore.

Nëse investitorit domosdoshmërisht i nevojiten këto zona, atëherë investitori duhet të propozojë masa korrigjuese, kërkesë për të ndërtuar mbështetje infrastrukturës mjedisore, për shembull impiante të trajtimit të ujërave të zeza.

Në maj të vitit 2013 janë parakualifikuar katër konkorsiume ndërkombëtare, të cilat kanë shprehur interesim për të investuar në Brezovicë.

Miratimi i këtij plani hapësinor në Kuvend është shumë i rëndësishëm për t’u dhënë këtyre investitorëve potencialë sigurimet e nevojshme ligjore për të investuar në kuadër të parkut kombëtar.

Prandaj, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, bazuar në një zhvillim ekonomik dhe bazuar në turizmin, i cili do të jetë një hap i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, në përgjithësi, do ta miratojë këtë strategji dhe këtë plan. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e “Vetëvendosjes”, Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Nuk mund ta fsheh që jam shumë i befasuar që prapa fjalëve kaq të bukura për ruajtjen e natyrës fshihen qëllime për ta shkatërrua natyrën.

Më lejoni që në fillim të kësaj, që plani hapësinor, të cilin ne e kemi marrë për shqyrtim, mbështetet kryesisht në të dhëna, harta, përshkrime sipas Ligjit të vitit 1986, edhe pse Kuvendi i Kosovës, më 13 dhjetor 2012, e ka aprovuar Ligjin e ri për Parkun Kombëtar “Sharri”, nëpërmjet të cilit caktohen edhe kufijtë e rinj.

Pra, po diskutojmë për një plan, i cili nuk përkon me gjendjen reale në terren, për një plan i cili ka mangësi sa i përket situatës aktuale, duke filluar prej përshkrimit të detajuar të zonave të mbrojtjes e deri te hartat mangëta që e përshkruajnë gjendjen në hapësirë.

Ky plan i cunguar, i bastarduar, i komplikuar, kundërthënës, që në 100 faqet e tij flet për ruajtjen e natyrës dhe në 17 rreshtat e fundit, në faqen 106, shkel mbi të gjitha ato që janë thënë më parë, vihet në diskutim në Parlament pa e zhvilluar për të asnjë debat publik, gjë që bie ndesh me Ligjin për planifikim hapësinor, neni 20, për shkak që për këtë plan, në fakt, është bërë një njoftim publik në medie, por nuk është bërë asnjë shqyrtim publik, asnjë debat publik.

Raporti i Qeverisë për informimin publik flet për një mangësi të interesit dhe këtë e tha edhe ministri.

Në kundërshtim me këtë raport janë reagimet e një varg organizatash e shoqatash të ndryshme ekologjike të Kosovës, të organizatave si GAP, INDEX, ..., GLPS, Safervorld, Aspuko, Interjus, DokuFest, e organizata të tjera në kuadër të KOSID-it, por edhe të ekspertëve të ndryshëm, të fushave të ndryshme dhe të qytetarëve, të cilët janë shumë të brengosur për situatën, e cila po diskutohet.

Pra, duke shumë qartë që kishte dhe që ka shumë të interesuar për të debatuar për planin hapësinor, ashtu siç duket qartë se ka vetëm një të interesuar për të mos diskutuar për këtë plan, dhe kjo është vetë Qeveria e Kosovës. Shtrohet pyetja, cila është arsyeja që Qeveria e Kosovës u mundua ta heshtë debatin për Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri”?

Kuvendi i Kosovës, më 13 dhjetor, e ka aprovuar Ligjin për Parkun Kombëtar “Sharri”, ligj i cili i përcakton kufijtë e parkut dhe vendos regjimin e zonave.

Zona e parë përfshin pjesën e territorit të Parkut Kombëtar “Sharri” me veçori natyrore të jashtëzakonshme, me lloje të rralla të rrezikuara të bimëve dhe të shtazëve dhe tipave të vendbanimeve në kushtet e natyrës së egër. Kjo zonë gëzon karakterin e mbrojtjes strikte.

Zonja Kusari, në kundërshtim me idenë themelore të Ligjit për parkun kombëtar për ruajtjen e natyrës, në kundërshtim me ligjet evropiane për ruajtjen e ambientit, e ktheu me një vendim të Qeverisë zonën e parë, në të cilën nuk guxon të prekë dora e njeriut, në zonë të tretë, për investime ekonomike. Kjo është një kusari e paparë e një Qeverie që të vetmen ide për zhvillimin ekonomik e ka kusarinë me pasurinë kombëtare.

Zona në të cilën Qeveria planifikon ndërtimin e Kompleksit Turistik për Brezovicën karakterizohet nga vlera burimore natyrore dhe peizazhet e bukura të paprekura nga dora e njeriut. Kjo është edhe arsyeja kryesore pse ky Kuvend në këtë përbërje e ka vënë këtë gjithmonë nën mbrojtjen e ligjit. Tani Qeveria kërkon nga Kuvendi, nga ky Kuvend i cili ka votuar jo më shumë se para një viti për mbrojtjen e vlerave natyrore, të votojë sot kundër këtyre vlerave.

Çka ndodhi në të vërtetë? Komisioni Evropian në vitin 2011 ndau 200 000 euro për masterplanin për Brezovicën. Plani u realizua nga ndërmarrja austriake “Ekocink”. Kjo është një ndërmarrje që merret me planifikim dhe këshillim për zhvillimin dhe optimimin e territoreve, respektivisht terreneve të skijimit. Deri këtu gjithçka në rregull. Ajo që nuk është në rregull është fakti që plani i përgjithshëm për Brezovicën është prezantuar më 10 shkurt 2012 në Shtërpçë, pra 10 muaj para aprovimit të Ligjit për parkun kombëtar. Qeveria, në vend se t’i bënte studimet në terren, në vend që ta kishte të miratuar planin hapësinor, ajo e bëri planin ekonomik për krejt kompleksin turistik ‘Brezovica’, edhe atë në kundërshtim me të gjitha rregullat e mundshme të menaxhimit.

Në vend se plani për kompleksin turistik ‘Brezovica’ t’i përshtatet planit hapësinor, Qeveria kërkon prej nesh që planin hapësinor t’ia përshtatim planit për kompleksin ‘Brezovica’. Qëllimi i Qeverisë në planin e saj për Brezovicën nuk është zhvillimi ekonomik, por privatizimi i 350 hektarëve tokë, nën mashtrimin e krijimit të 4 000 vendeve të reja të punës. Prej se ka filluar të flitet për kompleksin turistik ‘Brezovica’, qeveritarët tanë kanë përmendur shifra të ndryshme për punësim prej disa qindra, 2 000 nga kryeministri, 3 000 dhe tash së fundi 4 000 vende të reja të punës. Sa më shumë që afrohet dita për të votuar për planin hapësinor, aq më shumë shtohen vendet e punës për kompleksin turistik ‘Brezovica’.

Në fakt, sipas planit janë paraparë të ndërtohen dy hotele, të cilat nuk mund të punësojnë më shumë se 50 qytetarë. Nuk ka asnjë dyshim se ne jemi për zhvillim ekonomik, jemi gjithashtu të bindur se qendra aktuale turistike në Brezovicë ka potencial prej të cilit sot nuk shfrytëzohen as 10%. Le të bëhen investime në këtë pjesë të Brezovicës, le të krijohen vende të reja të punës këtu ku ka potencial, ku ka kushte dhe ku natyra nuk mund të shkatërrohet më shumë sesa është shkatërruar deri tash. Në këtë kuptim, ne kërkojmë nga Qeveria ta tërheqë draftin për planifikim hapësinor për ta dhënë në debat të mirëfilltë publik, për ta plotësuar dhe për t’i vendosur zonat ashtu siç është paraparë me ligj.

Pas miratimit të planit hapësinor, Qeveria duhet ta krijojë një plan të ri për zhvillimin e turizmit, duke e përqendruar zhvillimin në qendrën ekzistuese dhe në zonën e tretë, që është paraparë për zhvillim dhe ndërtim. Në vendet e Bashkimit Evropian jepen me qindra miliona euro për ta kthyer natyrën, për ta rregulluar aty ku e ka shkatërruar zhvillimi. Ne, në të vetëm pjesë të vendit tonë, ku e kemi ruajtur natyrën, duam ta shkatërrojmë në emër të zhvillimit, i cili në fakt nuk është zhvillim.

Ne jemi për zhvillim ekonomik, por zhvillimi ekonomik duhet të vihet në harmoni me ruajtjen e ambientit, e jo në harmoni me shkatërrimin e tij.

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Para një viti e keni votuar Ligjin për Parkun Nacional “Sharri”, sepse keni dashur që një zonë të bukur natyrore të vendit tonë për shkak të vlerave të rralla ta mbron me ligj. Shpresoj që sot një vit më vonë të mos e keni ndryshuar mendimin për këtë çështje.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kryetari i Grupit, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Mendoj se ka shumë për të thënë, ka mundësi edhe të sqarohen shumë tema. Sidoqoftë është diskutuar gjatë, me sa kemi marrë vesh ne është diskutuar gjatë në komision, është diskutuar gjatë edhe në publik edhe ne mendojmë se është koha e fundit që Kosova të marrë vendime të drejta sa herë kemi të bëjmë me projekte tepër të mëdha. Po krijohet njëfarë bindje se sa herë që kemi ndonjë projekt që është i madh, i cili do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit, ka debate tepër të mëdha, të cilat praktikisht edhe po e bllokojnë në njëfarë forme procesin.

Ne mendojmë se malet e Sharrit duhet të ruhen. Ajo zonë duhet të ruhet. Institucionet e Kosovës para së gjithash duhet të kenë kujdes me atë pjesë, me siguri edhe shoqëria civile, edhe institucionet lokale dhe vetë qytetarët e Kosovës. Sidoqoftë Kosova ka nevojë jetike për zhvillim dhe ne nuk e shohim këtë plan hapësinor të Kosovës si cenim të natyrës, si cenim të parkut.

Kuvendi ka të drejtë të marrë këso vendimesh. Ne duhet të synojmë që qytetarët tanë t’i shpenzojnë të hollat e veta sa më shumë që jetë e mundur në Kosovë, në zonat turistike në Kosovë, në qendrat e skijimit ose tjera në Kosovë, e të mos i shpenzojnë jashtë Kosovës, pa dashur ta përmend se ku.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet këtë plan hapësinor. E kemi të qartë se Qeveria ndoshta edhe ka pasur ide tjera kur e ka sjellë, por e kemi të qartë edhe një gjë - që kjo Qeveri aktuale nuk do të jetë ajo që do ta implementojë këtë projekt. Do të jetë një qeveri tjetër, një qeveri shumë më e mirë, besojmë ne, e cila do të ketë tepër shumë kujdes që të gjitha synimet të arrihen. Do të thotë, që të ketë zhvillim ekonomik, që ta kemi një qendër të madhe moderne të skijimit dhe që të hollat tona të

qarkullojnë sa më tepër që të jetë e mundshme brenda Kosovës, e jo jashtë vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar Kosova e Re, Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Plani hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharr” paraqet një dokument kyç për rregullimin e mbrojtjes së mjedisit, për caktimin e zonave të mbrojtjes dhe hapjen e mundësisë për implementimin e projekteve të ndryshme në këtë park kombëtar.

Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka punuar në këtë plan hapësinor tashmë 4 vjet, periudhë kjo gjatë së cilës përmbajtja e këtij plani është shqyrtuar më me hollësi, si nga ekspertë të ndryshëm, ashtu edhe nga organet tjera qeveritare. Më lejoni të theksoj faktin se komisioni e ka kaluar në një lexim edhe planin hapësinor të Kosovës, fushën e Mihjes së Re dhe planin hapësinor për Kleçkë dhe Divjakë sa u përket procedurave të tij.

Është e rëndësishme të theksohet fakti se ky plan hapësinor në fakt për herë të parë bën përcaktimin e zonave të mbrojtjes. Kosova ligjërisht nuk ka pasur zona të përcaktuara të mbrojtjes. Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri”, i cili është miratuar nga Kuvendi në janar të vitit 2013, përcakton se zonimi bëhet në planin hapësinor për parkun kombëtar, neni 3, pika 2, pra në dokumentin që ndodhet para nesh sot. Prandaj, është e pakuptimtë të thuhet se në këtë plan hapësinor është bërë ndërrimi i zonave nga zona 1 në zonën 3 të mbrojtjes.

Miratimi i këtij plani hapësinor nga Kuvendi është shumë i rëndësishëm për të hapur rrugën e zhvillimit të projekteve të ndryshme turistike në Brezovicë dhe në lokacionet e tjera, projekte që janë shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ne si Grup Parlamentar to ta përkrahim këtë plan hapësinor.

KRYESUESI: Faleminderit! Për grupin SLS, Murselj Haljilji e ka fjalën.

MURSELJ HALJILJI: Hvala predsedavajući!

Ministre,

Dame i gospodo poslanici,

Mi smo kao grupa razmatrali ovaj Nacrta poslovnog plana. Smatramo da ima potrebe da se o njemu kaže, uz neke primedbe, naročito hoću da spomenem da se najveći deo proširenje nacionalnog parka odnosi na opštinu Dragaš, ali neću da prejudiciram i na buduću opštinu Gora.

Međutim, iz dela gde se govori o tome ko su sve saradnici u izradi ovog nacrta, nisam primetio da je bilo stručnjaka i lica koji borave i žive na tom prostoru.

To je jedana od primedbi koja će ukazati na ono što ću reći, znači izrađene su zone i prva primedba je da veliki deo Nacionalnog parka i to proširenje od 24 hiljada hektara

obuhvata opštinu Dragaš. Kažem da nije konsultovan narod, žitelji i stručnjaci sa ta tog dela da vidimo oko određivanja zona. Druga zona je toliko blizu sela, naravno i oko granice. Kada se izglasao ovaj Zakon o nacionalnom parku 'Šari', mi smo dali primedbu da je veoma blizu naseljenih mesta, pa smo smatrali da će to zoniranje omogućiti nam da će bar ta treća zona da bude u onom delu gde se dotiču naselja ili sela u tom Opojskom i Gorskom delu opštine Dragaš.

Međutim, to nije slučaj. Ako posmatramo kartu, i ovde ću dati jednu posesbnu primedbu, smatram da bi trebalo da bi ova karta bude, ili ova mapa bude u boji, da bi imali jasniju sliku, a ne da predpostavljamo gde je koja zona. Videli smo to na ekranu, i vrlo je lepo to izgledalo da smo jednostavno mogli da dokučimo gde kokja zona počinje, međutim sa ovim dokumentom to nije slučaj.

Obzirom da ovaj prostorni plan trebalo bi da bude jednaka šansa za sve, smatram da to nije slučaj ovog puta, jer posmatrajući ovu kartu ili mapu, u delu opšte strategije, videćete da na delu opštine Dragaš ne postoji nijedna lokacija u funkciju turizma, znači ne predviđa se razvoj turizma na tom prostoru.

U delu koji govori o ulaganjima, takođe ne vidimo podatke koje će nas ohrabriti, znači ohrabriti stanovništvo na tom prostoru. Zašto? Projekti opštine Dragaš čak i ne postoji vremenski period ulaganja u tom delu, znači smatramo da ovaj nije kompletan dokumenat, i predvide se samo 210 000 eura u odnosu na celokupan iznos koji se spominja u 100-270 miliona evra. Šta je 210 000? Reći ćemo ništa.

Zato želim da postaknem da smo veoma zainteresovani da se zaštiti životna sredina, i fora i fauna u tom prosturu, ali želimo takođe da građanima, stanovnicima tog kraja dajemo šansu da bolje žive. Znači ne vidim ulaganja, vidim da je druga zona veoma blizu sela, i što će kasnije onemogućiti, ili će ovaj ograničiti 'slobodu' kretanja, življenja i tako dalje, pa Ministarstvu i naravno Institut za prostorno planiranje bi zamolio da u doradi ovog nacrtu poslovnog plana obuhvatimo ovo što sam ja rekao.

Znači da moj predlog je da zone tri budu prve te na udaru ili na dodiru sa selima ili sa naseljima u tom regionu. Nikome ništa neće smetati. Ja dolazim iz tog kraja i znam gde se prostire i šta sve tamo ima. Neće izgubiti Zakon o nacionalnom parku, i sam nacionalni park ništa od toga, ako se ta treća zona predvidi odmah kao granica sa naseljenim mestima, a zatim i ova druga zona i tako dalje. Znači, ja bih kakode želeo da zajedno sa ovim dokumentom isto ide i nacionalni plan upravljanja.

Složićete se da je veoma potrebno da to ide jedno s drugim sa ovim nacrtom poslovnog plana, da zajedno ide i sa njim i nacionalni plan upravljanja. Zašto? Jer u tom nacionalnom planu upravljanja će se dati jasna slika šta se dobija, šta se gubi, kako se upravlja, i sve one stvari koje veoma bitno interesuju narod i žitelje tog karaja.

Zato Vas molim da, naravno biće slobodnih, obzirom da su i veći deo poslanika govorio o ovom nacrtu, ali uglavnom su se fokusirali na Brezovicu, a ne na region opštine Dragaš koji je veoma značajan i veoma bitan za stanovništvo kako u Opoju, tako i u delu Gora,

da se to kokriguje u tom pravcu da građani imaju mogućnosti za jedanak razvoj sa ostalim delovima nacionalnog parka. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani deputetët, deputeti nga Grupi “6+”, Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Faleminderit!

Poštovani predsedavajući,

Poštovani ministre,

Poštovani poslanici kolege,

Parlamentarna grupa “6+” je razmotrila prostorni plan za Nacionalni park ‘Šar’. Samatramo da je ovaj predlog od velike važnosti za samo Kosovo, s obzirom da se govori o velikom turizmu kao što je i ministar obrazložio, da je to u interesu svih koji žive na Kosovu. Ono što bih skrenuo posebnu pažnju ovim nacrtom jeste da se ne zadire u interesu stanovnika koji žive, odnosno koji graniče sa Nacionalnim parkom, već je to naprotiv u interesu stanovnika Župe, Podgore i Gore, koji žive na tom području.

S obzirom da postoje tri zone gde smo više puta govorili o tim zonama, to jest prva, druga i treća, ovim nacrtom se ne zabranjuje bilo kakva aktivnost u smislu izgradnja novih objekata, ispaše stoke, i bilo koje druge aktivnosti tamo gde graniče stanovnici ili meštani Župe, Podgora i Gore. Dakle ovim ukazujem da nema bojaznosti za stanovnike Župe, Podgore i Gore, nego da naprotiv ovim zakonom možemo sačuvati ljepote ‘Šara’ i ozbiljno razmišljati o raazvoju i turizmu, dakle ono što je potrebno, gde smo više puta govorili da jedino sa turizmom, da iskoristimo ove ljepote ‘Šara’, kako bi to bilo u interesu i napretku države Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe unë dua të theksoj që ka munguar një debat publik në lidhje me këtë plan hapësinor dhe me këto investime që pritet të bëhen dhe natyrisht që këtu vërejtja kryesore shkon për Qeverinë.

Kur bëhet fjalë për një investim kaq të madh, siç premtohet, dhe që ka një impakt kaq të madh në natyrë, pa dyshim që duhet të përfshihen shumë aktorë në një debat dhe Kuvendi të jetë i fundit ai që debaton dhe në fund vendos, duke marrë parasysh pra të gjithë aktorët në shoqëri dhe faktorët.

Ditë më parë kemi marrë disa reagime nga një grup OJQ-ësh, me të cilat na bëhet thirrje neve si deputetë që të mos votojmë për shkak të dëmtimit të pyjeve dhe ambientit natyror. Por, unë i kam lexuar ato reagime dhe me të vërtetë nuk kam parë fare në to që përmendet për shembull shuma e parave që do të investohen.

Natyrisht, ne të gjithë jemi ambientalistë, së paku për veten mund të flas, dhe më dhimbset çdo dru që mund të pritet, por Kosova gjithashtu është një vend që ka shumë nevojë për investime. Gjithashtu, nuk kam parë në këto reagime të flitet për vendet e

punës që do hapen dhe çfarë është e rëndësishme për zhvillimin e vetë turizmit. Në fakt, të vetmin potencial për turizëm Kosova e ka turizmin malor dhe pak atë kulturor, por minimal, do të thosha.

350 milionë euro investime duken serioze dhe joshëse, por gjithsesi mendoj që ministri, i cili është i pranishëm këtu, duhet të na japë më shumë sqarime dhe shpjegime ne deputetëve të Kuvendit dhe qytetarëve në lidhje me këto investime, në lidhje me vizionin e këtyre investimeve dhe vizionin e ndërtimit të këtij kompleksi turistik. Gjithashtu, do të doja ta kishim përpara një analizë të zhvillimit ekonomik, që kjo do t'i sillte Kosovës. Për shembull, unë e kam një pyetje shumë konkrete, zoti ministër: a do të mund të shndërrohej ky kompleks turistik në një qendër ballkanike të turizmit, nëse mund të jemi kaq ambiciozë, ose cilat shtete me të vërtetë, keni bërë ndonjë analizë, do të përfshiheshin ta shfrytëzojnë këtë, në rast se e keni një studim të tillë? Cili do të ishte impakti ekonomik? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë po e shfrytëzoj rastin, jo vetëm në pyetjet e deputetes Lama, por në përgjithësi, konkretisht së pari rreth debatit publik. U cek disa herë se nuk paska pasur debat publik. Saktësisht prej datës 7.8. deri më 8.10.2013, do të thotë plot dy muaj ka qenë i hapur debati publik.

Tash është një problem natyrisht që nuk mund të shkojmë ne te secili që e ka harruar të vijë në debat publik, mirëpo debati ka qenë i hapur për publikun rrafsh dy muaj në parkun nacional vetë, në Prishtinë dhe nëpërmjet internetit ka pasur mundësi që të dërgohen në ueb-sajtin e ministrisë të gjitha ankesat dhe idetë.

Sa i përket planit, në veçanti planit zhvillimor të Brezovicës, nuk është bartëse ministria të cilin unë e udhëheq. Bartës i këtij projekti është Këshilli Ndërministror. U cek edhe më herët, janë parakualifikuar 4 konsorciume të ndryshme, të cilat kanë propozuar investime konkrete për një projekt të një madhësie të mesme, ose të lartë. Pra një projekt i cili nuk është vetëm për turizmin vendor, por i cili dedikohet turizmit ndërkombëtar, pra që pikërisht nga kjo zonë të krijohet një zonë turistike e karakterit ndërkombëtar, pra që të jetë zonë e vazhdueshme e investimeve.

Investimet do të jenë pjesë e asaj që diskutohet më vonë, mirëpo ajo që është paramenduar se do të jetë është ajo që e ceka edhe më herët, se u cek disa herë, afro 300 milionë euro. Vendet e punës janë diçka tjetër, edhe nëse janë kamerierë, janë vende të punës, edhe nëse janë kuzhinierë janë vende të punës. Jemi duke folur për turizëm.

Pra, Qeveria, edhe ky Kuvend, e ka dëshmuar edhe vitin e kaluar, edhe një vit më herët, se është e përkushtuar ta mbrojë mjedisin. Prej 25 000 hektarëve i kemi bërë 110 000 hektarë përafërsisht zona të mbrojtura edhe zonat tjera, si Ujëvarat e Mirushës, të cilat nuk përfshihen në këtë territor. Prandaj, nuk mendoj se ka hapësirë që të kritikohet qoftë

Qeveria, qoftë Kuvendi, se është duke vepruar diçka në dëm të mjedisit. Përkundrazi, mjedisi mbrohet aty ku ka edhe zhvillim, ku ka interes ekonomik.

Nëse dedikohet kjo zonë jo vetëm zonë e mbrojtur strikt, por edhe zonë e zhvillimit ekonomik, atëherë do ta kemi edhe bashkëpunimin e popullsisë vendore. Ashtu mendojmë të veprojmë edhe në zonën e Bjeshkëve të Nemuna, që për herë qëparë që për herë të parë ky Kuvend bashkë me këtë Qeveri e ka shpallur park nacional, ku mendojmë se po ashtu që ta mbajmë atë premtim, që ajo zonë do të zhvillohet ekonomikisht njësoj si zona e Brezovicës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk kemi qare, të them ashtu, pa ia filluar me këtë që po e thotë ministri - për shqyrtimin publik. Pra, edhe në letrat që janë dorëzuar si pjesë përbërëse e Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri” nga Ministria thuhet që ka pasur shqyrtim publik prej datës 7.8.2013 deri më 5.10.2013, siç e përmendi ministri. Por, askund nuk përmendet se sa dëgjime publike janë bërë për këtë çështje. Pas shqyrtimit publik, mund të jetë edhe një vendim, mund të them ashtu, një kërkesë, një thirrje që vendoset nga ministria në ueb-faqen e saj dhe pastaj presin rekomandime nga ata që e kanë parë ata, por nuk ka pasur asnjë tryezë, ose një format tjetër të dëgjimit publik për çështjen në fjalë, ku nuk ka pasur mundësi pra të marrin pjesë edhe shumë organizata, përfshirë Drejtorinë e Parkut Kombëtar “Sharri” dhe për t’i shprehur rekomandimet e veta. Kjo është çështja, nën një.

Çështja e dytë, në të njëjtën letër që është dërguar nga zoti Ilir Morina, kryeshef ekzekutiv i ministrisë, thuhet që kur shpjegohet se si është organizuar shqyrtimi publik, e kështu me radhë, e keni të gjithë deputetët aty, përmenden pastaj diku 6 rekomandime nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, të cilat janë marrë parasysht nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe, në fund, e kemi një paragraf, i cili thotë: Rekomandimet dhe komentet e pranuar nga OJQ “Ec Ma Ndryshe” nuk janë marrë parasysht për faktin se Komiteti Drejtues Ndërminstrior për Brezovicën i ka dhënë përparësi zhvillimit ekonomik të zonës.

Po çka na thotë kjo? Kjo na thotë dy gjëra, në njërin anë që nuk ka pasur kurrfarë kuptimi për të marrë pjesë në shqyrtimin publik, sepse edhe ashtu nuk do të merrej parasysht, përveç nëse jemi në vijë me vendimin e Komitetit Ndërminstrior për zhvillim ekonomik të zonës dhe, në anën tjetër, kjo na thotë që tashmë apriori Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtjes së Mjedisit e ka pranuar një vendim të Komitetit Drejtues Ndërminstrior që këtu do t’i jepet përparësi zhvillimit ekonomik, e jo mbrojtjes së mjedisit.

Dhe, rrjedhimisht, nuk kemi çka të flasim më për mbrojtjen e mjedisit, sepse zhvillimi ekonomik do të jetë ai që do ta prezantojë, por çka është këtu logjika? Logjika këtu është që tregu është i pa ndryshueshëm, besohet që prej natyrës presim që ai të ndryshojë për t’iu përshtatur tregut, që nënkupton natyra, që nënkupton shoqëria, që nënkupton njeriu.

Pra, ne duhet t'u përshtatemi kërkesave të tregut, e jo anasjelltas, që ta bëjmë ekonominë që të punojë për ne.

Çështja tjetër që ka të bëjë me fjalët që i dëgjova këtu nga disa deputetë, kryesisht ata që e mbrojnë këtë Plan Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, më duhet të them që shumica e asaj që dëgjova, nga shumica e deputetëve që e mbrojtën këtë plan, janë në fakt fjalët e përfaqësuesve të kompanisë ‘DELOIT’, që në këtë projekt paraqesin njëllë këshilltari të transaksionit për projektin dhe për procesin e parakualifikimit dhe pastaj procesin e tenderimit. Pra, nuk janë fjalët e deputetëve, por janë kryekëput fjalët e asaj që i thonë këshilltarët e transaksionit. Dhe, unë po e shfrytëzoj rastin t'u referohem dy dokumenteve që janë paraqitur nga këto që besoj se i kanë të gjithë deputetët, se më është thënë se u janë dorëzuar të gjithë deputetëve nga po të njëjtit.

Në njërin prej dokumenteve, pra në disa përgjigje që i kanë karshi konsorciumit të shoqërisë civile KOSID, që i kanë ngritur disa çështje sa i përket planit, thuhet që në kritikën që KOSID-i ia bën planit, thotë që në zonën A të projektit ‘Brezovica’ gjenden dy rezervarë të striktit në natyrës, ato veç i përmendi deputeti Hasani, që i tregoi edhe nëpërmjet fotografive, pra që quhen ‘Bisra’ dhe ‘Përroska e Dulës’, në përgjigjen që e jep këshilltari i transaksionit, ose dikush në emër të tyre, se për të qenë korrekt, ky dokument që na është dorëzuar nuk ka kurrfarë logoje, por nuk dihet se kush ka folur, thuhet që sipas këtij nenit të ligjit, por sipas nenit 3, paragrafi 2 të Ligjit për Parkun Kombëtar “Sharri”, që për caktimin e regjimit mbrojtës bëhet me Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, ndërsa veprimtaritë dhe aktivitetet zhvillohen sipas planit të menaxhimit dhe pastaj thuhet në përgjigje që, sipas këtij nenit të ligjit në fuqi, përcaktimi i regjimeve të mbrojtjes, duke përfshirë përcaktimin e zonave strikte të mbrojtura, bëhet me planin hapësinor, pra me këtë plan që po e diskutojmë ne sot.

Andaj, është e pamundur që projekti për zhvillimin e qendrës turistike ‘Brezovica’ të zhvillohet në zonat strikte të mbrojtura, pasi këto zona strikte veç nuk ekzistojnë. Pra, çka po thuhet këtu? Këtu po thuhet që meqenëse nuk është e sanksionuar me ligj, atëherë kjo natyrë, që duhet të mbrohet, nuk ekziston.

Pra, mendoj se Ministria për Mbrojtjen e Mjedisit të marrë masa që ato pak hapësira natyrore të Kosovës, që kanë pasuri natyrore, të mbrohen me ligj, këta e po na thonë që ato nuk ekzistojnë, sepse ligji nuk e thotë ashtu. Pra, natyra, prapë po e them, duhet t'i përshtatet asaj që sanksionohet me ligj, e jo ligji të bëhet për vendin, dhe këto mendoj se janë dy rrugëtime ose dy logjika goxha të rrezikshme që po duam t'i instalojmë në mënyrën se si funksionon shteti i Kosovës. Dhe, në dokumentin tjetër, i cili është i dorëzuar nga këshilltarët e transaksionit, në pikën 4, te çështjet dhe shqetësimet lidhur me planin hapësinor, pra në njërin prej këtyre pikave të fundme që i kanë përdorur këta, thuhet që në kuadër të kërkesave, pra të dokumenteve të tenderimit, do të jetë edhe futja e masave stimuluese për ta minimizuar ndikimin e mjedisit, duke shmangur për aq sa të jetë e mundur ndërtimin në zonat e ndjeshme mjedisore.

Nëse ofertuesi i kërkon këto zona, atëherë duhet të propozojë masa korrigjuese. Pra, këtu na tregon këshilltari i transaksionit që ky është i vetëdijshëm që ekzistojnë zona

mjedisore që duhet të mbrohen dhe po na thuhet që do të kërkojmë nga investitori që të mos i kërkojë ato, e nëse i kërkon ato, ne nuk kemi qare pa ia dhënë, mirëpo do të kërkojmë disa masa nga investitori tash...

Pra, po shihet se çfarë krimi po ndodh ndaj natyrës në këtë zonë, me këtë projekt të Qeverisë, dhe tërë kjo pastaj po na shitet sikur domosdo e zhvillimit ekonomik të vendit.

Ju lutem, zotërinj të nderuar deputetë, dhe ju zotërinj të nderuar ministra, zhvillimi ekonomik i vendit është pjesë dhe duhet të jetë në përputhje me mbrojtjen e mjedisit, sepse duhet ta keni parasysh një gjë: mjedisi është çështje dhe është pjesë përbërëse e lirisë së një shoqërie dhe pjesë përbërëse e mirëqenies të kësaj shoqërie. Pra, nëse degradohet mjedisi, ne as nuk mund ta quajmë veten më të lirë dhe as nuk mund ta gëzojmë një mirëqenie që po na servohet këtu nga Qeveria nëpërmjet një ‘baneri’ goxha të pakuptimtë të zhvillimit ekonomik.

Pra, zhvillim ekonomik, i cili na e degradon në njërën anë mjedisin dhe, në anën tjetër, një zhvillim ekonomik i cili është i përqendruar në shërbimet pa pasur kurrfarë prodhimi të vendit, as nuk është zhvillim ekonomik, as nuk ndikon në mirëqenien e qytetarëve dhe as nuk është i dobishëm për Kosovën. Pra, këtu po flitet shpeshherë shumë, por mendoj se spekulohet madje edhe qëllimshëm, dhe është degraduar ky termi në përgjithësi i investimeve të huaja në Kosovë, të cilat na qenkan të domosdoshme.

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jo secili investim do t’i shkojë për shtati Kosovës. Ta kemi parasysh këtë gjë. Pra, ka investime që mund ta shkatërrojnë vendin dhe ka investime natyrisht që do ta ndihmojnë vendin. Ne duhet ta kemi një vizion, një plan se ku duam të shkojmë ekonomikisht, e në bazë të kësaj duhet ta ndërtojmë pastaj ekonominë tonë dhe t’i kërkojmë investimet, qofshin ato të brendshme, apo të huaja.

Pra, investimet që i nevojiten Kosovës për ta zbutur papunësinë dhe për ta luftuar varfërinë dhe forcuar ekonominë, janë investime në prodhim, sepse parashohim se të gjitha këto investime që janë bërë deri tash në shërbime nuk është se i kanë ndihmuar shumë Kosovës. Pra, nga Qeveria e Kosovës na flitet dhe përflitet shumë për suksesin ekonomik të Kosovës, pse është hapur një ‘bont’ i huaj, zakonisht tash kohëve të fundit turke në vendin tonë, apo pse do të investohet në shfrytëzimin e kapaciteteve turistike të Kosovës, ndërkohë që asnjëherë dhe në asnjë moment nuk është marrë seriozisht çështja e zhvillimit të mirëfilltë ekonomik të vendit, që do të nënkuptonte rritje të prodhimit, përmirësim të bilancit tregtar të vendit dhe punësim të atyre punëtorëve, të cilët e kanë humbur vendin e punës, sepse fabrikat e tyre janë privatizuar.

Pra, të synojmë që ta zhvillojmë ekonominë nëpërmjet shërbimeve, e jo nëpërmjet prodhimit, është një grackë në të cilën kanë rënë shumë shtete që e quajnë veten në zhvillim dhe është një grackë e cila po i përgatitet edhe Kosovës përmes kësaj Qeverie.

Ne kemi thënë edhe nëpërmjet deputetit Topalli, por edhe më herët që ky plan hapësinor është i papranueshëm, sepse është një plan i cili e shkatërron mjedisin, i shkatërron edhe

ato pak resurse mjedisore që i ka Kosova dhe që do të duhej t'i mbronte, është në kundërshtim të plotë me çfarëdo logjike të funksionimit institucional të Kosovës, është në kundërshtim të plotë me kërkesat goxha strikte të mbrojtjes së natyrës nga Bashkimi Evropian dhe është në kundërshtim të plotë me interesin ekonomik, shoqëror dhe mjedisor të Kosovës.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem, predsedniče!

Nacionalni park Šar je prirodno bogatstvo naše zemlje koga trebamo svi mi zajedničkim snagama štititi, čuvati i negovati, pre svega mislim na insitucionalnu podršku Ministarstva za ambijent ali i lokalnu samoupravu određenih nadležnih opština.

Takođe rad na raznim projektima od strane međunarodnih i domaćih nevladinih organizacija u cilju zaštite životne sredine je za svaku vrstu pohvale.

Projekat za razvoj turističkog centra na Brezovici je od velikog nacionalnog interesa za opšti razvoj našeg kraja. Takođe sve što je Ministarstvo za ambijent u saradnji sa direktorom urbanizma u opštini Prizren uradio na teritoriji Prevalca je za svaku vrstu pohvale. Ali molim vas, ministre, obratite više pažnje oko bio diverziteta odnosno uništavanje flore i faune, ugrožavanje raznih zaštićenih bilnih i životinjskih vrsta, seče šume je i dalje veliki problem tog kraja.

Ono što je po meni prioritet, jeste zaštita izvora prirodnih voda Šar Planine što direktno ugrožava život stanovništva Župskog kraja tako da izražavam veliku zabrinutost zbog toga a kao poslanik koji dolazi iz tog kraja snosiću imoralnu odgovornost ako do toga dođe, pa vas molim da napravite komisiju eksperata u kojoj će biti odgovorne osobe za nadleganje kvaliteta pijaće vode kao preventivnu meru u budućnosti. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Më duket diskutimet janë kryer, edhe pse janë edhe dy deputetë që e kanë kërkuar fjalën. Nait, e ke fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Unë edhe një herë lus deputetët veç ta dëgjojnë konfirmimin e ministres që e ka shkruar më 6 shkurt për t'i ndërruar këto zona, duke dalë ministrja eksperte e natyrës dhe fushave të natyrës dhe përfaqësuesin e një kompanie të Agjencisë që thotë- klasifikimi i këtyre zonave si zonë e tretë brenda parkut kombëtar, do lehtësonte implementimin e projektit Brezovica.

Mendojnë që është një fushë që mund të mbrohet si të duan ata. Unë, për dijeninë e ministrit e të deputetëve e kam edhe petitionin që e ka bërë Drejtoria e parkut që asnjëherë nuk janë thirrur, por janë dëgjuar me këta, por unë do të them që ky Kuvend ka miratuar konventa evropiane për mbrojtjen e natyrës, mbrojtjen e pyjeve, mbrojtjen e parqeve. Prandaj ky Kuvend ka miratuar direktiva evropiane dhe sot ato direktiva

evropiane ky Kuvend i thyen, po kuvendet e shteteve evropiane këto direktiva i mbrojnë, ne i thejme.

Unë e kam një konkluzion këtu që e kanë pru përfaqësuesit e parkut, të cilët janë njerëzit kryesor që e mbrojnë atë pjesë dhe kërkojnë që pjesa ku është zonë e parë të mbetet zonë e parë dhe plani 'Brezovica' të bartet në kodrën tjetër ku është kodër e zhveshur, sepse kjo është një kodër, një mal ose një pyll i natyrës që është për tërë vitin i gjelbër, prandaj e ka biodiversitetin dhe vlerat e saj.

Në konkluzionet e tyre kërkohet që mos të miratohet ky ndërrim i planit, i zonimit nga zona e parë në zonën e tretë, sepse është shkelje e të gjitha direktivave dhe shkelje e gjithë pasurisë së Kosovës në atë pjesë.

Unë mund t'i lexoj edhe një herë të gjitha këto, po në komision edhe një herë e them se nuk është shqyrtuar plani hapësinor për "Sharrin", vetëm që është kërkuar të votohet dhe në Kuvend të debatohet, nuk ka pasur kurrfarë hapësire, prandaj unë kam votuar kundër planit pikërisht sepse nuk është shqyrtuar, është votuar me shumicë po megjithatë unë jam vetëm, por megjithatë vetëm do të qëndroj, sepse edhe nëpër çeli të burgut kam qëndruar vetëm.

KRYETARI: Po i njoftoj disa që po reagojnë se kryetari i komisionit ka të drejtë të flasë edhe në emër të komisionit edhe në emër të vetin, kështu që të mos ju vjen zor. Një herë ka folur në emër të komisionit dhe herën e dytë ka folur në emër të vetin dhe ka të drejtë të flasë në emër të vetin.

Shikoni Rregulloren, ajo i rregullon do sende. Mirë, po shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 47 vota për, 12 kundër dhe 10 abstenime, Kuvendi e miratoi Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri".

Vazhdojmë me pikën e radhës:

9. Emërimi i një anëtar në Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit i ka propozuar dy kandidatë për votim.

Ftoj kryetaren e Komisionit ad hoc, deputeten Xhevahire Izmaqu, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë rekomandimin.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit!

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, në bazë të neneve 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit si dhe të nenit 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2014, pas shqyrtimit të biografive dhe

intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit me votim të fshehtë. Për një pozitë të anëtarit të Bordit nga radhët e komunitetit serb, propozohen për votim dy kandidatë, si në vijim:

1. Aleksandar Janiçeviq dhe
2. Milena Gjeriq.

Kuvendi bën përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të RTK-së nga dy të propozuar. Anëtari i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës emërohet me mandat trevjeçar.

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, pas intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit ia propozon Kuvendit emërimin e një anëtari të Bordit nga radhët e komunitetit serb.

Anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të nenit 16 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.

Mandati i anëtarëve të Bordit të RTK-së, në bazë të nenit 26, paragrafi 3 është i shkallëzuar dhe vlen kur një bord formohet për herë të parë.

Kuvendi i Kosovës, më 30 gusht 2012, 30 janar, 2 maj dhe 15 nëntor 2013, në bazë të nenit 26, paragrafi 5, ka emëruar 10 anëtarë të Bordit të RTK-së me mandat trevjeçar. Faleminderit!

KRYETARI: Ju njoftoj se në pajtim me nenin 26 të Ligjit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, Kuvendi duhet të bëjë zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb nga dy të propozuar me votim të fshehtë, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.

Radha është që t’i emërtoni anëtarët e Komisionit votues. Ftoj kryetarin e Grupit të Partisë Demokratike që ta nominojë një kandidat.

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i PDK-së e propozon Xhevahire Izmakun.

KRYETARI: Lidhja Demokratike, Arben Gashi!

ARBEN GASHI: LDK e propozon Afërdita Shaqiri-Berisha.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi i “Vetëvendosjes”, Visar!

VISAR YMERI: “Vetëvendosje” e propozon deputeten Albana Gashi.

KRYETARI: Grupi i Aleancës, Donika!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Deputeten Teuta Haxhiu.

KRYETARI: Koalicioni për Kosovë të Re, Myzejene.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Ne e propozojmë zotin Jeton Svircën.

KRYETARI: SLS-ja, Jelena Bontiq!

JELENA BONTIĆ: U ime Parlamentarne grupe SLS, Jasmina Živković.

KRYETARI: Faleminderit! “6+”, Mufera Shinik!

MUFERA SHINIK: Kryetar, ne po e propozojmë Rasim Demirin, veç s’kemi çka të bëjmë, ai ka dalë.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, propozoje dikë që është këtu.

MUFERA SHINIK: Po vetëm unë jam këtu.

KRYETARI: Atëherë, propozojeni veten.

MUFERA SHINIK: U bë, s’ka problem.

KRYETARI: Atëherë, le të jetë deputetja, kryetarja e Grupit, Mufera Shinik. Vazhdojmë, apo duhet të presim pak?

(Ndërprerje e incizimit)

Vazhdojmë:

Adem Grabovci, Afërdita Shaqiri-Berisha, Afrim Hoti, s’është këtu, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Suzan Novobërdaliu, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Syla, Bahri Thaçi, Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi,

Hykmete Bajrami - ka votuar më duket, Emin Gërbeshi, Haxhi Shala, Xhavit Uka, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi, Jasmina Zhivkoviç,

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi; Faton Topalli, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Hatim Baxhaku, Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Mursel Halili, Nazane Breca, Kymete Bytyçi, Sasha Milosavleviq, Petar Miletiq, Rada Trajkoviç, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Xhafer Tahiri, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Xhafer Tahiri, Salih Morina, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanoviç, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todoroviç, Sreten Ivanoviç, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Valbona Dibra, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaçu, Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti.

(Ndërprerje më e gjatë)

Fjalën e ka kryetarja e Komisioni ad hoc, Xhevahire Izmaçu.

Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Milena Gjeriq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Milena Gjeriq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Milena Gjeriq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, E pavlefshme, Aleksandar Janiçeviq, E pavlefshme, E pavlefshme, Aleksandar Janiçeviq, E pavlefshme, Milena Gjeriq, Milena Gjeriq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Milena Gjeriq, Aleksandar Janiçeviq, Milena Gjeriq, Milena Gjeriq, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Milena Gjeriq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, E pavlefshme, Milena Gjeriq, Milena Gjeriq, E pavlefshme, Aleksandar Janiçeviq, Milena Gjeriq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Aleksandar Janiçeviq, Milena Gjeriq, Milena Gjeriq, E pavlefshme, Milena Gjeriq, E pavlefshme, Aleksandar Janiçeviq, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme.

(Ndërprerje më e gjatë)

KRYESUESI: Zotërinj deputetë, Komisioni e paraqet raportin.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit, për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit serb, në mbledhjen plenare të mbajtur më 11 shkurt 2014, konstaton si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 84 deputetë.

Të pavlefshme kanë qenë 19 fletëvotime.

Vota të fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

1. Aleksandar Janiçeviq ka fituar 50 vota.

2. Milena Gjeric ka fituar 15 vota.

Dhe, në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 26 të Ligjit numër 04/L-46 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se Aleksandar Janiçeviq zgjidhet anëtar i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, me mandat 3-vjeçar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete! Në bazë të raportit të Komisionit votues konstatohet se për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit serb u zgjodh Aleksandar Janiçeviq.

Zotërinj dhe zonja deputete, tani e kemi pikën:

2. Koha për pyetje parlamentare

Një rubrikë, të cilën e kemi vënë vetë në fund të rendit të ditës, unë dua t'ju njoftoj për sa vijon.

Këtu e kemi ministrin Ferid Agani, të cilit i drejtohen tri pyetje, një nga Alma Lama, një nga Xhevahire Izmaaku dhe një nga Rita Hajzeraj-Beqaj.

Unë e thërras Xhevahire Izmakun që të bëjë pyetjen.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Faleminderit ministër për praninë,

Sipas statistikave të Policisë së Kosovës, që nga viti 2001 deri në vitin 2013 në Kosovë, 731 persona kanë bërë vetëvrasje dhe 2 485 të tjerë kanë bërë tentim vetëvrasjeje.

Shqetësues është fakti se mosha mesatare e këtyre personave ka qenë prej 18 deri 40-vjeçare, ndërkaq shkaqet dhe motivet e këtyre akteve mbeten të ndryshme.

Sipas disa informacioneve të marra, këto fenomene janë shumë më të përhapura në vendet që kalojnë luftëra, por kjo nuk duhet të shikohet me indiferencë në një vend si i ynë që nuk ka edhe numër shumë të madh të banorëve.

Nga këta numra janë gjithsej 45 ish-ushtarë të UÇK-së, të cilët gjenden në këtë listë.

Po ashtu, fenomen që më parë nuk ka ndodhur, janë edhe rasti i dhjetëra fëmijëve nga paslufta që kanë kryer akte vetëvrasjeje.

I nderuar ministër,

Pyetja ime është: A është dashur që Ministria përkatëse të nxjerrë një propozim për një strategji kombëtare e cila do të parandalonte këtë fenomen të keq dhe të ri i cili nuk përkon as me traditat tona tradicionale? Faleminderit, ministër!

KRYESUESI: Zoti ministër Agani, urdhëroni!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

E nderuar zonja deputete,

Vetëvrasja në vetvete besoj se është fakt i njohur, nuk është sëmundje e as domosdoshmërisht nuk është manifestim i ndonjë sëmundjeje edhe pse në shumicën e madhe të rasteve bëhet fjalë për çrregullime ose sëmundje psikiatrike në themel të saj.

Është një problem serioz i shëndetit publik që kërkon vëmendje të gjithëve dhe për derisa çrregullimet mendore, pra siç thashë , konsiderohen se janë ndër faktorët kryesorë që i kontribuojnë vetëvrasjes, megjithatë për shkak të kompleksitetit të kësaj dukurie, të këtij fenomeni të ndërlidhur me shumë faktorë socialë, kulturorë, ekonomikë, në disa shtete edhe politikë, kërkohet një qasje multidisiplinare dhe ndërsektoriale.

Ky problem asnjëherë nuk ka qenë dhe në asnjë shtet nuk është problem ekskluziv i Ministrisë së Shëndetësisë, është çështje e cila duhet trajtuar siç thashë në mënyrë ndërsektoriale dhe kjo është bërë edhe në Kosovë.

Edhe në kohën para se të jem ministër, e dini se jam edhe ekspert i lëmit të psikiatrisë, jemi marrë me këtë problem në mënyrë intensive që nga ditët e para të pasluftës dhe qysh në vitin 2009 Qeveria e Kosovës e ka iniciuar një proces për përpilimin e strategjisë kombëtare shtetërore për parandalimin e vetëvrasjeve në Kosovë.

Në vitin 2009 Qeveria e Republikës së Kosovës ka organizuar Konferencën ndërkombëtare shkencore, e cila i ka mbledhur në Prishtinë ekspertët më të njohur ndërkombëtarë dhe edhe vetë kam qenë pjesëmarrës në atë konferencë dhe kam prezantuar, në të cilën janë trajtuar të gjitha modalitetet relevante për Kosovën dhe janë vu themelet e një dokumenti strategjik se si t'i qasemi kësaj problematike.

Në ndërkohë, puna në këtë strategji e cila ka filluar nën mbikëqyrjen e Zyrës për Qeverisje të Mirë të Kabinetit të Kryeministrit, është ndërprerë për shkaqe të cilat për mua nuk kanë qenë të njohura.

Pas marrjes së mandatit është riaktivizuar kjo çështje dhe Zyra e kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë është duke e koordinuar aktualisht procesin e hartimit të strategjisë për

parandalimin e vetëvrasjeve dhe vetë dëmtimeve në Kosovë dhe tani është duke u shkruar drafti i dytë i kësaj strategjie dhe atë në bashkëpunim me ekspertët e kësaj lomie nga Italia dhe ne shpresojmë se kjo strategji të finalizohet deri në fund të këtij viti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Deputete, ke pyetje shtesë? Xhevahire Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Faleminderit ministër!

Pikërisht se ju e keni këtë profesion si neuropsikiatër dhe pyetja ime është adresuar më me dëshirë, ndërsa pyetja ime e dytë shkon për çështjen e cila do të diskutohet, pra Projektligjin që do të diskutohet të enjten, a do të ketë ndonjë element i cili me të vërtetë ka për ta rregulluar me çështjen e Projektligjit të shëndetit mendor këtë fenomen i cili besoj se për të gjithë është shqetësues, posaçërisht për mua ka qenë shqetësues çështja e vetëvrasjeve të disa fëmijëve. Këtu nuk kam arritur ta kuptoj personalisht, domethënë për çfarë arsye. Thjesht , a do të ketë në këtë projektligj diçka pasi nuk është sektori im, unë këtë nuk e di. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Natyrisht se Projektligji për shëndetin mendor merret me rregullimin e problematikës e cila ka të bëjë me shërbimet shëndetësore në lëmin specifik të shëndetit mendor ku nëpërmjet zhvillimit dhe rregullimit të zhvillimit të kapaciteteve njerëzore, infrastrukturore, rregullimit të marrëdhënieve të ndërsjella dhe krijimit të kushteve për punë kualitative në lëmin e shëndetit mendor do të ndikohet edhe në mënyrë indirekte edhe në parandalimin e dukurisë së vetëvrasjeve dhe natyrisht trajtimit të situatave dhe rasteve që kanë të bëjnë me tentimet e vetëvrasjes.

Dua të theksoj se kjo dukuri e cila paraqet me të vërtetë një brengë të madhe është cilësuar si një kërcënim në rritje i shoqërisë tonë, duke pasur parasysh edhe strukturën specifike demografike të popullatës. Që nga vitet e '70-ta Kosova ka qenë me shkallën më të ulët të vetëvrasjeve në Evropë dhe vazhdojmë të jemi në fund të kësaj liste, mirëpo me trefishim të numrit në krahasim me periudhën e para luftës. Dhe për këtë arsye edhe projektligji ose Ligji kur të miratohet për shëndetin mendor do të jetë ligj i cili me siguri se do të shfrytëzojë, do t'i mobilizojë të gjitha resurset në këtë drejtim, por ajo që mendoj se është shumë me rëndësi të theksohet në këtë rast është që nevojitet që në kuadër të masave parandaluese për dukurinë e vetëvrasjeve, veçanërisht në mesin e rinisë tonë të fuqizohet komponenti edukativ në shkollat tona.

Mendoj se zbehja e këtij komponenti edukativ ka ndikuar në atë që tek të rinjtë të zbehen edhe fuqitë përballuese të tyre ndaj sfidave të jetës dhe në situatat me ansuzitet të shtuar ata nuk gjejnë përgjigje të duhura. Dhe mendoj se strategjia e cila është duke u punuar do të japë edhe përgjigjet e duhura në këtë dhe në bashkëpunim me Ligjin për shëndetin mendor do të krijojë një mjedis më të përshtatshëm për ballafaqimin më serioz dhe më të koordinuar me këtë dukuri kërcënuese.

KRYESUESI: Faleminderit zoti ministër! Deputeti Xhafer Tahiri, ka pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. E do fjalën, deputet? A do ta lexosh pyetjen? Xhafer Tahiri e ka fjalën.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Dy pyetjet e mia janë të ndërlidhura njëra me tjetrën, dhe pyetja tjetër e radhës është për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa kjo pyetje është për kryeministrin dhe kanë të bëjnë me një temë jashtëzakonisht të rëndësishme për këtë vend që është varfëria dhe sidomos varfëria tek të rinjtë dhe te gratë dhe unë pyetjen time do ta lexoj në seancën tjetër dhe pres që kryeministri dhe ministri të jenë prezentë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet! Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri ka pyetje për ministrin Dardan Gashi. Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, nënkryetar!

Ministri më është përgjigjur me shkrim, kështu që nuk kam nevojë ta bëj pyetjen.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputeti Halit Krasniqi ka pyetje për ministrin Agim Çeku. Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Unë kohë të gjatë e kam shtruar këtë pyetje, por derisa i ka ardhur radha dhe është mjaft materie sensitive dhe preokupim jashtëzakonisht i ndjeshëm për çështjen e statusit të pjesëtarëve të veteranëve, të invalidëve, të pjesëtarëve dhe të internuarve të UÇK-së, doemos e paraqet të nevojshme prezencën e ministrit për të dhënë një përgjigje dhe për të bërë një informacion, kështu që e kisha bartur për seancën e ardhshme.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Krasniqi! Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Kymete Bytyçi, do ta bësh pyetjen, ministri s'është këtu? E ka fjalën Kymete Bytyçi.

KYMETE BYTYÇI: Kryesues, unë pasi nuk është ministri këtu do ta lë pyetjen për seancën e ardhshme.

KRYESUESI: Halit, prapë ke pyetje. Halit Krasniqi për Fadil Ismajlin, që s'është këtu. A do ta bësh pyetjen?

HALIT KRASNIQI: Edhe preokupimi im për problematikat që i kam përmbledhur në pyetjen parlamentare për ministrin Fadil Ismajli, është e natyrës së ndjeshme të qytetarëve dhe e kisha bartur, sepse është e domosdoshme prania e ministrit.

KRYESUESI: Mirë, të ndjeshme janë të gjitha Halit, po ti s'po do ta bësh pyetjen, në rregull është. Deputetja Alma Lama, pyetje për Bajram Rexhepin. Nuk është deputetja.

Deputetja Alma Lama pyetje për ministrin Ferid Agani. Nuk është deputetja. Ministri Agani është këtu i vetmi. Përgëzime zoti ministër që je këtu!

Deputetja Xhevahire Izmaku, pyetje për ministrin Rexhepi. Zonja deputete, do ta bësh pyetjen? Xhevahire Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Po ashtu do ta lë edhe unë për seancën kur do të jetë i pranishëm ministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj, pyetje për ministrin Agani. Nuk është deputetja këtu. Ministri është këtu. Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj pyetje për ministrin Rashiq. As nuk është ministri, as nuk është deputetja. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Mungesa e Qeverisë, sidomos në kohën e pyetjeve parlamentare tregon që kjo Qeveri është e pa përgjegjshme dhe sa më shpejt që të jetë e mundur duhet të shkojë.

Sidoqoftë, unë po e bëj pyetjen, edhe pse në kohën kur e kam parashtruar, pra me datën 4 prill ka qenë pyetja për ministrin se cilat janë masat që i kanë ndërmarrë si Qeveri për parandalimin e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, mirëpo tash kemi deklarata publike të kryeministrit edhe zëvendësit të tij që këto zgjedhje, pra do t'i organizojë OSBE-a.

Dhe pyetja pra është se me çfarë baze ligjore kanë lejuar që OSBE-a ta bëjë organizimin e këtyre zgjedhjeve dhe a ka ndonjë vendim të Qeverisë në lidhje me këtë çështje? Arsyetimin që e kemi dëgjuar është e drejta e dyshtetësisë, mirëpo kjo Qeveri përveç se po e shkel sovranitetin e vendit edhe po tenton që t'u hedhë sy qytetarëve, pra t'i mashtrojë qytetarët në emër të drejtës së dyshtetësisë, pasi që është e ditur se e drejta e dyshtetësisë realizohet në kohën kur ka një njohje reciproke ndërmjet shteteve dhe e drejta e votimit realizohet përmes postës ose ambasadave dhe konsullatave. Dhe, është pra cenim i sovranitetit dhe integritetit territorial vendimi i Qeverisë për organizimin e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë e për këtë duhet të japim përgjegjësi edhe penale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po kjo ishte koment, nuk ishte pyetje. Të jemi korrektë. Kaq! Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. A do ta bësh pyetjen? Deputetja s'do ta bëjë pyetjen pa praninë e ministrit Bajram Rexhepi.

Kolegë dhe kolege, të nderuara, me kaq mbaron kjo seancë e Kuvendit. Mirupafshim në seancën e ardhshme! Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*